

RAPORTI I GJENDJES NË MJEDIS

2024

Pyjet dhe Biodiversiteti

Zhurmat

Ujërat

Mjedi Detar

TIRANË,
ALBANIA

Toka

Kimikatet

Ajri



Ky material është përgatitur për botim në kuadër të projektit “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme” i bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ), dhe zbatuar nga GIZ Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe në asnjë mënyrë nuk reflekton pikëpamjet e BE apo BMZ.

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS

2024

Përgatitur dhe publikuar nga:
Agjencia Kombëtare e Mjedisit

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	25
REFERENCA ME VITIN 2023	26
MESAZHET E RGJM 2024.....	28
GJETJET KRYESORE	29
VLERËSIMI SOCIAL-EKONOMIK.....	32
KAPITULLI 1 - CILËSIA E UJËRAVE.....	35
1.1. Burimi i të dhënave	35
1.2. Rëndësia	35
1.3. Kontribuesit kryesorë dhe ndikimi në mjedis.....	36
1.4. Forcat Shtytëse Dhe Presionet.....	40
1.5 Vlerësimi për cilësinë e ujërave sipërfaqësore	52
1.5.1. Cilësia e ujërave për parametrat fiziko-kimik	52
1.5.2 Radioaktiviteti në ujëra	111
1.5.3 Prurjet në lumenj	116
1.5.4 Ujërat nëntokësore.....	127
1.6 Rekomandime	132
KAPITULLI 2 - AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE	135
2.1 Burimi i të dhënave.....	135
2.2 Rëndësia për mjedisin dhe njerëzit.	135
2.3 Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis/ shëndet	135

2.4 Standartet e cilësisë së ajrit.....	138
2.5 Vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit.....	139
2.5.1 Rrjeti i monitorimit	139
2.5.2 Vlerësimi i cilësisë së ajrit sipas parametrave.....	140
2.5.3 Përfundime dhe Rekomandime	154
2.6 Ndryshimet Klimatike	156
2.6.1 Tendencat historike të emetimeve të GES dhe masat zbutëse.....	156
2.6.2 Skenarët sipas Sektorëve.....	156
2.6.3 Ndryshueshmëria e klimës dhe ndryshimet klimatike .	162
2.6.4 Rreziqet, ndikimet dhe cënueshmëria nga ndryshimet klimatike	163
KAPITULLI 3 ZHURMAT.....	174
3.1 Burimi i të dhënave.....	174
3.2 Rëndësia.....	174
3.3 Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis/shëndet	174
3.4 Standartet për zhurmat.....	175
3.5 Vlerësimi i gjendjes së zhurmave mjedisore	176
3.6 Rekomandime	201
KAPITULLI 4 MJEDISI BREGDETAR	202
4.1 Burimi i të dhënave.....	202
4.2 Kontribuesit e ndotjes, presioni dhe ndikimi në mjedis/ shëndet	202

4.3	Cilësia e ujërave bregdetare	204
4.3.1	Vlerësimi mikrobiologjik	204
4.3.2	Cilësia e ujërave bregdetare për parametrat fiziko-kimik.	244
4.3.3	Ndikimi i shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare.....	247
4.3.4	Lagunat.....	254
4.3.5	Sipërfaqet e shfrytëzuara të plazheve	263
4.3.6	Dinamika e vijës bregore të deteve Jon dhe Adriatik...	268
4.3.7	Gjendja e dinamikës së deltave të lumenjve.....	271
4.4	Përfundime.....	273
4.5	Rekomandime	275
KAPITULLI 5 TOKAT		277
5.1	Burimi i të dhënave.....	277
5.2	Rëndësia.....	277
5.3	Kontribuesit e ndotjes, presioni dhe ndikimi në mjedis/shëndet.....	278
5.4	Vlerësimi i gjendjes.....	280
5.4.1.	Vlerësimi për stacionet e monitorimit.....	281
5.5	Vlerësim përmbledhës	296
5.6	Konkluzione.....	299
KAPITULLI 6 MBETJET		300
6.1	Burimi i të dhënave.....	300

6.2 Rëndësia.....	300
6.3 Kontribuesit kryesor, presionet dhe ndikimi në mjedis/shëndet.....	301
6.4 Vlerësimi i gjendjes.....	301
6.4.1 Treguesit e ekonomisë qarkulluese.....	301
6.4.2 Mbetjet Bashkiake	314
6.4.3 Mbetjet industriale	325
6.4.4 Mbetjet nga bujqësia	326
6.4.5 Mbetjet spitalore	328
6.4.6 Mbetjet detare	334
6.5 Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI).....	337
6.5.1 Përmbledhje e Treguesve të Performancës për vitin 2024	338
6.5.2 Performuesit më të mirë në vitin 2024	338
6.5.3 Sektorët me shqetësim të lartë.....	338
6.5.4 Bashki me përpjekje për ndarje dhe trajtim në burim	339
6.6 Rekomandimet kryesore për përmirësim.....	340
6.7 Progresi mbi Rekomandimet e vitit 2024 dhe Rekomandime të reja për vitin 2025 në Kapitullin për Mbetjet	342
KAPITULLI 7 PYJET E BIODIVERSITETIT	345
7.1. Burimi i të dhënave.....	345
7.2. Rëndësia.....	345
7.3. Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis/shëndet	346

7.4 Standartet e besueshmerisë.....	346
7.5 Vlerësimi i gjendjes për pyjet	347
7.5.1 Gjendja e shëndetit dhe vitalitetit në pyjet e vendit tonë.	347
7.5.2. Llojet drunore dhe bimët aromatiko mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje	367
7.5.3. Mirëmbajtja, Konservimi dhe Përmirësimi i Diversitetit Biologjik të Ekosistemeve Pyjore në habitatin e dushk dhe gështenjë	373
7.5.4. Treguesit e fondit pyjor, kullosor dhe bimët aromatike mjekësore.....	374
7.6 Vlerësimi për biodiversitetin.....	392
7.6.1. Llojet invazive	393
7.6.2. Biodiversiteti detar dhe bregdetar	394
7.6.3 Fauna bregdetare dhe detare.....	395
7.6.4. Veçoritë e biodiversitetit:	396
7.6.5. Kuadri ligjor dhe i politikave	397
7.7 Rekomandime	399
KAPITULLI 8 ZONAT E MBROJTURA	402
8.1 Burimi i të dhënave.....	402
8.2 Rëndësia.....	402
8.3 Kontribuesit e ndotjes dhe kërcënimet ndaj zonave të mbrojtura	403
8.4 Vlerësimi i gjendjes	403

8.4.1. Zonat e mbrojtura	403
8.4.2 Monumentet e natyrës	408
8.4.3 Biodiversiteti në zonat e mbrojtura.....	411
8.5 Përfundime.....	415
8.6 Rekomandime	416
KAPITULLI 9 MJEDISI DHE SEKTORËT EKONOMIK.....	417
9.1 Mjedisi dhe Industria	417
9.1.1 Vetmonitorimet e aktiviteteve industriale	418
9.1.2 Aktivitetet që ushtrojnë subjektet sipas qarqeve	422
9.1.3 Lejet mjedisore dhe VNM.....	424
9.1.4 Inspektimet	425
9.1.5 Industria e shfrytëzimit të burimeve natyrore.....	428
9.1.6 Kontrolli dhe inspektimi për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të tyre për vitin 2024	430
9.1.7 Rekomandime.....	436
9.2 Mjedisi dhe Turizmi	436
9.2.1 Turizmi kulturor.....	437
9.2.2 Turizmi natyror	439
9.3 Mjedisi dhe Bujqësia	441
9.3.1 Sistemi i ushqimit.....	444
9.3.2 Impakti i bujqësisë në mjedis	447
9.4 Mjedisi dhe Transporti.....	449

9.4.1 Ndikimi i transportit në mjedis.....	450
9.4.2 Sistemi për lëvizshmërinë.....	451
9.4.3 Përfundime	453
9.5 Mjedisi dhe Energjia	454
9.5.1 Situata aktuale e energjisë	454
9.5.2 Ndikimi në mjedis	455
9.5.3 Skemë mbështetëse për burimet e rinovueshme të energjisë	456
9.5.4 Sfidat dhe Objektivat.....	457
9.5.5 Përfundime	457
9.6 Mjedisi dhe Inovacioni	458
9.7 Rekomandime	461
PËRMBLEDHJE	462
ANEKS 1 RRJETI I MONITORIMIT TË PYJEVE	472
Institucionet bashkëpunuese	480

Shkurtime

AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
AKSHI	Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit
ASHR	Autoriteti Rajonal Shëndetësor
AEM	Agjencia Europiane e Mjedisit
AKEM	Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BaU	Bussines as Usual (Punë si zakonisht)
BE	Bashkimi Evropian
BTEX	Benzen Toluen, Etilbenzen, meta-para Ksilen
DKU	Direktiva Kuadër e Ujit
EC	European Commision
EEA	European Environment Agency
ISHTI	Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial
IKPK	Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave
IFBZ	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
KE	Komisioni Evropian
KKBNK	Konventa e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
KKP	Kontributi Kombëtar i Përcaktuar
LM	Leje Mjedisore
NVM	Ndërmarrje të Vogla e të Mesme
NKO	Nevoja Kimike për Oksigjen
NBO5	Nevoja Biokimike për Oksigjen 5 ditore
NJQV	Njësi e Qeverisjes Vendore
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OKBZHI	Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development/Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

PV	Park Fotovoltaik
PP	Produkte plehëruese
PMB	Produkte per Mbrojtjen e Bimeve
PIPP	Proçeset Industriale dhe Përdorimi i Produkteve
PTNPTP	Përdorimi i Tokës dhe Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pyjet
PBB	Prodhim i Brendshëm Bruto
PK	Park Kombëtar
RGJM	Raport i Gjendjes në Mjedis
RNM	Rezervat Natyror i Mbrojtur
SIT	Sistemi i Inteligjences së Transportit Rrugor
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
UN	Ujëra Nëntokësore
UNEP	United Nations Environment Program/ Programi për Mjedisin i Kombeve të Bashkuara
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VNM	Vlerësim i Ndikimit në Mjedis
WHO	World Health Organization/Organizata Botërore e Shëndetësisë
ZAE	Zonat Agro - Ekologjike

Lista e Tabelave

Tabela 1 - Sasia e ujit në m ³ për vitin 2024.....	36
Tabela 2 - Përdorimi i burimeve ujore 2023-2024	38
Tabela 3 - Mbulimi me ujësjellës- kanalizime, 2024	41
Tabela 4 - Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN) në vitin 2024, UK Korçë	44
Tabela 5 - Vlerat limite të parametrave kimike në lumenj sipas DKU	53
Tabela 6 - Stacionet e monitorimit, Baseni i Matit.....	59
Tabela 7 - Stacionet e Basenit Ishëm - Erzen	64
Tabela 8 - Stacionet e Basenit të Shkumbinit.....	71
Tabela 9 - Pikat e monitorimit të Basenit të Vjosës	75
Tabela 10 - Pikat e monitorimit Baseni Seman	79
Tabela 11 - Cilësia e ujërave për Basenet 2018 - 2024	85
Tabela 12 - Vlerat limite të cilësisë së ujërave të liqeneve sipas DKU	88
Tabela 13 - Klasifikimi sipas parametrave Lumi Pogradec.....	95
Tabela 14 - Klasifikimi sipas parametrave Lumi Vërdovë.....	95
Tabela 15 - Klasifikimi sipas parametrave Lumi Pogradec.....	96
Tabela 16 - Krahësim për gjendjen e lumenjve 2018 - 2024.....	97
Tabela 17 - Ndryshimi i Statusit për Liqenet 2023 - 2024	100
Tabela 18 - Stacionet e monitorimit	111
Tabela 19 - Vlerat e radioaktivitetit alfa dhe beta total vjetore të kampioneve të marra në lumenj.....	114
Tabela 20 - Prurjet e lumenjve (m ³ /sek) në fazën e parë në vitet 2016-2024.....	124
Tabela 21 - Prurjet e lumenjve (m ³ /sek) në fazën e dytë në vitet 2016-2024	125
Tabela 22 - Normat për analizat kimike	128
Tabela 23 - Vlerat kufi të cilësisë së ajrit	138
Tabela 24 - Treguesit për stacionet	140
Tabela 25 - Rreziqet, ndikimet dhe cënueshmëria nga ndryshimet klimatike	163
Tabela 26 - Cënueshmëria e vendbanimeve dhe rreziqet që u kanosen	164
Tabela 27 - Cënueshmëria dhe rreziqet që i kanosen popullsisë dhe Turizmit	165
Tabela 28 - Vlerat mesatare të nivelit të zhurmave LAeq ditën dhe natën.....	177
Tabela 29 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Tiranës	188
Tabela 30 - Tendencat e zhurmave mjedisore 2019 -2024 për periudhën e ditës (dB)	199

Tabela 31 - Tendenca e zhurmave mjedisore 2019-2024 për periudhën e natës (dB)	199
Tabela 32 - Kategorizimi për cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes	205
Tabela 33 - Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2017-2024 (e shprehur sipas numrit të stacioneve dhe e shprehur në %)	244
Tabela 34 - Stacionet e monitorimit të zonave bregdetare	244
Tabela 35 - Stacionet e monitorimit për vitin 2024	248
Tabela 36 - Normat e shkarkimeve të lëngëta urbane	249
Tabela 37 - Tendenca të gjendjes trofike për lagunat	262
Tabela 38 - Plazhet sipas tipologjisë për çdo bashki, 2024	263
Tabela 39 - Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut) 2021-2024	268
Tabela 40 - Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut)	269
Tabela 41 - Vlerësim për mostrat në një thellësi	297
Tabela 42 - Vlerësimi për mostrat në dy thellësi	297
Tabela 43 - Vlerësimi për mostrat në tre thellësi	298
Tabela 44 - Treguesit e Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkulluese	302
Tabela 45 - Të dhënat të përgjithshme për mbetjet urbane dhe inerte të menaxhuara	315
Tabela 46 - Mbetjet sipas zonës së mbetjeve (2024)	320
Tabela 47 - Të dhëna për 10 bashkitë që kanë gjeneruar më shumë mbetje. (2024)	321
Tabela 48 - Bashkitë dhe zonat e mbetjeve që kanë menaxhuar me shume dhe me pak mbetje, 2024	322
Tabela 49 - Dhjetë bashkitë me gjenerimin më të lartë të mbetjeve për frymë në vit	323
Tabela 50 - Trendi i gjenerimit të mbetjeve urbane në Shqipëri gjatë periudhës 2020–2024	324
Tabela 51 - Raportimi vjetor nga AKU për sasinë e mbetjeve për vitin 2024	327
Tabela 52 - Mbetjet Shëndetësore sipas Ministrisë së Shëndetësisë	328
Tabela 53 - Rryma e mbetjeve, 2011 - 2021 - Skenari ideal	335
Tabela 54 - Shkalla e fenomeneve të gjendjes shëndetësore sipas klasave të vlerësimit	347
Tabela 55 - Dëmtuesit dhe sëmundjet e llojeve halorë dhe fletorë	354
Tabela 56 - Vlerësimi për llojet drunore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje.	367
Tabela 57 - Shpërndarja sipas mbulesës së tokës	374

Tabela 58 - Shpërndarja e pyjeve sipas pronësisë	374
Tabela 59 - Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumit në bazë të formës së qeverisjes.....	375
Tabela 60 - Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve bazuar në përbërjen llojore.	376
Tabela 61 - Shpërndarja e sipërfaqeve/zonave pyjore sipas tipit.....	377
Tabela 62 - Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës të trungishteve	378
Tabela 63 - Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës për pyjet cungishte.	379
Tabela 64 - Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve për klasat e moshës për shkurret.....	380
Tabela 65 - Rezultatet e rritjes mesatare në volum për tre format e qeverisjes	381
Tabela 66 - Sipërfaqja dhe vëllimi i pyjeve për sekuestrimin e karbonit	384
Tabela 67 - Mundësia vjetore e shfrytëzimit.	385
Tabela 68 - Fondi kullësor sipas pronësisë	386
Tabela 69 - Sipërfaqja e kullotave sipas tipit të kullotjes.	386
Tabela 70 - Sipërfaqja e kullotave sipas grupit të specieve bimore.....	387
Tabela 71 - Numri i zjarreve, sipërfaqet e përshkruara dhe të djegura pyje/kullota , 2024.....	388
Tabela 72 - Prodhimi i përgjithshëm bruto sipas inventarit dhe sasia e grumbulluar në vitin 2024	389
Tabela 73 - Llojet e bimeve medicinale dhe mjeksore me kryesoret që grumbullohen.	390
Tabela 74 - Numri total i llojeve të mbrojtura sipas kategorive	392
Tabela 75 - Rrjeti i Zonave Emerald për Shqipërinë.....	404
Tabela 76 - Kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe sipërfaqet respektive 2024	407
Tabela 77 - Monumentet e natyrës sipas VKM nr. 187, datë 25.03. 2021	409
Tabela 78 - Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetëmonitorimin për lejet e mjedisit A dhe për vitin 2024	419
Tabela 79 - Tendencat e numrit të subjekteve të cilat kanë realizuar vetëmonitorimin për lejet e mjedisit A dhe B.....	420
Tabela 80 - Shqyrtime për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, 2024.....	425
Tabela 81 - Dëgjesa me publikun, 2024.....	425
Tabela 82 - Lejet aktive të shfrytëzimit minerar, 2024	428

Tabela 83 - Subjektet që kanë nënshkruar Marreveshje Hidrokarbure me Shtetin Shqiptar	429
Tabela 84 - Numri i hidrocentraleve në prodhim, 2024	429
Tabela 85 - Numri i impianteve fotovoltaike të çertifikuara dhe në shfrytëzim	430
Tabela 86 - Numri i vizitorëve sipas llojit të udhëtimit.....	436
Tabela 87 - Vizitorët në institucionet e kulturës.....	437
Tabela 88 - Numri i vizitorëve në zonat e mbrojtura sipas qarqeve	439
Tabela 89 - Sipërfaqe me prodhime organike në tokë bujqësore, 2023.....	442
Tabela 90 - Prodhimet organike në tokat bujqësore 2023	442
Tabela 91 - Produkte organike të egra, 2019 – 2023	443
Tabela 92 - Automjete elektrike dhe hibride	453
Tabela 93 - Ndërmarrjet aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomikë dhe madhësisë së ndërmarrjes(%)	459

Lista e Figurave

Figura 1 - Forcat Shtytëse dhe Presionet.....	41
Figura 2 - Stacionet e monitorimit të ujërave të lumenjve	53
Figura 3 - Oksigjeni i tretur	54
Figura 4 - Nevoja Biokimike për Oksigjen	55
Figura 5 - Përmbajtja e amonjakut	56
Figura 6 - Përmbajtja e nitriteve	57
Figura 7 - Përmbajtja e nitrateve	57
Figura 8 - Përmbajtja e ortofosfatit	58
Figura 9 - Përmbajtja e fosforit total	58
Figura 10 - Oksigjeni i tretur	60
Figura 11 - Nevoja Biokimike për oksigjen	60
Figura 12 - Përmbajtja e amonjakut	61
Figura 13 - Përmbajtja e nitrateve	62
Figura 14 - Përmbajtja e ortofosfatit	63
Figura 15 - Përmbajtja e fosforit total	64
Figura 17 - Nevoja Biokimike për Oksigjen	66
Figura 16 - Oksigjeni i tretur	66
Figura 18 - Përmbajtja e amoniakut	67
Figura 19 - Përmbajtja e nitriteve.....	68
Figura 20 - Përmbajtja e nitrateve	69
Figura 21 - Përmbajtja e ortofosfatit	69
Figura 22 - Baseni i Shkumbinit, Oksigjeni i tretur.....	71
Figura 23 – Baseni i Shkumbinit, Nevoja Biokimike për Oksigjen	72
Figura 24 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e amoniakut.....	72
Figura 25 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e nitrateve.....	73
Figura 26 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e nitrateve.....	73
Figura 27 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e fosforit total	74
Figura 28 - Baseni i Vjosës, Oksigjeni i tretur	75
Figura 29 - Baseni i Vjosës, Përmbajtja e amoniakut.....	76
Figura 30 - Baseni i Vjosës, Përmbajtja e nitriteve	76
Figura 31 - Baseni i Vjosës, përmbajtja e nitrateve.....	77
Figura 32 - Baseni i Vjosës, përmbajtja e ortofosfatit	78
Figura 33 - Baseni i Vjosës, përmbajtja e fosforit total.....	78
Figura 34 - Baseni i Semanit, Oksigjeni i tretur	80
Figura 35 - Baseni i Semanit, Nevoja Biokimike për Oksigjen.....	80

Figura 36 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e amoniakut	81
Figura 37 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e nitriteve	82
Figura 38 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e nitrateve	82
Figura 39 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e nitrateve	83
Figura 40 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e fosforit total	83
Figura 41 - Monitorimi i Ujërave të Liqeneve	86
Figura 42 - Harta e monitorimit të lumenjve	87
Figura 43 - Liqeni i Shkodrës, Transparenca	89
Figura 44 - Liqeni i Shkodrës, Nevoja kimike për oksigjen.....	89
Figura 45 - Liqeni i Shkodrës, Nevoja biokimike për oksigjen.....	90
Figura 46 - Liqeni i Shkodrës, Përmbajtja e nitrateve	90
Figura 47 - Liqeni i Shkodrës, Përmbajtja e fosforit total	91
Figura 48 - Liqeni i Ohrit, Transparenca.....	92
Figura 49 - Liqeni i Ohrit, Nevoja Kimike për Oksigjen.....	92
Figura 50 - Liqeni i Ohrit, Nevoja Biokimike për Oksigjen.....	93
Figura 51 - Liqeni i Ohrit, Përmbajtja e nitrateve	93
Figura 52 - Liqeni i Ohrit, Përmbajtja e Fosforit total.....	94
Figura 53 - Liqeni i Prespës, Transparenca	98
Figura 54 - Liqeni i Prespës, Nevoja Kimike për Oksigjen.....	98
Figura 55 - Liqeni i Prespës, Nevoja Biokimike për Oksigjen.....	99
Figura 56 - Liqeni i Prespës, Përmbajtja e Nitrateve.....	99
Figura 57 - Liqeni i Prespës, Përmbajtja e fosforit total.....	100
Figura 58 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Fierzës për treguesit klorofil-a.	103
Figura 59 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Fierzës për treguesin turbulence.....	104
Figura 60 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Fierzës për treguesin sediment.....	104
Figura 61 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Vau i Dejës për treguesit klorofil-a.....	105
Figura 62 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Vau i Dejës për treguesin turbulence.....	105
Figure 63 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Vau i Dejës për treguesin sediment.....	106
Figura 64 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Komanit për treguesin klorofil.....	106

Figura 65 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Koman për treguesin turbulence.....	107
Figura 66 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Koman për treguesin sediment.....	107
Figura 67 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Ulzës për treguesin klorofil-a.....	108
Figura 68 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Ulzës për treguesin turbulence.....	108
Figura 69 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Ulzës për treguesin sediment.....	109
Figura 70 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Bulqizës për treguesin klorofil-a.....	109
Figura 71 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Bulqizës për treguesin turbulence.....	110
Figura 72 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Bulqizës për treguesin sediment.....	110
Figura 73 - Aktiviteti alfa total, mesatare vjetore mBq/L.....	115
Figura 74 - Aktiviteti Beta total, mesatare vjetore mBq/L.....	115
Figura 75 - Harta e rrjetit lumor të Shqipërisë.....	116
Figura 76 - Harta e Baseneve Ujëmbledhës të Shqipërisë.....	117
Figura 77 - Prurja e lumenjve m3/sek për vitin 2024.....	119
Figura 78 - Harta e pikave të monitorimit hidrokimik % hidrodinamik të Shqipërisë.....	127
Figura 79 - Harta e Monitorimit të ajrit 2024.....	139
Figura 80 - Vlerat mesatare të PM10, Janar – Maj 2024.....	141
Figura 81 - Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM10.....	141
Figura 82 - Vlerat mesatare të PM2.5 Janar - Maj 2024.....	143
Figura 83 - Vlera mesatare NO2 për periudhën Janar - Maj 2024.....	144
Figura 84 - Vlerat ditore të SO2 Janar - Maj 2024.....	145
Figura 85 - Vlerat mesatare të CO, Janar - Maj 2024.....	146
Figura 86 - Vlera 8 orare të O3 në Durrës gjatë periudhës Janar - Maj 2024.....	147
Figura 87 - Vlera 8 orare të O3 në Elbasan gjatë periudhës Janar - Maj 2024.....	148
Figura 88 - Vlera 8 orare të O3 në Fier gjatë periudhës Janar - Maj 2024.....	149
Figura 89 - Vlera 8 orare të O3 në Korçë gjatë periudhës Janar - Maj 2024.....	149
Figura 90 - Vlera 8 orare të O3 në Shkodër gjatë periudhës Janar - Maj 2024.....	150

Figura 91 - Vlera 8 orare të O3 në st. Tirana Higjena gjatë periudhës Janar - Maj 2024	151
Figura 92 - Vlera 8 orare të O3 në Sauk Tirane gjate periudhës Janar - 20 Mars 2024 me stacionin e lëvizshëm.....	152
Figura 93 - Vlera 8 orare të O3 në Lushnjë në periudhën 20 Mars - Prill 2024 me stacionin e lëvizshëm.....	153
Figura 94 - Vlerat mesatare të Benzenit për periudhën Janar - Maj 2024	154
Figura 95 - Harta e cilësisë së zhurmave 2024	176
Figura 96 - Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB (A)	178
Figura 97 - Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	179
Figura 98 - Vlorë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)	180
Figura 99 - Vlorë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	180
Figura 100 - Berat, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	181
Figura 101 - Berat, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)	182
Figura 102 - Shkodër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)	183
Figura 103 - Shkodër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	183
Figura 104 - Lezhë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	184
Figura 105 - Lezhë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)	185
Figura 106 - Fier, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	186
Figura 107 - Fier, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)	186
Figura 108 - Korçë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	187
Figura 109 - Korçë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)	187
Figura 110 - Tiranë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)	189
Figure 111 - Tiranë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)	190
Figura 112 - Sarandë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	191
Figura 113 - Sarandë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	191
Figura 114 - Kukës, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)	192
Figura 115 - Kukës, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)	193
Figura 116 - Gjirokastër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	194
Figura 117 - Gjirokastër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	194
Figura 118 - Pogradec, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	195
Figura 119 - Pogradec, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	196
Figura 120 - Përmet, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)	197
Figura 121 - Përmet, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	197
Figura 122 - Lushnje, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A).....	198
Figura 123 - Lushnje, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A).....	198
Figura 124 - Harta e cilësisë së ujërave larë.....	204

Figura 125 - Vlerat e FC dhe IE, Velipojë	206
Figura 126 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Velipojës	207
Figura 127 - Vlerat e FC dhe IE, Shëngjin	208
Figura 128 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Shëngjinit	209
Figura 129 - Vlerat e FC dhe IE, Tale	210
Figura 130 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Tales... ..	210
Figura 131 - Vlerat e FC dhe IE, Durrës	212
Figura 132 - Vlerat e FC dhe IE, Gjiri i Lalzit	214
Figura 133 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Shëngjinit	214
Figura 134 - Vlerat e FC dhe IE, Kavajë.....	216
Figura 135 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Kavajës	216
Figura 136 - Vlerat e FC dhe IE, Qerret	217
Figura 137 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Qerretit.....	218
Figura 138 - Vlerat e FC dhe IE, Spille.....	219
Figura 139 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Spilles.....	219
Figura 140 - Vlerat e FC dhe IE, Seman - Darzezë	220
Figura 141 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin Seman - Darzeze.....	221
Figura 142 - Vlerat e FC dhe IE, Divjakë.....	222
Figura 143 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në% në plazhin e Divjakë	222
Figura 144 - Vlerat e FC dhe IE, Zvërnec	223
Figura 145 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhin e Zvërnecit	224
Figura 146 - Vlerat FC dhe IE, Vlorë.....	225
Figura 147 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Vlorës.....	225
Figura 148 - Vlerat FC dhe IE, Orikum	226
Figura 149 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Orikumit	227
Figura 150 - Vlerat FC & IE, Palasa	228
Figura 151 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin e Palasës	228
Figura 152 - Vlerat e FC dhe IE, Drimadhë	229
Figura 153 - Vlerat e FC dhe IE, Dhërmi	230

Figura 154 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhet e Dhërmiut dhe Drimadhes.....	230
Figura 155 - Vlerat e FC dhe IE, Jale dhe Livadhe	232
Figura 156 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhin e Jalës dhe Livadhes	232
Figura 157 - Vlerat e FC dhe IE, Himarë	233
Figura 158 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Himarës	233
Figura 159 - Vlerat e FC dhe IE, Qeparo	234
Figura 160 - Tendenca e sipas kategorive në % , në plazhin e Qeparoit	235
Figura 161 - Vlerat e FC dhe IE, Borsh.....	236
Figura 162 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhin e Borshit	236
Figura 163 - Vlerat e FC dhe IE, Lukovë.....	237
Figura 164 - Vlerat e FC dhe IE, Sarandë	238
Figura 165 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Sarandës	239
Figura 166 - Vlerat e FC dhe IE, Ksamil.....	240
Figure 167 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhin e Ksamilit	240
Figura 168 - Vlerat e FC dhe IE, Pogradec	242
Figura 169 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhin e Pogradecit	242
Figura 170 - Kategorizimi i shprehur në përqindje, Viti 2024	243
Figura 171 - Tendenca e përmbajtjes së NBO5 në shkarkimet urbane, mg/l	252
Figura 172 - Tendenca e përmbajtjes së NKO, mg/l	252
Figura 173 - Tendenca e përmbajtjes së lëndës pezull, mg/l.....	253
Figura 174 - Tendenca e përmbajtjes së P-total, mg/l	253
Figura 175 - Harta e monitorimit të Lagunave 2024	254
Figura 176 - Tendenca e sipërfaqeve të shfrytëzuara të plazheve 2021-2024	266
Figura 177 - Tendenca e hapësirave të menaxhuara të plazheve 2021-2024.....	267
Figura 178 - Tendenca e hapësirave publike sipas bashkive	267
Figura 179 - Grafiku i erozionit dhe akumulimit ndaj totalit 2017 - 2024	270
Figura 180 - Ndryshimi i përmbajtjes së elementeve në tre thellësi.....	299
Figura 181 - Paraqitja grafike të mbetjeve për zonat e menaxhimit të mbetjeve	321

Figura 182 - Dhjetë bashkitë që kanë gjeneruar më shumë mbetje	322
Figura 183 - Gjenerimi i mbetjeve bashkiake gjatë 5 viteve	325
Figura 184 - Përmbledhje e treguesve për çdo bashki	340
Figura 185 - Fenomeni i ç'halëzimit halorët 2024	348
Figura 186 - Fenomeni i ç'halëzimit halorët 2023	349
Figura 187 - Fenomeni i ç'gjethëzimit fletorët 2024	350
Figura 188 - Fenomeni i ç'gjethëzimit fletorët 2023	350
Figura 189 - Fenomeni i ç'ngjyrosjes halorët 2024	351
Figura 190 - Fenomeni i ç'ngjyrosjes halorët 2023	352
Figura 191 - Fenomeni ç'ngjyrosjes fletorët 2024	353
Figura 192 - Fenomeni ç'ngjyrosjes fletorët 2023	353
Figura 193 - Shkalla e prekjes nga dëmtuesit haloret 2024	359
Figura 194 - Shkalla e prekjes nga dëmtuesit haloret 2023	359
Figura 195 - Shkalla e prekjes nga demtuesit fletore 2024	360
Figura 196 - Shkalla e prekjes nga dëmtuesit fletoret 2023	361
Figura 197 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet haloret 2024	362
Figura 198 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet haloret 2023	362
Figura 199 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet fletoret 2024	363
Figura 200 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet fletoret 2023	364
Figura 201 - Shpërndarja e sherebelës në Shqipëri	371
Figura 202 - Sipërfaqe e zonave të mbrojtura, ha	408
Figura 203 - Numri i subjekteve që kanë realizuar vetëmonitorimin, 2024 ...	420
Figura 204 - Përqindja e ndërmarrjeve aktive në Inovacion sipas aktivitetit ekonomik, 2020-2022 (%)	458
Figura 205 - % e ndrmarrjeve që zhvillojnë produkte inovacioni	460
Figura 206 - Ndërmarrje aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomikë dhe llojit të Inovacionit, 2020-2022(%)	460

Burimi i të Dhënave

Monitorimi/Dokument/Raport	Institucioni
Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare si dhe ndikimi i shkarkimeve të lëngëta urbane në cilësinë e tyre	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Vlerësimi i cilësisë së ujërave me imazhe satelitore	ASIG
Monitorimi i ndotjeve radioaktive të ujërave sipërfaqësor dhe precipitimeve atmosferike (fallout) në Shqipëri	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
Monitorimi i prurjeve ujore në lumenjtë e Shqipërisë	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferet e baseneve Drini, Mat, Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe Zona Jonike	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Monitorimi i cilësisë së ajrit urban me stacione automatike në qytetet kryesore të vendit tonë si Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë për treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban si: PM10, PM2.5, NO2, SO2 , O3, CO dhe BTEX.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Të dhënat për ndryshimet klimatike janë marrë nga dokumenti “Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar 2020”.	UNDP
Monitorimi i zhurmave në qytetet Tiranë Shkodër Vlorë, Lezhë, Kukës, Korçë, Pogradec, Berat, Sarandë, Gjirokastër, Fier, Përmet, Lushnje.	Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes gjatë sezonit turistik 2024.	Instituti i Shëndetit Publik
Sipërfaqet e shfrytëzuara të plazheve	Agjencia Kombëtare e Bregdetit
Raport mbi gjendjen aktuale të dinamikës bregore për bregdetin shqiptar, dhe gjendjes së deltave të lumenjve	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Monitorimi per tokat	Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
Studim i monitorimit të rrjedhjeve të plastikës në Shqipëri duke përdorur diagramën e rrjedhjes së mbeturinave.	GIZ
Të dhënat për sasinë dhe cilësinë e lëndëve djegëse	ISHTI
Të dhënat për raportet e vetmonitorimit/ leje mjediosre/VNM/ inspektive	Agjencia Kombëtare e Mjedisit
Të dhënat për HEC, leje minerare, hidrokarburet, impiante fotovoltaike, energjia e rinovueshme	Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
Të dhënat për përdorimin e ujit	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
Të dhënat për importin e produkteve për mbrojtjen e bimëve, produkteve plehëruese dhe sigurinë ushqimore	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Ujësjelles- kanalizime dhe impiantet e trajtimit të ujërave urbane	Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizime
Të dhënat për bujqësinë, transportin, inovacionin	INSTAT
Të dhënat për PP , PMB dhe sigurinë ushqimore	Autoritet Kombëtar i Ushqimit

Monitorimi i monitorimin e burimeve gjenetike pyjore në habitatin e lloit Dushk dhe Gështënjë, gjendja e shëndetit, vitalitetit në pyjet e vendit tonë, vlerësimi i specieve drunore dhe bimëve aromatiko-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje.	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
Të dhënat për fondin pyjor, kullosor (Inventari Kombëtar i Pyjeve dhe Kullotave)	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
Zonat e mbrojtura	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
Të dhënat për turizmin “Buletini i Turizmit “	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

HYRJE

Raporti i Gjendjes në Mjedis 2024 paraqet vlerësimin e situatës mjedisore në vendin tonë bazuar mbi informacione dhe të dhëna për komponentët mjedisor. Ky raport përmban kapitujt për cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajri dhe ndryshimet klimatike, zhurmat, mjedisi bregdetar, tokat, menaxhimi i mbetjeve, pyjet, zonat e mbrojtura, mjedisi dhe sektorët ekonomik.

Vlerësimi dhe analiza e gjendjes lidhet ngushtësisht jo vetëm me cilësinë e indikatorëve por edhe me zbatueshmërinë e politikave mjedisore.

Nëpërmjet këtij raporti synojmë lehtësimin e marrjes së informacionit mjedisor për publikun si dhe rritjen e ndërgjegjësimit për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu ka si qëllim njohjen e gjendjes në mjedis për politikëbërësit dhe marrja në konsideratë e masave/rekomandimeve për parandalimin e ndotjes apo përmirësimin e gjendjes mjedisore.

REFERENCA ME VITIN 2023

Lumi i Tiranës, Ishëm dhe Gjanica vijnë të jenë lumenjtë më të ndotur në Shqipëri. Basenet Ishëm-Erzen dhe Seman kanë të njëjtin status si në 2023. Ujërat e Basenit të Vjosës dhe Matit ruajnë statusin me cilësi të mirë si në vitin 2023. Cilësia e ujërave të basenit të Drinit dhe Shkumbin është përmirësuar në vitin 2024 .

Ujërat e liqeneve të Shkodrës, Prespë e madhe dhe Prespë e Vogël ruajnë të njëjtin cilësi si në vitin 2023. Vërehet përmirësim i cilësisë të ujërave të liqenit të Ohrit duke kaluar nga status mezotrofik në oligotrofik. Kemi të njëjtin status të cilësisë të lumit Pogradec për 2022-2024 në Klasa II-Gjendje e mirë. Cilësia e ujërave të lumit Vërdovë është përmirësuar dy vitet e fundit krahasuar me vitin 2022. Gjatë 2024 vërehet përkeqësim i cilësisë së ujërave në lumin Tushemisht krahasuar me vitin 2023, duke kaluar nga gjendje e lartë në gjendje të mirë.

Në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 kemi tendencë në rritje të cilësisë së ujërave të kategorisë A-cilësi e shkëlqyer dhe tendencë në ulje të cilësisë së ujërave të kategorisë D-cilësi e keqe.

Gjatë vitit 2024 kemi rritje të fenomenit të rënies së halave/ gjetheve, çngjyrosjes si dhe të shkallës së prekjes nga dëmtuesit dhe sëmundjet për llojet e halorëve dhe fletorë për klasën e tretë (61-100%) krahasuar me 2023. Gjatë 2024, kemi rritje të numrit të zjarreve dhe sipërfaqes të pëshkruar dhe të djegur në pyje dhe kullota.

Vendi ynë ka bërë progres në rritjen e numrit të kategorive dhe të sipërfaqes të zonave të mbrojtura në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023.

Kemi tendencë në rritje të subjekteve që kanë realizuar raportet e vetmonitorimit krahasuar me vitin 2023. Në vitin 2024 kemi rritje të numrit të inspektimeve në fushën e mjedisit dhe të ujërave krahasuar me vitin 2023.

Numri i vizitorëve të huaj dhe vendas që kanë vizituar zonat e mbrojtura është rritur me 22% krahasuar me vitin 2023.

Sipërfaqja e bujqësisë organike dhe sasia e prodhimeve organike është rritur gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022.

Niveli i zhurmave për periudhën e ditës (55 dB) dhe të natës (45 dB) përgjithësisht është më i ulët krahasuar me vitin 2023.

Rezulton një rritje e sasisë të mbetjeve urbane të gjeneruara krahasuar me vitin 2023.

Vlen të theksohet se në ndryshim me RGJM 2023, në këtë raport janë trajtuar çështje të reja si;

- Studim i monitorimit të rrjedhjeve të plastikës në sistemet ujore
- Vlerësim social- ekonomik
- Ndërlidhje e mjedisit me sektorët e tjerë ekonomik

MESAZHET E RGJM 2024

- Përfshirja e rekomandimeve dhe masave përmirësuese të gjetura nga vlerësimi i gjendjes së mjedisit në politikat mjedisore.
- Ofrimi i një pozicioni të politikës kombëtare për mjedisin për të trajtuar ndërveprimet, sinergjitë dhe shkëmbimet në të gjithë fushat e politikave mjedisore dhe për t'u ndërvepruar me fusha të tjera të politikave sektoriale.
- Shtytja e zbatimit të politikave për të arritur përfitimet dhe objektivat e përcaktuara.
- Transformimi i sektorëve tanë të energjisë, transportit, bujqësisë dhe industrisë është e domosdoshme për arritjen e një të ardhmeje të qëndrueshme.
- Investimi në infrastrukturën e ujit, impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura, energjisë, transportit, bujqësisë dhe menaxhimit të mbetjeve është thelbësore për të mbrojtur mjedisin tani dhe në të ardhmen.
- Mbrojtja e mjedisit është çelësi për mbrojtjen e shëndetit tonë dhe ne duhet të veprojmë për të reduktuar rreziqet për shëndetin tonë nga ekspozimet mjedisore.

GJETJET KRYESORE

Kapitulli 1 - Cilësia e Ujërave

Lumi i Tiranës, Lumi Ishëm dhe Lumi Gjanica vijojnë të jenë lumenjtë më të ndotur në Shqipëri. Kërkohej ndërhyrje e menjëhershme për trajtimin e ujërave të ndotura urbane që shkarkohen në ujërat pritëse duke qenë se janë shkaktari kryesor i ndotjes së lumenjve. Probleme shqetësuese në shumë basene janë shkaktuar nga hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve dhe në terracat aluviale të tyre duke shkaktuar ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore. Ka shfrytëzim të zhavorreve në shtratin e lumit Drin dhe Mat.

Kapitulli 2 - Ajri urban dhe ndryshimet klimatike

Ndotësit kryesorë të cilësisë së ajrit urban janë grimcat e pluhurit me diametër 10 mikron (PM10) dhe 2.5 mikron (PM2.5). Është e domosdoshme përmirësimi i infrastrukturës së transportit për lehtësimin e trafikut. Inkurajimi për përdorimin e automjeteve elektrike/hibride që nuk shkaktojnë ndotje. Kontrolli i vazhdueshëm i cilësisë të lëndës djegëse të mjeteve të transportit rrugor. Emetimet e gazeve me efekt serë janë kontribuesi kryesor që ndikojnë në ndryshimet klimatike. Zbatimi i masave zbutëse sipas sektorëve të Kontributit Kombëtar të Përcaktuar do të ndihmojë në arritjen e objektivit në zbutjen e emetimeve të gazeve me efekt serë me 20,9% derin në vitin 2030.

Kapitulli 3 - Zhurmat

Niveli më i lartë i zhurmave për periudhën e ditës është vlerësuar në qytetin Tiranës ndërsa për periudhën e natës është vlerësuar në qytetin e Vlorës. Shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Gjithashtu dhe lokalet gjenerojnë zhurma si ditën ashtu dhe natën.

Kapitulli 4 - Mjedisi Bregdetar

Plazhet me cilësi më të mirë janë; Lukova, Palasë, Drimadhe, Dhërmi, Jalë, Livadh dhe Borsh duke vijuar me plazhet Shëngjin, Tale, Gjiri i Lalzit, Seman e Darëzezë, Divjakë, Zvërnec, Orikum. Plazhet me cilësi jo të mirë që kanë stacione që i përkasin kategorisë D-cilësi e keqe/masa të menjëhershme janë Velipojë, Durrësi, Kavajë, Qerret, Spille, Vlorë, Himarë, Qeparo, Sarandë, Ksamil dhe Lin-Pogradec. Për përmirësimin e cilësisë të plazheve të ndotura

kërkohet marrja e masave për trajtimin e ujërave të ndotura urbane përpara derdhjes në ujërat pritëse si shkaktari kryesor i ndotjes së tyre.

Kapitulli 5 - Tokat

Nuk kemi ndotje të tokave nga metalet e rënda (Cd, Pb, Fe, Zn, Ni, Mn) dhe nuk paraqitet rrezik për mjedisin dhe shëndetin njerëzor. Të vijnë ruajtja e cilësisë të tokave të monitoruara.

Kapitulli 6 - Menaxhimi i Mbetjeve dhe Ekonomia Qarkulluese

Është e domosdoshme zhvillimi i zgjidhjeve inovative në reduktimin e mbetjeve, për të promovuar riciklimin dhe eficiencën e burimeve, dhe për të mbrojtur mjedisin për brezat e ardhshëm. Tashmë Bashkitë Cërrik, Belsh dhe Roskovec kanë në funksion qendra kompostimi për mbetjet organike. Skemat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) konsiderohen si instrumenti kryesor për të organizuar, zbatuar dhe financuar mbledhjen e veçuar dhe riciklimin e rrymave prioritare të mbetjeve. Nevojitet përmirësim i mëtejshëm për uljen e rrjedhjes së plastikës në sistemet ujore për t'iu afruar një niveli të dëshiruar nën 0.57 kg/banor/vit, i cili do të ishte i krahasueshëm me nivelet në BE.

Kapitulli 7 - Pyjet dhe Biodiversiteti

Viti 2024 është karakterizuar nga një situatë me raste të shumta dhe sipërfaqe të konsiderueshme të zjarreve kryesisht gjatë muajve gusht, korrik dhe shtator. Si pasojë, kemi rritje të numrit të zjarreve dhe sipërfaqes të pëshkruar dhe të djegur në pyje dhe kullota krahasuar me vitin 2023.. Kemi përkeqësim të gjendjes shëndetësore të pyjeve krahasuar me vitin 2023 dhe është e nevojshme marrja e masave për ruajtjen e tyre nga fenomeni i rënies së halave/gjethëve, sëmundjet dhe dëmtuesit. Vendi ynë ka bërë përparim të rëndësishëm në përafrimin e politikave të saj kombëtare për biodiversitetin me direktivat e Bashkimit Evropian, duke krijuar një themel të fortë për arritjen e objektivave të Kornizës Globale për Biodiversitetin. Sfidat dhe vështirësitë për biodiversitetin lidhen me; pengesa institucionale dhe administrative, mangësi në të dhëna dhe monitorim, angazhimi publik dhe ndërgjegjësimi.

Kapitulli 8 - Zonat e mbrojtura

Vendi ynë ka bërë progres në rritjen e numrit të kategorive të zonave të mbrojtura krahasuar me vitin 2023. Është e rëndësishme rritja e numrit të zonave të mbrojtura si faktor kryesor edhe në zhvillimin e turizmit dhe ruajtjen e biodiversitetit.

Kapitulli 9 - Mjedisi dhe sektorët ekonomik

Ndërlidhja dhe ndërveprimi i politikave mjedisore me politikat e tjera sektoriale të bujqësisë, transportit, energjisë, inovacionit me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit.

VLERËSIMI SOCIAL-EKONOMIK

Progresi social-ekonomik në Shqipëri është penguar së fundmi nga dy kriza të mëdha. Vendi u godit nga një tërmet shkatërrues në nëntor të vitit 2019. Ai shkaktoi dëme të mëdha materiale në 11 bashki, duke përfshirë këtu dy bashkitë më të populluara dhe të zhvilluara (Tirana dhe Durrësi). Strukturat turistike të akomodimit dhe banesat u prekën më rëndë. Tërmeti shkaktoi humbje të barasvlershme me rreth 7,5% të PBB-së.

Gjatë përpjekjeve për rindërtimin, kriza e shkaktuar nga COVID-19 ushtroi edhe më tepër presion mbi buxhetin dhe masat e qeverisë, si dhe në progresin socio-ekonomik të vendit, pasi e detyroi Shqipërinë që të bllokojë sektorët kryesorë të ekonomisë. Sektori i turizmit, i cili është një ndër sektorët kryesorë të rritjes ekonomike, u godit veçanërisht rëndë si pasojë e masave shtrënguese dhe kufizimeve të udhëtimit. Në tremujorin e dytë të vitit 2020, punësimi ra me 3,6% krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2021, në sajë të një stimuli politik dhe rigjallërimit të sektorit të udhëtimit, ndërtimit dhe veprimtarive të nxjerrjes, u vu re një rimëkëmbje e konsiderueshme.

Koeficienti Gini është një tregues që përfaqëson pabarazitë në të ardhura ose pasuri, (nga 0-100) ku vlera zero përfaqëson barazinë ideale. Është bere progres ne uljen e koeficientit Gini i të ardhurave të disponueshme të ekuivalizuara nga 36.8 ne viti 2017 ne 33 ne vitin 2021 duke iu afruar mesatares EU-27 prej 30.2 (2021).

Shpenzimet per mbrojtjen e mjedisit lidhen kryesisht me monitorimin e mjedisit, vleresimin e impaktin ne mjedis te lejeve mjedisore dhe kontrollet inspektuese. Buxheti per mbrojtjen e mjedisit gjate 2019-2022 eshte rritur nga viti ne vit.

INSTAT ka kryer për periudhën referuese 2020-2022 vrojtimin mbi aktivitetet e Inovacionit pranë ndërmarrjeve me 10 ose më shumë të punësuar, ku rezulton se 42,9 % e ndërmarrjeve të vrojtura kryen një aktivitet Inovacioni. Krahasuar me të dhënat e vrojtimin të mëparshëm të inovacionit me periudhë referuese 2018-2020, aktiviteti i inovacionit u rrit me 6,3 % (nga 36,6 % në 42,9 %). Krahasuar me të dhënat e vrojtimin të mëparshëm 2018-2020, vihet re se rritja e aktiviteteve inovative në ndërmarrje per 2020-2022, ka sjellë rritje me 1,6 % në numrin e të punësuarve. Gjatë periudhës 2020-2022, rreth 4,3 % e ndërmarrjeve aktive në

inovacion morën mbështetje financiare nga autoritetet publike nga 3,6 %, që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm. Për zhvillimin e bujqësisë dhe të prodhimit organik, që prej vitit 2021 ka filluar implementimi i skemës së mbështetjes të fermerëve me naftë falas, për punimet e mekanizuara në bujqësi.

Shpenzimet totale për edukimin terciar për 2016-2023 kanë ardhur në rritje nga viti në vit duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, programeve të studimit, përmirësimit të shërbimit për studentët si dhe në zgjerimin dhe përmirësimin e infrastrukturës akademike. Në vitin akademik 2022-2023, u diplomuan në arsimin e lartë 27.991 studentë.

Në Shqipëri, të ardhurat nga taksat mjedisore përfshijnë taksat e energjisë, transportit, burimeve natyrore dhe të ndotjes. Për periudhën 2010-2014 të ardhurat e taksave mjedisore nga totali i të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore kanë tendencë në rritje nga 11.37% në 2010 në 13.13% në 2014. Pas vitit 2014 kemi tendencë në uljen e të ardhurave të taksave mjedisore duke arritur në 10.25% në vitin 2022. Të ardhurat nga taksat mjedisore në 2022 arritën në vlerën e rreth 55.5 miliardë lekë, duke pësuar një rënie prej 4,53 %, krahasuar me vitin 2021. Taksat e energjisë zënë pjesën më të madhe të të ardhurave me 82,45 %, pasuar nga taksat e transportit 12,92 %, taksat e ndotjes me 4,5 % dhe taksat e burimeve natyrore me 0,13 %. Pesha e të ardhurave nga taksat mjedisore ndaj Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është 2,59 %, duke pësuar një rënie me 0,54 pikë përqindje, krahasuar me vitin 2021(3.13 %).

Varferia energjetike është e lartë në Shqipëri. Në periudhën 2017- 2021, përqindja e familjeve që nuk kanë mundësi të mbajnë ngrohtë ambientin në shtëpi, varion nga 38.7 % (2017) në 37.7 % (2021). Edhe pse kemi tendencë në ulje krahasuar me 2017, kërkohet shumë përpjekje për uljen e varfërisë energjetike për tu afruar me mesataren e EU- 27, me 9.3% në vitin 2022.

Materialet mjedisore që përdoren në Shqipëri përfshijnë; Biomasa dhe produktet e Biomases, Mineralet dhe koncentratet metalike, Mineralet jo metalike, Materialet fosile të energjisë, Produkte të tjera dhe mbetje. Përdorimi i brendshëm i materialeve mjedisore në raport me popullsinë në 5 vitet e fundit ka tendencë në ulje nga 8 ton/banorë në vitin 2018 në 7.7 ton/banorë në vitin 2022.

Në vitin 2022 rreth 82,1 % e të punësuarve janë të punësuar në Ndërmarrje të Vogla e të Mesme (NVM) nga 81,6 % që ishte në vitin 2021. Mikrondërmarrjet (1-9 të punësuar) kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e akomodimit dhe shërbimit ushqimor me 66,2 %. Ndërmarrjet e vogla (10-49 të punësuar) kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e ndërtimit me 29,4 %. Ndërmarrjet e mesme (50-249 të punësuar) kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e industrisë përpunuese me 38,0 %. Ndërmarrjet e medha (250+ të punësuar) kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e energjië elektrike, ujit dhe menaxhim mbetjesh me 57 %. Për vitin 2022 ndërmarrjet e medha realizuan 26.1% e vlerës së shtuar. Rreth 78,4 % e vlerës së shtuar realizohet nga ndërmarrjet e vogla e të mesme nga 76,1 % që ishte në vitin 2021.

Tre treguesit kryesorë të NVM-ve në Shqipëri, krahasuar me BE-në janë:

- Përqindja e NVM është 99,8 %, i njëjtë me BE;
- Përqindja e të punësuarve në këtë grup ndërmarrjesh është 82,1 % në Shqipëri nga 64,4 % në BE;
- Vlera e shtuar e realizuar nga NVM në Shqipëri përbën 78,4 % nga 51,8 % në BE

KAPITULLI 1 - CILËSIA E UJËRAVE

1.1. Burimi i të dhënave

Monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Monitorimi i ndotjeve radioaktive të ujërave sipërfaqësor dhe precipitimeve atmosferike (fallout) në Shqipëri është kryer nga Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar.

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka kryer monitorimin e prurjeve ujore në lumenjtë e Shqipërisë në 28 stacione për parametrat e përcaktuar në Direktivën Kuadër të Ujit.

Monitorimi hidrodinamik dhe hidrokimik i ujërave nëntokësore në akuiferet e baseneve Drini, Mat, Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe Zona Jonike është kryer nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar.

Monitorimi i cilësisë së ujërave të liqeneve për parametrat, turbullirë, klorofil-a, lëndë pezull është kryer nga ASIG nëpërmjet përdorimit të shërbimit satelitor.

1.2. Rëndësia

Cilësia e ujërave është jetike për biodiversitetin, shëndetin e njerëzve dhe ekonominë. Ujërat e ndotura ndikojnë në përhapjen e sëmundjeve infektive, shkaktojnë vdekjen e specieve ujore dhe ndikojnë negativisht në sektorët e turizmit dhe bujqësisë. Eutrofikimi i ujërave nga shkarkimet urbane dhe bujqësore sjell pasoja si rritja e algave toksike dhe reduktimi i oksigjenit, duke dëmtuar ekosistemet ujore. Ruajtja e cilësisë së ujit është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmbushjen e standardeve të BE-së.

Nga aktivitetet e kryera më parë rezulton se në disa lumenj dhe liqene radioaktiviteti alfa-beta total ka qenë mbi vlerën e rekomanduar 0,1 Bq/L për aktivitetin alfa total dhe 1 Bq/L për aktivitetin beta total (VKM Nr. 403, datë 19.06.2024). Në këto raste janë kryer analiza të mëtejshme të diferencuara për përcaktimin e radioizotopëve të Uraniumit dhe Radiumit si kontribues kryesorë.

Monitorimi sa më sistematik mbi nivelin e ndotjeve radioaktive të ujërave sipërfaqësore kryesore të vendit dhe precipitimeve atmosferike, në disa pika të caktuara të vendit tonë shërben për vëzhgimin dhe evidentimin e gjendjes nga pikëpamja e ndotjes radioaktive si dhe vlerësimin e burimeve të mundshme të ndotjes.

Monitorimi në kompleksitet i lumenjve, i dinamizmit të ndryshimit të kanaleve lumore, rolit të prurjeve ujore, proceseve që ndodhin në to si rezultat i faktorëve natyrorë dhe humane, ka patur gjithmonë një rëndësi të veçantë, sidomos në vitet e fundit. Po kështu, monitorimi i prurjeve të lëngëta luan rolin e vet si një nga faktorët determinues në aktivitetin e rrjedhës ujore si dhe në përcaktimin e potencialit të saj si një rezervë e shfrytëzueshme për qëllime të ndryshme në industri dhe ekonomi.

1.3. Kontribuesit kryesorë dhe ndikimi në mjedis

Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore përdoren nga njerëzimi për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme. Sasia e ujit të përdorur gjatë vitit 2024 paraqitet në tabelën në vijim:

Tabela 1 - Sasia e ujit në m³ për vitin 2024

Qëllimi i përdorimit	Sasia e ujit në m³	
Përdorim i burimit ujor sipërfaqësor(m³)	13,589,338.164	
Për furnizim me ujë të pijshëm të popullatës	87,528,131	
Për ujitje në bujqësi		Faturohet sipas sipërfaqes së vaditjes (nuk identifikohet qartë sasia e ujit të përdorur)
Për Akuakulture (ujra të rrjedhshem)	10,803,758	Faturohet për kg/peshk të shitur (nuk identifikohet sakte sasia e ujit te perdorur)

Per prodhim hidroenergjik	13,483,935,575	Përlllogaritur nga sasia e energjisë së prodhuar dhe tregtuar për 10 mujorin e 2023 dhe të dhënat e prurjeve të lejuara të llogaritura.
Për qëllime industriale dhe /ose teknologjike	887,477	
Ujitje	2,000,000	
Për qellime te tjera	4,183,223	
Përdorim burimi ujour nëntoksor(m³)	182,340,627	
Për furnizim me ujë të pijshëm (sistemim të furnizimit me ujë të popullatës)	148,232,280	
Për ujë të ambalazhuar	929,019	
Për akuakulturë	27,433,166	Faturohet për kg/peshk të shitur (nuk identifikohet saktë sasia e ujit të përdorur)
Për qëllime industrial dhe /ose teknologjike	1,560,954	
Për turizëm dhe argëtim	179	
Për ujitje në bujqësi		Faturohet sipas sipërfaqes së vaditjes (nuk identifikohet saktë sasia e ujit të përdorur)
Termal, Gjeotermal kurativ		Faturohet sipas vaskave (nuk identifikohet saktë sasia e ujit të përdorur)
Për qëllime blegtorale kur shoqërohet me instalime	1,257	

tubacionesh dhe ndërtime objektesh		
Për prodhim hidroenergjik	0	
Për qëllime të tjera	4, 182,920	
Totali(m³)	13,771,678,791	

Tabela 2 - Përdorimi i burimeve ujore 2023-2024

	2023	2024
Përdorim i burimit uhor sipërfaqësor (m³)	17,488,655,557	13,589,338.164
Përdorim burimi uhor nëntokësor (m³)	133,333,534	182,340,627
Total perdorimi i ujit (m³)	17,621,989,090	13,771,678,791

Një sërë aktiviteteesh njerëzore ushtrojnë presion mbi cilësinë e ujit. Presionet kryesore të rëndësishme që ndikojnë në trupat ujorë në rrezik janë si më poshtë.

Bujqësia

Çështja kryesore që lidhet me bujqësinë është humbja e lëndëve ushqyese të tepërta (kryesisht azotit dhe fosforit) nga aktivitetet bujqësore, si në oborr ashtu edhe në të gjithë fermën. Kjo shpesh shoqërohet me humbjen e sedimentit të imët, që është një çështje tjetër e rëndësishme. Kimikatat e rrezikshme si ato që gjenden në produktet për mbrojtjen e bimeve mund të kenë gjithashtu një ndikim në cilësinë e ujit.

Përdorimi i plehrave kimike dhe pesticideve rrit përmbajtjen e nitrateve dhe fosforit në lumenj dhe liqene.

Veprimtaritë që dëmtojnë hidromorfologjinë

Ndryshimet në rrjedhën dhe habitatin fizik mund të dëmtojnë ekologjinë dhe të ndryshojnë funksionin dhe proceset natyrore të trupave ujorë. Ndryshimet hidromorfologjike shoqërohen me kullimin e tokës dhe përrenjve (kryesisht për bujqësi ose pylltari), kanalizimin (kryesisht të nxitur nga skemat e kullimit, puna për mbrojtjen nga përmbytjet) dhe zonat urbane.

Pylltaria

Aktivitetet e tilla si pyllëzimi, punimet në rrugë pyjore, rrallimi, prerja dhe ripyllëzimi mund të shkaktojnë çlirimin e sedimenteve, lëndëve ushqyese dhe pesticideve në trupat ujorë dhe mund të ndikojnë në kushtet e habitatit. Rënia e cilësisë së ujit të shkaktohet nga aktivitetet pyjore mund të jetë thelbësore. Megjithatë, trupat ujorë mund të rikuperohen brenda pak vitesh dhe mund të mbeten në gjendje shumë të mirë kur pyjet janë të qëndrueshme. Pjesa më e madhe e këtij presioni lind nga praktikatat e papërshtatshme historike të pyllëzimit, të cilat përfshijnë mbjelljen e halorëve në tokat torfe, shpesh në malet e ndjeshme dhe pa distanca të frenimit të ujit në vend.

Ujërat e zeza urbane

Mungesa e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura çon në derdhjen direkte të ujërave të ndotura në lumenj. Çështjet kryesore që lindin nga ujërat e zeza urbane janë çlirimi i lëndëve ushqyese (azoti dhe fosfori), ndotja organike dhe çlirimi i patogjenëve nga ujërat e zeza të ndotura ose të patrajtuara që paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut.

Industria

Fabrikat dhe uzinat lëshojnë metale të rënda dhe kimikate të rrezikshme në ujërat sipërfaqësore.

Ndotja nga lëndët ushqyese

Çështja më e rëndësishme që prek trupat ujorë në rrezik për të mos përmbushur objektivin e tyre mjedisor është ndotja e lëndëve ushqyese. Kur fosfori ose azoti hyjnë në rrugët ujore, ato mund të shkaktojnë rritje të tepruar të bimëve dhe algave. Kjo rritje e tepërt mund të bllokojë ato rrugë ujore dhe të çojë në humbje të oksigjenit nga uji, gjë që dëmton ekologjinë. Rikuperimi mund të ndodhë relativisht shpejt kur hiqen burimet ushqyese dhe kur ka zona me cilësi të mirë të ujit në rrjedhën e sipërme. Ndotja me azot shkaktohet kryesisht nga aktivitetet bujqësore. Ndotja me fosfor vjen si nga humbjet bujqësore ashtu edhe nga ujërat e zeza urbane. Ndërsa përqendrimet e rritura të fosforit dhe azotit mund të çojnë në eutrofikim, prania e fosforit të tepërt është një shqetësim i veçantë për shëndetin ekologjik të lumenjve dhe liqeneve tanë. Nivelet e ngritura të azotit janë më shumë shqetësim për grykëderdhjet tona. Përqendrimet e larta të nitrateve në disa furnizime me ujë të pijshëm mund të përbëjnë rrezik për shëndetin e njeriut. Po ashtu përmes shkarkimeve të drejtpërdrejta, lëndët

ushqyese mund të gjejnë shtigje të ndryshme në ujërat tona në varësi të peizazhit dhe llojit të tokës. Azoti tenton të lëvizë poshtë përmes tokave që kullojnë lirshëm derisa të takohet në ujërat nëntokësore dhe përfundimisht në grykëderdhjen e poshtme. Fosfori ka tendencë të lëvizë në tokë, i bartur nga rrjedhja në toka të lagështa.

Shfrytëzimi i shtratit të lumit

Shfrytëzimi i zhavorreve në shtretërit e lumenjve për materiale ndërtimi ka ndikim negativ në cilësinë e ujërave të lumenjve. Gjithashtu këto zhavorre janë ushqyesit kryesorë të ujërave nëntokësore (akuifereve) nëpërmjet filtrimit të ujit të lumit. Sasia e materialeve inerte lumore të përdorur në vitin 2024 është më e lartë krahasuar me vitin 2023.

	2023	2024
Material inerte lumore (m³)	381,653	665,426

Ndikimi:

- Mjedisor: Reduktimi i biodiversitetit, humbja e habitateve natyrore dhe eutrofikimi i liqeneve.
- Shëndetësor: Konsumimi i ujit të ndotur rrit rrezikun e sëmundjeve gastrointestinale, dëmtime neurologjike dhe probleme të sistemit imunitar.

1.4. Forcat Shtytëse Dhe Presionet




Figura 1 - Forcat Shtytëse dhe Presionet

Shkarkimet e ujërave urbane të patrajuara në ujërat pritëse ndikojnë në cilësinë e ujërave. Mbulimi me ujësjellës dhe sistemin e kanalizimeve si dhe impiantet e trajtimit të ujërave urbane janë tregues të reagimit.

Tabela 3 - Mbulimi me ujësjellës- kanalizime, 2024

Emërtimi	Mbulimi me ujësjellës (%)	Mbulimi me kanalizime (%)
Shkodër	58.92	47.08
Fushë Arrëz	82.97	61.46
Pukë	41.22	24.93
Vau i Dejës	23.71	7.48
Malsi e Madhe	57.14	1.69
Lezhe	77.67	64.95
Mirdite	31.24	28.53
Kurbin	37.2	31.14

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

Kukes	59.62	43.2
Tropoje	46.05	18.42
Has	61.17	0
Tirane	104.2	97.15
Kamez	74.59	79.24
Kavaje	94.39	67.84
Rrogozhine	39.49	9.14
Vore	70.66	49.27
Durres	100.07	62.18
Kruje	22.63	19.46
Diber	93.13	41.13
Bulqize	55.69	17.39
Mat	58.27	45.88
Klos	48.7	9.27
Elbasan	72.1	60.56
Librazhd	35.66	22.87
Përrenjas	97.82	25.06
Gramsh	89.12	53.58
Cerrik	63.08	26.25
Belsh	61.21	16.88
Peqin	45.05	19.78
Korçe	73.68	65.91
Pogradec	86.65	60.12
Maliq	95.25	46.12
Pustec	89.53	36.57
Devoll	65.84	0
Kolonjë	77.76	69.92
Berat	74.38	63.46

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

Kuçovë	74.35	45.44
Dimal	45.39	11.27
Polican	68.7	67.8
Skrapar	79.6	40.41
Fier	59.05	42.33
Lushnje	63.73	33.1
Divjake	46.37	0
Patos	54.63	36.58
Roskovec	38.43	28.29
Mallakaster	50.01	18.68
Vlore	86.9	73.26
Selenice	76.57	26.67
Himare	91.59	26.51
Delvine	74.86	33.33
Sarande	97.46	78.59
Finiq	46.2	0
Konispol	75.8	0
Gjirokaster	89.42	52.39
Tepelene	66.63	46.96
Keqcyre	90.72	0
Permet	74.51	56.65
Libohove	98.07	0
Dropull	86.98	0
Memaliaj	42.05	27.12

Burimi: Agjencia Kombëtare e Ujësjetllës-Kanalizime

Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN) në vitin 2024

Tabela 4 - Impiantet për trajtimin e ujërave të ndotura (ITUN) në vitin 2024, UK Korçë

Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Korçë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Korçe
Vendndodhja	Korçë
Sipërfaqja sipas projektit	12 ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	85,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi I trajtimit të ujërave të ndotura	81.366
Lloji i impiantit të trajtimit:	- Uji trajtohet në nivel sekondar - Ka shkarkim të ujrave nga fabrika birra Korça në ITUN (ndotje në nivel detergjentesh pastrimi) - Trupa pritëse, Përrua
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	15,000
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	4,169
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	4169
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Pogradec
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Pogradec
Vendndodhja	Buçimas, Pogradec
Sipërfaqja sipas projektit	15 ha

Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	50,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi I trajtimit të ujërave të ndotura	55,688
Lloji i impiantit të trajtimit:	- Uji trajtohet në nivel: paraprak, primar, sekondar & terciar (reduktim i fosforit) - Nuk shkarkojnë ujra industriale në ITUN - Trupa pritëse, Liqen
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	38 l/s
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	2,867
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	2,867
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Durrës
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Durrës
Vendndodhja	Porto Romano Durrës
Sipërfaqja sipas projektit	70 ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	250,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi I trajtimit të ujërave të ndotura	227,628
Lloji i impiantit të trajtimit:	- ITUN Durrës përdor një teknologji të llumit aktiv, të avancuar me trajtim biologjik terciar, ku përftohet Biogaz për prodhimin e energjisë elektrike . Perbehet nga: linja e paratrajtimit, trajtimit primar, sekondar dhe terciar (reduktim i fosforit) & (Reduktim i azotit) - Trupa pritëse, Det
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	60,000

Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	9,128
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	4763
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Durrës
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Lalëz
Vendndodhja	Hamallaj Durrës
Sipërfaqja sipas projektit	1.5ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	15,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	
Lloji i implantit të trajtimit:	ITUN Lalëz përdor Llum aktiv (Pranim /Paratrajtim/ Oksigjenim /Dekantues/Trashues/Qetësues /Centrifugë)
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	2,500
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Lezhë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Shëngjin
Vendndodhja	Kune, Shëngjin
Sipërfaqja sipas projektit	29.5ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	60,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	38,823
Lloji i implantit të trajtimit:	- Biodiversitet, trajtim biologjik deri në nivel primar i avancuar

	- Nuk shkarkojnë ujra industriale në ITUN. - Trupa pritëse, Lumë
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	12,240
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	1,006
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	1006
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Sarandë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Sarandë
Vendndodhja	Fshati Çukë, Sarandë
Sipërfaqja sipas projektit	30 ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	60,000
Popullsia totale që i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	46,454
Lloji i implantit të trajtimit:	Impiant me trajtim biologjik të ujërave nëpërmjet pondeve të ajruara, trajtimi i ujërave deri në nivel sekondar - Nuk shkarkojnë ujra industriale në ITUN - Trupa pritëse, Lumë
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	12,240
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	1,671
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	1337.3
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Kavajë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Kavajë
Vendndodhja	Qerret, Kavajë
Sipërfaqja sipas projektit	18 ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	25,000

Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	0
Lloji i impiantit të trajtimit:	- Uji trajtohet në nivel sekondar. - Shkarkojnë ujra industriale në ITUN dhe janë të paratrajtuar. - Trupa pritëse, Det
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	4,500
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	0
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	0
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Shkodër
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Shkodër
Vendndodhja	Shirokë
Sipërfaqja sipas projektit	1913 m ²
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	25,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	16,644
Lloji i impiantit të trajtimit:	- Trajtim biologjik me llum aktiv - Nuk shkarkojnë ujra industriale në ITUN
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	350
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	300
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	300
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Shkodër
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Velipojë
Vendndodhja	Velipojë

Sipërfaqja sipas projektit	2.8 ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	48,300
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	16,644
Lloji i impiantit të trajtimit:	- Uji trajtohet me basene SBR dhe rreze ultraviolett.
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	15,800
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	300
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	300
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Vlorë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Vlorë
Vendndodhja	Vlorë
Sipërfaqja sipas projektit	25.5 ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	210,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	149,414
Lloji i impiantit të trajtimit:	- Uji trajtohet me paratrajtim dhe trajtim primar. - Nuk shkarkojnë ujra industriale në ITUN - Trupa pritëse, Det
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	42,000
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	4,774
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	4642.9
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Vlorë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Orikum

Vendndodhja	Orikum
Sipërfaqja sipas projektit	2ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	55,000
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	149,414
Lloji i impiantit të trajtimit:	I përfunduar, pritët të lidhet me sistemin e kanalizimeve
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	4,000
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	
Emri i Shoqërisë	Sh.A UK Tiranë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Tiranë
Vendndodhja	Kashar, Tiranë
Sipërfaqja sipas projektit	53ha
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	335,880
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	
Lloji i impiantit të trajtimit:	<i>ITUN trajton ujin e ndotur deri në nivelin sekondar me rrugë biologjike.</i> Linja e trajtimit të ujit të ndotur: përmban njësi paratrajtimi si: grila mekanike e automatike dhe stacion pompimi që dërgon ujin te niveli primar i trajtimit <i>dekantuesi primar</i>; Niveli sekondar i trajtimit është projektuar si filtër me pikim & dekantues sekondar. Pasi uji del i trajtuar nga niveli sekondar kalon në një njësi dizinfektimi. Më pas uji shkarkohet në trupën ujore më te afërt.

	<i>Linja e trajtimit te llumit</i> është projektuar me këto elemente: Trashues llumi; Tretës llumi & shtretër tharjeje për llumin. <i>Impjanti është në ndërtim</i>
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	75,843
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	
Emri i Shoqërisë	Bashkia Himarë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Dhrale - Palasë
Vendndodhja	Zona bregdetare Dhrale, Palasë në Bashkinë Himarë
Sipërfaqja sipas projektit	-
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	Faza e pare 1500
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	
Lloji i impiantit të trajtimit:	1.Grilë fine (vetpastrim); 2. Para sedimentim yndyre, vaj (FOG) vaska e mbledhjes së llumit; 3. Rezervuari i barazimit (i ajrosur); 4. Pompim i vazhdueshëm i rrjedhës; 5. Matja e rrjedhës; 6. Trajtim biologjik; 7. Sedimentim-riciklim llumi & refuzim; 8..Klorinim - pompim te filtrimi; 9. Filtrimi i rërës; 10. Mbledhja e ujit të trajtuar
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	450
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	

Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	
Emri i Shoqërisë:	Bashkia Himarë
Emërtimi i ITUN	Impianti i trajtimit të ujit të ndotur Drimadhe -Dhërmi
Vendndodhja	Zona bregdetare Drimadhe, Dhërmi në Bashkinë Himarë
Sipërfaqja sipas projektit	
Popullsia ekuivalente sipas projektit (Banorë)	Aktualisht 3000 banoresh/vizitore/dite dhe me prespektive ne te ardhmen maksimalisht 6000 banoresh/vizitore/dite
Popullsia totale qe i ofrohet shërbimi i trajtimit të ujërave të ndotura	-
Lloji i impiantit të trajtimit:	Trajtim me llum aktiv i tipit MBBR (Biologjik) <i>Impianti është në ndërtim</i>
Kapaciteti trajtues sipas projektit (m³/ditë)	Kapaciteti i trajtimit të llumit 10m³/ore (240m³/ditë)
Volumi ujit të ndotur që hyn në ITUN (000m³)	-
Volumi ujit të ndotur që del i trajtuar (000m³):	-

1.5 Vlerësimi për cilësinë e ujërave sipërfaqësore

1.5.1. Cilësia e ujërave për parametrat fiziko-kimik

1.5.1.1 Lumenj

- Stacionet e monitorimit




Figura 2 - Stacionet e monitorimit të ujërave të lumenjve

- Standartet e cilësisë

Vlerësimi i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE.

Tabela 5 - Vlerat limite të parametrave kimike në lumenj sipas DKU

	Njësia	Vlerat limite te parametrave kimike				
		Gjendje e Lartë Kl.I	Gjendje e Mirë Kl.II	Gjendje e Moderuar Kl.III	Gjendje e Varfër Kl.IV	Gjendje e Keqe Kl.V

Oksigjen i tretur	mgO/l	>7	>6	>5	>4	<3
NBO ₅	mg/l	<2	<3.5	<7	<18	>18
pH (acid)			>6.5	>6		
pH (alkalin)			<8.5	<9		
NH ₄	mgN/l	<0.05	<0.3	<0.6	<1.5	>1.5
NO ₂	mgN/l	<0.01	<0.06	<0.12	<0.3	>0.3
NO ₃	mgN/l	<0.8	<2	<4	<10	>10
PO ₄	mgP/l	<0.05	<0.10	<0.2	0.5	>0.5
P-total	mgP/l	<0.1	<0.20	<0.4	<1	>1

- Vlerësimi i gjendjes

Baseni i Drinit


Ky basen monitorohet në 7 stacione kampionimi që nga stacioni i referencës, burimi i tij deri para derdhjes në det.

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	D1	Drini i Zi	Topojan – Ura Burrel Peshkopi
2.	D2	Drini	Bahçallëk– Ura Bahçallëk
3.	D3	Drini i Bardhë	Luma - Kukës
4.	Bu1	Buna	Muriqan – afër fshatit, në kufi
5.	Ki	Lumi Kir	Ura e Mesit
6.	Bu2	Buna	Ura e vjetër Shkodër - Shirokë
7.	Dle	Drini Lezhë	Kune – Vain para derdhjes në det

✓ Oksigjeni i tretur

Grafiku i mëposhtëm paraqet vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara, ku vlerësojmë se të gjitha stacionet janë të ngopura me oksigjen me vlera > 7 (Klasa I – Gjendje e lartë)

Figura 3 - Oksigjeni i tretur



✓ Nevoja Biokimike për Oksigjen

Vlerat mesatare të monitorimit janë paraqitur në mënyrë grafike, ku vlerësojmë se ujërat paraqesin cilësi të mirë në lidhje me këtë parametër në rrjedhën e sipërme duke u klasifikuar në Klasën I dhe në Klasën II, ndërsa në stacionet pranë zonave të banuara dhe përkatësisht stacioni DLe – Drini Lezhë klasifikohet në Klasën III – Gjendje e moderuar.




Figura 4 - Nevoja Biokimike për Oksigjen

✓ **Përmbajtja e Amonjakut**

Përcaktimi i përmbajtjes së amonjakut në kampione uji është parametër kryesor i klasifikimit të cilësisë së ujërave sipas DKU. Drini Lezhë ka një përmbajtje më të lartë të amonjakut në vlerën 0.6 mg/l duke u klasifikuar në Klasën III- Gjendje e moderuar.

✓ **Përmbajtja e Nitriteve**

Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar që varion në vlerat $< 0.001 - 0.014$ mg/l duke i klasifikuar të gjitha stacionet në Klasën I – Gjendje e lartë.




Figura 5 - Përmbajtja e amonjakut




Figura 6 - Përmbajtja e nitriteve

✓ **Përmbajtja e Nitrateve**

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar, në vlerat 0.12 – 0.53 mg/l duke i klasifikuar të gjitha stacionet në Klasën I – Gjendje e lartë.




Figura 7 - Përmbajtja e nitrateve

✓ Përmbajtja e fosforit

Referuar vlerave mesatare të monitorimit vërehet se nuk kemi tejkalim të vlerave të lejuara për përmbajtjen e orto – fosfateve. Vlerat më të larta janë vlerësuar në stacionin D1 – Topojan dhe DLe – Drini Lezhë por brenda normës së lejuar.





Figura 8 - Përmbajtja e ortofosfatit

✓ Përmbajtja e fosforit total

Në stacionet e monitoruara vlerësojmë se nuk ka prani të përmbajtjes së fosforit total, duke i klasifikuar stacionet në Klasën I – Gjendje e lartë.



Duke vlerësuar të gjithë parametrat e DKU të paraqitura edhe më sipër, vlerësojmë cilësinë e ujërave të Basenit të Drinit në Klasën III – Gjendje e moderuar duke nënvizuar se në stacionin DLe – Drini Lezhë ka përmbajtje të amonjakut dhe përmbajtje të lëndëve organike në sasi të moderuar ku duhet të mbahet në monitorim pasi është në nivelin kufi të ndotjes.

Baseni i Matit

Ky basen monitorohet në 4 stacione kampionimi në gjithë gjatësinë e vet.

Tabela 6 - Stacionet e monitorimit, Baseni i Matit

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	Ma1	Fani i Madh	Ndërfushë, ndërmjet urave Milot – Kukës dhe Milot - Rrëshen
2.	Ma2	Fani i Vogël	Bukemire – Ura e Vjetër Milot – Kukës që të lidh me Rrugën e Kombit
3.	Ma3	Lumi Mat	Klos – Darsë
4.	Ma4	Lumi Mat	Ura e Re Tiranë - Shkodër

✓ Oksigjeni i tretur

Referuar përmbajtjes së oksigjenit të tretur, vlerësohet se stacionet janë të ngopura me oksigjen.

✓ Nevoja Biokimike për Oksigjen

Vlerësojmë se vlerat mesatare janë nën normën e lejuar duke i klasifikuar stacionet në Klasën II – Gjendje e mirë.




Figura 10 - Oksigjeni i tretur




Figura 11 - Nevoja Biokimike për oksigjen

✓ **Përmbajtja e amonjakut**

Përmbajtja e amonjakut i klasifikon stacionet në cilësi shumë të mirë – Klasa I dhe stacionin Ma 2 – Fani i Vogël në Klasën II – Gjendje e mirë.

✓ **Përmbajtja e nitriteve**

Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar, duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë.




Figura 12 - Përmbajtja e amonjakut




Figura 12 - *Përmbajtja e nitriteve*




Figura 13 - *Përmbajtja e nitrateve*




Figura 14 - Përmbajtja e ortofosfatit

✓ Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar, duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë.

✓ Përmbajtja e fosforit

Referuar grafikut për ortofosfate vihet re se nuk ka tejkalim të vlerave të lejuara për përmbajtjen e orto – fosfateve duke i klasifikuar stacionet në Klasën I – Gjendje e lartë.

✓ Përmbajtja e fosforit total

Referuar pranisë së fosforit total këto stacione klasifikohen në Klasën I – Gjendje e lartë.




Figura 15 - Përmbajtja e fosforit total

Duke vlerësuar të gjithë parametrat bazë të Direktivës Kuadër të Ujit, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Matit klasifikohen në Klasën II – Gjendje e mirë.

Baseni Ishëm – Erzen

Ky basen monitorohet në 10 stacione ku perfshihen lumi Tirana, Lana, Ishëm dhe Erzen.

Tabela 7 - Stacionet e Basenit Ishëm - Erzen

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	T1	Lumi i Tiranës	Ura e Brarit
2.	T2	Lumi i Tiranës	Kamëz – poshtë urës
3.	L1	Lumi i Lanës	Lanabregas- 200 – 300 m sipër gurores Dajti
4.	L2	Lumi i Lanës	Ish dogana Kashar në autostradë 200m poshtë urës,

			700 – 800m nga kryqëzimi i Coca - Colës
5.	Ish1	Lumi Ishëm	Ura Rinas
6.	Ish2	Lumi Ishëm	Ura e Gjolës
7.	Ish3	Lumi Ishëm	Ura Salmer
8.	Er1	Lumi Erzen	Pëllumbas
9.	Er2	Lumi Erzen	Ura e Beshirit
10.	Er3	Lumi Erzen	Sallmone – Fshati Rinia

✓ Oksigjeni i tretur

Vlerat mesatare në stacionet e L2 – Yrshek (Ish Dogana), Ish2 – Ura e Gjolës dhe Ish 3 – Ura Salmer janë nën vlerën e lejuar duke i klasifikuar stacionet në Klasën III – Gjendje e moderuar. Lumi Erzen paraqitet të jetë me ujëra të pasur me oksigjen duke u klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë në të tre stacionet.

✓ Nevoja biokimike për oksigjen

Tejkalim të vlerës limite për parametrin nevoja biokimike për oksigjen kemi në stacionet T2 – Kamëz poshtë urës , L1 – Lanabregas, L2 – Ish Dogana Kashar ku vlera mesatare e ekspeditave të realizuara është 72 mgO/l një vlerë shumë e lartë që dëshmon një shkallë ndotjeje shumë të lartë duke e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe ku duhet të merren masa të menjëhershme (> 18 mg/l). Tejkalim të normës kemi edhe në tre stacionet e monitorimit të Lumit Ishëm ku gjendja paraqitet me një ndotje të lartë e klasifikuar në Klasën V – Gjendje e keqe.

Lumi Erzen në stacionin Er2 – Ura e Beshirit dhe Er3 – Ura Sallmone, paraqitet me vlera në normën kufi duke u klasifikuar në Klasa III – Gjendje e moderuar.




Figura 17 - Nevoja Biokimike për Oksigjen




Figura 16 - Oksigjeni i tretur

✓ Përmbajtja e amonjakut

Në stacionet e monitoruara kemi tejkalim të vlerës limite për përmbajtjen e amonjakut në stacionin T2 – Ura Kamëz, L1 – Lanabregas me vlerën mesatare 9.5 mg/l dhe L2 – Yrshek (Ish Dogana) në vlerën më të lartë 24.7 mg/l duke i klasifikuar këto stacione në Klasën V – Gjendje e keqe, si dhe në tre stacionet e Ishmit të cilat klasifikohen në Klasën V – Gjendje e keqe. Stacionet e Lumit Erzen , Er2 dhe Er3 klasifikohen në Klasën III – Gjendje e moderuar.

✓ Përmbajtja e nitriteve

Përmbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar në të gjitha stacionet e këtij baseni. Përmbajtja më e lartë është vlerësuar në stacionin L1 – Lanabregas por nën normën e lejuar.




Figura 18 - Përmbajtja e amoniakut




Figura 19 - Përmbajtja e nitriteve

✓ Përmbajtja e nitrateve

Përmbajtja e nitrateve në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar.

✓ Përmbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare vjetore, vlerësojme se kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve në stacionin T2 – Ura e Kamzës, L1 – Lanabregas në vlerën 0.749 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe, L2 – Yrshek (Ish Dogana) në vlerën më të lartë 2.009 mg/l duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën V – Gjendje e keqe

Tejkalim të vlerës limite kemi edhe në të tre stacionet e Ishmit duke e klasifikuar këtë lumë në Klasën e V – Gjendje e keqe. Stacionet e Lumit Erzen nuk kanë përmbajtje të fosforit.




Figura 20 - Përmbajtja e nitrates





Figura 21 - Përmbajtja e ortofosfatit

✓ Përmbajtja e fosforit total

Referuar vlerave mesatare të ekspeditave të realizuara vlerësojmë se stacioni L2 – Lanabregas ka përmbajtje të lartë dhe i përket Klasës V – Gjendje e keqe. Gjithashtu, është vlerësuar se ka prani të fosforit total në vlera të larta në një stacion të lumit Tirana dhe dy prej stacioneve të monitorimit të Lumit Ishëm. Lumi i Erzenit nuk ka përmbajtje të fosforit total.



Vlerësohet se në stacionet e referencës lumenjtë janë të pastër, ndërsa duke kaluar afër zonave të banuara impakti i shkarkimeve urbane të cilat derdhen direkt të patrajtuarra sjell këtë klasifikim me një ndotje të lartë. Baseni Ishëm – Erzen klasifikohet në Klasën V – Gjendje e keqe.

Baseni i Shkumbinit

Monitorimi i këtij baseni realizohet në 4 stacione kampionimi në të gjithë gjatësinë e tij.

Tabela 8 - Stacionet e Basenit të Shkumbinit

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	Sh1	Lumi i Shkumbinit	Qukës – 500 mbi fshatin Qukës
2.	Sh2	Lumi i Shkumbinit	Ura Toplias
3.	Sh3	Lumi i Shkumbinit	Ura e Paprit
4.	Sh4	Lumi i Shkumbinit	Ura Rrogozhinë

✓ Oksigjeni i tretur

Stacionet dëshmojnë për ujëra të ngopura me oksigjen duke i klasifikuar ujërat e Basenit të Shkumbinit në Klasën I – Gjendje e lartë.

✓ Nevoja Biokimike për oksigjen

Referuar vlerave vlerësohet se nuk ka tejkalim të vlerës limite për këtë parametër në asnjë nga stacionet e monitoruara.





Figura 22 - Baseni i Shkumbinit, Oksigjeni i tretur



✓ Përbajtja e amonjakut

Përqendrimi i amonjakut paraqitet nën normën e lejuar për të gjitha stacionet duke u klasifikuar në Klasën II – Gjendje e mirë.

Figura 23 – Baseni i Shkumbinit, Nevoja Biokimike për Oksigjen

✓ Përbajtja e nitriteve

Përbajtja e nitriteve është në vlera të cilat variojnë 0.0018 – 0.012 mg/l dhe janë nën normën e lejuar duke i vlerësuar stacionet në Klasën I – Gjendje e lartë.




Figura 24 - Baseni i Shkumbinit, Përbajtja e amoniakut

✓ Përmbajtja e nitrave

Përmbajtja e nitrave në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.

✓ Përmbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se nuk kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve.




Figura 26 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e nitrave




Figura 25 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e nitrave

✓ Përmbajtja e fosforit total

Referuar vlerave mesatare vjetore vlerësojmë se stacionet nuk e tejkalojnë vlerën e lejuar, përmbajtja e të cilave varion nga 0.007mg/l – 0.025 mg/l duke i klasifikuar në Klasën I - Gjendje e lartë




Figura 27 - Baseni i Shkumbinit, Përmbajtja e fosforit total

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se ujërat e Basenit të Shkumbinit klasifikohen në Klasën e II – Gjendje e mirë.

Baseni i Vjosës

Baseni i Vjosës monitorohet në 5 pika monitorimi.

Tabela 9 - Pikat e monitorimit të Basenit të Vjosës

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	Vj1	Lumi i Vjosës	Çarshovë – pas fshatit Petran
2.	Vj2	Lumi i Vjosës	Ura e qytetit
3.	Vj3	Lumi Drino	Ura e Leklit - Tepelenë
4.	Vj4	Lumi i Vjosës	Ura Memaliaj
5.	Vj5	Lumi i Vjosës	Ura e Mifolit - Vlorë

✓ Oksigjeni i tretur

Vlerat mesatare vjetore të ekspeditave të realizuara janë paraqitur në formë grafike si vijon, ku vlerësojmë se ujërat e këtyre 5 stacioneve të monitoruara janë të pasura me oksigjen duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.

✓ Nevoja biokimike për oksigjen

Ky parametër për të gjithë stacionet është brenda vlerës limite të lejuar duke i klasifikuar stacionet në klasën II – Gjendje e mirë.




Figura 28 - Baseni i Vjosës, Oksigjeni i tretur

✓ **Përmbajtja e amonjakut**

Ujërat e këtyre stacioneve për përmbajtjen e amonjakut janë të një cilësie shumë të mirë, të klasifikuara në Klasën I – Gjendje e lartë.

✓ **Përmbajtja e nitriteve**

Përmbajtja e nitriteve në stacionet e monitorimit të Basenit të Vjosës është në vlera shumë të ulëta, në nivelin e limitit të dedektimit duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë.




Figura 29 - Baseni i Vjosës, Përmbajtja e amoniakut




Figura 30 - Baseni i Vjosës, Përmbajtja e nitriteve

✓ Përmbajtja e nitrave

Përmbajtja e nitrave në të gjitha stacionet e monitoruara rezulton në vlera më të ulëta se norma e lejuar duke i klasifikuar në Klasën I – Gjendje e lartë të gjitha stacionet e monitoruara.




Figura 31 - Baseni i Vjosës, përmbajtja e nitrave

✓ Përmbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se nuk kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve duke i klasifikuar këto stacione në Klasën I – Gjendje e lartë përse i përket përmbajtjes së fosforit.




Figura 32 - Baseni i Vjosës, përmbajtja e ortofosfatit

✓ **Përmbajtja e fosforit total**

Referuar vlerave mesatare të cilat variojnë nga 0.0045 mg/l – 0.044 mg/l vlerësojme se stacionet nuk e tejkalojnë vlerën e lejuar duke i klasifikuar në Klasën I - Gjendje e lartë(< 0.1mgP/l).




Figura 33 - Baseni i Vjosës, përmbajtja e fosforit total

Referuar vlerave për të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se stacionet e Basenit të Vjosës klasifikohen si ujëra me cilësi të mirë të cilat renditen në Klasën II – Gjendje e mirë.

Baseni i Semanit

Ky basen monitorohet në 8 pika monitorimi në të gjithë gjatësinë e tij.

Tabela 10 - Pikat e monitorimit Baseni Seman

Nr.	Kodi i kampionit	Emërtimi i Lumit	Vendndodhja
1.	Dv0	Lumi i Semanit	Bilisht – Ura e Treshit
2.	Dv1	Lumi Devoll	Kuçovë – Ura Kuçovë Kozarë
3.	Os1	Lumi Osum	Ura Lapan
4.	Os2	Lumi i Osumit	Fshati Uznovë
5.	Os3	Lumi i Osumit	Ura Vajgurore
6.	Gj4	Lumi Gjanicë	Ura e Qytetit Fier
7.	Se5	Lumi Seman	Ura e Mbrostarit
8.	Se6	Lumi Seman	Mujalli, Libofsh

✓ Oksigjeni i tretur

Ujërat e basenit Seman janë të ngopura me oksigjen.

✓ Nevoja Biokimike për oksigjen

Ky parametër është i rëndësishëm për vlerësimin e cilësisë së ujërave të lumenjve si një tregues i shkallës së ndotjes, ku stacioni Gj4 – Ura e qytetit ka një përmbajtje të lartë të NBO₅ duke e klasifikuar këtë stacion në Klasën IV – Gjendje e Varfër, pasi impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale të qytetit është i ndjeshëm.




Figura 34 - Baseni i Semanit, Oksigjeni i tretur




Figura 35 - Baseni i Semanit, Nevoja Biokimike për Oksigjen

✓ Përbajtja e amonjakut

Referuar vlerave mesatare vjetore, vlerësojmë ndotje në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier me një përbajtje 1.28 mg/l klasifikuar në Klasën IV – Gjendje e varfër.




Figura 36 - Baseni i Semanit, Përbajtja e amoniakut

✓ Përbajtja e nitriteve

Përbajtja e nitriteve është nën normën e lejuar duke i vlerësuar në cilësi të mirë, Klasa I – Gjendje e Lartë.




Figura 37 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e nitriteve

✓ Përmbajtja e nitrateve është brenda normës së lejuar për të gjithë stacionet e monitoruar.




Figura 38 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e nitrateve

✓ Përmbajtja e fosforit

Referuar të dhënave mesatare, vlerësojmë se kemi tejkalim të vlerës limite të përmbajtjes së orto – fosfateve në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier me një përmbajtje 0.29 mg/l duke e klasifikuar stacionin në Klasën IV – Gjendje e varfër.




Figura 39 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e nitrteve

✓ Përmbajtja e fosforit total

Stacionet nuk e tejkalojnë vlerën e lejuar, përmbajtja më e lartë është vlerësuar në stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier por brenda normës së lejuar.




Figura 40 - Baseni i Semanit, Përmbajtja e fosforit total

Duke marrë në konsideratë të gjithë parametrat e DKU, vlerësojmë se Baseni i Semanit klasifikohet në Klasën IV- gjendje e varfer me nje ndotje te konstatuar ne stacionin Gj4 – Ura e qytetit Fier ku impakti i shkarkimeve urbane dhe industriale është i lartë.

Duke vlerësuar të dhënat e marra nga ekspeditat e kryera është vlerësuar se në rrjedhën e sipërme ujërat janë të një cilësie shumë të mirë por duke zbritur afër zonave urbane vihet re një impakt shumë i lartë i shkarkimeve që shkojnë direkt në lumë pa asnjë lloj trajtimi paraprak si pasojë e shkarkimeve urbane, industriale e bujqësore duke ndikuar në cilësinë e ujërave sipërfaqësore.

Lumenjtë më të ndotur në Shqipëri janë Lumi i Tiranës me stacionet e monitorimit më të ndotura Ura – Kthesa e Kamzës, Lanabregas dhe Yrshek – Ish Dogana, Lumi Ishëm me të tre stacionet e monitorimit Ura Rinas, Ura e Gjolës dhe Ura Salmer. Ndërsa në Basenin e Semanit Lumi Gjanica i klasifikuar në Klasën IV – Gjendje e varfër.

Ky vlerësim i situatës së lumenjve kryesorë të Shqipërisë ka impaktin e vet në cilësinë e ujërave nëntokësore, në cilësinë e deteve dhe në ekosistemet ujore dhe përmirësimi i tyre lidhet me :

- Shfrytëzimin i inerteve pa kriter në zona të caktuara
- Mënjanimi i shkarkimeve urbane
- Ndërtimi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza
- Ndërgjegjësimi i qytetarëve për mos-përdorimin e lumenjve si vend-depozitime

Bazuar mbi trendin ndër vite vlerësohet se baseni i matit, Vjosës, Ishëm -Erzen përgjatë 3 viteve të fundit ruajnë të njëjtin klasifikim të cilësisë të ujërave . Cilësia e ujërave të basenit Seman është përmirësuar gjatë dy viteve të fundit krahasuar me 2022. Vërehet përmirësim i cilësisë të ujërave në basenet Drini-Bunë dhe Shkumbin krahasuar me vitin 2023.

Tabela 11 - Cilësia e ujërave për Basenet 2018 - 2024

Viti	Baseni Drini-Bunë	Baseni Ishëm-Erzen	Baseni i Shkumbinit	Baseni i Semanit	Baseni i Vjosës	Baseni i Matit
2018	Klasa III	Klasa V	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2019	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa II
2020	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2021	Klasa IV	Klasa V	Klasa II	Klasa V	Klasa II	Klasa III
2022	Klasa III	Klasa V	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa II
2023	Klasa IV	Klasa V	Klasa III	Klasa IV	Klasa II	Klasa II
2024	Klasa III	Klasa V	Klasa II	Klasa IV	Klasa II	Klasa II

1.5.1.2 Liqenet

- Stacionet e monitorimit

Rrjeti i monitorimit përfshin stacione në liqenet natyrale Shkodër, Ohër, Prespë, Prespë e Vogël dhe për tributarët e liqenit të Ohrit (lumi Pogradec, Tushemisht, Vërdovë).




Figura 41 - Monitorimi i Ujërave të Liqeneve



Figura 42 - Harta e monitorimit të lumenjve

- *Standartet e cilësisë*

Vlerësimi i cilësisë së lumenjve dhe liqeneve përcaktohet në bazë të parametrave fiziko-kimikë duke i krahasuar me normat e lejuara të përcaktuara në Direktivën Kuadër të Ujit të BE.

Tabela 12 - Vlerat limite të cilësisë së ujërave të liqeneve sipas DKU

Parametrat	Njësia matëse	Vlerat limite për përcaktimin e gjendjes		
		Oligotrofik	Mezotrofik	Eutrofik
Transparenca	m	5-10 (max 15-20)	1-2 (max.5-10)	<1 (max 2-3)
Nevoja Kimike për Oksigjen (NKO)	mg O ₂ /l	1-2	8-9	20-65
Nevoja Biokimike për Oksigjen(NBO ₅)	mg O ₂ /l	<3	3-5,5	5,5-14
Nitrate (NO ₃ -N)	mg N/l	<1	<1	>2
Fosfor total (P-total)	µg P/l	4-10	10-35	35-100

- Vlerësimi i gjendjes

Liqeni i Shkodrës

Monitorimi i Liqenit të Shkodrës realizohet në tre stacione në Koplik (Stërbec), Shirokë dhe Zogaj, ku në çdo pikë monitorimi janë kampionuar mostra në 2 thellësi të ndryshme: 0 m dhe 10m.

Transparenca e ujit

Vlerat mesatare të këtij parametri variojnë nga 1.3 m – 1.6 m duke i klasifikuar ujërat me cilësi mezotrofike.

Nevoja kimike për oksigjen

Referuar vlerave mesatare të përmbajtjes kimike për oksigjen në të tre stacionet e Liqenit të Shkodrës vlerësojmë se ujërat e liqenit janë të cilësisë mezotrofike.




Figura 43 - Liqeni i Shkodrës, Transparenca




Figura 44 - Liqeni i Shkodrës, Nevoja kimike për oksigjen

✓ Nevoja biokimike për oksigjen

Nevoja biokimike për oksigjen paraqitet me vlera të cilat i klasifikojnë ujërat e liqenit në cilësi mezotrofike në te tre stacionet e monitoruar.

✓ Përmbajtja e nitrave

Ky parametër rezulton të plotësojë kushtet për cilësi oligotrofike, pasi vlerat mesatare të monitorimit janë < 1 mgN/l.




Figura 45 - Liqeni i Shkodrës, Nevoja biokimike për oksigjen




Figura 46 - Liqeni i Shkodrës, Përmbajtja e nitrave

✓ Përmbajtja e fosforit total

Përmbajtja mesatare e fosforit total në stacionin e Koplikut rezulton më e lartë duke e klasifikuar me cilësi mezotrofike.




Figura 47 - Liqeni i Shkodrës, Përmbajtja e fosforit total

Duke u nisur nga vlerat e transparencës, të nevojës kimike për oksigjen dhe nevojës biokimike për oksigjen rezulton se ujërat e liqenit të Shkodrës janë të cilësisë mezotrofike.

Liqeni i Ohrit

Monitorimi i Liqenit të Ohrit është realizuar në dy pika, ku stacioni i parë është stacion reference në thellësi 150 metra, dhe mostrat merren në 8 thellësi nga sipërfaqja deri në fund të liqenit e përkatësisht 0, 20, 40, 60, 80, 100, 120, 150 m, kurse stacioni nr.2 është 200 m nga bregu, përballë qytetit, në thellësi mbi 5 metra.

✓ Transparenca e ujit

Transparenca e matur në stacionin e referencës ka një vlerë mesatare 6.4 m i cili është një tregues i oligotrofisë së këtij liqeni, ndërsa në stacionin litoral transparenca është në vlerën 5.5 m.

Ujërat e liqenit janë të ngopura me oksigjen me vlera që variojnë 7 – 9.4 mgO/l. Liqeni i Ohrit për parametrin e transparencës paraqet gjendje oligotrofike në të dy stacionet.

✓ Nevoja kimike për oksigjen

Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen në stacionin e referencës paraqet vlerën 4 mg/l, ndërsa në stacionin litoral në vlerën 5.6 mg/l duke e klasifikuar me cilësi mezotrofike.




Figura 48 - Liqeni i Ohrit, Transparenca




Figura 49 - Liqeni i Ohrit, Nevoja Kimike për Oksigjen

✓ Nevoja biokimike për oksigjen

Përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen për stacionin e referencës është në vlerën 2.3mgO/l, ndërsa në stacionin litoral është 3mg/l duke i vlerësuar në cilësi oligotrofike të dy stacionet.




Figura 50 - Liqeni i Ohrit, Nevoja Biokimike për Oksigjen

✓ Përmbajtja e nitrateve

Ky parametër rezulton të plotësojë kushtet për cilësi oligotrofike për stacionin e referencës, pasi në stacionin litoral është vlerësuar përmbajtja e nitrateve në vlerën 1.4 mgN/l duke u klasifikuar në cilësi mezotrofike.




Figura 51 - Liqeni i Ohrit, Përmbajtja e nitrateve

✓ Përmbajtja e fosforit total

Vlera mesatare e përmbajtjes së fosforit total në të dy stacionet është e ulët duke i klasifikuar stacionet në cilësi oligotrofike.




Figura 52 - Liqeni i Ohrit, Përmbajtja e Fosforit total

Duke vlerësuar të gjithë parametrat e monitoruar vlerësojmë cilësinë e Liqenit të Ohrit oligotrofike.

Tributarët e liqenit të Ohrit (Lumi i Pogradecit, Lumi Vërdovë, Lumi Tushemisht)

Ujërat e këtyre tre lumenjve vlerësohen acide me $\text{pH} > 6.5$, me vlera që variojnë nga 7.45 – 8.68. Temperaturat mesatare të ujërave variojnë në përputhje me ndryshimet sezonale.

Lumi i Pogradecit

Tabela 13 - Klasifikimi sipas parametrave Lumi Pogradec

Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
Përmbajtja e Nevoja biokimike për Oksigjen	2.6 mg/l	< 7	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e amonjakut	0.1 mg/l	< 0.6	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e nitriteve	0.038 mg/l	< 0.12	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e nitrateve	1.21 mg/l	< 4	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e orto – fosfateve	0.019 mg/l	< 0.2	Gjendje e lartë – Klasa I
Përmbajtja e fosforit total	0.023 mg/l	< 0.4	Gjendje e lartë – Klasa I

Bazuar në vlerat mesatare vjetore, Lumi i Pogradecit klasifikohet në lumë me cilësi të mirë.

Lumi Vërdovë

Tabela 14 - Klasifikimi sipas parametrave Lumi Vërdovë

Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
Përmbajtja e Nevoja biokimike për Oksigjen	4.3 mg/l	< 7	Gjendje e moderuar – Klasa III
Përmbajtja e amonjakut	0.39 mg/l	< 0.6	Gjendje e moderuar – Klasa III

Përmbajtja e nitriteve	0.1 mg/l	< 0.12	Gjendje e moderuar – Klasa III
Përmbajtja e nitrateve	1.16 mg/l	< 4	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e orto – fosfateve	0.14 mg/l	< 0.2	Gjendje e moderuar – Klasa III
Përmbajtja e fosforit total	0.15 mg/l	< 0.4	Gjendje e mirë – Klasa II

Lumi i Vërdovës referuar gjithë parametrave të mësipërm klasifikohet në një lumë me cilësi të moderuar ku vlerësohet përmbajtje e amonjakut dhe fosforit, të cilat dëshmojnë për shkarkime urbane të cilat derdhen direkt pa asnjë trajtim paraprak.

Lumi Tushemishtit

Tabela 15 - Klasifikimi sipas parametrave Lumi Pogradec

Parametri	Vlera mesatare vjetore	Norma	Klasifikimi
Përmbajtja e Nevoja biokimike për Oksigjen	2.6 mg/l	< 7	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e amonjakut	0.034 mg/l	< 0.6	Gjendje e lartë – Klasa I
Përmbajtja e nitriteve	0.03 mg/l	< 0.12	Gjendje e mirë – Klasa II
Përmbajtja e nitrateve	0.45 mg/l	< 4	Gjendje e lartë – Klasa I
Përmbajtja e orto – fosfateve	0.011 mg/l	< 0.2	Gjendje e lartë – Klasa I
Përmbajtja e fosforit total	0.015 mg/l	< 0.4	Gjendje e lartë – Klasa I

Lumi i Tushemishtit referuar parametrave të statusit kimik vlerësohet në ujëra me cilësi të mirë.

Duke marrë parasysh klasifikimin e cilësisë së ujërave të tributarëve ndër vite, vlerësojmë se:

- ✓ Kemi të njëjtën status të cilësisë të lumit Pogradec për 2022-2024 në Klasa II-Gjendje e mirë.
- ✓ Cilësia e ujërave të lumit Vërdovë është përmirësuar dy vitet e fundit krahasuar me vitin 2022.
- ✓ Gjatë 2024 vërehet përkeqësim i cilësisë së ujërave në lumin Tushemisht krahasuar me vitin 2023, duke kaluar nga gjendje e lartë në gjendje të mirë.

Tabela 16 - Krahasim për gjendjen e lumenjve 2018 - 2024

Viti	Lumi i Pogradecit	Lumi i Vërdovës	Lumi i Tushemishtit
2018	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa II - Gjendje e mirë
2019	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa II - Gjendje e mirë
2020	Klasa II- Gjendje e mirë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa I - Gjendje e lartë
2021	Klasa I - Gjendje e lartë	Klasa V- Gjendje e keqe	Klasa I - Gjendje e lartë
2022	Klasa II-Gjendje e mirë	Klasa IV - Gjendje e varfër	Klasa II- Gjendje e mirë
2023	Klasa II-Gjendje e mirë	Klasa III- Gjendje e moderuar	Klasa I - Gjendje e lartë
2024	Klasa II-Gjendje e mirë	Klasa III- Gjendje e moderuar	Klasa II- Gjendje e mirë

Liqeni i Prespës

Monitorimi i Liqenit të Prespës së Madhe realizohet në tre pika kampionimi përkatësisht në Goricë, Liqenas dhe Gollomboç dhe monitorimi i Prespës së Vogël realizohet në një pikë kampionimi.

- ✓ Transparenca e ujit

Vlera mesatare e transparencës për ujërat e liqenit të Prespës së Madhe janë 2.58 m duke e klasifikuar Prespën e Madhe me cilësi mezotrofike dhe në Prespën e Vogël vlera e transparencës është 0.75 m.





Figura 53 - Liqeni i Prespës, Transparenca

✓ Nevoja kimike për oksigjen

Në të tre stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave të Liqenit të Prespës së Madhe kemi një klasifikim në cilësi mezotrofike të ujërave me tendence eutrofike, ndërsa Prespa e Vogël klasifikohet në cilësi eutrofike.



✓ Nevoja biokimike për oksigjen

Figura 54 - Liqeni i Prespës, Nevoja Kimike për Oksigjen

Përsa i përket nevojës biokimike për oksigjen në të tre stacionet e monitorimit të Prespës së Madhe dhe në Prespën e Vogël janë matur vlera të larta të NBO_5 .




Figura 55 - Liqeni i Prespës, Nevoja Biokimike për Oksigjen

✓ Përmbajtja e nitrateve

Ky parametër është vlerësuar brenda normës së lejuar $< 1\text{mg/l}$ për të gjitha stacionet.




Figura 56 - Liqeni i Prespës, Përmbajtja e Nitratesve

✓ Përmbajtja e fosforit total

Referuar përmbajtjes mesatare të fosforit total është vlerësuar përmbajtje e fosforit total në Prespën e Vogël duke e klasifikuar në cilësi mezotrofike.




Figura 57 - Liqeni i Prespës, Përmbajtja e fosforit total

Duke u nisur nga vlerësimi i të gjithë parametrave bazë të mësipërm, vlerësojmë se ujërat e Liqenit të Prespës së Madhe janë të cilësisë mezotrofike me tendence eutrofike, ndërsa ujërat e Prespës së Vogël të cilësisë eutrofike.

Nga krahasimi me vitin 2023 shihet se ujërat e liqeneve të Shkodrës, Prespë e madhe dhe Prespë e Vogël ruajnë të njëjtën cilësi. Vërehet përmirësim i cilësisë të ujërave të liqenit të Ohrit duke kaluar nga status mezotrofik në oligotrofik.

Tabela 17 - Ndryshimi i Statusit për Liqenet 2023 - 2024

	2023	2024
Liqeni i Shkodres	Mezotrofik	Mezotrofik
Liqeni i Ohrit	Mezotrofik	Oligotrofik
Liqeni Prespë e Madhe	Mezotrofik	Mezotrofik
Liqeni Prespë e Vogël	Eutrofik	Eutrofik

Rekomandime

Rekomandojmë marrjen e masave nga organet e Pushtetit Vendor apo edhe në nivel Kombëtar për të minimizuar shkaktarët e ndotësve pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në lumenj, liqene apo edhe nëzona bregdetare.

Përmirësimi i situatës mjedisore të ujërave sipërfaqësore kërkon realizimin e investimeve në trajtimin të shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në Tiranë, Fier e në qytetet e mëdha të zonës bregdetare pasi gjendja dhe cilësia e tyre vazhdon të jetë në të njëjtën situatë.

Të respektohen standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për shkarkimet e lëngëta nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësorë. Nga ana tjetër kontrolli i vazhdueshëm në zbatimin e ligjit do të luante një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Përdorimi i shërbimeve satelitore për monitorimin e cilësisë së ujërave në liqenet Fierzë, Koman, Ulzë, Bulqizë, Vau i Dejës.

Prezantimi i Marrëveshjes dhe Shërbimeve Satelitore

Në Shtator të vitit 2022, Republika e Shqipërisë nënshkroi një marrëveshje trevjeçare me kompaninë “Satellogic” për ofrimin e shërbimit satelitor për vendin tonë. Ky shërbim ofron dy satelitë të dedikuar, Albania-1 dhe Albania-2, të cilët mbledhin imazhe multispektrale dhe hyperspektrale. Këto imazhe ofrojnë qasje të avancuar në informacionin gjeohapësinor, duke pasqyruar trendet globale të përdorimit të teknologjisë për mbledhjen e të dhënave për përdorimin e tokës.

Fushat e Aplikimit të Imazheve Satelitore

Imazhet satelitore janë të dobishme në disa fusha të aplikimit, të cilat përfshijnë:

- **Mbulesa e Tokës:** Përdorimi për monitorimin dhe analizën e mbulesës së tokës, duke mundësuar vlerësimin e përdorimit të saj.
- **Monitorimi i Pyjeve:** Ndhmon në ndjekjen e shëndetit të pyjeve dhe identifikimin e mundësive të menaxhimit të tyre.
- **Vlerësimi i Cilësisë së Ujit:** Vlerësimi dhe monitorimi i cilësisë së ujërave në lumenj, liqene, dhe laguna, duke përfshirë indikatorë si klorofila, sedimentet dhe kripësia.

- **Ortoimazheria:** Përdorimi i imazheve satelitore për krijimin e hartave dhe pamje të sakta gjeografike.

Vlerësimi i Cilësisë së Ujërave

Një nga fushat kryesore ku përdoren këto imazhe satelitore është **vlerësimi i cilësisë së ujërave**. Ky proces përfshin matjen e disa indekseve të rëndësishme për trupat ujore si lumenj, liqene dhe laguna. Indeksat që përdoren për këtë qëllim janë:

Indeksi i Klorofilës: Ky indeks përcakton prani të algave në ujërat sipërfaqësore. Algat janë një indikator i rëndësishëm për cilësinë e ujit, pasi një prani e madhe e tyre mund të tregojë ndotje ose ndryshime në ekosistemin e ujit. Algat gjithashtu mund të ndikojnë në shëndetin e ujërave, duke shkaktuar rritje të turbullirave dhe të oksigjenit të ulët në ujë, të cilat janë të dëmshme për jetën ujore.

Indeksi i Sedimentit: Ky indeks mat lëndën pezull në ujërat sipërfaqësore. Sedimentet janë pjesë të rëndësishme që ndikojnë në shëndetin ekologjik të ujërave dhe mund të shkaktojnë turbullira që ndikojnë negativisht në ekosistemin ujore. Turbullirat mund të bllokojnë dritën për algat dhe bimët ujore, duke ndikuar në proceset e fotosintezës dhe duke shkaktuar ndryshime në cilësinë e ujit dhe biodiversitetin e tij.

Indeksi i Turbulencës: Ky indeks mat shkallën e turbullirave dhe lëvizjes së ujërave në trupat ujore. Turbulenca ka një ndikim të drejtpërdrejtë në cilësinë e ujit, pasi mund të shpërndajë lëndë të ndryshme si sedimentet, ndotësit dhe materie organike, që mund të ndikojnë në ekosistemin e ujit dhe biodiversitetin. Vlerësimi i turbulencës ndihmon në parashikimin e përhapjes së ndotësve dhe mundësitë për reduktimin e ndotjes së ujit.

Përmes përdorimit të satelitëve Albania-1 dhe Albania-2, Shqipëria ka mundësinë të mbledhë të dhëna të sakta dhe të përditësuara për gjendjen e burimeve natyrore, si dhe të monitorojë ndryshimet në mjedis me efikasitet më të madh. Ky shërbim mundëson një mbikëqyrje të avancuar të ekosistemit dhe ndihmon në marrjen e masave të duhura për menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe mbrojtjen e mjedisit.

Teknologjia satelitore ofron mundësi të jashtëzakonshme për monitorimin e vazhdueshëm të ekosistemeve ujore dhe tokësore, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqeneve për treguesit klorofil-a, turbulence dhe sediment paraqitet në imazhet satelitore të mëposhtme. Vlerësimi për përmbajtjen e treguesve bazohet mbi klasifikimin e gjendjes sipas ngjyrave që paraqiten në imazhet satelitore ku;

- “E lartë” - tregon se ka përmbajtje të lartë të treguesve dhe ka ndotje
- “E ulët” - tregon se ka përmbajtje të ulët të treguesve dhe nuk ka ndotje.

Liqeni i Fierzës



Figura 58 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Fierzës për treguesit klorofil-a.



Figura 59 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Fierzës për treguesin turbulence.



Figura 60 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Fierzës për treguesin sediment.

Liqeni Vau i Dejës




Figura 61 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Vau i Dejës për treguesit klorofil-a



Figura 62 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Vau i Dejës për treguesin turbulence



Figure 63 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Vau i Dejës për treguesin sediment.

Liqeni i Komanit



Figura 64 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Komanit për treguesin klorofil



Figura 65 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Koman për treguesin turbulence.



Figura 66 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit Koman për treguesin sediment.

Liqeni i Ulzës




Figura 67 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Ulzës për treguesin klorofil-a



Figura 68 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Ulzës për treguesin turbulence




Figura 69 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Ulzës për treguesin sediment

Liçeni i Bulqizës




Figura 70 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Bulqizës për treguesin klorofil-a



Figura 71 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Bulqizës për treguesin turbulence




Figura 72 - Vlerësimi i cilësisë së ujit të liqenit të Bulqizës për treguesin sediment.

1.5.2 Radioaktiviteti në ujëra

- Stacionet e monitorimit

Tabela 18 - Stacionet e monitorimit

Lumi dhe pika e mostrimit	Koordinatat	Sezoni I dhe II
Lumi Drin (Baçallëk, Shkodër)	N 42° 02' 630; E 19° 29' 57"	Muaji Qershor/Nëntor
Lumi Mat (Ura e Re në Milot)	N 41° 41' 223; E 19° 44' 43"	Muaji Qershor/Nëntor
Lumi Erzen (Ura e Peshkatarit)	N 41°15' 43"; E 19° 52' 11"	Muaji Qershor/Nëntor
Lumi Erzen (Ura e Beshirit)	N 41°17' 33"; E 19° 43' 28"	Muaji Qershor/Nëntor
Lumi Shkumbin (Qukës)	N 41° 09' 28; E 19° 43' 43"	Muaji Qershor/Nëntor
Lumi Shkumbin (Ura Rrogozhinë)	N 44° 03' 039; E 19° 38' 55"	Muaji Qershor/Nëntor
Lumi Vjosë (Ura e Mifolit)	N 40° 38' 126; E 19° 27' 67"	Muaji Qershor/Nëntor
Stacioni i Fallout		
Tiranë (IFBZ)	N 41°34' 80"; E 19° 85' 60"	Muaji Qershor/Nëntor

- Standartet e cilësisë

Sipas legjislacionit Shqiptar të përditësuar (VKM Nr. 403, datë 19.06.2024) dhe rregullave të KE, normat e lejuara për ujin e pijshëm janë: 0.1 Bq/l për radioaktivitetin alfa total dhe 1 Bq/l për radioaktivitetin beta total.

- Vlerësimi i gjendjes

Aktiviteti alfa-total i ujërave të lumenjve të monitoruar

Vlera më e lartë e aktivitetit alfa total për sezonin e pranverës vrojtohet në lumin Vjosë (Ura e Mifolit), (97.79 ± 9.82) mBq/L, ndërsa vlera më e lartë e aktivitetit alfa total në sezonin e vjeshtës vrojtohet në lumin Erzen (Ura e Peshkatarit),


(99.13 ± 9.65) mBq/L. Luhatja e vlerave varion në intervale rreth 30 - 50 % më e madhe në krahasim me sezonin e pranverës, por këto vlera janë të pranueshme.

Ndërsa vlerat më të ulta për sezonin e pranverës në lumin Shkumbin (Qukës) LLD (vlera më e ulët e detektimit), ndërsa për sezonin e vjeshtës vërohet në lumin Vjosë (ura e Mifolit) LLD (vlera më e ulët e detektimit). Duke u referuar bazës së të dhënave të viteve të kaluara që ka IFBZ (vitet 2000-2005, 2015, 2023, 2024) ka luhatje të vlerave që mund të konsiderohen variacion sezonal normal brenda limit të lejuar.


Aktiviteti Beta-total i ujërave të lumenjve

Vlera më e lartë e aktivitetit beta total në sezonin e pranverës vërohet në lumin Drin (Baçallëk, Shkodër) 864.60 ± 87.15 mBq/L ndërsa vlera më e lartë e aktivitetit beta total në sezonin e vjeshtës vërohet në lumin Erzen, (ura e Peshkatarit) 751.05 ± 74.19 mBq/L. Vlera më e ulët në sezonin e pranverës vërohet në lumin Erzen (Ura e Beshirit) 282.58 ± 29.14 mBq/l, ndërsa vlera më e ulët në sezonin e vjeshtës vërohet në lumin Mat (Ura e Milotit) 458.09 ± 47.21 mBq/l.

Në një vlerësim vjetor shihet që vlerat e radioaktivitetit beta total janë relativisht më të larta se viti i kaluar 2023, mesatarisht 20%, por këto mund të jenë si rezultat i shumë faktorëve, sidomos i reshjeve sezonale. Vlen të theksojmë se lumi Erzen, (ura e Peshkatarit) kishte vlerën më të lartë edhe sezonin e kaluar, por gjithësesi brenda normave të lejuara. Përgjithësisht janë variacione të pranueshme, nisur nga statistikat edhe të rajonit.



Grafiku 1. Vlerat e radioaktivitetit alfa/beta total (në mBq/L) të kampioneve të marra në lumenj pranverë 2024



Grafiku 2. Vlerat e radioaktivitetit alfa/beta total (në mBq/L) të kampioneve të marra në lumenj vjeshtë 2024

Tabela 19 - Vlerat e radioaktivitetit alfa dhe beta total vjetore të kampioneve të marra në lumenj

Lumi dhe pika e kampionimit	Aktiviteti alfa totale vjetore mBq/L	Aktiviteti beta totale vjetore mBq/L
Lumi Mat (Ura e Re në Milot)	76.83	527.01
Lumi Drin (Bacallëk, Shkodër)	89.7	766.16
Lumi Erzen (Ura e Beshirit)	32.42	509.93
Lumi Erzen (Ura e Peshkatarit)	85.75	723.08
Lumi Shkumbin (Qukës)	98.65	643.23
Lumi Shkumbin (Ura Rrogozhinë)	59.23	702.40
Lumi Vjosë (Ura e Mifolit)	97.79	686.09
Stacioni për Fallout	Aktiviteti alfa total vjetor	Aktiviteti alfa total vjetor
IFBZ, Tiranë	< LLD*	0.5

*LLD, Limiti më i vogël i dedektimit

Aktiviteti alfa-beta total i precipitimeve atmosferike (Fallout)

Përsa i perket vlerave të aktivitetit alfa-beta total të precipitimeve atmosferike (Fallout), nga matjet e kryera para vitit 2005, gjatë 2015 - 2023 - 2024 mund të thuhet se aktiviteti alfa beta total është në intervalin e vlerave që janë konstatuar në vendin tonë gjatë dekadës së kaluar. Vlerat e matura për aktivitetin alfa total variojnë nga LLD (Vlera më e vogël e matshme) deri në 1.2 Bq/m2 /muaj. Po kështu për aktivitetin beta total rendi i vlerave nga matjet e kaluara është 2.1 – 12.9 Bq/m2 /muaj.

Gjatë këtij viti shihet se vlerat e radioktivetit alfa dhe beta total janë nën vlerat e përcaktuara në standartet kombëtare, në disa raste pranë vlerës kufi. Duke

patur parasysh që disa nga burimet e ujit që përdoren për konsum të popullatës dhe sidomos për nevoja të përdorimit të gjerë në bujqësi furnizohen nga lumenjtë është shumë e rëndësishme që treguesit e radioaktivitetit të jenë në monitorim të vazhdueshëm periodik.

▪ **Krahasimi me vitin 2023 i aktivitetit radioaktiv**




Figura 73 - Aktiviteti alfa total, mesatare vjetore mBq/L




Figura 74 - Aktiviteti Beta total, mesatare vjetore mBq/L

1.5.3 Prurjet në lumenj

- Stacionet e monitorimit




Figura 75 - Harta e rrjetit lumor të Shqipërisë




Figura 76 - Harta e Baseneve Ujëmbledhës të Shqipërisë

- *Standartet e cilësisë*

Monitorimi dhe vlerësimi i prurjeve ujore bazohet në kërkesat e Direktivës Kuadër të Ujit për përcaktimin e statusit sasior të ujrave sipërfaqësorë.

- *Vlerësimi i gjendjes*

Stacionet në të cilat u kryen matjet e prurjeve ujore janë 28 të shpërndara në të gjithë rrjetin kryesor lumor të Shqipërisë (përveç stacionit në përroin e Sopit, degë e lumit Cemi i Selcës). Parametrat kryesor janë sasia e prurjes ujore Q dhe rrezja hidraulike e cila tregon kapacitetin apo efikasitetin e kanalit të rrjedhës për të lejuar kalimin e sasive të ujit. Ajo përcaktohet si raport i sipërfaqes së lagur me perimetrin e lagur. Nga rezultati i matjeve të kryera, rezulton se në përgjithësi kemi patur sasira të vogla të prurjeve ujore në të gjitha stacionet ku janë kryer këto matje, referuar edhe stinëve përkatëse dhe sasisë tepër të kufizuar të reshjeve në vendin tonë. Shtojmë këtu edhe reshjet e pakta që kanë rënë sidomos në periudhën natyrale të tyre, në atë të vjeshtës.

Rezultatet e marra për periudhën e muajve 27 Maj deri në 1 Korrik për fazën e parë dhe 1 Tetor - 4 Nëntor të vitit 2024 për fazën e dytë, pra gjatë stinës së pranverës dhe asaj të dimrit, do të jenë një ndihmesë e konsiderueshme edhe në hartimin dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Baseneve Ujore të Shqipërisë.

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten prurjet e lumenjve në vitin 2024.




Figura 77 - Prurja e lumenjve m³/sek për vitin 2024

Analiza e treguesve sipas stacioneve të zgjedhura dhe faktorëve që mund të kenë ndikuar:

- Në stacionin e Urës së Topojanit , sasia e prurjeve është në funksion të prurjeve që dalin nga kaskada e HEC-it në tokën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu ndikim në sasinë e prurjeve ka edhe stina në të cilën kryhen matjet dhe sasia e rreshjeve që bien në basenin ujëmbledhës.
- Në stacionin Ura e Lumës sasia e prurjeve kontrollohet nga HEC-i i ngritur fare pranë si dhe nga sasia e rreshjeve që bien në basenin ujëmbledhës.

- Në stacionin e Bahçallëkut (lumi i Drinit) vlera më e lartë e rrezes hidraulike (R_H) është në seksionin e tretë dhe të katërt çka korrespondon edhe me sasi të mëdha të prurjeve në këto seksione.
- Në stacionin Ura e Mesit (lumi i Kirit, Drin), falë reshjeve të shiut, shtrati i Kirit ka pasur prani të rrjedhës ujore në të dy sezonet e matjeve. Lumi i Kirit ka karakter të theksuar stinor dhe torrencial ndaj dhe në pjesën më të madhe të fundit të pranverës dhe verës shtrati është i thatë.
- Përroi i Shllapit bashkohet me Cemin e Selcës dhe zbresin në drejtim të Tamarës duke mbledhur rrugës edhe përroska e përrenj të tjerë të vegjël dhe duke rritur prurjen e tyre.
- Në stacionin e Tamarës (lumi i Cemit) sasia e prurjeve është shumë më e lartë se sa të dy degët e matura më sipër, gjë që dëshmon për praninë e një rrjeti më të gjerë të përrenjve apo prroskave që derdhen poshtë bashkimit të degëve Cemi i Selcës dhe përroi i Shllapit. Kjo dëshmohet edhe nga vëzhgimi i hartave topografike të kësaj zone (përroi i Milsit, përroi i Goçes, përroi i Samogut, përroi i Rahit, etj).
- Në stacionin e Cemit të Vuklit (degë e Cemit) :Gjykuar edhe nga prurjet shumë herë më të larta sesa dega e Selcës, kjo degë e lumit Cem mbart edhe sasinë kryesore të prurjeve të lumit Cem.
- Në stacionin Ura e Bunës (lumi i Bunës) vlerat e fazës së parë janë thuajse të njëjta me ato të llogaritura një vit më parë në këtë stacion. Vlerat më të ulta të R_H janë në seksionet anësore ku janë edhe prurjet më të vogla ndërsa në seksionet e tjera janë thuajse të njëjta që korrespondon me një regjim të njëtrajtshëm rrjedhe në gjerësinë e saj. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të mëdha nga kaskada e Vaut të Dejës mbi lumin e Drinit. Kohët e fundit, në krahun e majtë të rrjedhës, thuajse ngjitur me urën, janë kryer punimet për ndërtimin e portit të varkave dhe ambienteve përreth tij.
- Në stacionin e Murriqanit (lumi i Bunës), vlera e rrezes tregon aftësi të mira përcjellëse të kanalit, por në raste prurjesh të mëdha, për shkak të

disniveleve të vogla me bankot e lumit, rrjedha kalon edhe në stadin e përmbytjes.

- Në stacionin e Urës së Darsit (lumi i Matit), gjatë këtij viti, në momentin e matjeve, ndryshe nga një vit më parë, bashkimi i të dyja rrjedhave ujore të Matit dhe Darsit ndodh sipër urës së Darsit dhe në vendin e matjeve Mati vjen si një rrjedhë e vetme.
- Në stacionin Ura e Fanit (lumi i Fanit të Vogël), sasia e ulët e ujit në shtrat lidhet kryesisht me kushtet e motit, por edhe me regjimin e HEC-eve të ngritura mbi lumin e Fanit. Pjesa më e madhe e rrjedhës janë ujra të zeza.
- Në stacionin Ura e Zogut (lumi i Matit) Në kanalën vaditës që merr ujë nga rrjedha kryesore sipër Urës së Zogut, në të dy fazat nuk ka rrjedhë uji. Edhe sasitë e ujit në këtë stacion janë funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të HEC-eve mbi lumenjtë e Fanit dhe Matit. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm në pjesët poshtë Urës së autostradës deri në det, sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në periudhë të shkurtër kohore.
- Në stacionin Ura e Brarit (lumi i Ishmit), forma e shtratit e ngushtë dhe e thellë lejon kalimin e sasive të mëdha të ujit për në sektorët e mëposhtëm. Nuk ka rrezik përmbytjeje.
- Në stacionin Salme-Shetaj (lumi i Ishmit) sasia më e madhe e ujit kalon në krahun e djathtë të shtratit. Rreziku për përmbytje është i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëherëshme në kohë të shkurtër.
- Në stacionin Pëllumbas (lumi i Erzenit), sasia e ujit është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të rezervuarit të Skoranes në hyrje të kanionit. Rreth 50 m sipër vendmatjes është ndërtuar një kapërderdhës për uljen e energjisë së rrjedhës, pasi në këtë sektor, fenomeni i erozionit fundor dhe anësor është mjaft i zhvilluar. Kjo vepër do të ndihmojë në uljen e intensitetit të këtij fenomeni si dhe për ruajtjen e brigjeve në tërësi dhe investimeve turistike të bëra në krahun e majtë të këtij shtrati.

- Në stacionin e Sallmones (lumi i Erzenit) sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Nuk ka rrezik përmbytjeje.
- Në stacionin e Proptishtit (lumi i Shkumbinit) sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Ky stacion ndodhet në pjesën më të sipërme të rrjedhës së Shkumbinit. Rreziku i përmbytjes në pjesët anësore të shtratit është gjithmonë evident.
- Në stacionin Labinot + Përroi i Gurës (lumi i Shkumbinit) gjatë periudhës së matjeve, kanali vaditës ishte i thatë për të dyja periudhat. Kjo për shkak të punimeve gjërmuese që kryhen në shtrat të Shkumbini sipër vendit të matjeve, të cilat kanë ndryshuar tërësisht panoramën e shtratit dhe kanalit të rrjedhës.
- Në stacionin Ura e Rrogozhinës (lumi i Shkumbinit), prurja është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të digës në rezervuarin ujëmbledhës në Çengelaj. Kjo është edhe arsyeja sepse sasitë e ujit që përcillen nga stacioni i Rrogozhinës në këtë fazë të matjeve janë më të vogla se ato në stacionin e Paprit. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në kohë të shkurtër.
- Në stacionin e Paprit (lumi i Shkumbinit), matjet u kryen në Urën e Zezë. Sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Nuk vërehet rrezik për përmbytje në këtë pjesë të rrjedhës.
- Në stacionin e Bilishtit (lumi i Devollit), sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Ky stacion ndodhet në pjesën e sipërme të rrjedhës së lumit Devoll dhe nuk ka asnjë rrezik për përmbytje.
- Në stacionin Ura e Lapanjtit (Lumi i Osumit), sasia ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Forma e thellë e kanionit lejon kalimin e sasive të mëdha të ujit për në sektorët e mëposhtëm. Vërehet qëndrueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera.

- Në stacionin Fier (lumi i Gjanicës), sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Një pjesë e madhe e prurjeve të matura janë ujra të zeza të cilat shkarkohen fare pranë Urës, në krahun e sipërm të saj.
- Në stacionin Ura e Mbrostarit (lumi i Semanit), sasia më e madhe e ujit në këtë stacion kalon në krahun e djathtë të shtratis gjë që përkon edhe me vlerën e R_H . Prurja është funksion i reshjeve stinore dhe regjimit të digës në rezervuarin e Thanës. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të menjëhershme në kohë të shkurtër.
- Në stacionin Tri Urat (lumi i Vjosës), sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Vlera e rrezes R_H tregon aftësi përcjellëse relativisht të mira të kanalit të rrjedhës. Nuk ka rrezik për përmbytje. Vërehet ndryshueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera, kjo për shkak të mungesës së reshjeve.
- Në stacionin Ura e Leklit (lumi i Drinosit), sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Nuk ka rrezik për përmbytje. Vërehet ndryshueshmëri e sasisë së prurjeve midis dy matjeve të kryera, kjo për shkak të sasisë së reshjeve.
- Në stacionin Memaliaj (lumi i Vjosës), sasia e ujit në këtë stacion është funksion i reshjeve stinore. Vlera e Rrezes Hidraulike (R_H) tregon aftësi përcjellëse të kënaqëshme të kanalit të rrjedhës. Nuk ka rrezik për përmbytje në këtë sektor.
- Në stacionin Ura Mifolit (lumi i Vjosës), ka vlera të R_H që lëvizin nga krahu i majtë i rrjedhës në atë të djathtë, kjo tregon për një jouniformitet të rrjedhës. Krijimi i barrierave të depozitimeve të rërës që vijnë si rezultat i pjerrësisë shumë të ulët të kanalit të rrjedhës, ndikojnë fuqimisht në shpejtësinë e lëvizjes së ujit. Rreth 30-35 m poshtë urës vërehet një dalje e një grumbullimi rëre në mes të rrjedhës çka dëshmon mbushjen e madhe të këtij kanali. Rreziku për përmbytje është gjithmonë i pranishëm sidomos në rastin e prurjeve të mëdha në periudhë të shkurtër kohore.

Tabela 20 - Prurjet e lumenjve (m3/sek) ne fazën e parë në vitet 2016-2024.

Stacionet e matjes	Kodi i stacionit	Lumi	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
			2016	2018	2019	2022	2023	2024
Ura Topojanit, Drin	D1	Drin	20.9	156.9	20.7	10.786	59.8	73.59
Ura e Lumës, Drin	D3	Drin	14.3	39	7.6	0.6	1.01	3.633
Bahçallëk, Drin	D2	Drin	656.4	466	196.4	280.94	242.2	378.25
Ura e Mesit, Kir	K1	Kir	-	-	11.4	0	0	3.9
Cemi i Selcës	Cm1	Cem	-	-	-	-	-	0.388
Ura e Tamarës	Cm2	Cem	-	-	-	-	-	4.04
Cemi i Vuklit	Cm3	Cem	-	-	-	-	-	9.28
Përroi Shllapit	Cm4	Cem	-	-	-	-	-	0.436
Ura e Bunës, Bunë	Bu2	Bunë	76.5	457.8	236	77.89	119.5	128.59
Murriqan, Bunë	Bu1	Bunë	777	1049.3	441.3	368.97	321.48	436.77
Ura e Darsit, Pr i Darsit	Ma3	Pr i Darsit	35.5	45.1	8.6	2.766	4.19	12.87
Ura e Fanit, Fan	Ma1	Fani Vogël	6.7	2.4	10	0.399	0.83	0.832
Ura e Zogut, Mat	Ma5	Mat	126.4	180.5	143.3	10.744	9.84	72.67
Ura e Brarit, Ishëm	T1	Ishëm	5.4	1.9	3.4	0.736	0.55	0.294
Salme-Shetaj, Ishëm	Ish3	Ishëm	29.9	6.1	10.6	3.2	3.83	3.259
Pëllumbas, Erzen	Er1	Erzen	8.3	6.5	2.8	0.543	0.81	1
Sallmone, Erzen	Er3	Erzen	14.3	16.8	7.66	0.906	2.32	2.67
Proptisht, Shkumbin	Sh6	Shkumbin	27.3	18.8	16.2	0.797	1.36	2.09
Labinot, Shkumbin	Sh5	Shkumbin	144.9	125	101.1	6.15	26.02	9.358
Papër	Sh11	Shkumbin	-	-	-	-	-	10.7
Rrogoshinë, Shkumbin	Sh4	Shkumbin	98.2	105.4	133.1	3.24	25.52	7.4
Bilisht, Devoll	Dv2	Devoll	-	5	2.6	0.473	1.103	0.59
Ura Lapanjit, Osum	Os4	Osum	-	23.7	10.7	2.347	2.34	3.15
Fier, Gjanicë	Gj4	Gjanicë	2.1	3.7	3.2	1.154	0.656	0.462
Ura Mbrostarit, Seman	Se5	Seman	60.2	231.4	151.5	13.41	10.12	23.92
Tri Urat, Vjosë	Vj1	Vjosë	74.2	85.4	58.4	16.01	13.51	20.74
Ura e Leklit, Drinos	Vj3	Drinos	105.5	47.3	18.8	5.38	5.63	6.014
Memaliaj, Vjosë	Vj4	Vjosë	-	135.5	78	40	32.8	38.95
Ura Mifolit, Vjosë	Vj5	Vjosë	247.6	234.7	125.4	49.93	31.9	71.34

Tabela 21 - Prurjet e lumenjve (m3/sek) ne fazën e dyte në vitet 2016-2024

Nr	Stacionet e matjes	Kodi i stacionit	Lumi	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti	Viti
				2016	2018	2019	2022	2023	2024
1	Ura Topojanit	D1	Drin	15.40	50.90	8.93	18.81	13.90	87.65
2	Ura e Lumës	D3	Drin	0.70	6.20	0.62	0.33	2.85	0.66
3	Bahçallëk	D2	Drin	231.90	278.20	70.27	334.80	167.30	377.50
4	Ura e Mesit	K1	Kir	0.00	0.00	0.00	1.48	0.00	115.87
5	Cemi i Selcës	Cm1	Cem	-	-	-	-	-	0.521
6	Ura e Tamarës	Cm2	Cem	-	-	-	-	-	8.443
7	Cemi i Vuklit	Cm3	Cem	-	-	-	-	-	10.76
8	Përroi Shllapit	Cm4	Cem	-	-	-	-	-	0.176
9	Ura e Bunës	Bu2	Bunë	64.40	66.20	93.27	92.45	90.63	529.30
10	Murriqan	Bu1	Bunë	341.20	360.00	202.22	384.78	310.03	911.60
11	Ura e Darsit	Ma3	Pr i Darsit	7.70	2.20	1.80	9.55	3.11	9.09
12	Ura e Fanit	Ma1	Fani Vogël	0.50	2.30	0.25	3.07	0.70	2.00
13	Ura e Zogut	Ma5	Mat	26.90	16.10	14.24	20.83	15.33	23.14
14	Ura e Brarit	T1	Ishëm	1.50	0.40	0.46	1.42	0.31	0.13
15	Salme-Shetaj	Ish3	Ishëm	7.10	5.10	4.44	4.33	4.89	4.94
16	Pëllumbas	Er1	Erzen	1.30	1.20	1.21	2.11	1.30	1.45
17	Sallmone	Er3	Erzen	5.00	3.80	4.08	4.31	2.57	2.24
18	Proptisht	Sh6	Shkumbin	4.90	1.40	0.94	0.90	2.26	1.15
19	Labinot	Sh5	Shkumbin	26.00	12.40	4.08	19.54	7.91	8.04
20	Papër	Sh11	Shkumbin	-	-	-	-	-	14.765
21	Rrogozhinë	Sh4	Shkumbin	41.80	20.90	4.45	14.58	10.61	11.66
23	Bilisht	Dv2	Devoll	-	0.50	0.27	0.48	0.71	0.34
24	Ura Lapanjit	Os4	Osum	-	0.90	3.03	2.53	2.11	2.28
25	Fier	Gj4	Gjanicë	0.30	1.50	0.74	0.11	0.25	0.37
26	Ura Mbrostarit	Se5	Seman	40.20	29.90	14.26	22.30	23.42	13.65
27	Tri Urat	Vj1	Vjosë	29.80	14.90	20.86	15.77	9.82	6.56
28	Ura e Leklit	Vj3	Drinos	0.60	6.90	7.05	3.20	3.22	3.70
29	Memaliaj	Vj4	Vjosë	-	37.40	44.81	38.16	20.64	22.56
30	Ura Mifolit	Vj5	Vjosë	59.60	41.60	115.69	84.76	48.75	41.23

Përfundime:

Lumenjtë e Shqipërisë paraqesin një potencial uJOR të larmishëm i cili mund të kontrollohet, disiplinohet dhe menaxhohet duke u vënë në dispozicion të bujqësisë, industrisë dhe drejtimeve të tjera të ekonomisë në dobi të komunitetit.

Në faktorët natyrorë që ndikojnë në sasinë e prurjeve ujore, rëndësi parësore kanë:

- faktorët hidrometeorologjikë (rreshjet dhe intensiteti i tyre),

- ndërtimi gjeologjik i rajonit (shkalla e përshkueshmërisë së formacioneve),
- pjerrësitë e relievit në brigjet e shtretërve, shkalla e pyllëzimit (koefiçienti i rrjedhës),
- pjerrësitë e vetë shtratit (gradienti i shtratit dhe i rrjedhës),
- sedimentimi apo erozioni i aluvioneve në shtratin e lumit (ulje-ngritjet e bazamentit),
- shkalla e zhveshmërisë së pellgut ujëmbledhës (mbulesa bimore), etj.

Gjatë matjeve të këtij viti, janë shtuar edhe 4 stacione të tjera (tre në lumin e Cemit dhe një në atë të Shkumbinit) duke marrë informacion shtesë i cili ka munguar prej vitesh. Ky stacion plotëson më mirë panoramën e burimit të prurjeve në këtë lumë.

Rreziku i përmytjeve mbetet gjithmonë evident në rrjedhjet e poshtme të lumenjve, por edhe në sektorë të tjerë të cilët kanë filluar të evidentohen në vitet e fundit. Kjo tregon shtrirjen në rritje të këtij fenomeni drejt pjesëve më të sipërme të pellgut. Nga shkaqet kryesore të këtij fenomeni janë ulja e pjerrësisë së shtratit në rrjedhën e poshtme, mbushja e tabanit të kanalit të rrjedhës dhe prurjet e shpejta me intensitet të lartë.

Informacioni i fituar shërben për orientimin e një menaxhimi të mirë të burimeve ujore (por edhe atyre inerte) në shtretërit e lumenjve. Orienton marrjen e masave për mbrojtjen nga erozioni lumor, mbrojtjen e objekteve inxhinierike të rrezikuara në shtrat të lumit nga energjia e rrjedhës, mbrojtjen e tokave bujqësore dhe ndërtimeve të popullatës nga rreziku i përmytjeve, etj.

Tabela 22 - Normat për analizat kimike

	pH	Na	Mg	Fe ²⁺³	NH 4	Cl	NO 3	NO 2	MP	FP °gj	T°C	Ko nd ukt ivit et
VKM 379	6.5- 8.5	200	50	0.2- 0.3	0.1 (0.5)	250	50	0.5	120 0	0- 20 (25)	8- 15;20	250 0.0
E.C 80/77 8	6,5-8,5	20-150	30-50	0.05- 0.2	0,05- 0.5	25	25- 50	nl- 0,1		>60	12- 25,0	400(250 0)

- Vlerësimi i gjendjes

Gjatë viteve 2020-2024, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka kryer monitorimin e ujërave nëntokësore në akuiferet e baseneve Drini, Mat, Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe Zona Jonike. Monitorimi hidrodinamik (niveli i ujërave) dhe hidrokimik (pH, konduktivitet, fortësi e përgjithshme, mineralizim i përgjithshëm, nitrite-NO2, nitrate-NO3, amonjak-NH4, natrium-Na, klor-Cl, hekur -Fe, magnez-Mg) është kryer nga dy herë ne vit në periudhat Mars/Prill dhe Shtator.

Baseni Drin:

Në Basenin e Drinit shfrytëzohen rezervat e ujërave nëntokësore (UN) për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Shkodrës, Malësisë së Madhe, Tropojës, Pukës, Kukësit, Peshkopisë, Pogradecit si dhe të fshatrave që i përkasin këtyre bashkive. Monitorimi hidrodinamik është kryer në akuiferin poroz ne 3 shpime: Shtoj i Vjetër, Grude Fushe, Dobrac. Nga kryerja e monitorimit për vitet 2020 - 2024, rezulton se amplituda e luhatjes se UN varion nga A= 2.06-3.34- 5.51 m.

Monitorimi hidrokimik eshte kryer në akuiferin e Shkodrës (Kisha e Madhe-Shkodër, Hot i ri, Grudë, Fushë Koplik, Dobraç- 3 puse) Nënshkodrës-Zadrimë (Stacionet Velipojë, Gocaj, Blinisht, Bërdicë) dhe akuiferin karbonatik (Syri i Sheganit, Lin dhe Tushemisht dhe rezulton se ujërat nentokesore në përgjithesi janë të mira dhe brenda standartit të ujit të pijshëm.

Baseni Mat:

Në basenin e Matit shfrytëzohen rezervat e ujërave nëntokesore, për furnizimin me ujë të pijshëm të qyteteve të Lezhës, Durrës, Laç, Rrëshen, Burrel, etj. si dhe fshatrat që i përkasin këtyre bashkive. Monitorimi hidrokinamik është kryer në 3 shpime në Shënkoll, Gorre-Laç dhe Kompleksi Kasmi. Nga kryerja e këtij monitorimi në këtë basen për vitet 2020 - 2024, rezultojnë se amplituda e luhatjes së UN për akuiferin e Lezhës Kisha Shënkoll është 1.4 m, në Garre 1 m dhe në Fushe Milot 0.44 m për akuiferin e Fushë Kuqe. Monitorimi hidrokinamik është kryer në akuiferët Lezhë (Barbullonje-2 stacione, Shengjin, Rrile-2 stacione, Hotel i Gjuetisë, Kisha Shënkoll) dhe Milot-Fushë Kuqe (Laç, Milot-2 stacione, Puset e Durrësit, Gurrëz, Patok- 2 stacione, Fushë Kuqe -4 stacione, Gorre. Rezultojnë se ujërat nëntokësore në përgjithësi janë të mira dhe brenda standartit të ujit të pijshëm.

Baseni Erzen-Ishëm:

Monitorimi hidrokinamik është kryer në 3 shpime në Laknas, Rinas dhe Fushë Krujë. Monitorimi hidrokinamik është kryer në akuiferët kuaternar të Tiranës dhe Fushë Kruje (Selitë-2 stacione, Unaza e re -2 stacione, Valis, Bërçull, Laknas – 2 stacione, Rr.Kavajës, Rinas, Thumanë, Gramëz, Fushë-Krujë, Ura e Gjolës). Vlerësohet se ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Ndotjet e ujit me jonet NH_4 , NO_2 , NO_3 , janë ndotje lokale dhe lidhen me moszbatimin e zonave të rreptesise dhe mbrojtjes sanitare. Rrezik i ndotjes së ujërave nëntokësore janë infiltrimet e ujërave të ndotura të lumenjve Tiranë, Lanë, Tërkuze, Erzen në shtresat ujëmbajtëse. Shfrytëzimi i shtresave zhavorrore ujëmbajtëse të tarracave lumore për materiale inerte, të cilat janë jo vetëm burim i furnizimit me ujë të pijshëm të shumë fshatrave por dhe ushqyesi kryesor i pellgut ujëmbajtës të Tiranës, ka çuar në prishjen e ekuilibrit hidrokinamik dhe hidrokimik.

Baseni Shkumbin:

Monitorimi i ujërave nëntokësore është kryer në periudhat Prill dhe Shtator. Monitorimi hidrokinamik është kryer në 3 shpime në akuiferet poroze të Lushnjës (Çerme-Konjat) dhe Elbasanit (Vidhas). Amplituda rezultojnë $A = 4.2 - 7$ m. Monitorimi hidrokinamik është kryer në Peqin, Rrogazhinë, Çermë -2

stacione, Konjat- 6 stacione, Pusi 2V, Krastë (2stacione). Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira.

Baseni Seman:

Monitorimi hidrodinamik është kryer në akuiferin e Korçës (Bulgarec). Amplituda e luhatjes se nivelit te ujerave nentokesore ne akuiferin e Korçës ne vitin 2024 eshte $A = 0.12$ m. Monitorimi hidrokimik eshte kryer në akuiferet poroz të Korçës (Libonik, Bulgarec, Turan-3 stacione, I.Terova, Zvirinë, Sheqeras), akuiferi karbonatik (Mançurisht) dhe akuiferi magmatik (H.Xhorxho). Ujërat nëntokësore të këtij baseni në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira dhe nuk ka ndotje masive të akuiferëve ujëmbajtëse. Në ndonjë rast vihet re prezenca e NO_2 , por në vlera të ulëta, e cila vjen nga mos zbatimi i zonave të rreptësisë sanitare.

Baseni Vjosë:

Monitorimi hidrodinamik është kryer në akuiferet poroz Vjosa dhe Drinos në shpimet Buduk, Lazarat, Kakavi, Novosele, Kafaraj 3/96 dhe Kafaraj Pusi i Ri. Nga kryerja e këtij monitorimi ne keta akuiferë ujëmbajtës per vitet 2020 - 2024, rezulton se amplituda e luhatjes se UN varion nga $A = 1.35 - 9.77$ m. Monitorimi hidrokimik është kryer në akuiferin poroz Vjosë dhe Drinos (Buduk, Kakavi, Lazarat, Novoselë, Kafaraj, Kafaraj Pus i ri). Në akuiferin karstik (karbonatik) monitorimi është kryer në burimin e Ujit të Ftohtë - Tepelenë. Ujërat nëntokësore të këtij baseni kanë veti fiziko - kimike të mira, jane pa erë, pa ngjyrë, pa shije.

Baseni i Zonës Jonike:

Monitorimi hidrodinarnik i ujërave nëntokësore të akuiferit ujëmbajtës kuaternar të Vurgut është kryer në 2 shpime, stacioni i pompimit Vrion, dhe në fshatin Karahaxh. Monitorimi hidrokimik është kryer në akuiferin poroz (Orikum, Çukë -2 stacione, Karanxh, Vrion -2 stacione), akuiferin karbonatik (uji i ftohtë, galeria-Vlorë, Mursi, Syri i kaltër). Ujërat nëntokësore të këtij baseni kanë veti fiziko - kimike të mira.

1.5.4.1 Problematikat e ujërave nëntokësore që rezultojn nga monitorimi i kryer.

Vlerësimi dhe ndikimi i faktorëve natyrorë në regjimin e ujërave nëntokësore.

Ujërat nëntokësore janë gjithmonë në lëvizje të vazhdueshme. Sasia e ujërave nëntokësore shtohet (ushqehet) nga reshjet atmosferike, pra nga rritja e infiltrimit, apo edhe nga akuifere të tjere fqinje. Nga ana tjetër sasia e UN në shtresat ujembajtëse zvogëlohet me rritjen e evapotranspirimit, shkarkimit me ane të burimeve, rritjes së shkarkimeve në lumenj etj, duke çuar gjithmonë në uljen e niveleve të tyre.

Analizimi dhe zgjidhja e këtij problemi bëhet me ane të monitorimit sistematik të niveleve për çdo akuifer dhe për të gjithë basenet. Monitorimi hidrodinamik bën të mundur vlerësimin e parametrave kryesore të luhatjes-ndryshimeve të nivelit të UN të lidhura me faktorët natyrorë (klimen, kushtet gjeologjike), si nivelet mesatare mujore, vjetore, shumëvjeçare, nivelet ekstremale, amplituden e luhatjes së nivelit të UN, pra vlerësimin e gjithë regjirnit natyror.

Vlerësimi dhe ndikimi i faktorëve artificial në regjimin e ujërave nëntokësore.

Kryerja dhe vënia në shfrytëzim e shpimeve pa leje të cilet shfrytëzojnë rezervën të konsiderueshme të UN. Shfrytëzimi i akuifereve poroze në disa raste mbi kapacitetin ujedhënës të tyre. Shfrytëzimi pa kriter i zhavorreve në shtreterit të lumenjve për materiale ndërtimi. Këto zhavorre janë ushqyesit kryesore të ujërave nëntokësore (akuifereve) nëpërmjet filtrimit të ujit të lumit. Hapja e vendit pa vend të karrierave të ndryshme në akuiferet karstike.

Faktorët e mësipërm se bashku kanë krijuar probleme në resurset ujore nëntokësore si:

- Ulje e nivelit të ujërave nëntokësore, si rrjedhojë edhe zvogëlim i prurjeve në pusët e shpimit dhe të disa burimeve.
- Tharje pjesore të disa akuifereve.
- Prishje të cilësisë së ujërave nëntokësore për shkak të zhvendosjes së kufirit të UN me mineralizim të lartë drejt UN të freskëta, ndodhje të akuifereve me prezencë të nutrienëve si dhe kolmatim të tyre.

Probleme shqetësuese në shumë basene janë shkaktuar nga hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve dhe në terracat aluviale të tyre duke shkaktuar ndotje të ujërave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore.

1.6 Rekomandime

Ujërat sipërfaqësore (lumenj, liqene)

- Rekomandojmë marrjen e masave nga organet e Pushtetit Vendor apo edhe në nivel Kombëtar për të minimizuar shkaktarët e ndotësve pasi impakti kryesor janë shkarkimet urbane dhe ato industriale të cilat derdhen direkt në lumenj, liqene apo edhe nëzona bregdetare
- Përmirësimi i situatës mjedisore të ujërave sipërfaqësore kërkon realizimin e investimeve në trajtimin të shkarkimeve të lëngëta urbane, sidomos në Tiranë, Fier e në qytetet e mëdha të zonës bregdetare pasi gjendja dhe cilësia e tyre vazhdon të jetë në të njëjtën situatë.
- Të respektohen standartet e përcaktuara nga Legjislacioni Shqiptar për shkarkimet e lëngëta nga subjektet prodhuese në ujërat pritës sipërfaqësorë. Nga ana tjetër kontrolli i vazhdueshëm në zbatimin e ligjit do të luante një rol të rëndësishëm në këtë drejtim.

Radioaktiviteti në ujëra

- Monitorim i vazhdueshëm i ujërave të lumenjve në të gjitha pikat e përcaktuara dhe caktimi i pikave të tjera për të monitoruar më mirë të gjithë vendin tonë (në kontratat e disa viteve të kaluara të monitorimit të ujërave të lumenjve kanë qenë 13 pika monitorimi lumenj dhe liqene).
- Kontrolli i vazhdueshëm i gjendjes mjedisore të ndotjes radioaktive të ujërave sipërfaqësore në përputhje me Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit.

- Rekomandojmë monitorimin e vazhdueshëm të precipitimeve atmosferike pasi ata janë një nga treguesit e rëndësishëm të ndotjes radioaktive që vjen nga ajri.

Prurjet e ujërave

- Të kryhen matjet edhe në stacionet e tjera ekzistente (janë rreth 40 gjithsej në të gjithë rrjetin lumor) pasi kjo do t'i shërbente rritjes së shkallës së informacionit për të gjithë lumenjtë.
- Të kryhen matjet edhe në lumenj të tjerë në të ardhmen për të rritur shkallën e informacionin në të gjithë hapësirën e rrjetit ujqor të vendit tonë.

Ujërat nëntokësore

- Monitorimi i cilësisë së UN rekomandohet të kryhet me frekuencë katër herë në vit në shkëmbinjtë e shkrifët dhe 2 herë në vit në periudhën ujë shumë dhe ujë pakët në shkëmbinjtë kompakt.
- Rekomandojmë zbatimin e zonave të rreptësisë dhe mbrojtjes sanitare rreth shpimeve të shfrytëzimit për mbrojtjen e UN nga ndotjet sipërfaqësore, pasi vihet re prania e NO₂ dhe e NH₄ në disa shpime monitorimi të baseneve.
- Të vlerësohen përmbajtja e elementeve mbi normë si Na, Cl ne akuiferin e Lezhës dhe Fushë – Kuqes.
- Zbutja e fortësisë së përgjithshme brenda parametrave maksimal të lejuar (PML) per uje te pijshem në:

Basenin Erzen-Ishëm per Stacionet e pompimit te ujesjellesave si: St.Pompimi Berxull, St. Pompimit Laknas, St. Pompimit Valias -Rinas (St.Kamez), St.Pompimit Gramez, St. Fushe-Kruje shpimit 327 Stacioni qe furnizon me uje Fabriken e çimentos dhe shpimi 3/97 Valias Rinas. Basenin Shkumbin për stacionet e pompimit Vidhas fshat, Peqin dhe Rrogozhine, Çerme pusi 286, 2 puse te Konjatit.

Shpimet në të cilët takohen ndotje të monitorohen 4 herë në vit, si dhe tu rekomandohet ndërmarrjeve të ujësjellësave të marrin masa për përmirësimin e kushteve higjieno - sanitare të stacioneve të shfrytëzimit.

- Te sistemohen kanalet e shkarkimit te ujerave te perziera qe kalon prane stacioneve te Konjatit dhe pusit 281 Çërme, pasi verehet prezenca e amonjakut (NH₄) ne menyre te vahdueshme mbi parametrat maksimale te lejuar te ujit te pijshem.
- Stacioni i pompave te Pish Poros te mos perdoret per furnizimin me uje te pijshem te popullsise, pasi uji i tij nuk ploteson standardin per uje te pijshem. Furnizimi me uje te pijshem i fshatrave Poro, Pish Poro, Darezeze, Qarri, etj te behet nga ujesjellesi i Kafarajt.
- Ne rast pamundesie per te ulur vlerat e elementeve kimike qe jane mbi normen e lejuar ne stacionet e pompimit, te studiohen mundesi te reja fumizimi me uje per keto zona.
- Te vendoset sonde multi parametrike ne akuiferin kuaternar te Korçes, dhe ate te Beratit ne shpimin Bulgarec e Banaj
- Marrjen e masave per menjanimin e infiltrimit te ujerave te ndotura urbane, qe shkarkohen mbi zonen e drenimit te UN ne zonen e burimeve karstike Uji i Ftohte - Vlore dhe Burimi i Syrit te Kalter, si dhe te shpimeve ne Vrion 1&2, Çuke 1&2, Karahaxh dhe Mursi.
- Rekomandojme ndalimin e shfrytezimit te zhavoreve ne shtratin e lumit Drin, Mat per ruajtjen e ekuilibrave hidrodinamike dhe hidrokimike te ushqimit te akuferëve ujembajtëse.
- Klorinimi i ujit duhet te jete ivazhdueshem ne stacionet e pompimit si dhe mbajtja nen monitorim te vazhdueshem.

KAPITULLI 2 - AJRI DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

2.1 Burimi i të dhënave.

Mbështetur në legjislacionin mjedisor dhe në Programin Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit, miratuar nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2024, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka realizuar monitorimin e cilësisë së ajrit urban me stacione automatike në qytetet kryesore të vendit tonë si Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier dhe Korçë për treguesit kryesorë të cilësisë së ajrit urban si: PM10, PM2.5, NO2, SO2, O3, CO dhe BTEX. Të dhënat për ndryshimet klimatike janë marrë nga dokumenti “Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar 2020”.

2.2 Rëndësia për mjedisin dhe njerëzit.

Ndotja e ajrit është prania e substancave në atmosferë që janë të dëmshme për njerëzit dhe qeniet e tjera të gjalla, ose që shkaktojnë dëme në mjedis. **"Ne jemi ajo që marrim frymë"**. Ekspozimi ndaj ndotjes së ajrit lidhet me efekte të shumta në shëndetin e njeriut duke përfshirë dëmtime në mushkëri, enët e gjakut irritim të lëkurës, syve dhe sistemin nervor. Efektet shëndetësore mund të ndryshojnë nga personi në person. Grupet me rrezik të lartë si të moshuarit, fëmijët e vegjël, gratë shtatzëna dhe ata që vuajnë nga sëmundjet kronike të zëmres dhe mushkërive janë më të ndjeshme ndaj ndotjes së ajrit.

2.3 Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis/ shëndet

Burimet kryesore të ndotjes së ajrit urban janë transporti, ndërtimet, ngrohja shtëpiake, industria etj.

Ndotësi	Burimi i ndotjes	Ndikimi në mjedis/shëndet
Lënda e ngurtë e grimcuar (particulate matter) PM10, PM 2.5	Lënda grimcore kategorizohet në bazë të madhësisë së grimcave, PM10 dhe PM2.5 janë grimca me diametër më të vogël se 10 dhe 2.5 µm dhe clirohet nga burime të ndryshme të lëndëve djegëse. Nivelet e PM2.5 janë veçanërisht problematike pranë qendrave urbane, fshatrave, dhe qyteteve, për shkak të efekteve kumulative të burimeve të shumta të ndotësit, ku burimi dominues janë lëndët djegëse të ngurta që përdoren në ngrorjen e shtëpive. Burime të PM-së vijnë si nga aktivitetet njerëzore, ashtu edhe ato natyrore	Lëndët grimcore dytësore përfshijnë sulfate, nitrare dhe amonium të formuara nga: SO2, NOX dhe NH3 që janë faktorët kryesorë të acidifikimit dhe eutrofikimit. Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe con në humbjen e biodiversitetit. Ekspozim në terma afatshkurtër dhe afatgjatë mund të përkeqësojë sëmundjet respiratore dhe kardiovaskulare, si dhe rritjen e vdekshmërisë. Grimcat e vogla PM 2.5 mund të depërtojnë në mushkëri dhe të hyjnë në sistemin e gjakut, duke shkaktuar dëme.
NOx	Të gjitha proceset e djegies në ajër prodhojnë okside azoti (NOx). Dyoksidi i azotit (NO2) dhe monoksidi i azotit (NO) janë të dy okside azoti dhe të dy së bashku referohen si (NOx). Transporti rrugor është burimi kryesor, i ndjekur nga sektori i industrisë.	Oksidet e azotit (NOx) gjithashtu kontribuojnë në acidifikimin e tokës dhe ujërave sipërfaqësore, dhe në formimin e ozonit (O3) në nivelin e tokës. Ato mund të kontribuojnë në azotin e tepërt në ekosistemet tokësore. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe probleme në funksionimin e mushkërive dhe kardiovaskulare.

SO2	Ka për origjinë djegien e karburanteve që përmbajnë squfur, si qymyri dhe vajra të rëndë nga rafineritë.	Kontribuon në acidifikimin dhe eutrofikimin e tokës dhe ekosistemeve ujore, duke dëmtuar habitatet, dhe con në humbjen e biodiversitetit Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Përfshihet në formimin e PM-së
O3	Ozoni nuk emetohet direkt nga ndonjë burim njerëzor. Ai është produkt i reaksioneve kimike, që ndodhin ndërmjet ndotësve të ndryshëm të ajrit, kryesisht NOx, dhe përbërjet organike të avullueshme (volatile) VOC, të iniciuar nga rrezatimi i fortë diellor	Mund të shkaktojë dëmtime në bimë, duke cuar në uljen e prodhimtarisë dhe ndikimit në biodiversitet. Ozoni është gjithashtu Gaz me Efekt Serë. Mund të shkaktojë inflamacion në rrugët e frymëmarrjes dhe problem në funksionimin e mushkërive. Gjithashtu shkakton dhe irritim të syve.
CO-monoksid i karbonit	Formohet nga djegia jo e plotë e karburanteve që përmbajnë karbon. Burimi më i madh është transporti rrugor, që së bashku me djegien nga sektori shtëpiak dhe industrial, konsiderohen si kontribues kryesorë	CO kontribuon në formimin e smogut, ozonit të nivelit të tokës, që shkakton probleme serioze të frymëmarrjes Shkakton dëmtime të rënda në shëndet, duke reduktuar shpërndarjen e oksigjenit në gjak, në organet e trupit

		(si zemra dhe truri) dhe në indet.
Benzen	Ka një shumëllojshmëri burimesh, por mënyra kryesore është përftimi nga djegiet shtëpiake, si dhe nga transporti rrugor.	Benzeni avullon shumë shpejt në ajër dhe transportohet në distanca të largëta. Nëse ai shkarkohet në tokë, mund të zbërthehet shpejt dhe të kontaminojë ujërat nëntokësore. Ekspozimi i njerëzve ndaj benzenit është i lidhur me një sërë sëmundjesh dhe efektesh në shëndet, akute dhe afatgjata, përfshirë kancerin dhe anemone plastike. Benzeni është shumë i avullueshëm dhe ekspozimi më i madh është nëpërmjet frymëmarrjes.

2.4 Standartet e cilësisë se ajrit

Vlerësimi është kryer bazuar mbi normat e lejuara sipas VKM Nr. 352, datë 29.4.2015 që janë të unifikuara me normat e BE.(VKM e sipërmenduar është transpozuar në përputhje me direktivën 2008/50 /EC “Mbi cilësinë e ajrit të mjedisit dhe ajrit më të pastër për Europën”.)

Tabela 23 - Vlerat kufi të cilësisë së ajrit

Normat e lejuara	PM10 µg/m³	PM2.5 µg/m³	SO2 µg/m³	O3 µg/m³	CO mg/m³	NO2 µg/m³	Benzen µg/m³
Orare			350			200	
8 Orare				120	10		
24 Orëshe	50		125				
Vjetore	40	25				40	5

2.5 Vlerësimi i gjendjes së cilësisë së ajrit

2.5.1 Rrjeti i monitorimit




Figura 79 - Harta e Monitorimit të ajrit 2024

Tabela 24 - Treguesit për stacionet

Stacionet	Vendndodhja	Treguesit
Tirana Mobile	Sauk,Tiranë (01.01.2024-20.03.2024) Parkimi publik ngjitur me Teatrin Vaçe Zela, Lushnjë (20.03.2024 -31.05.2024)	PM ₁₀ , NO ₂ , SO ₂ , O ₃ , CO dhe BTEX
Tirana Higjena	Instituti i Higjenës	PM ₁₀ , NO ₂ , SO ₂ , O ₃ , CO dhe BTEX
Tirana MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	PM ₁₀ , PM _{2.5}
Tirana AKM	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	PM ₁₀ , PM _{2.5}
Durrës	Oborri i shkollës “Jusuf Puka”	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
Shkodër	Oborri i Qendrës Shëndetësore të Reabilitimit të Handikapatëve Mendore	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
Elbasan	Përpara godinës së qarkut Elbasan	PM ₁₀ , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
Korcë	Oborri i shkollës “Raqi Qirinxhi”.	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX
Fier	Oborri i shkollës “Janaq Kilica”.	PM ₁₀ /PM _{2.5} , SO ₂ , NO ₂ , O ₃ , CO, BTEX

2.5.2 Vlerësimi i cilësisë së ajrit sipas parametrave

- Vlerësimi për PM10:




Figura 80 - Vlerat mesatare të PM10, Janar – Maj 2024

Nga grafiku vërejmë që kemi tejkalim të normës në stacionin Grimm AKM me vlerë $42.09 \mu\text{g}/\text{m}^3$ nga ku norma është $40 \mu\text{g}/\text{m}^3$. Në stacionin e Korçës, Tirana Higjena dhe Grimm MTM nuk kemi tejkalim të normës vjetore por vlera është afër limitit vjetor. Në stacionet Shkodër, Durrës dhe Fier vlerat vjetore janë të ulëta.




Figura 81 - Numri i ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM10

Numri më i lartë i ditëve që tejkalojnë normën ditore të PM10 për periudhën Janar – Maj 2024 është në stacionin e Korçës ku kemi 23 ditë që tejkalojnë normën ditore të PM10 prej 50 m^3 nga 35 ditë që është norma e lejuar në një vit.

Tirana më 27.03.2024



Në periudhën 26 - 31 Mars 2024, disa qytete të vendit tonë janë mbuluar nga pluhuri afrikan duke shkaktuar rritjen e nivelit të pluhurit në këto qytete.

Vlerësimi për PM2.5




Figura 82 - Vlerat mesatare të PM2.5 Janar - Maj 2024

Referuar të dhënave të PM2.5 në periudhën Janar-Maj 2024, kemi tejkalim të vlerës mesatare të PM 2.5 në qytetin e Elbasanit. Vlera vjetore e monitoruar është $30.15 \mu\text{g}/\text{m}^3$ dhe norma është $25 \mu\text{g}/\text{m}^3$. kemi 20% tejkalim të normës në këtë qytet.

Theksojme se monitorimi i PM 2.5 në Elbasan kryhet për herë të parë. Sipas inventarit të shkarkimeve të vitit 2022, sasia totale e grimcave të pluhurit me madhësi 2.5μ të shkarkuara janë llogaritur 2.21 kt, ku 80.0% vjen nga prodhimi i mineraleve jo-metalike.

Vlerësimi për NO_2 (Dioksid Azoti)




Figura 83 - Vlera mesatare NO₂ për periudhën Janar - Maj 2024

Monitorimi i NO₂ për vitin 2024 është realizuar për periudhën Janar – Maj në stacionet Tirana Higjena, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë dhe Shkodër. Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se nuk kemi tejkalim të vlerës limite vjetore në asnjë nga stacionet e monitoruara. Por në stacionet Tirana Higjena, Elbasani dhe Korça vlera e monitoruar është shumë afër normës vjetore.

Vlerësimi për SO₂ (Dioksid Squfuri)

Monitorimi i SO₂ për periudhën Janar – Maj 2024 është realizuar në stacionet Tirana Higjena, Shkodër, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë dhe Stacioni Mobile. Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se kemi tejkalim të vlerës limite ditore në stacionin Mobile - Tirana, specifikisht në datën 25.01.2024 vlera ditore e SO₂ ka qenë 203.69 µg/m³ nga 125 µg/m³ që është norma dhe në datën 26.01.2024 vlera ditore ka qenë 170.8 µg/m³ nga 125 µg/m³ që është norma. Numri i ditëve të lejuar të tejkalimit të normës 24 orarëshe të SO₂ është 3 ditë/vit.





Figura 84 - Vlerat ditore të SO₂ Janar - Maj 2024

Vlerësimi i situatës për CO (monoksidi i karbonit)*Figura 85 - Vlerat mesatare të CO, Janar - Maj 2024*

Monitorimi i CO është realizuar në stacionet e Durrësit, Elbasanit, Fierit, Korçës, Shkodrës, Tirana Higjena dhe Stacionin e lëvizshëm – Tiranë / Lushnjë. Bazuar në mesataret 8 orare të CO krahasuar me normën 8 orare të BE vërejtje se nuk kemi tejkalim të saj në asnjë stacion.

Monitorimi i CO është realizuar në stacionet e Durrësit, Elbasanit, Fierit, Korçës, Shkodrës, Tirana Higjena dhe Stacionin e lëvizshëm - Tiranë/ Lushnjë. Bazuar në mesataret 8 orare të CO krahasuar me normën 8 orare të BE vërejtje se nuk kemi tejkalim të saj në asnjë stacion.

Vlerësimi për ozonin (O₃)

Monitorimi i O₃ për periudhën Janar - Maj 2024 është realizur në stacionet e Durrësit , Elbasanit, Fierit, Korçës, Shkodrës dhe Tirana Higjena.




Figura 86 - Vlera 8 orare të O₃ në Durrës gjatë periudhës Janar - Maj 2024




Figura 87 - Vlera 8 orare të O3 në Elbasan gjatë periudhës Janar - Maj 2024




Figura 88 - Vlera 8 orare të O₃ në Fier gjatë periudhës Janar - Maj 2024




Figura 89 - Vlera 8 orare të O₃ në Korçë gjatë periudhës Janar - Maj 2024




Figura 90 - Vlera 8 orare të O3 në Shkodër gjatë periudhës Janar - Maj 2024




Figura 91 - Vlera 8 orare të O₃ në st. Tirana Higjena gjatë periudhës Janar - Maj 2024

Bazuar në të dhënat e monitoruara në qytetet Durrësit, Elbasanit, Fierit, Korçës, Shkodrës dhe Tirana Higjena në periudhën Janar –Maj 2024, rezulton se nuk kemi tejkalim të vlerave 8 orare krahasuar me normën 8 orare sipas VKM nr 352, datë 29.4.2015 dhe që janë të unifikuara me normat e BE

Në stacionin e Korçës, në datat 09.05.2025 dhe 22.05.2024 kemi vlera që janë afër normës 8 orare, saktësisht 113.53 µg/m³ dhe 111.23 µg/m³ krahasuar me normën 8 orare të O₃ që është 120 µg/m³.

Gjithashtu me stacionin e lëvizshëm, për periudhën 01.01.2024-20.03.2024 është realizuar monitorimi i O₃ në Sauk Tiranë dhe në periudhën 20.03.2024 - 31.05.2024, stacioni është pozicionuar në Parkimin publik ngjitur me Teatrin Vaçe Zela, Lushnjë




Figura 92 - Vlera 8 orare të O3 në Sauk Tirane gjate periudhës Janar - 20 Mars 2024 me stacionin e lëvizshëm




Figura 93 - Vlera 8 orare të O3 në Lushnjë në periudhën 20 Mars - Prill 2024 me stacionin e lëvizshëm

Bazuar në të dhënat e monitoruara me stacionin e lëvizshëm për periudhën 01.01.2024-20.03.2024 në Sauk Tirane dhe për periudhën 20 Mars - Prill 2024 në qytetin e Lushnjës, nuk kemi tejkalim të vlerave 8 orare të O3 krahasuar me normën 8 orare.

Vlerësimi i situatës nga benzeni

Monitorimi i Benzenit për periudhën Janar – Maj 2024 është realizuar në stacionet Tirana Higjena, Durrës, Fier, Shkodër, Korçë dhe Elbasan dhe me stacionin e lëvizshëm në (Tiranë/Lushnjë)

Bazuar në të dhënat e monitoruara rezulton se në asnjë stacion nuk kemi tejkalim të vlerës mesatare për periudhën e monitoruar, krahasuar me normën vjetore për Benzenin që është $5 \mu\text{g}/\text{m}^3$.




Figura 94 - Vlerat mesatare të Benzenit për periudhën Janar - Maj 2024

2.5.3 Përfundime dhe Rekomandime

Bazuar në të dhënat e monitoruara të cilësisë së ajrit urban, për periudhën Janar – Maj 2024, mund të vlerësohet se cilësia e ajrit në qytetet e monitoruara nuk është e një niveli shumë të mirë.

- Ndotësit kryesorë të cilësisë së ajrit urban janë grimcat e pluhurit me diametër 10 mikron (PM10) dhe 2.5 mikron (PM2.5), specifikisht në stacionin Grimm AKM, Korçë dhe Elbasan. Burimet kryesore të ndotjes nga PM10 dhe PM2.5 në stacionin Grimm AKM dhe Elbasan lidhet me trafikun dhe ndërtimet në afërsi të stacioneve ndërsa në qytetin e Korçës lidhen me ngrohjen me dru gjatë periudhës së dimrit.
- Vlerat më të larta të O₃ janë monitoruar në qytetin e Korçës. Kemi vlera që janë afër normës 8 orare, saktësisht 113.53 µg/m³ dhe 111.23 µg/m³ krahasuar me normën 8 orare të O₃ që është 120 µg/m³.

Masat për reduktimin e shkarkimeve përfshijnë:

- Inkurajimi i kalimit nga përdorimi i automjeteve private drejt llojeve të tjera të udhëtimit dhe nxitjen e përdorimit të transportit publik për të reduktuar shkarkimet e automjeteve dhe për të përmirësuar cilësinë e ajrit.
- Menaxhimi dhe kontrolli i rrjedhës së trafikut në mënyrë që të shmanget bllokimi i automjeteve dhe qëndrimi i zgjatur në kryqëzimet e rrugëve dhe në zonat urbane, duke përmirësuar cilësinë e ajrit në këto vende.
- Rregullimi dhe kufizimi i shkarkimeve nga të gjitha mjetet motorike. Forcimi i kontroleve të detyrueshme të shkarkimeve të gazta në të gjithë vendin, për të gjitha automjetet. Ndalimi i qarkullimit për të gjitha automjetet private dhe publike që nuk janë në gjendje të mirë, ose që tejkalojnë vlerën e përcaktuar të kufirit të shkarkimeve.
- Promovimi i përdorimit të automjeteve me ndikim të ulët në mjedis (automjeteve elektrike) dhe forcimi i rrjetit shpërndarës për karikimin elektrik jo vetëm në Tiranë por në të gjithë Shqipërinë.
- Ndotja e NO₂ mund të zvogëlohet duke reduktuar vëllimet e përgjithshme të trafikut në qytete dhe duke rritur numrin e automjeteve elektrike.
- Sigurimi i karburantit me përmbajtje të ulët të squfurit. Kontrolli i rregullt i testimit të shkarkimeve të automjeteve për të kufizuar dhe për të reduktuar shkarkimet e grimcave dhe ndotësve të tjerë të ajrit.
- Kufizimi dhe zvogëlimi i nivelit të parkimit në rrugë dhe jashtë rrugës, në qendrat urbane, për të reduktuar volumet e trafikut dhe shkarkimet e automjeteve.
- Ndërtimi i hapësirave të gjelbëruara. Ndërtimi i zonave me gjelbërim të përhershëm me një përthithje të lartë përgjatë rrugëve kryesore të trafikut.
- Përmirësimi i planifikimit urban dhe ndalimi i djegies në natyrë, në veçanti në fushat e ndërtimit të materialeve të mbetura.
- Larja e mjeteve të tonazhit të rëndë dhe jo vetëm, që dalin nga kantierët e ndërtimit.
- Në sektorin e bujqësisë, kufizimi i aktiviteteve të djegies së kashtës dhe drithërave në tokat bujqësore, realizimi i instalimeve për rikuperimin dhe ripërdorimin e biogazit nga bagëtitë, reduktimi i emetimeve nga drutë e zjarrit.

- Promovimin e përdorimit të burimeve të energjisë së rinovueshme me qëllim përmbushjen e kërkesave të energjisë për ngrohje, ajër të kondicionuar, ndriçim dhe prodhimin e ujit të nxehtë.
- Ndotja PM 2.5 mund të reduktohet duke ndryshuar mënyrën se si ngrohim shtëpitë tona, veçanërisht duke u larguar nga lëndët djegëse që çlirojnë tym dhe duke zgjedhur opsione më të pastra.

2.6 Ndryshimet Klimatike

Ndryshimet klimatike aktuale dhe ato të projektuara do të ndikojnë në kushtet meteorologjike dhe mjedisore në Shqipëri. Ndërkohë që temperatura mesatare rritet, ulja e nivelit të reshjeve dhe rritja e nivelit të detit do të kenë disa ndikime në terma afatgjatë. Këto ndryshime do të çojnë gjithashtu në rritje të shpeshtësisë dhe intensitetit të fatkeqësive që lidhen me motin. Emetimet e gazeve me efekt serë (GES) janë kontribuesi kryesor që ndikojnë në ndryshimet klimatike.

2.6.1 Tendencat historike të emetimeve të GES dhe masat zbutëse

Kontributi relativ i çdo sektori në totalin e emetimeve mbetet i ngjashëm me situatën e vitit referencë, përveç sektorit të PTNPTP-së që ka kontribut në rënie për shkak të nivelit më të lartë të përthithjes dhe nivelit më të ulët të emetimeve nga burimet.

Duke marrë në konsideratë të gjithë sektorët (përfshirë PTNPTP-në), emetimet për skenarin KKP (duke përfshirë masat zbutëse) parashikohet të rriten nga 10 139 kt CO₂e në vitin 2016, në 11 978 kt CO₂e në vitin 2030, çka përfaqëson një rritje prej +18.1%. Diferenca me skenarin BaU në vitin 2030 është -3170 kt CO₂e, çka përbën një zbutje prej -20,9%. Në përgjithësi, masat zbutëse të marra në konsideratë në skenarin KKP mund të ndihmojnë që, gjatë periudhës 2021-2030, të shmangen në total 16 828 kt CO₂e krahasuar me skenarin BaU. Ky është efekti kumulativ i reduktimit të emetimeve ndërmjet skenarit KKP dhe skenarit BaU.

2.6.2 Skenarët sipas Sektorëve

● Sektori i Energjisë

Efiçenca e energjisë (EE): Ky skenar supozon se Shqipëria përmbush angazhimet e saj në Traktatin e Komunitetit të Energjisë përmes zbatimit të Planit të Dytë Kombëtar të Veprimit për Efiçencën e Energjisë, të ligjit “Për efiçencën e energjisë” (së bashku me përmirësimin e ligjit për transpozimin e kërkesave të Direktivës për Efiçencën e Energjisë) dhe të ligjit “Për performancën e energjisë në ndërtesa”. Objektivi i EE për vitin 2030 është caktuar në 15%.

Burimet e rinovueshme të energjisë (BRE): Supozon se Shqipëria përmbush angazhimet e saj në Traktatin e Komunitetit të Energjisë për të arritur një objektivi të energjisë nga burimet e rinovueshme prej 38% në vitin 2020, përmes zbatimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Burimet e Rinovueshme të Energjisë. Objektivi i BRE për vitin 2030 është caktuar në 42.5%.

Promovimi i gazit natyror: Supozon penetrimin maksimal të mundshëm të gazit natyror në përputhje me Master Planin e Gazit. Objektivi i penetrimit të gazit natyror për vitin 2030 është caktuar në 8-10% (Master Plani Kombëtar i Gazit Natyror). Gazi natyror në Shqipëri do të përdoret kryesisht për të garantuar sigurinë e furnizimit me energji elektrike, duke qenë se sektori i energjisë elektrike në Shqipëri bazohet tërësisht në burimet hidrike dhe në importin e energjisë elektrike.

Skenari i kombinuar: Kombinon skenarët EE, BRE dhe të promovimit të gazit natyror. Sipas këtij skenari, të gjitha objektivat e përmendura më sipër janë agreguar dhe garantojnë një skenar zhvillimi të përshtatshëm për zhvillimin e sektorit të energjisë deri në vitin 2030.

Emetimet për skenarin KKP (duke përfshirë masat zbutëse) parashikohet të rriten nga 4664 kt CO₂e në vitin 2016, në 6544 kt CO₂e në vitin 2030, çka përfaqëson një rritje prej +40.3%.

Masat zbutëse për sektorin e Energjisë (eficienca e energjisë)

Rritja e përqindjes së transportit publik për udhëtarët dhe mallrat (rrugor, hekurudhor dhe në rrugë ujore). Deri në vitin 2030, 30% e transportit rrugor prej

mbi 300 km do të kalojë në modalitete të tjera transporti, si p.sh. transporti hekurudhor. Deri në vitin 2050, objektivi për t'u arritur është 50%.

1. Etiketimi i energjisë së mjeteve të reja.
2. Përmirësimi i performancës së energjisë në ndërtesa, duke marrë në konsideratë kushtet klimatike dhe lokale të vendit, komfortin e brendshëm të ndërtesave dhe efikasitetin e kostos me 2% të sipërfaqes së ngrohur/ftohur për ndërtesat që administrohen apo përdoren nga një autoritet publik ose që ofrojnë një shërbim publik, me qëllim përmbytjen e kërkesave minimale të performancës së energjisë.
3. Reduktimi i humbjeve të transmetimit dhe shpërndarjes nëpërmjet nxitjes së prodhimit të shpërndarë.
4. Reduktimi i emetimeve nga industritë bazuar në eficientësinë e energjisë.
5. Proçesi i diversifikimit dhe largimit nga energjia hidrike dhe promovimi i burimeve alternative të energjisë së rinovueshme: Deri në vitin 2030, energjia nga burimet e rinovueshme duhet të përbëjë 42% të konsumit final bruto të energjisë.
6. Rritja e përqindjes së makinave elektrike (ME) në totalin e flotës së makinave të pasagjerëve (deri në 10% pasagjerë-km në vitin 2030). Rritja e përdorimit të biçikletës si një mjet udhëtimi (deri në 5% pasagjerë-km në vitin 2030)
7. Rritja e penetrimit të gazit natyror
8. Zhvillimi i shërbimeve dhe tregut të gazit në Shqipëri bazuar në gazin natyror të furnizuar përmes Gazsjellësit Trans-Adriatik (Projekti GTA/TAP), si dhe përmes burimeve të mundshme të gazit të zbuluara dhe të përdorura në vend, ose përmes gazsjellësve, si p.sh. Gazsjellësi Adriatik-Jon (Projekti PGAI/IAP) dhe Gazsjellësi Shqipëri-Kosovë (Projekti GShK/ALKOGAP).

Shqipëria synon të krijojë një depozitë nëntokësore të gazit natyror në Dumre, pranë Elbasanit (Projekti GNN/UGS Dumre). Ndërtimi i tubacionit që do të lidhë projektin GTA, pranë zonës së Stacionit të Kompresorëve të Fierit, me TEC-in e Vlorës dhe me të gjithë qarkun e Vlorës, do të bëjë të mundur rifunksionimin e TEC-it të Vlorës duke përdorur gazin natyror si lëndë djegëse.

Sektori i Proçeseve Industriale dhe Prodhimit të Produkteve (PIPP)

Pothuajse 90% e emetimeve të GES-ve nga proceset industriale varen nga prodhimi i çimentos.

Emetimet nga konsumi i energjisë në industrinë e prodhimit përfshihen në sektorin e energjisë. Në sektorin e PIPP-së, emetimet parashikohet të rriten nga 1020 kt CO₂e në vitin 2016, në 1854 kt CO₂e në vitin 2030, çka përfaqëson një rritje prej +81,9%.

Shqipëria ka ratifikuar Amendamentin e Kigalit të Protokollit të Montrealit “Për substancat që hollojnë shtresën e ozonit”, në vitin 2019. Në vitin 2030 pritet që HFC-të të përbëjnë rreth 16% të emetimeve të CO₂e nga PIPP.

Sektori i Mbetjeve

Në sektorin e mbetjeve, emetimet për skenarin KKP parashikohet të rriten nga 838 kt CO₂e në vitin 2016, në 959 kt CO₂e në vitin 2030, çka përfaqëson një rritje prej +14,5%. Diferenca me skenarin BaU në vitin 2030 është -7 kt CO₂e, çka përbën një zbutje prej -0,7%.

Masat zbutëse për sektorin e mbetjeve

1. Reduktimi i sasisë së mbetjeve që shkojnë në landfill. Në vitin 2030, parashikohet të reduktohet me 35% sasia e mbetjeve urbane që shkojnë në landfill kundrejt sasisë totale (sipas peshës) të mbetjeve urbane të biodegradueshme të prodhuara në vitin 2010.
2. Ngritja e sistemit të kapjes së metanit. Fillimi i kapjes së CH₄ në vitin 2025 dhe zhvillimi linear deri në një nivel kapjeje prej 10% të sasisë prej 1,34 milion m³ CH₄ në vitin 2030
3. Rritje e sasisë së mbetjeve të kompostuara. Rritje e sasisë së mbetjeve të kompostuara me 85% në periudhën 2009-2020 dhe më pas +3% çdo vit deri në vitin 2030.
4. Niveli konstant i sasisë totale të mbetjeve klinike të incineruara. Niveli konstant i sasisë totale të mbetjeve klinike të incineruara. Nga viti 2017 deri në vitin 2030, parashikohet incinerimi i 0,04 kt mbetje klinike.
5. Rritje e incinerimit të mbetjeve të ngurta urbane. Rritje graduale e incinerimit të mbetjeve. ndërmjet periudhës 2021 - 2030:

6. Ulje e sasisë së mbetjeve të djegura në ambiente të hapura. Ulja e sasisë së mbetjeve të djegura në ambiente të hapura në raport me sasinë e mbetjeve të pagrumbulluara në vend, 2016 - 2030: -74%
7. Trajtimi i ujërave të përdorura në zonat rurale dhe në industri.
8. Rritje e konsumit të proteinave. Rritje e konsumit vjetor të proteinave për frymë, përlogaritur nga të dhënat e FAOSTAT 2019-2030: 40,12 kg/person/vit.

Sektori i Bujqësisë

Emetimet për skenarin KKP për këtë sektor (duke përfshirë masat zbutëse) parashikohet të ulen nga 2344 kt CO₂e në vitin 2016, në 2071 kt CO₂e në vitin 2030, çka përfaqëson një rënie prej -11,6%.

Masat zbutëse për sektorin e bujqësisë

1. Nxitja e prodhimit bujqësor dhe konkurrueshmërisë në Shqipëri. Rritje e prodhimit, mosulje e popullatës së bagëtive, rritje e rendimentit
2. Përmirësimi i plehërimit me plehërues të prodhuar nga azoti duke aplikuar normën e duhur. duke nxitur përdorimin e lëndëve organike dhe të mbetjeve të kulturave bujqësore në vend të plehëruesve mineral.
3. Rritje e kohës së kaluar në kullota. Parashikohet se në vitin 2030, ato do të kalojnë 25% të kohës duke kullotur. Kjo masë rrit nivelin e sekuestrimit të karbonit në kullota dhe ul emetimet e N₂O.
4. Optimizimi i ushqimit të kafshëve me qëllim reduktimin e emetimeve të N₂O dhe CH₄. Teknikat e përmirësuara të ushqyerjes çojnë në: - Ulje të normës së sekretimit të azotit (inputet e azotit në rastin kur ushqimi i përshtatet më mirë nevojave të kafshëve). Supozohet se përmirësimi i ushqyerjes çon në një reduktim prej 10%. Një ulje e nivelit të CH₄ enterik (shtimi i yndyrës në ushqim): sipas instrumentit MKPGES, mund të çojë në një reduktim prej 4% të emetimeve të CH₄ për çdo 1% yndyrë të shtuar.

Sektori i Përdorimit të Tokës dhe Ndryshimit të Përdorimit të Tokës dhe Pyjeve (PTNPTP)

Në sektorin e PTNPTP-së, emetimet (kryesisht humbjet e karbonit nga vjelja e druve të zjarrit, e materialit drusor dhe nga zjarret në pyje) janë më të mëdha se sa përthithjet (rritja e biomasës së pyjeve). Për këtë arsye, ky sektor nuk përfaqëson një përthithës neto.

Në sektorin e PTNPTP-së, emetimet për skenarin KKP (duke përfshirë masat zbutëse) parashikohet të ulen nga 1319 kt CO₂e në vitin 2016, në 598 kt CO₂e në vitin 2030, çka përfaqëson një rënie prej -54,7%.

Masat zbutëse për sektorin e PTNPTP-së

1. Masa në lidhje me energjinë ku përfshihen: ndryshimet në përzjerjen e lëndëve djegëse, reduktimi i përdorimit të druve të zjarrit, moratoriumi mbi drutë e zjarrit. Konsumi i druve të zjarrit parashikohet që ndërmjet periudhës 2016-2030 të ulet me 4% sipas skenarit KKP. Në vitin 2030, parashikohet që zbatimi i kësaj mase të mundësojë uljen e emetimit vjetor që përlllogaritet në -314 kt CO₂e krahasuar me skenarin BaU.
2. Sipërfaqe të reja pyllëzimi. Në bazë të rrethanave kombëtare dhe duke marrë në konsideratë tendencat aktuale, potenciali për pyllëzime të reja vlerësohet në 300 ha në vit. Në vitin 2030, parashikohet që zbatimi i kësaj mase të mundësojë uljen e emetimit vjetor që përlllogaritet në -7 kt CO₂e krahasuar me skenarin BaU.
3. Përmirësimi i menaxhimit dhe monitorimit me qëllim parandalimin e zjarreve. Në vitin 2030, parashikohet që zbatimi i kësaj mase të mundësojë uljen e emetimit vjetor që përlllogaritet në -251 kt CO₂e krahasuar me skenarin BaU.
4. Përmirësimi i efijencës së vjeljes së druve të zjarrit. Në vitin 2030, parashikohet që zbatimi i kësaj mase të mundësojë uljen e emetimit vjetor që përlllogaritet në -145 kt CO₂e krahasuar me skenarin BaU.

5. Përmirësimi i menaxhimit të qëndrueshëm të pyjeve. Në vitin 2030, parashikohet që zbatimi i kësaj mase të mundësojë uljen e emetimit vjetor që përlllogaritet në -18 kt CO₂e krahasuar me skenarin BaU.

2.6.3 Ndryshueshmëria e klimës dhe ndryshimet klimatike

Temperatura. Të dhënat për temperaturën që prej vitit 1901 tregojnë se temperatura mesatare vjetore në Shqipëri në pjesën më të madhe të shekullit ka qenë ndërmjet 11 dhe 12°C. Që nga viti 1998, mesatarja e rumbullakosur ka qenë mbi 12°C dhe ka vazhduar qartësisht në rritje duke arritur në 12,72°C në vitin 2016.

Tendencat e projektuara tregojnë se temperatura mesatare vjetore në Shqipëri do të rritet me 1,3°C deri në 2,2°C brenda vitit 2050 dhe me 1,2°C deri në 4,4°C brenda vitit 2100 nga niveli bazë prej 11,8°C i regjistruar në periudhën 1986-2005. Rritjet më të mëdha do të vërehen gjatë muajve qershor dhe shtator dhe parashikohet që temperatura mesatare e verës të arrijë rreth 27°C brenda vitit 2100.

Reshjet. Nivelet mesatare të reshjeve kanë mbetur relativisht të qëndrueshme që nga 1901, edhe pse me një tendencë të lehtë në ulje. Brenda vitit 2050, niveli i reshjeve në Shqipëri pritet të ulet me 2,1 % nga niveli bazë prej 929,7 mm i periudhës 1986-2005. Brenda vitit 2100, në një “Botë 2°C”, reshjet do të pësonin rënie me 1,8% (më pak se brenda vitit 2050), ndërsa në një “Botë 4°C” do të pësonin ulje me 12,2%.²⁰

Rritja e nivelit të detit. Anomalitë e nivelit të detit të regjistruara që në vitin 1993 shfaqin një tendencë në rritje të nivelit të detit në bregdetin e Shqipërisë. Nuk ekzistojnë projeksione për rritjen e nivelit të detit në të gjithë bregdetin shqiptar. Projeksionet për deltën e lumenjve Drin-Mat tregojnë se brenda vitit 2100, niveli i detit mund të rritet nga 45 cm deri në 60 cm, ndërsa Projeksionet për basenin e Vjosës tregojnë se brenda vitit 2100 mund të ketë një rritje nga 25 deri në 105 cm.

2.6.4 Rreziqet, ndikimet dhe cënueshmëria nga ndryshimet klimatike

Ndryshimet klimatike aktuale dhe ato të projektuara do të ndikojnë në kushtet meteorologjike dhe mjedisore në Shqipëri. Ndërkohë që temperatura mesatare rritet, ulja e nivelit të reshjeve dhe rritja e nivelit të detit do të kenë disa ndikime në terma afatgjatë. Këto ndryshime do të çojnë gjithashtu në rritje të shpeshtësisë dhe intensitetit të fatkeqësive që lidhen me motin.

Tabela 25 - Rreziqet, ndikimet dhe cënueshmëria nga ndryshimet klimatike

Faktori	Ndryshimi	Efektet/rreziqet
Temperatura	Rritje e temperaturës mesatare vjetore, veçanërisht gjatë muajve të verës Rritje e temperaturës minimale dhe maksimale te bregdetit (në të gjitha stinët) Rritje e shpeshtësisë së temperaturave ekstreme të larta te bregdetit Rritje e numrit të netëve tropikale Rritje e numrit dhe kohëzgjatjes së valëve të të nxehtit	Rritje e avullimit Rritje e gradë-ditëve të ftohjes Rritje e sasisë së reshjeve në formën e shiut (jo të borës) gjatë dimrit. Rritje e shpeshtësisë së thatësirave
Reshjet	Ulje e nivelit të reshjeve vjetore, veçanërisht gjatë muajve të verës Rritje e nivelit të reshjeve gjatë muajve të dimrit Rritje e ndryshueshmërisë së reshjeve, dhe rritje e shpeshtësisë dhe intensitetit të reshjeve të dendura të shiut Ulje e sasisë kumulative të ujit gjatë 12 muajve (ISAT)	Rritje e rasteve të përmbytjeve, veçanërisht gjatë dimrit, por edhe gjatë muajve të vjeshtës dhe pranverë

		Rritje e shpeshtësisë së thatësirave Ulje e prurjes vjetore të lumenjve (baseni i Vjosës)
Rritja e Nivelit të Detit	Rritje e nivelit të detit	Kripëzimi i akuifereve bregdetare Rritje e cënueshmërisë së zonave bregdetare nga përmbytjet që shkaktohen nga stuhitë detare dhe erozion

Cënueshmëria e vendbanimeve dhe rreziqet që u kanosen

Tabela 26 - Cënueshmëria e vendbanimeve dhe rreziqet që u kanosen

Faktorët sektorialë të cënueshmërisë	Rreziqet ndaj sektori
Infrastruktura dhe ndërtimet • Sipërfaqja e sheshtë e zonës bregdetare • Dendësia e banesave, ndërtesave, infrastrukturës, tokës bujqësore dhe zonave historike/kulturore në bregdet • Zënia e zonave bregdetare, të cilat janë shumë të ekspozuara ndaj përmbytjeve dhe erozionit • Infrastruktura e kufizuar për parandalimin e përmbytjeve • Mirëmbajtja e dobët e infrastrukturës për parandalimin e përmbytjeve • Erozioni që lidhet me sasinë e kufizuar të sedimenteve nga lumenjtë në të cilët janë ndërtuar diga	Infrastruktura dhe ndërtimet • Fatkeqësitë mund të shkaktojnë humbje të aksesit në shërbime thelbësore, si strehimi, energjia elektrike, uji i pijshëm, transporti, shëndetësia dhe institucionet arsimore, sektori i industrisë, infrastruktura turistike etj. • Humbje të jetës dhe të mjeteve të jetesës nga fatkeqësitë klimatike • Humbje të sipërfaqes tokësore për zhvillim në të ardhmen
Uji Humbje të rëndësishme në sistemin aktual të furnizimit me ujë	Uji

Kërkesa po rritet në mënyrë natyrale	Ulja e kapacitetit për të siguruar ujë për popullsinë dhe industrinë/kërkesa e paplotësuar për ujë gjatë verës
Energjia Varësia e lartë nga hidrocentralet Mirëmbajtja e dobët e infrastrukturës energjetike/Niveli i lartë i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes	Energjia Ulja e kapacitetit për të siguruar energji elektrike për popullsinë dhe industrinë/kërkesa e paplotësuar për energji elektrike gjatë verës

Cënueshmëria dhe rreziqet që i kanosen popullsisë dhe Turizmit

Tabela 27 - Cënueshmëria dhe rreziqet që i kanosen popullsisë dhe Turizmit

Faktorët sektorialë të cenueshmërisë	Rreziqet ndaj sektori
Jeta dhe mjetet e jetesës Dendësia e lartë e popullsisë në zonat bregdetare, duke përfshirë në zonat me rrezikshmëri të lartë • Cenueshmëria e vendbanimeve	Jeta dhe mjetet e jetesës Fatkeqësitë klimatike mund të shkaktojnë: • Humbje të jetës dhe lëndime • Shkatërrim ose dëmtim të shtëpive • Akses të kufizuar në shërbime (ujë, energji elektrike, shëndetësi, arsim etj.) • Humbje dhe/ose ndërprerje të mjeteve të jetesës si pasojë e fatkeqësive që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë (p.sh. përmbytjet e centraleve) ose të tërthortë (p.sh. humbja e aksesit në shërbimet thelbësore, si energjia elektrike ose transporti) me klimën
Shëndeti • Infrastruktura shëndetësore e ndërtuar në zona të cenueshme dhe e cila nuk është e përgatitur në tërësi për të përballuar ndryshimet klimatike të parashikuara	Shëndeti • Humbje të jetës dhe lëndime që lidhen me fatkeqësitë klimatike, veçanërisht me përmbytjet • Pasoja në shëndetin mendor që vijnë nga fatkeqësitë klimatike

• Cenueshmëria e vendbanimeve	• Rritje e rasteve të sëmundjeve me prejardhje nga uji dhe insektet • Ulje e disponueshmërisë dhe/ose e cilësisë së ujit dhe ushqimit • Rritje e rasteve të sëmundjeve dhe vdekjeve që lidhen me nxehtësinë • Përkeqësim i cilësisë së ajrit që shkakton sëmundje respiratore dhe kardiovaskulare • Reduktim i aksesit në infrastrukturën dhe shërbimet shëndetësore • Rritje e barrës së elementëve të mësipërm në sistemin shëndetësor
Turizmi • Zhvillim i kufizuar i sektorit të turizmit • Sezon turistik i përqendruar në muajt korrik dhe gusht • Infrastruktura turistike (hotelet, parqet etj.), infrastruktura mbështetëse (aeroportet, rrugët etj.) është ndërtuar në zona të ulëta • Cenueshmëria e vendbanimeve	Turizmi • Rënie e interesit gjatë periudhës qershor-shtator për shkak të temperaturës së lartë • Shkatërrimi ose dëmtimi i infrastrukturës turistike (hotele, zona kulturore etj.) • Shkatërrimi ose dëmtimi i infrastrukturës mbështetëse (aeroporte, rrugë etj.) • Ekspozimi i turistëve ndaj efekteve shëndetësore afatshkurtra (goditjet nga nxehtësia etj.) • Reduktimi i sipërfaqes së plazhit • Dëmtimi i trashëgimisë kulturore • Shkatërrimi dhe degradimi i biodiversitetit dhe peizazheve natyrore

Cënueshmëria dhe rreziqet që i kanosen sektorit të Bujqësia Pyjet dhe Përdorimet e tjera të Tokës.

Kulturat bujqësore

Ndryshimet e ardhshme klimatike në Shqipëri pritet të kenë efekte të konsiderueshme në prodhimin e kulturave bujqësore. Veçanërisht në zonat fushore, parashikohet që rendimenti i misrit të ulet me 17% dhe rendimenti i domateve dhe shalqirit të bjerë me 6-11%. Në zonat bujqësore me mundësi

të kufizuara vaditjeje ose me mungesë të plotë vaditjeje, pritet që rendimenti i jonxhës të ulet me 6%, rendimenti i rrushit me 17-23%, rendimenti i ullinjve me 11- 20%, ndërsa rendimenti i grurit pritet të rritet me 4-5%.

Rrisqet që i kanosen sektorit të kulturave bujqësore janë:

- Rritje e rrezikut të thatësisë dhe mungesës së ujit
- Rritje e kërkesës për ujitje
- Rritje e rrezikut në bujqësi nga insektet e dëmshme, sëmundjet dhe barërat e këqija (sasia e përdorur e pesticideve është rritur ndjeshëm, çka tregon rritje të nivelit të infeksioneve dhe zonave të trajtuara për të eliminuar sëmundjet dhe insektet e dëmshme).
- Nëse analizojmë strukturën e prodhimit gjatë dhjetë viteve të fundit, do të konstatojmë se sipërfaqja e kultivuar me grurë është ulur me rreth 22%, ndërsa prodhimi ka rënë me 13%.
- Përmbetje masive, çdo 3-4 vjet (përmbytjet kanë shkaktuar humbjen e rreth 10 000 ha grurë, 15 000 ha foragjere, 1000 ha pemë frutore dhe mbi 1500 ha vreshta). Dëmtimi më i madh ka ndodhur në verilindje (rajonet e Shkodrës dhe Lezhës)

Blegtoria

Ndikimet e ndryshimeve klimatike në prodhimin blegtoral përfaqësohen nga:

1. Ndikimet e drejtpërdrejta në prodhimin blegtoral, riprodhimin, shëndetin dhe vdekshmërinë e kafshëve si pasojë e rritjes së temperaturave, si dhe të shpeshtësisë dhe intensitetit të valëve të të nxehtit.
2. Efektet e tërthorta që lidhen me ndryshimin e disponueshmërisë dhe cilësisë së produkteve ushqimore dhe të ujit të pijshëm, si dhe me mbijetesën dhe rishpërndarjen e patogjenëve dhe/ose vektorëve të tyre.

Rrisqet që i kanosen sektorit të blegtorisë janë:

- Stresi i shkaktuar nga nxehtësia mund të ndikojë në nivelin e përdorimit të elementëve ushqimorë, përthithjen e ushqimit, prodhimin blegtoral, riprodhimin, shëndetin dhe vdekshmërinë e kafshëve. Stresi i shkaktuar nga nxehtësia do të përjetohej më tepër në sistemet e kullotjes në zonat malore ku kafshët, kryesisht bagëtitë e imëta, pavarësisht se janë raca lokale, nuk janë të përshtatura me stresin e shkaktuar nga nxehtësia.
- Në zonat fushore dhe me lartësi mesatare, stresi i shkaktuar nga nxehtësia do të jetë më i fortë, por pjesa më e madhe e bagëtive mbahen në stalla të cilat janë relativisht të mbrojtura nga stresi i shkaktuar nga nxehtësia.
- Efekti i stresit të shkaktuar nga nxehtësia në prodhimin e mishit do të lidhet me mungesën e prodhimit të foragjereve, vlerën më të ulët ushqyese dhe rritjen e kostos së prodhimit. Për ushqyerjen do të përdoren produktet ushqimore më të koncentruara.
- Prodhimi i mishit të derrave dhe shpendëve do të preket më shumë në zonat fushore si pasojë e temperaturave të larta.
- Rritja e temperaturës veçanërisht në zonat fushore do të rrisë lignifikimet e hershme të kulturave foragjere, duke reduktuar tretshmërinë dhe degradueshmërinë e tyre të bagëtisë e imëta dhe do të rrisë nevojën për të përdorur produkte ushqimore më të koncentruara në racionet e tyre ushqimore. Kjo do të rrisë koston e prodhimit të qumështit dhe mishit.
- Disponueshmëria e ujit dhe problemet me cilësinë e tij do të ndikojnë në sektorin e blegtorisë, i cili e përdor ujin për t'i mundësuar kafshëve ujë të pijshëm, për të vaditur kulturat bujqësore dhe për të përpunuar produktet shtazore. Kafshët në sistemin e kullotjes do të preken më shumë nga mungesa e ujit, për shkak të infrastrukturës së kufizuar të ujit dhe mirëmbajtjes së saj të dobët.
- Disponueshmëria e ujit do të ndikojë në mungesën e higjienës gjatë procesit të mbarështimit të kafshëve, duke sjellë pasojë në shëndetin e tyre, si dhe në cilësinë dhe sigurinë e produkteve të tyre. • Sëmundjet me prejardhje nga insektet mund të ndikohen nga temperaturat më të larta dhe ndryshimet në modelet e reshjeve, të cilat mund të përkthehen në rritje të përhapjes së sëmundjeve ekzistuese që shkaktohen nga insektet dhe makroparazitët, të shoqëruara nga shfaqja dhe përhapja e

sëmundjeve të reja. Në disa fusha, ndryshimet klimatike mund të gjenerojnë gjithashtu modele të reja transmetimi.

- Në rastin e stresit të shkaktuar nga nxehtësia ekstreme, do të përballemi me nivele më të larta vdekshmërie.
- Racat lokale dhe ato të rralla mund të zhduken si rezultat i ndikimit të ndryshimeve klimatike dhe epidemive të sëmundjeve
- Shumica e bagëtive të imëta, deleve dhe dhive, janë raca lokale shqiptare të rritura kryesisht në sistemin e kullotjes dhe do të jenë më të cenueshme nga ndryshimet klimatike në Shqipëri. Nga dhjetë raca të deleve, tre prej tyre rrezikojnë të zhduken dhe nga 17 raca të dhive, 10 prej tyre rrezikojnë të zhduken. Ndryshimet klimatike do të ndikojnë negativisht në nivelin e tyre të rrezikut.
- Sasia dhe cilësia e foragjereve ndikohen nga kombinimi i faktorëve në vijim si: rritja e temperaturave dhe sasisë së CO₂, dhe ndryshimi i nivelit të reshjeve. Efekti i ndryshimeve klimatike do të ndryshojë sipas Zonave Agro-Ekologjike (ZAE), reshjeve të shiut dhe temperaturave.
- Në zonat e ujtura: Prodhimi i jonxhës së ujitur do të rritet në të gjitha ZAE-të nga 6-13%, me ndikim më të lartë në zonat malore në jug të vendit. Prodhimi i misrit do të ulet nga 3 deri në 11%, me ndikim më të lartë në zonat malore në veri të vendit. Në zonat malore në jug të vendit, reshjet do të kenë efekt disi pozitiv në prodhimin e misrit.
- Në zonat që ushqehen nga reshjet e shiut: Prodhimi i jonxhës do të ulet me 2-6% veçanërisht në zonat me lartësi mesatare. Në zonat malore në juglindje të vendit, ndikimi i ndryshimeve klimatike do të jetë pozitiv, duke sjellë një rritje prej 7% të prodhimit.
- Përmbytjet rajonale janë shoqëruar me humbje të kafshëve dhe mungesë të kulturave foragjere

Pyjet

Përveç problemeve të shkaktuara nga mungesa e kapaciteteve dhe e mbështetjes për sektorin e pylltarisë, mungesa e zbatimit të ligjit dhe zjarret në pyje, pritet që pyjet të preken në mënyrë të konsiderueshme nga ndryshimet e ardhshme klimatike. Në zonat me kushte më të ftohta, pyjet mund të shfaqin, mesatarisht, rritje të produktivitetit, ndërsa pyjet në zonat më të ngrohta mund të shfaqin rënie të produktivitetit. Gjithashtu, insektet e dëmshme dhe sëmundjet do të jenë më

të pranishme, duke prekur një sipërfaqe më të madhe pyjore dhe më shumë specie në Shqipëri.

Rrisqet që i kanosen sektorit të pyjeve janë:

- Ulja e produktivitetit të pyjeve
- Rritje e produktivitetit të pyjeve në rastin e specieve tolerante ndaj thatësirës.
- Rritja e numrit të insekteve të dëmshme dhe sëmundjeve do të shkaktojë më shumë dëmtime
- Rënie e aftësisë së pemëve për të prodhuar rrëshirë
- Do të ketë zgjerim apo përparim të llojeve, veçanërisht drejt zonave jopyjore (p.sh. në kullotat alpine)
- Më shumë zjarre në pyje
- Reduktim i sipërfaqeve pyjore për disa lloje (bredhi, bredhi evropian, pisha skoceze etj.)
- Fragmentimi i sipërfaqeve pyjore
- Pakësim në masë të brezit të pyllëzimeve mbrojtëse bregdetare, ose do të vuajnë nga ujërat e kripur, erozioni dhe ujërat e ëmbla
- Ulja e produktivitetit të pyjeve në rastin e specieve që janë më pak tolerante ndaj thatësirës.
- Stresi i shkaktuar nga uji do të reduktojë produktivitetin e pyjeve
- Reshjet ekstreme do të shkaktojnë përmytje në pjesën perëndimore të vendit dhe përgjatë zonave bregdetare
- Niveli i rritur i CO₂ mund të ketë efekte pozitive në produktivitetin e pyjeve.
- CO₂ mund të bëjë që pemët të jenë më produktive, çka mund të ndryshojë shpërndarjen e specieve të pemëve

Kullotat dhe livadhet

Risqet që i kanosen sektorit të kullotave dhe livadheve janë:

- Ndryshimet në cilësinë e foragjereve
- Ndryshimet në përbërjen e komuniteteve bimore
- Ulje e produktivitetit si pasojë e reduktimit të lëndëve ushqyese nga toka

- Kohëzgjatja sezonale e kullotjes mund të zgjatet me të paktën 2,5 muaj.
- Dëmtim i bimëve shumëvjeçare. Rikuperim më i gjatë dhe më i ngadaltë i barishteve
- Diversiteti biologjik mund të kërcënohet/reduktohet në mënyra të ndryshme.
- Reduktim i variacioneve gjenetike
- Gërryerje e tërësisë së materialit gjenetik
- Zhdukje e specieve endemike
- Ndryshimi i mënyrës së funksionimit të habitatit dhe ekosistemit.
- Ndryshimi i ciklit dhe përbërjes së lëndëve ushqyese nga toka.
- Fragmentimi i ekosistemeve vendase

Lagunat dhe Ligatina

Krahas ndikimeve të tjera të mundshme, rritja e nivelit të detit parashikohet të reduktojë sasinë e ujërave të ëmbla në dispozicion, si pasojë e depërtimit të ujit të detit në tabanet e ujërave nëntokësore. Gjithashtu, kjo ka gjasa të shkaktojë rritje të depërtimit të ujit të detit në trupat e ujërave të ëmbla, duke ndikuar kështu në cilësinë e ujit në laguna dhe ligatina.

Disa nga risqet që i kanosen sektorit të lagunave dhe ligatinave:

- Humbje e habitatit dhe rënie e produktivitetit
- Reduktimi i nivelit të oksigjenit të tretur ndikon negativisht në biotën aerobe, ndërsa komunitetet bentike pritet të përballen me presionet më të mëdha.
- Ulje e sasisë së ujërave të ëmbla të sjella nga baseni i ujit ose nga lumenjtë, çka rezulton në një nivel më të lartë të kripësisë
- Ligatinat e brendshme rrezikojnë të thahen duke çuar në humbje të habitateve të shpendëve dhe specieve të tjera.
- Reduktim i biodiversitetit lokal për shkak të konkurrencës me specie të huaja dhe ndryshime në komunitetet ujore (si *Callinectes sapidus*).

Akuakultura dhe peshkimi

Rritja e temperaturës dhe e numrit të ditëve të valëve të të nxehtit përfaqësojnë faktorët e ndryshimeve klimatike, të cilët, së bashku me faktorët e lidhur në mënyrë të tërthortë me ndryshimet klimatike, mund të rrisin më tej ndikimin e efekteve të ndryshimeve klimatike në sektorët e akuakulturës.

Disa nga risqet që i kanosen sektorit të akuakulturës dhe peshkimit

- Pakësimi i peshqve pelagjikë (të vegjël dhe të mëdhenj) për shkak të reduktimit të prodhimit parësor
- Pengimi i mbarështimit të gocave të detit dhe, për rrjedhojë, ka sasi të ulët gjatë peshkimit të specieve të molusqeve dykapakore
- Ndikimi i paevitueshëm në nivelet e punësimit në sektorin e peshkimit si dhe në opsionet e konsumatorëve.
- Pengimi i mbarështimit të gocave të detit dhe, për rrjedhojë, ka sasi të ulët gjatë peshkimit të specieve të molusqeve dykapakore.
- Zhdukja e disa specieve që mund të shërbejnë si ushqim për speciet gjithçkangrënëse të peshqve (si p.sh. peshqit blu dhe barbuni);
- Dëmtim i pajisjeve të peshkimit dhe i shëndetit të peshkatarëve
- Përhapja e sëmundjeve të reja në ujërat territoriale dhe zonat bregdetare
- Ndikimi negativ social-ekonomik kryesisht të peshkimi në shkallë të vogël.
- Rritja e levrekut evropian ka hasur probleme për shkak të ujit më të ngrohtë në detin Mesdhe dhe në Shqipëri (simulimet tregojnë nivele më të larta të ushqyerjes, normë më të ulët të rritjes dhe biomasës) dhe ndjeshmërisë përkatëse ndaj sëmundjeve
- Nevojitet rritja/mbarështimi i specieve që kanë tolerancë më të lartë ndaj temperaturës më të ngrohtë, si p.sh. koca evropiane
- Kafazet e levrekut evropian duhet të zhvendosen në zona më të ftohta apo të hidhen rrjeta më të thella - rritje e kostove për prodhimin e levrekut evropian.
- Ndikim në shëndetin e njeriut nëpërmjet konsumit të produkteve të detit të kontaminuara dhe gëlltitjes së patogjenëve që transmetohen nga uji - ndikim negativ në tregtimin e produkteve përkatëse të akuakulturës
- Ngrohja dhe reshjet më të ulëta rrisin cënueshmërinë ndaj prodhimit të midhjeve mesdhetare cilësore

- Rritje e parashikuar e vdekshmërisë së midhjeve mesdhetare në lagunën e Butrintit
- Rritja e dukshme e temperaturës, e kombinuar me nivele më të ulëta të reshjeve, çon në luhatje të papritura të prurjeve të lumenjve dhe në degradim ekologjik të paparashikuar
- 40% e specieve të peshqve në lumenjtë e Mesdheut janë të rrezikuara për shkak të reduktimit të prurjeve të lumenjve, duke sjellë ndikim në peshkimin e brendshëm.

Rekomandohet: Zbatimi i masave zbutëse sipas sektorëve përkatës të përcaktuar në dokumentin Kontributi Kombëtar i Përcaktuar për ndryshimet klimatike.

KAPITULLI 3

ZHURMAT

3.1 Burimi i të dhënave

Monitorimi i zhurmave është kryer nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në qytetet Tiranë Shkodër Vlorë, Lezhë, Kukës, Korçë, Pogradec, Berat, Sarandë, Gjirokastrë, Fier, Përmet, Lushnje për dy tregues LAeq ditën dhe LAeq natën. Monitorimi është realizuar në një kohë matje 24 orëshe dhe niveli ekuivalent i presionit akustik LAeq për periudhën e ditës u llogarit nga ora 06⁰⁰- 23⁰⁰ dhe LAeq për periudhën e natës nga ora 23⁰⁰- 06⁰⁰.

3.2 Rëndësia

Ndotja nga zhurmat në nivel të lartë mund të shkaktojë humbjen e dëgjimit qoftë për një kohë të shkurtër apo edhe për tërë jetën. Zhurmat e padëshirueshme rritin presionin, shkaktojnë lodhje, ulin gjumin, rritin stresin dhe pengojnë përqëndrimin. Zhurma e trafikut mund të shkaktojë ndikime në biodiversitet duke krijuar probleme për kafshët kur frekuencat pengojnë transmetimin e informacionit midis kafshëve. Gjenerimi i zhurmave ka efekte negative në shëndetin e njeriut si dhe në mjedis dhe për këtë duhen marrë masa mbrojtëse për zvogëlimin e nivelit të zhurmave në mjedis nëpërmjet ndërhyrjeve dhe të veprimeve, që merren ndaj burimit të zhurmës, si dhe në vendin e ndikimit të saj negativ, duke e sjellë atë në nivelin kufi.

3.3 Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis/shëndet

Burimi i zhurmës së jashtme në mbarë botën shkaktohet kryesisht nga transporti rrugor, hekurudhor, ajror, sistemet e përhapjes, sheshet ku zhvillohen veprimtari industriale dhe nga aktivitetet e ndërtimit në natyrë. Planifikimi i dobët urban mund të shkaktojë shpërbërje ose ndotje akustike, ndërtesat industriale dhe rezidenciale krah për krah mund të rezultojnë në ndotje akustike në zonat e banuara. Disa nga burimet kryesore të zhurmës në zonat e banuara në vendin

tonë përfshijnë muzikën me zë të lartë, transportin (trafikun, sirenat e automjeteve etj), ndërtimin dhe njerëzit.

Ekspozimi i vazhdueshëm ndaj zhurmave shkakton impakt në shëndet si: Probleme me dëgjimin, inflamacion i trurit, humor i keq, imuniteti i dobët, mungesë përqendrimi, probleme me gjumin. Shkaktojnë probleme psikologjike (agresivitet, padurueshmëri) dhe frenim në shpejtësinë e komunikimit. Sjellin ndryshime në sistemin hormonal dhe imunitar si dhe ndikojnë negativisht në aparatën tretës. Nivelet e larta të zhurmës mund të rezultojnë në efekte kardiovaskulare dhe ekspozimi ndaj niveleve të larta gjatë një periudhe të vetme tetë-orëshe shkakton një rritje në presionin e gjakut.

3.4 Standartet për zhurmat

Matjet e zhurmave bëhen në mungesë të reshjeve, mjegullës dhe borës, shpejtësia e erës nuk duhet të jetë më e lartë se 5 m/s, mikrofoni i mbrojtur me kufje anti-erë. Zinxhiri i matjeve duhet të jetë në përputhje me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe në përputhje me normat e CEI 29-10 dhe EN 60804/1994. Vlerësimi inivellit të zhurmave është kyer duke u bazuar mbi Ligjin Nr.9774, datë 12.07.2007 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis” si dhe normat e OBSH ku vlera limite për periudhën e ditës është 55 dB dhe për periudhën e natës është 45 dB.

3.5 Vlerësimi i gjendjes së zhurmave mjedisore




Figura 95 - Harta e cilësisë së zhurmave 2024

Monitorimi i zhurmave është kryer në qytetet Tiranë Shkodër Vlorë, Lezhë, Kukës, Korçë, Pogradec, Berat, Sarandë, Gjirokastër, Fier, Përmet, Lushnje.

Bazuar mbi të dhënat e monitorimit gjatë vitit 2024, niveli i zhurmave tejkalon vlerat limite për periudhën e ditës (55 dB) në të gjitha qytetet e monitoruara duke përjashtuar qytetin Lushnje.

Për periudhën e natës (45 dB) niveli i zhurmave në qytetet Kukës, Përmet dhe Lushnje është brenda vlerave limite ndërsa në qytetet e tjera të monitoruara, tejkalojnë vlerat limite.

Shkaktari kryesor i emetimit të zhurmave është trafiku rrugor. Gjithashtu dhe lokalet gjenerojnë zhurma si ditën ashtu dhe natën.

Tabela 28 - Vlerat mesatare të nivelit të zhurmave LAeq ditën dhe natën.

Viti 2024	LAeq/Ditën dB(A)	LAeq/Natën dB(A)
Tiranë	63.35	52.43
Fier	61.31	50.63
Vlorë	63.13	53.44
Sarandë	62.52	51.45
Korçë	61.27	50.53
Berat	60.01	49.15
Gjirokastër	61.11	50.73
Pogradec	56.52	45.44
Shkodër	58.33	48.26
Kukës	56.19	44.51
Lezhë	58.43	46.66
Përmet	55.02	44.03
Lushnje	54.15	43.52

Monitorimi i zhurmave ditën kryhet nga ora 06:00 deri në orën 23:00 ku me të dhënat e monitoruara në këtë periudhë llogariten LAeq ditën për çdo stacion dhe LAeq ditën për qytetet e monitoruara.




Figura 96 - Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB (A)

Bazuar në të dhënat e monitorimit të zhurmave ditën, siç duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë se kemi tejkalimin të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet, përveç qytetit të Lushnjes. Niveli më i lartë i zhurmave është vlerësuar në qytetin Tiranës ku kemi tejkalim të normës në masën 15.1 %, Vlorës 14.7%, Sarandes 13.6%, Gjirokastrës 11.1%.

Nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit, Permetit dhe Lushnjes. Trafiku rrugor është një fenomen i karakterit të rastësishëm, për këtë arsye themi që ndikimi i trafikut ose i çdo faktori tjetër të jashtëm që shkakton zhurmë në momentin e monitorimit mund të jetë shkaktari i uljes apo rritjes së nivelit të zhurmave urbane në qytetet që monitorohen.

Monitorimi i zhurmave natën kryhet nga ora 23:00 deri në orën 06:00 ku me të dhënat e monitoruara në këtë periudhë llogariten LAeq ditën dhe LAeq natën për qytetet e monitoruara.




Figura 97 - Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Bazuar në të dhënat e monitoruara natën siç duket dhe nga grafiku i mësipërm vërejmë se tejkalimin më të lartë të normës natën (që është 45 dB) pothuajse kemi në të gjitha qytetet.

Niveli më i lartë është monitoruar në qytetin e Vlorës ku kemi tejkalim të normës me 18.75 %, Tiranës me 16.51% dhe Sarandës me 14.6% dhe nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit, Përmetit dhe Lushnjës.

Qyteti Vlorë

Në stacionet e Vlorës vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën. Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Hyrja e Qytetit” në vlerën 63.87 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Xhamia” 62.34 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 16.1 % tek stacioni “Hyrja e Qytetit” dhe në masën 13.34% tek stacioni “Xhamia” me nivelin më të ulët të monitoruar.




Figura 98 - Vlorë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 99 - Vlorë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Xhamia” në vlerën 54.44 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Uji i Ftohte” në vlerën 52.13 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 20.97% tek stacioni “Xhamia” dhe në masën 15.8% tek stacioni “Uji i Ftohte” me nivelin më të ulët të monitoruar.

Qyteti Berat

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Beratit është realizuar në dy stacione, Bashkia dhe Kryqëzimi i Spitalit për të dy treguesit LAeq ditën dhe LAeq natën, ku rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën ditën dhe natën.




Figura 100 - Berat, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 101 - Berat, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Beratit vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën.

Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Kryqezimi i Spitalit” në vlerën 60.51 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Bashkia” 59.52 dB(A), e shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 8.2% tek stacioni “Bashkia” dhe në masën 10% tek stacioni “Kryqezimi i Spitalit” me nivelin më të lartë të monitoruar.

Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Kryqezimi i Spitalit” në vlerën 49.91 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Bashkia” 48.4 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 7.5% tek stacioni “Bashkia” dhe në masën 10.9% tek stacioni “Kryqezimi i Spitalit” me nivelin më të lartë të monitoruar.

Qyteti Shkodër

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Shkodrës është realizuar në dy stacione, në “Kryqëzimin e Hyrjes” dhe “Universiteti (Hotel Rozafa)”.




Figura 102 - Shkodër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 103 - Shkodër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Referuar të dhënave të monitoruara vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të dy stacionet. Në stacionin “Universiteti (Hotel Rozafa)” niveli i zhurmave e tejkalon normën ditën 4.3%, dhe natën me 8.4%, ndërsa në stacionin “Kryqezimi i hyrjes” niveli i zhurmave ditën e tejkalon normën me 7.8% ndërsa niveli i zhurmave natën e tejkalon normën me 6.1%.

Qyteti Lezhë

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Lezhës është realizuar në dy stacione, në Kryqëzimin Lagja Gurra dhe 11 Janari. Niveli i zhurmave ditën dhe natën në stacionin “11 Janari” është në vlerën kufi të normës së lejuar.

Ndërsa në stacionin e “Kryqëzimi të Lagja Gurra” niveli i zhurmave ditën është 9.67% më i lartë se norma, ndërsa natën është në masën 7% më i lartë se norma.




Figura 104 - Lezhë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 105 - Lezhë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Qyteti Fier

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Fierit realizohet në 4 stacione. Sipas të dhënave të monitoruara, niveli i zhurmave ditën është më i lartë se norma në të katër stacionet e monitoruara. Niveli më i lartë ditën është matur në stacionin “Prefektura” në vlerën 63.11 dB(A) me një tejkalim në vlerën 14.7%.




Figura 106 - Fier, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 107 - Fier, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Niveli i zhurmave natën është më i lartë se norma në të katër stacionet e monitoruara. Niveli më i lartë natën është matur në stacionin “Kryqëzimi për në Vlorë” ku kemi tejkalim të normës në masën 16.9%.

Qyteti Korçë

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Korçës është realizuar në 4 stacione ditën dhe natën.




Figura 108 - Korçë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 109 - Korçë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Vërejmë se niveli më i lartë i zhurmave në qytetin e Korçës është monitoruar në stacionin “Telekom” në nivelin 13.7 % mbi normën e lejuar krahasuar kjo me normën ditore dhe në stacionin “Kryqëzimi i spitalit” në masën 17.8% për nivelin e zhurmave natën. Në stacionin “Tregu i shumicës” kemi tejkalimin më të ulët të nivelit të zhurmave natën, ku vlera e monitoruar është 46.15dB(A).

Qyteti Tiranë

Monitorimi i zhurmave në Tiranë për vitin 2024 është realizuar në 15 stacione si më poshtë

Tabela 29 - Stacionet e monitoruara në qytetin e Tiranës

Tiranë	LAeq/Diten dB(A)	LAeq/Naten dB(A)
Rruga Elbasanit	63.2	56.7
Kryqezimi "Vasil Shanto"	64.5	57.5
Kryqezimi "21 Dhjetori"	63.99	51.97
Drejtoria e Policise	63.99	52.54
Shkolla e Bashkuar	60.13	51.11
Stadiumi Dinamo	61.69	51.58
Laprake	69.8	52.67
Stacioni i Trenit	66.69	52.12
Sheshi Skenderbej	62.11	47.67
Partizani Panjohur	61.54	51.07
Kryqezimi te Selvia	61.18	50.96
Pallati Kongreseve	63.19	50.37
Farmacia Nr.10	63.38	53.7
Shkolla Edit Durham	62.55	54.81
Ish Banka Amerikane	62.31	51.76




Figura 110 - Tiranë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)

Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Laprakë” në vlerën 69.8 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Shkolla e Bashkuar” në vlerën 60.13 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 26.9% tek stacioni “Laprakë” dhe në masën 9.3% tek stacioni “Shkolla e Bashkuar” me nivelin më të ulët.




Figure 111 - Tiranë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Nivelet më të larta natën janë monitoruar në stacionin “Kryqëzimi Vasil Shanto” në vlerën 57.5 dB(A) dhe më e ulëta në stacionin “Sheshi Skënderbej” në vlerën 47.67 dB(A). E shprehur në përqindje kemi tejkalim të normës me 27.7 % tek stacioni “Kryqëzimi Vasil Shanto” dhe në masën 5.9% tek stacioni “Stadiumi Dinamo”. Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Tiranës vërejmë se kemi tejkalim të normës ditën dhe të normës natën në të gjitha stacionet e monitoruara

Qyteti Sarandë

Monitorimi i zhurmave urbane për vitin 2024 në Sarandë është realizuar në 4 stacione.




Figura 112 - Sarandë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 113 - Sarandë, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Niveli i zhurmave në qytetin e Sarandës, krahasuar me normën si ditën ashtu dhe natën rezulton i lartë në të gjitha stacionet. Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Bashkia” ku vlera e monitoruar është 63.71 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 15.8% më e lartë se norma. Gjithashtu për periudhën e natës, nivelet më të larta janë monitoruar në stacionin “Bashkia” ku vlera e monitoruar është 52.01 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 15.57% më e lartë se norma.

Qyteti Kukës

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Kukësit është realizuar në dy stacione, stacioni i “Bashkia” dhe “Stacioni i autobusave”.




Figura 114 - Kukës, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 115 - Kukës, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)

Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Stacioni i Autobuzave” ku vlera e monitoruar është 57.12 dB dhe e shprehur në përqindje 3.85 % më e lartë se norma. Edhe natën nivelet më të larta janë monitoruar në stacionin “Stacioni i Autobuzave” ku vlera e monitoruar është 46 dB dhe e shprehur në përqindje 2.2 % më e lartë se norma.

Qyteti Gjirokastrë

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Gjirokastrës është realizuar në dy stacione, “Kryqëzimi në hyrje” dhe “Rrethrotullimi tek Stadiumi”.




Figura 116 - Gjirokaštër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 117 - Gjirokaštër, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)

Kemi tejkalim të normës ditën dhe natën në të dy stacionet. Nivelet më të larta ditën janë monitoruar në stacionin “Kryqëzimit në Hyrje” ku vlera e monitoruar është 62.11 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 12.9% më e lartë se norma. Edhe natën nivelet me të larta janë monitoruar në stacionin “Kryqëzimit në Hyrje” ku vlera e monitoruar është 51.02 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 13.37% më e lartë se norma.

Qyteti Pogradec

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Pogradecit është realizuar në dy stacione “Hyrja e Qytetit” dhe “Kryqëzimi tek Terminali”.




Figura 118 - Pogradec, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 119 - Pogradec, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Pogradecit vërejmë që kemi tejkalim të normës ditën dhe natën vetëm në stacionin “Kryqëzimit tek Terminali Autobuzave” ku vlera e monitoruar është 58.25dB dhe e shprehur në përqindje 5.9 % më e lartë se norma.

Për periudhën e natës, niveli mbi normë është vlerësuar në stacionin “Kryqëzimit tek Terminali Autobuzave” në vlerën 46.34 dB(A) dhe e shprehur në përqindje 2.97% më e lartë se norma.

Qyteti Përmet

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Permetit është realizuar në dy stacione për periudhën e ditës dhe të natës.




Figura 120 - Përmet, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 121 - Përmet, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Në stacionet e Përmetit, kemi tejkalim të normës ditën në stacionin “Bashkia” ku vlera e monitoruar është 56.67 dB dhe e shprehur në përqindje 3% më e lartë se norma, dhe natën nuk kemi tejkalim në asnjë nga stacionet.

Qyteti Lushnje

Monitorimi i zhurmave në qytetin e Lushnjes është realizuar në dy stacione Rrethrrrotullimi i plasmasit dhe Shkolla “18 Tetori”. Monitorimi është realizuar për LAeq ditën dhe LAeq natën dhe rezultatet e monitoruara janë krahasuar me normën e zhurmave ditën dhe natën.




Figura 122 - Lushnje, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Ditën dB(A)




Figura 123 - Lushnje, Niveli i zhurmave 2024 LAeq/Natën dB(A)

Referuar të dhënave të monitoruara në stacionet e Lushnjes vërejmë që nuk kemi tejkalim të normës as ditën dhe as natën.

Tabela 30 - Tendenca e zhurmave mjedisore 2019 -2024 për periudhën e ditës (dB)

L _{Aeq} /Diten dB(A)	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Tiranë	67.15	62.47	63.36	62.91	64.88	63.35
Fier	58.16	60.47	62.07	60.62	62.2	61.31
Vlorë	64.6	60.47	61.82	62.82	62.8	63.13
Sarandë	65.16	60.1	62.36	61.28	60.54	62.52
Korçë	60.96	58.05	59.99	60.05	61.68	61.27
Berat	62.25	57.1	58.26	59.4	59.31	60.01
Gjirokastër	61	58.34	59.83	59.71	60.74	61.11
Pogradec	56.78	56.33	58.07	56.28	56.95	56.52
Shkodër	59.36	63.15	62.01	65.23	63.26	58.3
Kukës	56.42	54.76	53.88	54.56	56.65	56.19
Lezhë	60.69	62.12	62.64	61.89	62.28	58.43

Tabela 31 - Tendenca e zhurmave mjedisore 2019-2024 për periudhën e natës (dB)

L _{Aeq} /Naten dB(A)	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Tiranë	57.49	56	53.05	50.8	54.52	52.43
Fier	49.36	52.89	51.62	50.5	51.27	50.63
Vlorë	53.44	51.1	49.05	47.56	54.79	53.44

Sarandë	50.6	48.7	50.39	48.45	51.5	51.45
Korçë	51.02	52.89	47.72	48.13	49.76	50.53
Berat	52.17	48.6	47.07	43.5	50.23	49.15
Gjirokastrë	53	49.89	50.8	49.98	50.35	50.73
Pogradec	46.08	45.52	46.6	46.02	46.66	45.44
Shkodër	52.14	53.83	50.84	51.05	53.36	48.26
Kukës	45.24	43.35	42.41	44.03	45.31	44.51
Lezhë	48.44	48.5	49.83	49.05	51.49	46.66

Niveli i zhurmave si ditën ashtu edhe natën pothuajse në të gjitha qytetet është mbi normë, me përjashtim të Pogradecit dhe Kukësit. Tejkalimin më të lartë ndër vite e kemi vlerësuar në qytetet e Tiranës, Shkodrës, Vlorës, Sarandës dhe Lezhës. Ndërsa tejkalimet më të ulta i kemi në qytetin e Kukësit, Pogradecit dhe Beratit.

Përfundime:

Referuar të dhënave të monitorimit të zhurmave ditën, kemi tejkalimin të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet, përveç qytetit të Lushnjës. Niveli më i lartë i zhurmave është vlerësuar në qytetin Tiranë ku kemi tejkalim të normës në masën 15.1 %, Vlorës 14.7%, Sarandës 13.6%, Gjirokastrës 11.1%. Nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit, Permetit dhe Lushnjës.

Për periudhën e natës, niveli më i lartë është monitoruar në qytetin e Vlorës ku kemi tejkalim të normës me 18.75 %, Tiranës me 16.51% dhe Sarandës me 14.6% dhe nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit, Përmetit dhe Lushnjës.

3.6 Rekomandime

- Sigurimi i brezit mbrojtës të gjelbër dhe hapësirave të mbjella me pemë midis zonave të banuara dhe rrugës kryesore, si një nga masat më eko - miqësore për të reduktuar nivelin e ndotjes.
- Të përcaktohen me rregullore distancat midis rrugëve dhe banesave.
- Të bëhen projekte për zvogëlimin e zhurmës, që në projektimin e ndërtimeve të reja (institucione, shkolla, spitale, rrugë etj.)
- Të sigurohet kontrolli periodik i mjeteve të transportit që gjenerojnë zhurmë.
- Të parashikohen ndërhyrjet në sinjalistikën rrugore, ku të përfshihen në të sinjalet që lidhen me zhurmat si dhe vendosjen e tyre në pika të caktuara.
- Vendim – marrja për efektet negative që shkakton zhurma në shëndetin fizik dhe mendor të popullsisë.
- Edukimi i publikut është kërkesa më e rëndësishme. Programet e ndërhyrjes për zvogëlimin e zhurmës mund të mos kenë sukses pa pjesëmarrjen e publikut.

KAPITULLI 4

MJEDISI BREGDETAR

4.1 Burimi i të dhënave

Instituti të Shëndetit Publik, kontraktuar nga Agjencia Kombetare e Mjedisit ka kryer monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes gjatë sezonit turistik 2024.

Gjithashtu nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit është realizuar monitorimi i cilësisë së ujrave bregdetare për parametrat fiziko –kimik në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvernec dhe Ksamil, Lagunat si dhe ndikimi i shkarkimeve urbane në ujrat bregdetare. Gjatë vitit 2024, Drejtoria e Gjeologjisë Detare e Shërbimit Gjeologjik Shqiptar ka vazhduar të kryejë monitorimin periodik të pozicionit të vijës bregore dhe të përcaktimit të dinamikës së kësaj vije nëpërmjet krahasimit të dy pozicioneve të njëpasnjëshme.

4.2 Kontribuesit e ndotjes, presioni dhe ndikimi në mjedis/shëndet

Burimet e ndotjes së ujrave të larjes janë numri i lartë i pushuesve sidomos në pikun e sezonit por dhe gjatë muajit Shtator, derdhja e ujërave sipërfaqësore dhe shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, si dhe prania e mbetjeve urbane inerte. Ndotja e ujërave bregdetar ka ndikim në mjedis duke konsistuar në prishjen e ekosistemeve, eutrofikimi dhe akuakultura.

Praktikat e peshkimit mund të kenë një ndikim në mjedisin detar nëpërmjet shqetësimit të habitateve të shtratit të detit. **Ndryshimet klimatike** janë një tjetër faktor që ndikojnë në temperaturën e sipërfaqes së detit si dhe në rritjen e nivelit të detit.

Kritja e lëndëve ushqyese si rezultat i aktiviteteve njerëzore, si bujqësia dhe prodhimi i ujërave të zeza urbane janë nxitësi kryesor i rënies së statusit të cilësisë të grykëderdhjeve tona. Pasurimi i lëndëve ushqyese ka ndikime serioze në këto zona, duke përfshirë akumulimet e mëdha të algave të detit, lulëzimin e

fitoplanktonit dhe rënien e kushteve të oksigjenit. Efektet direkte ose indirekte të nutriendeve në mjediset ujore dhe sasia e tyre ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e ujërave larëse bregdetarë dhe ujërat e tjerë sipërfaqësorë dhe nëntokësorë. Sidomos azoti dhe fosfori të cilët kanë origjinën nga aktivitetet e njeriut në tokë ose në ujë, ose shpeshhere dhe nga ajri nga emisionet e aktiviteteve të anijeve dhe trakteve. Pjesa më e madhe e ndotësve kanë origjinën nga aktivitetet në tokë siç është përdorimi i fertilizantëve të ndryshëm dhe/ose shkarkimi i ujërave urbane të pa trajtuara. Efekti direkt i eutrofikimit nga rritja e sasive të nutriendeve në ujë lidhen me zhvillimin dhe lulëzimin sidomos të algave toksike siç janë algat blu, të cilat mund të shkaktojnë asgjësimin e faunës bentonike, peshqit e egër ose intoksikim të molusqeve të cilët përdoren për njerëzit. Efekt tjetër negativ ka të bëjë me ngjyrimin e ujit, i cili shoqërohet në uljen e transparencës së ujit që lidhen me rritjen e algave në sipërfaqe të ujit në kushtet e mungesës së oksigjenit.

Veprimtaritë e akuakulturës mund të ndikojnë potencialisht në mjedisin detar, si p.sh. përhapjes së patogjenëve dhe parazitëve në popullatat vendase dhe shqetësimit dhe zhvendosjes së mundshme të peshqve, butakëve, zogjve dhe popullatave të tjera.

Gërmimet dhe hedhjet e materialeve në det për qëllime ndërtimi ndikojnë në mjedisin detar.

Zhurma nënujore: Vjen nga aktivitetet njerëzore në mjedisin detar (p.sh. transporti ose ndërtimi) dhe ka potencial të shkaktojë ndikime negative në jetën detare. Burimet antropogjene të tingullit kategorizohen si impulsive ose të vazhdueshme. Trafiku i anijeve është burimi kryesor i zhurmës së vazhdueshme të krijuar nga njeriu në mjedisin detar

Mbeturinat detare dhe plastika: Mbeturinat e plazhit përkufizohen si çdo material i ngurtë i qëndrueshëm, i prodhuar ose i përpunuar i hedhur ose i braktisur në mjedisin detar dhe bregdetar dhe i hasur në plazhe. Plastika njëpërdorimshe dhe mbeturinat plastike që hidhen në det, janë përbërësit më të zakonshëm të mbeturinave të plazhit.

4.3 Cilësia e ujërave bregdetare

4.3.1 Vlerësimi mikrobiologjik

- *Stacionet e monitorimit të plazheve*

Vlerësimi mikrobiologjik për 2 tregues bakteriologjike, Intestinal Enterococci (IE) dhe Escherichia Coli (E.coli) është kryer në 123 stacione monitorimi në plazhet kryesore të bregdetit të tilla si: plazhet e Velipojës, Shëngjinit, Tales, Durrësit, Gjiri i Lalzit, Kavajës, (Qerret, Spille), Divjakës, Semanit, (Darëzezës), Vlorës, (Zvërnec, Orikum), Palasës, Drimadhes, Dhërmiut, Jalës, Livadhes, Himarës, Qeparoit, Borshit, Lukovës, Sarandës, Ksamilit, Pogradecit dhe Linit.

Inspektimi higjieno sanitar, u krye për përcaktimin e burimeve të ndotjes në plazhe, përcaktimi i burimeve pikësore ose difuze të ndotjes (shkarkimeve të lëngëta dhe/ose të ujërave të larta, që derdhen direkt ose indirekt në plazhe si dhe pastërtia e plazheve nga mbeturinat urbane apo inerteve).

- *Standartet e cilësisë*

Monitorimi është kryer bazuar në rregulloren higjieno-sanitare “Për administrimin e cilësisë së ujërave të larjes”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 797, datë 29.09.2010 si dhe në përshtatje me Direktivën 2006/7/KE, datë 15 Shkurt 2006 “Për administrimin e cilësisë së ujrave të larjes”. Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes për parametrat mikrobiologjik Escherichia Coli (EC) dhe Intestinal Enterococce (IE), kryhet bazuar mbi standarte të WHO/UNEP, BE për kategorizimin sipas vlerave 90- 95%-tile.

Tabela 32 - Kategorizimi për cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes

Kategoria	A	B	C	D
Vlera Limite	< 100 *	101-200*	185**	> 185 **
Cilësia e ujit	Cilësi e shkëlqyer	Cilësi e mirë	Cilësi e mjaftueshme	Cilësi e keqe/Masa të menjëhershme
* - 95 -th percentile Intestinal Enterococci/100 ml				
** - 90 - th percentile Intestinal Enterococci /100 ml				

Plazhi i Velipojës: Në plazhin e Velipojës ka pasur frekuentim me numër të lartë të pushuesve veçanërisht në muajt Korrik e Gusht. Në përgjithësi në brezin ranor u konstatua rregull e pastërti. Në stacionet e mostrimit në plazhin e Velipojës, u

konstatua prani e pakët leshterikësh, prezencë të koshave të mbeturinave. Pothuajse në të gjitha stacionet e mostrimit përdoren nga pushuesit anekset sanitare të subjekteve ekonomike. Në asnjë stacion mostrimi në plazhin e Velipojës nuk u vërejt prani e ujërave sipërfaqësore. Gjithshtu u vërejt angazhim i subjekteve që administrojnë plazhet në pastrimin dhe plugimin e rërës. Ka prezent tabela ku janë të afishuara rregullat për zbatim. Përgjithësisht janë prezent dushe, dhoma ndërrimi të veshjeve dhe kulla vrojtimi.




Figura 125 - Vlerat e FC dhe IE, Velipojë




Figura 126 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Velipojës

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Velipojës vlerësohen në kategorinë: B - Cilësi e mire, stacionet B-R Belavista, Hotel Adriatik, B-R Fantazia, Pallatet e reja dhe Prane lagunes se Vilunit.

C- Cilësi e mjaftueshme, stacioni Dolcevida,

D-Cilësi e keqe, stacioni

Hyrja ne plazh

Për Plazhin e Velipojës për periudhen 2023- 2024, asnjë stacion nuk i përket kategorisë A. Numri i stacioneve të kategorisë B, kategorisë C dhe kategorisë D për vitin 2024 është më i lartë se në periudhen 2017-2022 dhe pak me i ulët se në vitin 2023.

Plazhi i Shëngjinit: Në stacionet e mostrimit në plazhin e Shëngjinit, u konstatua prani e banjatorëve më të shumtë në pikat e mostrimit Ish- kabinat, Hotel Doro dhe Kristian, B-R Gjahtari dhe më të pakët në pikën Kune. Gjithshtu u vërejt angazhim i subjekteve që administrojnë plazhet në pastrimin e e rërës. Në stacionet e mostrimit, për shkak të pozicionimit të këtyre plazheve

pranë subjekteve private, ata përmbushin nevojat sanitare pranë këtyre subjekteve. U vërejt prezencë e koshave të mbeturinave.

Në asnjë stacion mostrimi në plazhin e Shëngjinit nuk u vërejt prani e ujërave sipërfaqësore. Gjithashtu u konstatua prezencë e afishimit të rregullave për zbatim nga pushuesit, dusheve, dhomave të ndërrimit të veshjeve dhe kullave të vrojtimit. Gjatë monitorimit u konstatua në përgjithësi pastërti e rregull në brezin ranor pa mbeturina, pastrimi dhe plugimi i tij. Në pikën Kune të kampionimit vërehen lështerikë në brezin ranor dhe ka nevojë të pastrohet më shpesh nga këto mbetje.




Figura 127 - Vlerat e FC dhe IE, Shëngjin




Figura 128 - Tendenza e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Shëngjinit

Sipas rezultateve mikrobiologjik, plazhet e Shëngjinit vlerësohen në kategorinë B - Cilësi e mire, ish kabina, Hotel Doro dhe Kune. Në kategorinë C- Cilësi e mjaftueshme Hotel Kristian dhe B-R Gjahtari.

Për vitin 2024, numri i stacioneve të kategorisë B është e barabartë me vitin 2021 dhe është më i lartë në krahasim me vitin 2017- 2020, dhe 2022 -2023. Numri i stacioneve të kategorisë C është më i lartë në krahasim me vitet 2017- 2023 dhe numri stacioneve të kategorisë D- Cilësisë së keqe të ujërave, është më i ulët në krahasim me vitin 2023 dhe i barabartë me vitet 2017-2022

Plazhi i Tales: Në të gjitha stacionet e mostrimit në plazhin e Tales u konstatua se ka përmirësim të situatës. U vërejt angazhim i subjekteve qe administrojnë plazhet, në pastrimin dhe plugimin e rerës, prezencë të koshave të mbeturinave, dusheve, dhomave të ndërrimit dhe të kullave të vrojtimit. Në zonën majtas pikes të monitorimit Bar- Restorant USA, u konstatua një kanal me ujëra sipërfaqësorë që derdhet në det, majtas hyrjes qendrore Tale.




Figura 129 - Vlerat e FC dhe IE, Tale




Figura 130 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Tales

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Tales vlerësohen në kategorinë:

C- Cilësi e mjaftueshme stacionet Hyrja qendrore, djathtas tek Palmat dhe Në qëndër të hyrjes qendrore, tek Antena.

B- Cilësi e mirë, stacioni Majtas hyrjes qendrore, Bar-Restorant USA

Për vitin 2024, për plazhet e Tales vërehet tendencë në ulje të cilësisë së ujrave të kategorise A - Cilesi e shkelqyer dhe D-cilësi e keqe. Vërehet tendencë në rritje të kategorisë B-cilësi e mirë dhe C –cilësi e mjaftueshme

Plazhet e Durrësit dhe Gjirit të Lalzit

Plazhi i Durrësit: Në plazhet e Durrësit ka pasur një frekuentim me numër të lartë të pushuesve. Pika e monitorimit që përfaqëson zonën pas kanalit Plepa, vazhdon të jetë problematike me vlera të larta të ndotjes. Në zonën pas kanalit Plepa u konstatua prani e shkarkimeve të ujërave urbane të pa trajtuara, dhe me erë të rëndë. Në këtë pikë kanali ka ngjyrë jeshile të theksuar po ashtu edhe uji i detit në zonë ka marrë këtë ngjyrim si pasojë e ndotjes. Gjithashtu u konstatua kanali me erë të rëndë te kompleksi Gjardino Durrës. Përgjithësisht rëra është e pluguar dhe ka prezencë të koshave të mbeturinave, dusheve, kullave të vroitimit. Në disa zona konstatohen mbeturina inerte të palarguara, leshterike të dalë nga deti veçanërisht zona Currila1 dhe Currila 2 si dhe barishte.





Figura 131 - Vlerat e FC dhe IE, Durrës

Sipas rezultateve mikrobiologjike te vitit 2024, stacionet e plazhit të Durrësit vlerësohen në kategorinë:

A-Cilësi e shkëlqyer, stacionet Iliria pranë Bllokut (Hotel Vila Lule) dhe Ministria e Rendit,

B - Cilësi e mirë, stacionet Plazhi Currila 1, Plazhi Currila 2, Ura e Dajlanit, Plazhi Filadelfia (Hotel & SPA Palace), Plazhi Teuta Vivas (Hotel VIVAS), Plazhi Gostivari (Piceri-Restorant Gostivari), Apollonia (Hotel Grande), Hekurudha (tek Policia), Hotel Adriatik, Plazhi Iliria (Pista), Plazhi Hotel Andi dhe Kompleksi Xixa.

D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, stacionet Plazhi Zhiron (Kështjella), Kompleksi Tropikal, Pas Kanalit (Plepa), Shkëmbi i Kavajës (Restorant Tirona), Bar-Hotel Hoti, Plazhi Benilva dhe Kompleksi Xhardino.



Për vitin 2024, për plazhet e Durrësit vërehet tendencë në rritje e cilësisë së ujrave të kategorisë A – Cilësi e shkëlqyer dhe B - Cilësi e mirë krahasuar me vitin 2023 dhe tendencë në ulje krahasuar me vitet e tjera. Vërehet tendencë në ulje të kategorisë C – cilësi e mjaftueshme dhe D - cilësi e keqe krahasuar me vitin 2023 dhe tendencë në rritje krahasuar me vitet e tjera.

Plazhi i Gjirit të Lalzit: Në vijën bregdetare të plazhit të Gjirit të Lalzit përgjithësisht u konstatua pastërti e rërës, plazh i sistemuar. U konstatua prezencë e dusheve, të koshave të mbeturinave, prezencë e kullave të vrojtimit. Në plazhet e Gjirit të Lalzit ka pasur një frekuentim me numër të lartë të pushuesve. Pushuesit shfrytëzojnë subjektet private për tualete.




Figura 132 - Vlerat e FC dhe IE, Gjiri i Lalzit




Figura 133 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Shëngjinit

Sipas rezultateve mikrobiologjike te vitit 2024, stacionet e plazhit te Gjirit te Lalzit vlerësohen në kategorinë:

- B- Cilësi e mire, stacionet Kepi i Rodonit, Plazhi Publik pas Lurës, Gjiri Lalzit
- 4- Kompleksi Alioma, Gjiri Lalzit 5- Fshati Turistik Lura 3
- C- Cilësi e mjaftueshme, stacioni Fshati Turistik Lura

Për vitin 2024, për plazhet e Gjirit të Lalzit verehet tendencë në ulje e cilësisë së ujërave të kategorisë A –Cilësi e shkëlqyer krahasuar me vitet e tjera, dhe tendencë në rritje të kategorisë B-Cilësi e mirë dhe C –cilësi e mjaftueshme.

Plazhi i Kavajës: Në plazhet e Kavajës ka pasur një frekuentim me numër të lartë të pushuesve. Plazhet në përgjithësi janë të sistemuara, disa zona kanë dhoma ndërrimi veshje. Kosha mbeturinash ka në brezin ranor, ka kulla vrojtimi e dushe. Nevojat sanitare për tualete pushuesit i përmbushin pranë subjekteve private për shkak të pozicionimit të këtyre plazheve pranë subjekteve.

Nga ekspertiza higjeno-sanitare e disa serive u konstatuan prani e shkarkimeve të ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse. U konstatuan kanale të shkarkimeve të ujërave urbane në pikën 4 (stacioni (Vapori i mbytur), kanali me ujëra me erë të rëndë. Në Malin e Robit stacioni Lokali Reshatit ndodhet kanali i madh që derdhet në det, gjithashtu ka mbeturina në rërë pasi mungon koshi për mbeturina. Në stacionin Mak Albania nuk dallohet kanal që derdhet në det por grumbull gurësh në bregun ranor. Në stacionin Piceri Argjendi vihet re një grumbull i madh leshterikësh dhe grumbull gurësh në det.

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Kavajës vlerësohen në kategorinë:

- A-Cilësi e shkëlqyer, stacioni Piceri Argjendi
- B- Cilësi e mire, stacioni Kompleksi FAFA (ish Piceri Jurgen)
- C- Cilësi e mjaftueshme, stacionet Vapori mbytur dhe Mak Albania
- D-Cilësia e keqe/ Masa të menjëherëshme stacionet. Majami, Vjena, Golem-Kosmira, Lokali Reshatit




Figura 134 - Vlerat e FC dhe IE, Kavajë




Figura 135 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Kavajës

Për vitin 2024, për plazhet e Gjirit të Lalzit vërehet tendencë në rritje e cilësisë së ujrave të kategorisë A –Cilësi e shkëlqyer krahasuar me 2023, dhe tendencë në ulje të kategorisë B-Cilësi e mire . Nuk ka ndryshim të cilësisë së ujrave të kategorisë C dhe D krahasuar me vitin 2023.

Plazhi i Qerretit: Plazh në përgjithësi i sistemuar me dhoma ndërrimi veshje, kosha mbeturinash dhe pastërti e rregull në brezin ranor. Nevojat sanitare për tualete pushuesit i përmbushin pranë subjekteve private për shkak të pozicionimit të këtyre plazheve pranë subjekteve. Në krahasim me vitin 2023 vërehet përmirësim i cilësisë pasi ka pasur ndotje në të gjitha pikat e kampionimit.




Figura 136 - Vlerat e FC dhe IE, Qerret

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Qerretit vlerësohen në kategorinë:
 B- Cilësi e mire, stacioni Qerret Ish Fusha Sportit
 C- Cilësi e mjaftueshme, stacioni Qerret, Kompleksi Belavista
 D-Cilësia e keqe/ Masa të menjëherëshme stacioni. Qerret, Bar-Kafe Holliday
 Për vitin 2024, për plazhet e Qerretit vërehet tendencë në rritje e cilësisë së ujrave krahasuar me vitin 2023 duke kaluar nga kategoria D- cilesi e keqe/Masa te menjehershme në kategorie B, C dhe D.




Figura 137 - Tendenza e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Qerretit

Plazhi i Spillesë: Në përgjithësi është i sistemuar me dhoma ndërrimi veshje në disa zona, me pastërti e rregull në brezin ranor, me kosha mbeturinash. Nevojat sanitare për tualete pushuesit i përmbushin pranë subjekteve private. Në krahasim me vitin e 2023 vërehet përmirësim i cilësisë. Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Spillese vlerësohen në kategorinë:

A-Cilësi e shkëlqyer, stacioni Spille Djathtas, Bar-Rest. Martini

B-Cilësi e mirë, stacioni Greth i Mesëm, Palmat e fundit C-Cilësi e mjaftueshme, Qerret, Kompleksi Belavista

D- Cilësia keqe / Masa të menjëherëshme Spille Qender, Hotel Basana




Figura 138 - Vlerat e FC dhe IE, Spille




Figura 139 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Spilles

Për vitin 2024, për plazhet e Spillesë vërehet tendencë në rritje e cilësisë së ujrave krahasuar me vitin 2023 duke kaluar nga D- cilesi e keqe/Masa te menjehershme ne kategorine A, B dhe D.

Plazhi Semanit dhe Darzezës: Rëra që administrohet nga privatët e pluguar. Në Seman vërehet plazh i pastruar dhe i sistemuar por në stacionet Hyrja ne plazh, tek Policia (Bunkeri) dhe Kulla e ujit ka trungje pemësh në rërë. Nyjet higjeno sanitare e dhomat e ndërrimit të veshjeve ne disa zona janë të papërshtatshme, tualetet janë primitive. Plazhi Darëzezë, tek Kulla është i pasistemuar, mungojnë koshat e mbeturinave. Në pikat e tjera rëra është e pluguar, ka kosha mbeturinash, ka dushe. Stacioni Lokal Gjermanit, Seman është pa kulla vrojtimi dhe zona e rërës me shkurre.

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Seman- Darzezës vlerësohen në kategorinë:

B- Cilësi e mirë, stacionet Hyrja ne plazh tek Policia (Bunkeri), Kulla e Ujit, Plazhi Darzeze, Lokal Gjermanit Seman, Bar restaurant 4 Flamuj Seman dhe stacioni Ish reparti ushtarak Pish Poro

C- Cilësi e mjaftueshme, stacioni Lokal Ilir Lani Darzezë




Figura 140 - Vlerat e FC dhe IE, Seman - Darzezë




Figura 141 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin Seman -Darzeze

Për vitin 2024, për plazhet e Seman-Darzezës vërehet tendencë në rritje e cilësisë së ujërave të kategorisë B-cilësi e mirë dhe tendence në ulje për kategorinë A-cilësi e shkëlqyer, krahasuar me vitet e mëparshme.

Plazhi i Divjakës: Në plazhin e Divjakës në përgjithësi, u konstatua prezenca e koshave për mbeturinat dhe prezenca e kullave të vrojtimit, rëra e pluguar në zonat që administrohen nga privatët, gjithashtu u konstatuan mbeturina leshterikësh në pjesën publike. Në zonën midis stacioneve Hyrja në plazh, tek Policia dhe Hyrja kryesore në plazh ka shumë leshterikë në breg të bërë një grumbull shumë i madh. Stacioni 1000 m larg dhe majtas pikes 2 është më e organizuar. Gjatë monitorimit u konstatua prezencë e afishimit të rregullave për zbatim nga pushuesit. Dhomat e ndërrimit dhe tualetet nuk janë të rregullta, duhen përmirësuar kushtet e tyre. Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Divjakës vlerësohen 100% në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larës në stacionet Hyrja në plazh, tek Policia, Hyrja kryesore në plazh , 1000 m larg dhe majtas pikes 2- hyrja kryesore në plazh.




Figura 142 - Vlerat e FC dhe IE, Divjakë




Figura 143 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në% në plazhin e Divjakë

Për vitin 2024, për plazhet e Divjakës vërehet tendencë në rritje e cilësisë së ujrave të kategorisë B-cilësi e mirë dhe tendencë në ulje për kategorinë A-cilësi e shkëlqyer, C-cilësi e mjaftueshme dhe D-cilësi e keqe, krahasuar me vitet e mëparshme.

Plazhi i Zvërnecit: Përgjithësisht në të gjitha plazhet që administrohen nga subjekte private u konstatuan kushte të mira, me dushe, kosha mbeturinash dhe prezencë e kullave të vrojtimit. Para hyrjes në zonën e triportit e cila nuk është pikë monitorimi, ndodhet kanali i madh që derdhet në det dhe ndihet aroma shumë e rëndë gjatë kalimit në rrugë. Brezi ranor është i pluguar dhe i pastër në përgjithësi. Frekuentuesit e plazheve shfrytëzojnë tualetet e subjekteve private që ushtojnë aktivitetin në brezin ranor.

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Zvërnecit vlerësohen:

Në kategorinë C-Cilësi e mjaftueshme e ujërave larës vlerësohet 33.33 %, stacioni Para Xhemalit (djathtas),

Në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larës 66.67% , stacionet Bar-Restorant Olsi (ne mes) dhe Bar-Restorant Kapiteni (majtas).

Krahasuar me vitet e mëparshme tendenca e cilësisë së ujrave të larjes është në ulje për kategorinë A-cilësi e shkëlqyer dhe C- cilësi e mjaftueshme dhe tendencë në rritje për kategorinë B-cilësi e mirë.




Figura 144 - Vlerat e FC dhe IE, Zvërnec




Figura 145 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhin e Zvërnecit

Plazhi i Vlorës: Në plazhin e Vlorës në përgjithësi, u konstatua prezenca e koshave për mbeturinat dhe prezenca e kullave të vrojtimit. Në pikën që përfaqëson plazhin Shkolla e Marinës u konstatua kanali i mbuluar me gure e rërë pra është përmirësuar pamja vizuale por përsëri ka derdhje të ujërave në det dhe uji i detit në drejtimin e kanalit me pamje me ngjyrë karakteristike. Tubat që kanë qenë të futur në det nuk kishin derdhje të ujit nëpër to në momentin e mostrimit, ishin bosh pa ujë. Plazhi i Ri Vlorë përkohet në dy sektorë të tij me 2 kanale të hapura që derdhen në det në drejtim të Moto dhe Boutique. Në pikën 10, lokali Boja u konstatua një kanal i madh i mbuluar me beton i cili shkakton erë të rëndë. Midis Gold Hotel dhe Boja ndodhet një kanal që derdhet në det. Tek pikat e monitorimit Plazhi i Vjetër Kampi pionierëve dhe Plazhi i vjetër Kabinat nuk ka mbeturina në brezin ranor por sipërfaqja pranë ish ndërtesave është e mbuluar me shkurre. Pikat me frekuencën më të lartë me ndotje janë, Plazhi Vjetër ish Kampi i Pionierit , Plazhi Vjetër Kabinat, Shkolla e Marinës dhe Plazhi i Ri.




Figura 146 - Vlerat FC dhe IE, Vlorë




Figura 147 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Vlorës

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Vlorës vlerësohen në kategorinë:

A- Cilësi e shkëlqyer, stacioni Plazhi Lame Borshi

B- Cilësi e mirë, stacionet Ish Vilat Blloku dhe Plazhi Paradise

C- Cilësi e mjaftueshme, stacionet Jonufer dhe Radhime, Hotel Grand

D- Cilësia keqe / Masa të menjëherëshme stacionet Plazhi i Vjetër, Kampi i Pionierëve, Plazhi i Vjetër Kabinat, Shkolla e Marinës, Plazhi I Ri dhe Lokali Boja 1.

Për plazhin e Vlorës, për vitin 2024, kemi përkeqësim të cilësisë së ujrave të larges krahasuar me vitet e mëparshme sepse vërehet tendencë në rritje të ujrave të kategorisë D-cilësi e keqe.

Plazhi i Orikut: Plazhi në përgjithësi i sistemuar, me kosha mbeturinash në brezin ranor, me kulla vrojtimi e dushe. Frekuentuesit e plazheve shfrytëzojnë tualetet e subjekteve private që ushtojnë aktivitetin në zonën e plazhit. Kanali në mes me aromë të rëndë derdh ujërat në det. Bregu i detit ka leshterikë në disa zona. Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Orikut vlerësohen: Në kategorinë C-Cilësi e mjaftueshme vlerësohet 33.33% e stacioneve .

Në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larës vlerësohen 66.67 % e stacioneve.




Figura 148 - Vlerat FC dhe IE, Orikum




Figura 149 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Orikumit

Sipas rezultateve mikrobiologjike, plazhet e Orikumit vlerësohen në kategorinë: B- Cilësi e mirë, stacionet Kompleksi Orikum dhe Para Repartit Pashaliman C- Cilësi e mjaftueshme, stacioni Bar- Restorant Aleksandër

Krahasuar me vitet e mëparshme cilësia e ujërave të larjes ka tendence ulje për A- cilësi e shkëlqyer ku në vitet 2023-2024 nuk ka asnjë stacion të kësaj kategorie.

Plazhi i Palasës: Gjatë inspektimit higjeno sanitar u konstatua se plazhet që administrohen nga privatët kanë krijuar kushte të përshtatshme për pushuesit dhe bregu është i pastër. Konstatohet prezencë e kullave të vrojtimit, dusheve, koshave të mbeturinave.

Plazhi i Palasës për periudhën 2020-2024 ka cilësi të shkëlqyer të ujërave. Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike këto plazhe vlerësohen në kategorinë A - Cilësi e shkëlqyer e ujërave (100%) në të gjitha pikat e monitorimit.




Figura 150 - Vlerat FC & IE, Palasa




Figura 151 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin e Palasës

Plazhi i Drimadhës: Brezi bregdetar i pastruar, i sistemuar me ndonjë mbeturinë inertesh në seritë e para. Në plazhet e Drimadhes, në përgjithësi u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve, prezencë e kullave të vrojtimit, dusheve, koshave të mbeturinave.

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Drimadhe vlerësohen:

Në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larës 50% dhe në kategorinë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave 50%.

A-Cilësi e shkëlqyer, stacioni Drimadhe 2

B- Cilësi e mirë, stacioni Drimadhe 1

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Drimadhe vlerësohen:

Në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larës 50% dhe në kategorinë A- Cilësi e shkëlqyer e ujërave 50%.

A-Cilësi e shkëlqyer, stacioni Drimadhe 2

B- Cilësi e mirë, stacioni Drimadhe 1




Figura 152 - Vlerat e FC dhe IE, Drimadhë

Plazhi i Dhërmiut: Në stacionet e monitorimit në Dhërmi u konstatuan kushte të mira, brezi bregdetar i pastruar. Konstatohet prezencë e kullave të vrojtimit dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve. Në stacionet e monitorimit në Dhërmi u konstatuan prezencë të koshave të mbeturinave dhe dushe. Në qendër tek pjesa e shkrimit DHËRMI është mbuluar kanali.




Figura 153 - Vlerat e FC dhe IE, Dhërmi




Figura 154 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % , në plazhet e Dhërmiut dhe Drimadhes

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Dhërmiut vlerësohen në kategorinë:

B- Cilësi e mirë e ujërave larës stacionet Hotel Anastasia dhe Kampi i Punetoreve.

A-Cilësi e shkëlqyer e ujërave stacioni Plazhi te Lisi.

Për plazhin e Dhermiut dhe Drimadhes, për vitin 2024. vërehet tendencë në ulje e cilësisë së ujrave të larjes së kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer dhe rritje te B- Cilësisë së mire. Nuk ka stacione të kategorisë C- Cilësi e mjaftueshme dhe D- Cilësi e keqe.

Plazhi i Jalës: Në stacionet e monitorimit u konstatuan kushte të mira, me dushe dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve. Konstatohet prezencë e kullave të vrojtimit. Brezi bregdetar i pastër, me prani të koshave të mbeturinave. Në plazhet e Jalës, u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve.

Plazhi i Livadhe: Në stacionet e monitorimit përgjithësisht u konstatuan plazhe të sistemuara. Brezi bregdetar i pastër dhe me prani të koshave të mbeturinave. Në stacionet e monitorimit u konstatuan kushte të mira, me dushe dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve.

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Jalës dhe Livadhes vlerësohen në kategorinë:

A-Cilësi e shkëlqyer e ujërave stacionet, Jalë Djathtas dhe Jalë Majtas dhe stacioni Livadhe 3

B- Cilësi e mirë e ujërave larës stacionet Livadhe 1 dhe Livadhe 2

Referuar cilësisë së ujrave të larjes ndër vite, vlerësohet se janë cilësi e shkëlqyer. Ujërat janë pa ngarkesa mikrobiale.




Figura 155 - Vlerat e FC dhe IE, Jale dhe Livadhe




Figura 156 - Tendenda e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin e Jalës dhe Livadhes

Plazhi i Himarës: Në stacionet e monitorimit u konstatuan kushte të mira, pothuajse në të gjitha plazhet, janë prezent kullat e vrojtimit, dhomat e ndërrimit të veshjeve, dushe, kosha mbeturinash dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve. Në plazhet e Himarës u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve. Plazhet që administrohen nga privatët kanë krijuar kushte të përshtatshme për pushuesit.




Figura 157 - Vlerat e FC dhe IE, Himarë




Figura 158 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Himarës

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Himarës vlerësohen në kategorinë:

B- Cilësi e mirë e ujerave larës stacionet Potam Alqi dhe Hotel Likoka

D- Cilësisë së keqe të ujërave larës stacionet Himarë Qendër dhe Pas Shkëmbit
Për vitin 2024 krahasuar me vitet e mëparshme cilësia e ujrave të larjes ka tendencë ulje për ujrën e kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer dhe tendencë në rritje për ujrën e kategorisë D- Cilësisë së keqe.

● **Plazhi i Qeparoit:** Në përgjithësi u konstatuan kushte të mira, u konstatuan mbeturina inertesh në territor dhe leshterikë përgjatë bregut në seritë e para. Në përgjithësi u konstatuan dushe, kosha mbeturinash, kulla vrojtimi në brezin bregdetar dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve.




Figura 159 - Vlerat e FC dhe IE, Qeparo




Figura 160 - Tendenca e sipas kategorive në %, në plazhin e Qeparoit

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Qeparoit vlerësohen në kategorinë:

B- Cilësi e mirë e ujerave larës stacionet Qeparo majtas

D- Cilësisë së keqe të ujërave larës stacionet Qeparo djathtas

Gjatë 2024 kemi ulje të cilësisë së ujrave të kategorisë B dhe rritje të kategorisë D duke ndikuar në përkeqësimin e cilësisë së ujrave në këtë plazh krahasuar me vitet e mëparshme.

Plazhi i Borshit: Në plazhin e Borshit në përgjithësi u konstatuan kushte të mira, me dushe, kosha mbeturinash, kulla vrojtimi në brezin bregdetar dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve. Kanali kryesor në mes tani është mbushur me zhavorr dhe nuk derdhet direkt në det, ka pak ujë.

Nga pika e parë djathtas e deri në drejtim me rrugën kryesore (hyrja) ndodhen 3 kanale të hapura që derdhen në det direkt. Nuk kanë erë të rëndë. U konstatuan mbeturina inertesh në territor në seritë e para. Në fund majtas vihet re një tub i madh që shkon në det.




Figura 161 - Vlerat e FC dhe IE, Borsh




Figura 162 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin e Borshit

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Borshit vlerësohen në kategorinë:

A-Cilësi e shkëlqyer 33.33% , stacioni Borshi majtas

B- Cilësi e mirë e ujërave larës 66.67%, stacionet Borshi djathtas dhe Borshi ne mes

Për vitin 2024, cilësia e ujërave që i përket kategorisë A- Cilësi e shkëlqyer ka vlera më të ulëta se në vitet 2017-2023. Në kategorinë B – Cilësia e mirë e ujërave ka vlera më të larta se në vitet 2017-2023. Nuk ka stacione të kategorisë C dhe D në vitet 2017-2024

Plazhi i Lukovës: Në Lukovë vërehet një ndryshim për mirë. Kanali është mbyllur dhe nuk derdhen ujëra në det. Në plazhet e Lukovës, u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve. U konstatuan kushte të mira, me dushe, kosha mbeturinash, kulla vrojtimi në brezin bregdetar.

Cilësia e ujërave të larjes në plazhin e Lukovës për vitin 2024, vlerësohet A-Cilësi e shkëlqyer të gjitha stacionet e monitorimit Gjithashtu referuar tendencës në vite cilësia e ujërave të larjes është shumë e mirë.





Figura 163 - Vlerat e FC dhe IE, Lukovë



Plazhi i Sarandës: Në plazhet e Sarandës u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve. Plazhet përgjithësisht ato që administrohen nga privatët por edhe plazhet publike kanë krijuar kushte të përshtatshme me prezencë të dusheve, koshave të mbeturinave, dhomave për ndërrimin e veshjeve, kulla vrojtimi dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve. Pika e kampionimit Kanali i Çukës vazhdon të derdhet në det por nuk ka erë të rëndë dhe ka vlera të mira.




Figura 164 - Vlerat e FC dhe IE, Sarandë




Figura 165 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në % në plazhin e Sarandës

Cilësia e ujrave të largjes në plazhin e Sarandës për vitin 2024, vlerësohet e kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme, stacionet Plazhi Limion, Plazhi Pllaka, Plazhi i Ri, Plazhi i Fëmijve, Hotel Grand. Stacioni Kanali i Çukës vlerësohet në kategorinë B- Cilësia e mire.

Për plazhin e Sarandes për vitin 2024, cilësia e ujërave që i përket kategorisë D - Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme ka tendencë në rritje krahasuar me vitet 2020-2023. Kjo ndikon në rritjen e ngarkesës mikrobiale dhe përkeqësimin e cilësisë së ujrave të largjes.

Plazhi i Ksamilit: Në plazhet e Ksamilit u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve gjatë gjithë sezonit. Plazhet përgjithësisht, ato që administrohen nga privatët kanë krijuar kushte të përshtatshme me prezencë të dusheve, koshave, dhomave për ndërrimin e veshjeve, kulla vrojtimi dhe afishimi i rregullave për zbatim nga frekuentuesit e plazheve.




Figura 166 - Vlerat e FC dhe IE, Ksamil




Figure 167 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin e Ksamilit

Sipas rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Ksamilit vlerësohen: Stacionet Plazhi Bora-Bora dhe Plazhi Kështjella të kategorisë D- Cilësisë së keqe. Plazhi Rilindja vlerësohet në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larës.

Referuar tendencës në vite verëhet se ka përqendrim të cilësisë së ujërave të largjes krahasuar me vitet 2020-2023

Plazhet Lin -Pogradec: Në plazhet e Pogradecit u konstatua frekuentim i lartë i pushuesve. Plazhet që administrohen nga privatët kanë krijuar kushte të përshtatshme për pushuesit por edhe plazhi publik. Nga vlerësimi higjeno-sanitar në plazhet e Pogradecit përgjithësisht u konstatua prezencë e koshave të mbeturinave, kulla vrojtimi dhe në disa zona dhoma ndërrimi të veshjeve. Problematike me ngarkesë bakteriale ashtu si në vitin e kaluar mbeten pika e monitorimit që përfaqësojnë plazhet: Hotel Enkelana (ish Turizmi) dhe Hotel 1 Maji, Hotel Depo.

Gjatë vijës liqenore të Pogradecit u konstatuan disa kanale të hapura që derdhin drejtpërdrejtë ujëra në liqen. Pranë pikës së monitorimit “Hotel 1 Maji” vazhdon derdhja e dy kanaleve majtas e djathtas. Në zonën e Volorekës ujërat e kanalit të Buçimasit derdhen në liqen duke shkaktuar ngjyrë karakteristike dhe erë. Përgjatë bregut liqenor të Pogradecit u konstatua prania e algave dhe likeneve veçanërisht në Muajin Shtator.

Në zonën pas pikës Hotel Depo (Kashtës) ndodhet një kanal i hapur që derdhet direkt në liqen, në këtë vend ndodhet dhe një grumbull i madh papastërtish. Kanali tjetër që del nga Driloni dhe derdhet direkt në liqen. Tushemisht kanali derdhet direkt në liqen. Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike pikat me frekuencë më të lartë me ngarkesë mikrobike vlerësohen Enkelana, Hotel 1 Maji, Hotel Depo.




Figura 168 - Vlerat e FC dhe IE, Pogradec




Figura 169 - Tendenca e cilësisë sipas kategorive në %, në plazhin e Pogradecit

Referuar rezultateve të analizave bakteriologjike plazhet e Pogradecit vlerësohen:

Në kategorinë A- Cilësi e shkëlqyer, 25% e stacioneve (stacionet Lin Hotel-Resort Relaks, Dogana –pika e Molit,

Në kategorinë B- Cilësi e mirë e ujërave larë 25% e stacioneve (stacionet Resort Komplex Lyhnida, Tushemisht Hotel Millenium)

Në kategorinë C- Cilësi e mjaftueshme vlerësohet 12.5% e stacioneve (stacioni Volorek)

Në kategorinë D-Cilësi e keqe e ujërave larës vlerësohen 37.5% e stacioneve, (stacionet Hotel Enkelana (Ish Turizmi i vjetër), Hotel 1 Maj, Hotel Depo)

Në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 kemi tendencë në rritje të cilësisë së ujërave të kategorisë A-cilësi e shkëlqyer dhe tendencë në ulje të cilësisë së ujërave të kategorisë D-cilësi e keqe.

Grafiku paraqet vlerësimin e cilësisë së ujërave bregdetarë të larjes shprehur në përqindje për vitin 2024. Pjesa më e madhe e stacioneve të ujërave bregdetare i përket kategorisë B-Cilësi e mirë 46.35 %




Figura 170 - Kategorizimi i shprehur në përqindje, Viti 2024

Tabela 33 - Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare të larjes sipas kategorive, për periudhën 2017-2024 (e shprehur sipas numrit të stacioneve dhe e shprehur në %)

Cilësia	2017		2018		2019		2020		2021		2022		2023		2024	
	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione	%	Stacione
A-Cilësi e shkëlqyer	68%	53	82.4%	89	89%	106	89.9%	107	51%	60	67.5%	83	27.8%	34	14.64%	18
B-Cilësi e mirë	15%	12	13%	14	2.5%	3	5.0%	6	32%	38	19.5%	24	32.5%	40	46.35%	57
C-Cilësi e mjaftueshme	6%	5	0.9%	1	6%	7	0.9%	1	8%	10	4.1%	5	12.1%	15	12.19%	15
D-Cilësi e keqe/Masa të menjëherëshme	10%	8	3.7%	4	2.5%	3	4.2%	5	9%	11	8.9%	11	27.6%	34	26.82%	33

4.3.2 Cilësia e ujërave bregdetare për parametrat fiziko-kimik.

Për vitin 2024 është realizuar vlerësimi i parametrave fiziko – kimik në zonat bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvernec dhe Ksamil. Parametrat e matur janë: oksigjeni i tretur, nevoja kimike për oksigjen (NKO), nevoja biokimike per oksigjen (NBOs), nitritet, nitratet, amonjaku, orto – fosfatet.

Tabela 34 - Stacionet e monitorimit të zonave bregdetare


Nr.	Kodi i kampionit	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dhe	Në mes të plazhit kryesor	N 40.083187 E 19.380408
2.	Hi	Plazhi në mes të qytetit të Himarës	N 40.060153 E 19.443742
3.	Bo	Në det 100 m larg bregut	N 40.023901 E 19.503488
4.	Lu	Në det 100 m larg bregut	N 39.582651 E 19.543780

5.	Ks	Në det 100 m nga bregu, në mes të plazhit	N 39.462753 E 20.000157
6.	Zv	Në det 100 m nga bregu, në mes të plazhit	N 40.294703 E 19.251227


✓ **Oksigjeni i tretur**
Ky parametër është matur in – situ dhe nga vlerat mesatare të ekspeditave të realizuara ujërat janë të ngopura me oksigjen të cilat variojnë nga 10 – 11 mg/l.

✓ **Nevoja kimike për oksigjen**
Vlerat mesatare të matura janë vlerësuar në vlera 3 – 4 mgO/l m, në vlera shumë të ulëta.


✓ **Fosfori total**
Është vlerësuar përmbajtje shumë e ulët 0.004 mg/l , nën limitin e dedektimit.




Ky parametër është shumë i rëndësishëm për të vlerësuar ndotjen organike e cila ka si burim shkarkimet urbane të patrajtura. Vlerat mesatare të matura janë vlerësuar në vlera 1 – 2 mgO/l m, në limitin e dedektimit.



Vihet re përmbajtje në vlera shumë të ulëta të amonjakut që variojnë nga 0.09 – 0.23 mg/l (< 1 mg/l).



Prania e nitriteve në ujërat bregdetare të monitoruara në keto stacione është vlerësuar në vlera shumë të ulëta, në vlera të limitit të dedektimit



Përmbajtja e fosforit është vlerësuar shumë e ulët në vlera deri 0.0064mg/l.

Në stacionet e monitoruara vlerësojmë një cilësi të mirë të ujërave bregdetare për të gjithë parametrat fiziko – kimikë.

4.3.3 Ndikimi i shkarkimeve urbane në cilësinë e ujërave bregdetare

Stacionet e monitorimit

Stacionet e monitorimit të cilësisë së ujërave bregdetare për statusin kimik janë shtrirë në qytetet Durrës, Vlorë dhe Sarandë. Përzgjedhja e stacioneve të monitorimit është bazuar sipas skemës ku kolektori shkarkues përfaqëson burimin ndotës dhe pas shkarkimit në mjedisin pritës, në det në distancën 10 m. Sipas kësaj skeme vlerësohet cilësia e ujërave të shkarkimeve në pikën e shkarkimit (kolektorë ose stacione pompimi) dhe impakti i tyre në cilësinë e ujërave bregdetare.

Në qytetin e Durrësit dhe Vlorës ujërat urbane shkarkohen nëpërmjet stacioneve të pompimit. Në qytetin e Durrësit, ujërat urbane shkarkohen në det, në zonën e Porto Romanos (Spitalle), në qytetin e Vlorës shkarkohen në det në zonën e Pyllit të Sodës, kurse në qytetin e Sarandës shkarkohen në kanalin e Çukës e më pas në det.

Tabela 35 - Stacionet e monitorimit për vitin 2024.

Nr.	Kodi i kampionit	Zona bregdetare	Vendndodhja	Koordinatat gjeografike
1.	Dr1	Durrës	Porto Romano	N 41.375550 E 19.421549
2.	Dr2	Durrës	10 m në det	N 41.374478 E 19.421225
3.	Dr3	Durrës	Curilat	N 41.319580 E 19.430960
4.	Dr4	Durrës	Kanali Plepa – Shkëmbi i Kavajës	N 41.28543 E 19.50894
5.	V2	Vlorë	Në det 20 m pas stacionit të pompimit – Pylli i Sodës	N 40.469208 E 19.454117
6.	V3	Vlorë	Plazhi i Ri - Vlorë	N40.453422 E 19.478732
7.	V4	Vlorë	Shkolla e Marinës	N 40.442729 E 19.494879
8.	S1	Sarandë	Plazhi i qytetit – Tek porti	N 39.873377 E 20.008538
9.	S2	Sarandë	Bar Riviera në qendër të qytetit	N 39.868564 E 19.998654
10.	Shgj 1	Shëngjin	Tek porti jashtë argjinaturës	N 41.4841 E 19.3533
11.	Shgj 2	Shëngjin	Në fund të plazhit, afër Kunes	N 41.4741 E 19.3680
12.	Ve 1	Velipojë	Kompleksi “La Maroja”	N 41.5653 E 19.3613
13.	Ve 2	Velipojë	100 m larg ujë këmbimit det-lagunë	N 41.5435 E 19.2625


Standartet e cilësisë

Vlerësimi i cilësisë së ujërave urbane është kryer sipas normave të shkarkimeve të lëngëta urbane nga impiantet e trajtimit, të përcaktuara në Legjislacionin Shqiptar VKM Nr.177 datë 31.03.2005.


Tabela 36 - Normat e shkarkimeve të lëngëta urbane

Parametrat	Përqëndrimi
Nevoja biokimike per oksigjen (NBO5)	25 mg/l O2
Nevoja kimike per oksigjen (NKO)	125 mg/l O2
Lenda totale ne suspension	35 mg/l
Fosfori total	1 mg P/l


Vlerësimi i cilësisë së ujërave bregdetare




Përmbajtja e Nevojës Biokimike për Oksigjen tejkalon normën e lejuar në stacionet Dr1 – Porto Romano (Hidrovori), Dr4 – Kanali i ujerave ruarale (Plepa) dhe V1 – Në det pas hidrovorit tek Pylli i Sodës.



Përmbytja e Nevojës Kimike për Oksigjen është nën vlerën e lejuar, për të gjitha stacionet e monitorimit.



Përmbytja e lëndëve totale në suspension rezulton mbi normën e lejuar në stacionin e Durrësit Dr4 – Kanali i ujërave rurale (Plepa), V2 – pas hidrovorit në det dhe në stacionet e Shëngjinit dhe Velipojës.



Përmbajtja e fosforit total është vlerësuar mbi normën e lejuar vetëm në stacionin V1 – pas stacionit te pompimit në Vlorë

Stacionet e pompimit që kanë më shumë ndikim në cilësinë e ujërave bregdetare janë në Durrës- Porto Romano (Hidrovari), Kanali i ujërave ruarale (Plepa) dhe Vlorë - Në det pas hidrovorit tek Pylli i Sodës.

Trendi në vite

Në grafikët e mëposhtem janë paraqitur tendencat e përmbajtjes së NBO5, NKO, e lëndës pezull dhe P-total.




Figura 171 - Tendenca e përmbajtjes së NBO5 në shkarkimet urbane, mg/l




Figura 172 - Tendenca e përmbajtjes së NKO, mg/l




Figura 173 - Tendenca e përmbajtjes së lëndës pezull, mg/l




Figura 174 - Tendenca e përmbajtjes së P-total, mg/l

Përsa i përket tendencës së përmbajtjes së NBO5 vërehet se në stacionet Dr1 Dr4, V2, V3, S1 kemi rritje të NBO5 krahasuar me vitin 2023, ndërsa në stacionet e tjera shihet përmirësim i cilësisë krahasuar me vitin e mëparshëm.

Referuar përmbajtjes së NKO, gjatë vitit 2024 kemi tendencë në ulje krahasuar me 2023, pothuajse në të gjitha stacionet duke përjashtuar Dr1 Dr4.dhe V2 ku terehet tendencë në rritje.

Gjatë vitit 2024, vlerësohet se kemi rritje të përmbajtjes së lëndës pezull në stacionet V2 dhe ulje të vlerave në stacionet e tjera krahasuar me vitin e mëparshëm.

Referuar përmbajtjes së P-total vërehet se kemi rritje të vlerave krahasuar me vitet 2021-2023 në stacionet Dr4, V2 dhe V2. Kemi përmirësim të cilësisë në stacionet e tjera ku paraqiten vlera më të ulëta krahasuar me vitin e mëparshëm

4.3.4 Lagunat




Figura 175 - Harta e monitorimit të Lagunave 2024

Monitorimi është kryer në lagunat Nartë, Karavasta dhe Butrint të cilat kanë komunikim me detin dhe janë habitate me kripshmëri të lartë. Direktiva Kuadër e Ujit thekson kërkesën për monitorim dhe vlerësim të vazhduar të këtyre habitateve.

Kjo direktivë përcakton 4 kategori të ujërave sipërfaqësore që ndahen në lumenj, liqene, ujëra kalimtare dhe ujëra bregdetare.


Lagunat nuk janë lumenj, por në vlerësimin sipas kësaj direktive i referohen normat limite të liqeneve.

Laguna e Karavastasë


Monitorimi i Lagunës së Karavastasë realizohet në dy pika monitorimi, një pikë është në det dhe tjetra në ujë – këmbimin det – lagunë. Ujërat e kësaj lagune paraqesin vlerë mesatare të pH 7.84.

Transparenca e ujit është vlerësuar 0.45m, transparencë shumë e ulët e kësaj lagune duke e klasifikuar këtë lagunë me cilësi eutrofiqe.


- Përmbajtja e nevojës kimike për oksigjen është 18.5 mgO/l duke i klasifikuar ujërat të cilësisë eutrofiqe.




- Vlerat e nevojës biokimike për oksigjen janë vlerësuar me një vlerë mesatare 11.5 mg/l duke e klasifikuar lagunën me cilësi eutrofike.



- Përmbajtja mesatare e nitrateve është në vlerën 1.69 mg/l duke i klasifikuar ujërat e kësaj lagune me një cilësi mezotrofike.



- Vlera mesatare e përmbajtjes së fosforit total në të dy stacionet e kampionimit është 0.015 mg/l duke i klasifikuar ujërat e kësaj lagune me cilësi mezotrofike.




Ujërat e lagunës së Karavastasë vlerësohen me transparencë shumë të ulët dhe me përmbajtje të lartë të kërkesës për oksigjen duke e klasifikuar këtë lagunë me cilësi eutrofike.


Laguna e Nartës

Kjo lagunë monitorohet në 2 pika kampionimi, njëra në Urën e Manastirit dhe tjera në ujëkëmbimin det – lagunë. Transparenca e ujit është matur në vlerën 0.4 m, transparencë shumë e ulët e kësaj lagune duke e klasifikuar këtë lagunë me cilësi eutrofike.


- Përmbajtja e nevoja kimike për oksigjen është vlerësuar me një vlerë mesatare të të dy stacioneve të kampionimit 29 mgO/l duke i klasifikuar ujërat të cilësisë eutrofike.




- Përmbajtja e nevojës biokimike për oksigjen është vlerësuar 34 mgO/l duke e klasifikuar këtë lagunë me cilësi eutrofike.



- Parametri nitrate rezulton brenda vlerave limite të lejuara në vlerën 0.43 mg/l (<1 mg/l).



- Vlera mesatare e përmbajtjes së fosforit total në të dy stacionet e kampionimit është 0.0085 mg/l.




Referuar të dhënave të mësipërme vlerësojmë se ujërat e Lagunës së Nartës janë me transparence të ulët dhe me vlera të larta të nevojës kimike dhe biokimike për oksigjen duke e klasifikuar këtë lagunë me cilësi eutrofike.


Laguna e Butrintit

Monitorimi realizohet në një stacion kampionimi me dy thellësi dhe përkatësisht 0 m dhe 5 m thellësi ku temperatura e ujit varion nga 21.3 – 35.1°C dhe oksigjeni i tretur i matur in – situ rezultoi të ishte 7.8 – 11.7 mgO/l ku dëshmon që ujërat janë të pasura me oksigjen. Vlera mesatare e transparencës së matur është 1.16 m dhe referuar këtij treguesi vlerësojmë se cilësia është mezotrofike.


- Vlerat e nevojës biokimike për oksigjen e klasifikojnë Lagunën e Butrintit me cilësi mezotrofike.




- Nevoja kimike për oksigjen është vlerësuar në vlerë mesatare 9 mgO/l, duke e klasifikuar lagunën me cilësi mezotrofike.



- Përmbytja e nitrative rezulton të plotësojë kushtet për cilësi oligotrofike pasi vlera mesatare e dy stacioneve të monitorimit është 0.46 mg/l (<1 mg/l).



- Vlera mesatare e përmbytjes së fosforit total në të dy stacionet e kampionimit me thellësi të ndryshme përkatësisht 0 m dhe 5 m thellësi është 0.011 mg/l ku i klasifikojnë këto ujëra me cilësi mezotrofike.



Referuar të dhënave të ekspeditave të kryera vlerësojmë se ujërat e lagunës së Butrintit bazuar në parametrat e mësipërm vlerësohen me cilësi mezotrofike.

Për vitin 2024 vlerësohet se kemi përmirësim të gjendjes trofike në Lagunën e Butrintit duke kaluar nga cilësi eutrofike në vitin 2023 në cilësi mezotrofike. Laguna e Karavastase është në gjendje eutrofike në vitet 2021-2022 dhe 2024, Kemi përkeqësim të gjendjes trofike të Lagunës së Nartës duke kaluar nga mezotrofike në vitin 2021 në eutrofike në vitin 2024.

Tabela 37 - Tendenca të gjendjes trofike për lagunat

	2020	2021	2022	2023	2024
Laguna e Butrintit	Cilësi mezotrofike me tendencë eutrofie	Cilësi eutrofike	Cilësi mezotrofik e	Cilësi eutrofike	Cilësi mezotrofike
Laguna e Karavastasë	Cilësi eutrofike	Cilësi eutrofike	-	-	Cilësi eutrofike

Laguna e Nartës	Cilësi eutrofike	Cilësi mezotrofike	-	-	Cilësi eutrofike
-----------------	------------------	--------------------	---	---	------------------

4.3.5 Sipërfaqet e shfrytëzuara të plazheve

Agjencia Kombëtare e Bregdetit, bazuar në VKM nr 171, date 27.03.2019” Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kritetret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” të ndryshuar, ka kryer monitorime të sipërfaqeve të plazheve të shfrytëzuara gjatë sezonit turistik 2024. Sipërfaqet kategorizohen në hapësira me kontrate, të cilat menaxhohen nga subjekte private, hapësira publike që shfrytëzohen nga publiku,hapsira të menaxhuara dhe investim strategjik.

Tabela 38 - Plazhet sipas tipologjisë për çdo bashki, 2024

Bashkia	Tipologjia	Numri i Parcelave	Shuma e siperfaqes per Tipologji (m2)	Sip per Tipologji/Sip totale per Bashki (%)
Divjakë	E MENAXHUAR	24	95,309	53.90%
	KONTRATE	1	28,188	15.94%
	PUBLIKE	13	53,337	30.16%
	Totali	38	176,834	100.00%
Durrës	E MENAXHUAR	485	338,326	29.11%
	INVESTIM STRATEGJIK	36	220,251	
	KONTRATE	128	115,908	9.97%
	PUBLIKE	166	487,919	60.92%
	Totali	815	1,162,404	100.00%
Fier	E MENAXHUAR	137	359,032	69.01%

	KONTRATE	0	0	0.00%
	PUBLIKE	20	161,198	30.99%
	Totali	157	520,230	100.00%
Himare	E MENAXHUAR	168	208,797	36.60%
	INVESTIM STRATEGJIK	21	114,657	
	KONTRATE	68	105,168	18.43%
	PUBLIKE	77	141,859	44.96%
	Totali	334	570,481	100.00%
Kavaje	E MENAXHUAR	135	118,093	40.83%
	KONTRATE	71	70,909	24.51%
	PUBLIKE	46	100,258	34.66%
	Totali	252	289,260	100.00%
Lezhe	E MENAXHUAR	360	314,764	53.99%
	KONTRATE	84	52,281	8.97%
	PUBLIKE	53	215,996	37.05%
	Totali	497	583,041	100.00%
Pogradec	E MENAXHUAR	48	83,474	54.70%
	KONTRATE	11	17,975	11.78%
	PUBLIKE	18	51,147	33.52%
	Totali	77	152,596	100.00%
Rrogozhine	E MENAXHUAR	30	131,998	30.74%
	KONTRATE	38	166,205	38.70%
	PUBLIKE	46	131,261	30.56%
	Totali	114	429,464	100.00%
Sarande	E MENAXHUAR	139	98,895	54.98%

	INVESTIM STRATEGJIK	1	1,665	
	KONTRATE	45	26,411	14.68%
	PUBLIKE	9	52,903	30.34%
	Totali	194	179,874	100.00%
Shkoder	E MENAXHUAR	124	102,204	45.46%
	INVESTIM STRATEGJIK	31	29,916	
	KONTRATE	24	21,060	9.37%
	PUBLIKE	50	71,652	45.18%
	Totali	229	224,832	100.00%
Vlore	E MENAXHUAR	276	423,209	59.05%
	KONTRATE	50	63,863	8.91%
	PUBLIKE	25	229,601	32.04%
	Totali	351	716,673	100.00%
	Sipërfaqja Totale e Parcelave	3058	5,005,689	
	Sipërfaqja Totale Publike		1,697,131	

Burimi: Agjencia Kombëtare e Bregdetit

Sipërfaqja totale e hapësirave publike është 1 697 131m² ndërsa sipërfaqe totale e hapësirave të menaxhuara është 5,005,689 m2. Bashkia Durrës ka sipërfaqen më të madhe totale me 1,162,404 m2 duke vijuar me Vlorën 716,673m2.

Gjatë sezonit turistik 2024 sipërfaqja totale e shfrytëzuar është me e lartë se në vitin 2023 duke treguar një rritje të sipërfaqeve të plazheve të shfrytëzuara krahasuar me vitin 2023 ku sipërfaqja totale rezulton 4,971,346 m², nëvitin 2022 rezulton 4,531,889 m² dhe në vitin 2021 me një sipërfaqe totale 4,579,706 m².

Në paraqitjet grafike të mëposhtme jepet tendenca në vite e sipërfaqeve totale të shfrytëzuara si dhe të sipërfaqeve të menaxhuara dhe publike.




Figura 176 - Tendence e sipërfaqeve të shfrytëzuara të plazheve 2021-2024

Kemi një tendencë në rritje të sipërfaqeve të shfrytëzueshme gjatë sezonit turistik 2024 krahasuar me vitin 2023 në të gjitha bashkitë duke përjashtuar Rrogozhinen e cila ka tendencë në ulje të hapësirave të shfrytëzuara.

Përsa i përket hapësirave të menaxhuara për vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 vihet re tendencë në ulje për të gjitha bashkitë ndërsa hapësira publike ka tendencë në rritje përveç bashkisë Durrës, Rrogozhine dhe Divjake të cilat kanë tendencë në ulje. Një pjesë të sipërfaqes totale e zë dhe sipërfaqja për investim strategjik në bashkitë Durrës, Himarë, Sarandë dhe Shkodër.




Figura 177 - Tendenca e hapësirave të menaxhuara të plazheve 2021-2024




Figura 178 - Tendenca e hapësirave publike sipas bashkive

Bashkia Durrës përgjatë viteve 2021-2024 ka vënë në dispozicion të publikut më shumë hapësira publike të plazheve se bashkitë e tjera.

4.3.6 Dinamika e vijës bregore të deteve Jon dhe Adriatik


Monitorimi kryhet me një periudhë kohore 4 vjeçare për secilin segment monitorimi që shtrihet në bregdetin e deteve Jon dhe Adriatik. Zonat me problematikë më të madhe mbahen në monitorim të vazhdueshëm nëpërmjet sondazheve të përvitshme. Të dhënat e nxjerra të kthyera në sipërfaqe të eroduara apo të akumuluarra përftohen si rezultat i krahasimit.

Ky rajon ka përfshirë vijën bregdetare të të gjithë gjirit detar të Drinit, nga grykëderdhja e Bunës deri në kepin e Rodonit dhe pjesën veriore të gjirit detar të Lalzit, segmenti nga plazhi i Shën Pjetrit në fshatin Hamallaj. Të dhënat përkatëse për segmentet janë ndërtuar si diferencë mes vlerave finale të vitit 2021 dhe atyre të matura gjatë këtij viti dhe jepen në tabelën në vazhdim:

Tabela 39 - Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut) 2021-2024

Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut) 2021-2024			
Rajoni Gjiri i Drinit			
Segmentet	Akumulim	Erozion	Bilanci
	Hektarë (ha)		
Grykëderdhja e Bunës – Gryka e Vilunit (Rrjoll)	7,03	13,9	-6,87
Gryka e Vilunit (Rrjoll) – Shëngjin	5,01	7,7	-2,69
Shuma	12,04	21,6	-9,56
Shëngjin – Grykëderdhja e Drinit	0,26	3	-2,74
Grykëderdhja e Drinit – Grykëderdhja e Matit	1,5	11,2	-9,7
Grykëderdhja e Matit – Grykëderdhja e Ishmit	6,1	1	5,1
Shuma	7,86	15,2	-7,34

Rajoni Gjiri i Lalzit*			
Shën Pjetër – Hamallaj	2,01	2,6	-0,59



Më poshtë jepet një tabelë e shumatores së sipërfaqeve nën akumulim, erozion, bilanci si dhe vlera përmbledhëse e ritmit të erozion - akumulimit të shprehur në hektarë për vit mes dy periudhave të fillimit dhe fundit të krahasimit 2017 – 2024.

Tabela 40 - Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut)

Dinamika e vijës bregore (Bregdeti i Adriatikut) Periudha e krahasimit 2017-2024				
Rajoni Gjiri i Drinit				
Segmentet	Akumulim	Erozion	Bilanci	ritmi
	Hektarë (ha)			ha/vit
Grykëderdhja e Bunës – Gryka e Vilunit (Rrjoll)	20,18	28,82	-8,64	-1,08
Gryka e Vilunit (Rrjoll) – Shëngjin	6,41	18,20	-11,79	-1,47

Shuma	26,59	47,02	-20,43	-2,55
Shëngjin – Grykëderdhja e Drinit	2,13	10,93	-8,80	-1,10
Grykëderdhja e Drinit – Grykëderdhja e Matit	1,85	26,00	-24,15	-3,02
Grykëderdhja e Matit – Grykëderdhja e Ishmit	13,20	3,70	9,50	1,19
Shuma	17,18	40,63	-23,45	-2,93
Rajoni Gjiri i Lalzit*				
Shën Pjetër – Hamallaj	9,2	14,6	-5,4	-0,675

Grafiku i mëposhtëm jep një paraqitje të peshës së erozionit dhe akumulimit ndaj totalit për segmentet e marra në shqyrtim për periudhën kohore 2017 – 2024.




Figura 179 - Grafiku i erozionit dhe akumulimit ndaj totalit 2017 - 2024

Rajoni i Gjirit të Drinit vijon të jetë rajon problematik me bilanc negativ. Këtu ka segmente ku mbizotërimi i erozionit ndaj akumulimit është i dukshëm. Këto

segmente përfshihen në atë pjesë të vijës bregore e cila shtrihet nga gryka e Vilunit deri në grykëderdhjen e Matit. Kjo hapësirë përbën një linjë afërsisht 35 kilometra ose afër 75% të bregdetit të ulët ranor të këtij gjiri.

Tendenca e erozionit duket të jetë verilindore dhe e ka kahun kryesor në drejtim të brezit që ndan kënetën e Kune – Vainit prej detit.

Kjo zonë ka ndërhyrje të shumta antropogjene dhe ka patur një zhvillim të ndërtimeve dhe veprimtarisë ekonomike turistike. Këto kanë çuar në zhdukjen pothuaj të plotë të brezave me pisha të mbjella në zonën e Kunes duke prishur mbrojtjen e dunave, dhe duke bërë që veç detit dhe era të kryejë erozionin e saj. Shtimi i sipërfaqes së gjelbëruar përgjatë detit do ishte një ndërhyrje që mendojmë se do e zbuste sadopak ritmin e erozionit.

4.3.7 Gjendja e dinamikës së deltave të lumenjve

Gjatë vitit 2024 u kryen matje batimetrike për një konturim fillestar të morfologjisë së zonave të grykëderdhjes, ku përfshihet dhe pjesa e deltave, për lumenjtë Bunë, Drin, Mat, Ishëm, Shkumbin, Vjosë dhe Pavlo. Gjatë matjeve janë arritur edhe përfundime mbi erozion akumulimin e kufirit të fushës deltore, që përfaqëson ekstremin e pjesës kontinentale me me pjesën nënujore të deltës, përfaqësuar nga fronti i deltës.

Delta e Lumit Buna. Fronti i deltës përfaqëson një bar grykëderdaje deri diku të bifurkëzuar. Ky bar ka formën e një gysëmelpsoidi me rrezen e madhe 575 metra e cila orientohet veriperendim – juglindje me azimut 280° , dhe rreze të vogël 351 metra me orientim veri-veriperendim, jug-juglindje me azimut 347° . Kanali i lumit është i zhvendosur në perendim të pikëprerjes së dy diametrave të elipsit, dmth sedimente synojnë të lëvizin e depozitohen në krahun lindor të deltës, duke qenë kështu kontributor në zonën bregore që rezulton akumulative midis grykëderdhjes së Bunës dhe grykës së Vilunit. Nga përlllogaritjet ky bar ka një volum rreth $447970,7 \text{ m}^3$. Aksi i barit thyhet dhe krijon një kënd lindor prej 14° , në lidhje me aksin e kanalit lumor deri në batimetrinë 3 metra dhe më tej ky kënd zgjerohet deri në 50° . Si rezultat i kësaj, kufiri i fushës deltaike ka pësuar në erozion të materialit, i cili krahas prurjeve ranore të lumit ka kontribuar në krijimin e barit në grykëderdhje. Tendanca e lëvizjes së aksit grykëderdhjes shihet të jetë në sensin antiorar nga kuadranti i III drejt kuadrantit IV. Kjo tregon

se në të ardhmen lumi do vazhdojë të erodojë bregun e majtë të tij duke krijuar probleme në territorin që i përket Republikës së Shqipërisë.

Delta e Lumit Drin. Fronti i deltës dallohet nga një bar grykëderdhjeje i tipit të lumit me aks të thyer pranë bregut. Kjo thyerje e aksit mendojmë se u shkaktua nga vepra mbrojtëse e ndërtuar në grykëderdhje në krahun e majtë të rrjedhës. Bari i grykëderdhjes ka formë eliptike me rrezen e madhe 302,1 metra dhe të voglën 200,4 metra me një vëllim përafërt të llogaritur prej 99108,7 m³. Aksi i madh ka orientim veri, verilindje – jug, jugperendim me një azimut 28°, ndërsa i vogli orientim veri, veriperendim – jug, juglindje me azimut 329°. Tendenca e lëvizjes së aksit të grykëderdhjes është në sens orar, nga kuadranti II drejt kuadrantit I. Matjet flasin për erodim në të dyja krahët të fushës deltore. Është e mundur sedimentet që dalin nga ky lumë të lëvizin më tej drejt veriperendimit dhe të kenë ndikim pozitiv akumulues në pjesën e plazhit përballë hapësirës urbane të Shëngjinit.

Delta e Lumit Mat. Në frontin e deltës krijohet një bar grykëderdhjeje me aks të thyer pranë bregut. Thyerja e aksit i dedikohet pozicionit gjeografik ku bregu i Tales në veri ka avanicism më të madh drejt perendimit krahasuar me litoralin që mbyll lagunën e Patokut në jug. Kjo diferencë është rreth 1 kilometër. Forma e barit të grykëderdhjes është elipsoidale me rrezen më të madhe drejt përparimit të deltës me gjatësi 517 metra, ndërsa rrezja e vogël shtrihet përgjatë bregut me gjatësi 387.4 metra. Volumi i llogaritur i barit është 364329,6 m³. Tendenca e lëvizjes së aksit të grykëderdhjes është në sens antiorar prej kuadrantit III drejt kuadrantit IV. Ky drejtim i bën sedimentet që vijnë nga lumi Mat kontribuese në sektorin akumulativ Grykëderdhja e Matit – Grykëderdhja e Ishmit.

Delta e lumit Ishëm. Krijon një bar delte të thjeshtë. Rrezja e madhe e tij është 334,1 m ndërsa e vogla 201,9 m me një volum të përafërt prej 42903,9 m³. Pasi del nga zona e këtij bari, aksi i lëvizjes së grumbullit të sedimenteve rrotullohet në sens orar nga kuadranti II drejt kuadrantit I duke qenë kontribuese sëbashku me ato me prejardhje nga lumi Mat në sektorin akumulativ Grykëderdhja e Matit – Grykëderdhja e Ishmit.

Delta e lumit Shkumbin. Bari i grykëderdhjes së kësaj delte ka formë elipsoidale. Rrezja më e madhe është 233 m, dhe përputhet me drejtimin e përparimit të deltës, me një orientim veriperendim juglindje me azimut 295°.

Aksi i vogël orientohet pingul me të dhe ka një rreze prej 124,6 metrash. Volumi i sedimenteve në këtë bar llogaritet në rreth 13407 m³. Në të dy anët e grykëderdhjes dallohet akumulim i sedimentit, dhe erozion në zonën përtej elipsoidit.

Delta e lumit Seman. Edhe këtu bar i grykëderdhjejes ka aks të thyer pranë bregut. Thyerja e aksit nuk është shumë e madhe dhe i dedikohet pjesës më të avancuar të fushës deltore në krahun e djathtë, me një diferencë të vogël 150-200 m në krahasim me krahun e majtë. Bari ka në formë elipsoide me aksin e madh të orientuar gati veri - jug me rreze afërsisht 312 m, dhe rreze të vogël rreth 249 m. Në të dy krahët vërehet një gjendje erozioni i kufirit të fushës deltore.

Delta e lumit Vjosa. Ka në bar relativisht të vogël eliptik të krijuar në pjesën e zgjerimit të grykëderdhjes. Rrezet e tij janë 408 m dhe 233 m, me një vëllim të përafërt prej 35397,6 m³. Aksi i përparimit të kësaj delte ndjek atë të lumit. Në të dy krahët, në kufirin e fushës deltore vërehet si fenomeni i akumulimit dhe i erozionit. Më i theksuar erozioni është në krahun e djathtë ndërsa akumulimi në të majtin. Kjo na bën të mendojmë se aksi i depozitimit po mënjanohet ngadalë nga kuadranti III ku ndodhet drejt kuadrantit të II. Kjo do ketë si pasojë në të ardhmen ulje të kontributit të sedimenteve të Vjosës për akumulim në pjesën drejt jugut dhe rritje për pjesën veriore.

● **Delta e lumit Pavlo.** Edhe këtu bar i grykëderdhjejes ka aks të thyer pranë bregut. Bari ka formën e elipsit me rrezen e aksit të madh 188 m dhe atij të vogël 151 m. Llogaritet një vëllim sedimentesh në trupin e barit prej 25490,8 m³.

4.4 Përfundime

Bazuar në vlerësimin e mësipërm për mjedisin bregdetar theksojmë se:

1. Gjatë sezonit veror të vitit 2024 u konstatua rritje e fluksit të pushuesve gjatë gjithë bregdetit të Shqipërisë dhe një sezon i zgjatur turistik në të gjithë bregdetin e Shqipërisë.
2. Përgjatë bregdetit u konstatuan derdhje ujërash sipërfaqësore në det të cilat në pjesën më të madhe të rasteve përkojnë me të dhënat mikrobiologjike të konstatuara me ndotje.

3. Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetarë të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktajnë ndotje të këtyre ujërave.
4. Nga rezultatet vihet re se ka ndotje mikrobike veçanërisht në seritë e katërt, të pestë, të gjashtë dhe të shtatë, që përfaqësojnë pikun e sezonit turistik por u konstatua se ka pasur shtim të ngarkesës mikrobike në disa pika gjatë muajit Shtator.
5. Përsa i përket shkarkimeve urbane, përmbajtja e lëndëve totale në suspension rezultojnë mbi normën e lejuar në stacionin e Durrësit Dr4 – Kanali i ujërave ruarale (Plepa), V2 – pas hidrovorit në det dhe në stacionet e Shengjinit dhe Velipojes
6. Referuar të dhënave të ekspeditave të kryera vlerësojmë se ujërat e lagunës së Karavastasë vlerësohen me transparencë shumë të ulët dhe me përmbajtje të lartë të kërkesës për oksigjen duke e vlerësuar këtë lagunë me cilësi eutrofike.
7. Ujërat e lagunës së Nartës dhe të Karavastasë vlerësohen me transparencë të ulët dhe me vlera të larta të nevojës kimike dhe biokimike për oksigjen duke i klasifikuar këto laguna me cilësi eutrofike ndërsa ujërat e lagunës së Butrintit bazuar në parametrat e mësipërm vlerësohen me cilësi mezotrofike.
8. Sipërfaqe totale e hapësirave të shfrytëzuara është 5,005,689 m². Bashkia Durrës ka sipërfaqen më të madhe totale prej 1,162,404 m² duke vijuar me Vlorën 716,673m². Kemi një tendencë në rritje të sipërfaqeve të shfrytëzueshme gjatë sezonit turistik 2024 krahasuar me vitin 2023.
9. Rajoni i Gjirit të Drinit vijon të jetë rajon problematik me bilanc negativ. Këtu ka segmente ku mbizotërimi i erozinit ndaj akumulimit është i dukshëm. Kjo zonë ka ndërhyrje të shumta antropogjene dhe ka patur një zhvillim të ndërtimeve dhe veprimtarisë ekonomike turistike.

Këto kanë çuar në zhdukjen pothuaj të plotë të brezave me pisha të mbjella në zonën e Kunes duke prishur mbrojtjen e dunave, dhe duke bërë që veç detit dhe era të kryejë erozionin e saj

10. Gjatë matjeve të deltave të lumenjve janë arritur edhe përfundime mbi erozion akumulimin e kufirit të fushës deltore, që përfaqëson ekstremin e pjesës kontinentale me pjesën nënujore të deltës, përfaqësuar nga fronti i deltës.

4.5 Rekomandime

- Të zgjerohen kapacitetet e Impianteve të Trajtimit të Ujërave Urbane dhe të vendosen në efikasitet të plotë si dhe të merret në konsideratë shtimi i impianteve të reja.
- Të merren masa nga Pushteti Lokal për përmirësimin e sistemimin e ujërave të zeza në zonat e plazheve, për trajtimin e ujërave urbane përpara shkarkimit të tyre në ujërat pritëse.
- Të përmirësohen kushtet higjieno sanitare në disa plazhe të vendit, si në plazhet publike dhe në plazhet që administrohen nga subjektet private, (referuar materialit me sipër)
- Të merren masa nga Pushteti Lokal për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave inerte si dhe mbeturinave urbane në plazhe.
- Të shtohen pikat e monitorimit në bregdetin Shqiptar duke vënë re rritje të hapësirave bregdetare të frekuentuara nga pushuesit (plazhe të rinj). Ky element mund të bëhet i mundur me një grup pune për vlerësimin paraprak të gjendjes aktuale të plazheve të rinj.
- Të informohet publiku nga Pushtetit Lokal mbi cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes dhe të vendosen elemente të sinjalistikës informuese në çdo pikë monitorimi.
- Të informohet me shkresë zyrtare Pushteti Lokal, për praninë e kanaleve dhe derdhjen e tyre në det.
- Me shumë rëndësi është vënia në funksionim me efikasitet të plotë dhe zgjerimi i kapaciteteve të Impianteve të Trajtimit të Ujërave Urbane ekzistuese si dhe ngritja e Impianteve të rinj.

- Të informohet publiku nga Pushtetit Lokal mbi cilësinë e ujërave bregdetarë të larjes dhe të vendosen elemente të sinjalistikës informuese në çdo pikë monitorimi.
- Të merren masa nga Pushteti Lokal dhe subjektet private respektivisht, për vendosjen e nyjeve higjiëno-sanitare.
- Shtimi i sipërfaqes së gjelbëruar përgjatë detit do ishte një ndërhyrje që mendojmë do e zbuste sadopak ritmin e erozionit.

Ndër veprimet që mund të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit detar perfshihen:

- Zhvillimi dhe zgjerimi i zonave të mbrojtura detare
- Zhvillimi i zgjidhjeve të bazuara në natyrë në sistemet bregdetare dhe detare për të mbrojtur biodiversitetin, për të përmirësuar qëndrueshmerinë ndaj ndryshimeve klimatike dhe për të zvogëluar ndikimin e ndotjes.
- Udhëzime për reduktimin e zhurmës nënujore për të mbrojtur gjitarët detarë.
- Zbatimi i Direktivës për Plastikën njëpërdorimshe dhe dokumentit të Ekonomisë Qarkulluese si pjesë e një game të gjerë veprimesh që synojnë reduktimin e mbeturinave dhe plastikës në det.

KAPITULLI 5

TOKAT

5.1 Burimi i të dhënave

Identifikimi, lokalizimi dhe monitorimi i tokave të ndotura nga metalet e rënda. Shkaqet e ndotjes dhe masat që duhet të merren për përmirësimin e tyre është kryer nga Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore. Monitorimi është kryer për metalet e rënda Cd, Fe, Cu, Ni, Pb, Zn, Mn. Qëllimi kryesor është identifikimi i zonave më të ndotura, ku kemi shkallën më të lartë të pranisë së elementeve të metaleve të rënda dhe llojin e tyre.

5.2 Rëndësia

Toka është një komponent thelbësor i mjedisit që luan rol kyç në mbështetjen e jetës së bimëve, kafshëve dhe njerëzve. Cilësia e saj ndikon drejtpërdrejt në prodhimin bujqësor, ruajtjen e biodiversitetit dhe mirëqenien njerëzore. Ndotja e tokës përbën një kërcënim serioz për shëndetin e njerëzve dhe ekosistemet. Tokat janë habitatet më të madh, duke qenë shtëpia e shumicës së të gjitha specieve të gjalla. Ndërsa toka është një ekosistem më vete, ky ekosistem është jetik për shëndetin e bimëve dhe prodhimin bujqësor. Tokat ndikojnë në shumëllojshmërinë e bimëve që rriten dhe faunën që varen nga jeta e bimëve. Gjithashtu është thelbësore për rritjen e bimëve që përdoren për furnizim me ushqim, lëndë djegëse dhe materiale si lëndë të parë. Biota e tokës mund të largojë azotin dhe fosforin nga ekosistemi. Shëndeti i tokës përkufizohet si kapaciteti i vazhdueshëm i tokës për të funksionuar si një ekosistem jetësor që mbështet bimët, kafshët dhe njerëzit. Një tokë e shëndetshme ka veti të mira biologjike, kimike dhe fizike (strukturore). Tokat e shëndetshme duhen shumë vite për t'u formuar, kështu që mbrojtja e shëndetit të tyre është me rëndësi jetike për ekosistemet dhe sistemet ushqimore. Tokat e shëndetshme mbështesin veprimin klimatik. Toka mund të veprojë si një përthithës karboni për të zbutur ndryshimet klimatike dhe tokat e shëndetshme kanë kapacitet më të mirë të mbajtjes së ujit për t'i bërë ballë thatësirave ose për të ndihmuar me menaxhimin e përmytjeve gjatë reshjeve ekstreme dhe ngjarjeve të përmytjeve. Shëndeti i tokës mbrohet duke siguruar që kimia e tokës është në ekuilibrin e duhur, duke ruajtur strukturën dhe biomën e tokës.

5.3 Kontribuesit e ndotjes, presioni dhe ndikimi në mjedis/shëndet

Ndotja e tokës me metale të rënda, sot është kthyer në një problem shqetësues dhe të rëndësishëm mjedisor. Përmbajtja e tyre në tokë mbi normativë, pëbën një rrezik për shëndetin e njeriut, pasi jonet e metaleve mund të absorbohen dhe të kalojnë në organizmin e njeriut, me pluhurat përmes frymëmarrjes, si edhe mund të merren nga konsumi i produkteve ushqimore të ritura në këto toka të kontaminuara. Metalet e rënda të akumuluar në trupin e njeriut në doza më të larta sesa vlerat e lejuara, shkaktojnë probleme kancerogjene, toksike dhe kardiovaskulare.

Për nga origjina e ndotjes së tokës me metalet e rënda mund të dallojmë:

1. Ndotje të ardhur nga origjina e formacionit amnore, me përmbajtje të lartë të elementeve të mineraleve të rënda, të cilët edhe pas alterimit janë të pranishme në formacionin e shfrytëzueshëm të tokës. Për ndryshe këto quhen toka të ndotura me origjinë: antropogjene, litogjenike ose pedogjenike
2. Ndotje të ardhura nga aktivitete industriale, të cilat gjatë aktivitetit të tyre funksionale, paralelisht me prodhimin, emetojnë ndotësit e metaleve të rënda, në ajër në formë të gaztë dhe që gradualisht kthehen në sipërfaqen e tokës në formë të lirë duke u absorbuar nga sipërfaqja e tokës ose nëpërmjet rreshjeve në forma të tretëshme.
3. Ndotje që vijnë si rezultat i shkarkimeve të mbetjeve të lëngëta ose të ngurta në ambient, në trajtë të pa përpunuar ose të trajtuara më pare, për të eliminuar ndotësit e metaleve të rënda.
4. Ndotje që vijnë si rezultat i veprimeve të gabuara të njeriut në mënyrën e keqmenaxhimit, të mbetjeve industrial, natyrës së plehërimit të pa kontrolluar dhe me doza të larta të plehrave me përmbajtje të metaleve të rënda.

Rritja e përmbajtjes së metaleve të rënda në toka, vihet re përgjithësisht në zona me aktivitet të lartë industrial. Industria metalurgjike ka një ndikim të veçantë për shkak se prodhon sasi të madhe gazërash të ndotur dhe mbetje të ngurta, me prani të lartë të metaleve të rënda.

Këto ndotës shkaktojnë akumulimin e metaleve të rënda si plumbi, kadmiumi, zinku dhe nikeli, të cilët janë toksikë për organizmat e gjallë dhe mund të hyjnë në zinxhirin ushqimor.

Faktorët që mund të ndikojnë në shkallen e ndotjes së tokës janë distanca nga burimi i emetimit, drejtimi dhe shpejtësia e erës, shpeshtësia dhe sasia e precipitimit, si dhe veçoritë e tokës. Shumë studime kanë treguar se aktivitetet industriale ndikojnë në përqendrimin e metaleve të rënda në këto zona.

Tokat ndihmojnë në rregullimin e klimës dhe cilësisë të ajrit. Tokat mbajnë rezervat më të mëdha të karbonit tokësor dhe janë përthithës të karbonit. Ruajtja e karbonit si karbon organik i tokës është e rëndësishme si përthithës karboni. Tokat mund të jenë burim i gazeve serrë (GHG) si dioksidi i karbonit, metani dhe oksidi i azotit.


Përdorimi i produkteve për mbrojtjen e bimëve dhe produktet plehëruese në sektorin e bujqësisë ka ndikim në cilësinë e tokës. Në vendin tonë sasitë e Produkteve Plehëruese të importuara për vitin 2024 janë: 125.974 ton dhe 128.869 litra ndërsa Sasitë e Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve të importuara për vitin 2024 rezultojnë se janë: 913.266 ton dhe 442.796 litra

Faktorët ekonomikë dhe socialë që lidhen me ndotjen e tokës përfshijnë:

- Kostoja e lartë për rehabilitimin e tokave të ndotura.
- Ndikimi negativ në prodhimin bujqësor dhe të ardhurat e fermerëve.
- Rreziku për shëndetin publik dhe shpenzimet shëndetësore të lidhura me ndotjen.

5.4 Vlerësimi i gjendjes

- *Stacionet e monitorimit*



Rrjeti i monitorimit përfshin 25 stacione monitorimi: Topojan, Karavasta, Liqenas, Theth, Butrint, Sirian, Karaburun, Kutë, Miras, Dritaj, Klos, Koplik, Ishull Lezhe, Himarë, Lapani, Goricë, Dajti, Rrotull, Gjegjan, Tepelene, Vodicë, Dumre, Lin, Qarisht, Zogaj.

- *Treguesit kryesorë*

Kadmium (Cd): Metal i rëndë shumë toksik që grumbullohet në organizma dhe ndikon në shëndetin e tyre.

Plumbi (Pb): Element toksik që prek sistemin nervor dhe metabolizmin e kalciumit.

- Bakri (Cu):Mikronutrient esencial, por në përqendrime të larta bëhet toksik.
- Zinku (Zn):Element esencial, por mund të ndikojë negativisht në nivele të larta.
- Nikel (Ni):Element me ndikime toksike dhe alergjike në organizma.
- Mangani (Mn):Element esencial për bimët, por i dëmshëm në sasi të mëdha.
- Hekuri (Fe):Element thelbësor për jetën, por prania e tepruar mund të ndikojë negativisht në cilësinë e tokës.

5.4.1. Vlerësimi për stacionet e monitorimit

Monitorimi i tokave përfshin vlerësimin e burimeve të ndotjes dhe ndikimeve të mundshme në mjedis nëpërmjet matjeve të përqendrimeve të metaleve të rënda në thellësi të ndryshme (0-30 cm, 30-60 cm, dhe 60-100 cm) dhe krahasimin e rezultateve me limitet e lejuara për çdo element.

▪ Stacioni i Topojanit (DIBËR)

Kjo pikë është në anën e majtë të rrugës nacionale Topojan – Maqellarë me një devijancë të vogël nga rruga. Terreni është kodrinor me thyerje të lehta, me lartësi mbi nivelin e detit 482 m. Bimësia është spontane, dominojnë bimësia tipike e një livadhi polifit dhe në anët e kodrës gjenden dushku dhe bimësi shkurresh shumëvjeçare, shqop, marre etj. Mostrat janë marrë në thellësi 0 – 30 m dhe 30 – 60 m. Toka vjen në ngjyrë të kuqerremtë, vërehet dominancë argjile, me pak prezencë gurësh. Toka është e pakultivuar, aktualisht livadh.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
TOPOJAN	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.90	2.01	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.73	2.34	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.9	0.9	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	3.8	4.4	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.91	2.08	-

	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.71	1.9	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	39.5	42.0	-

▪ Stacioni i Karavastasë

Kjo pikë ndodhet në perëndim të lagunës së Divjakës, mes lagunës dhe detit, lartësia mbi nivelin e detit 3 metra. Bimësia është tipike bregdetare, në bimësinë e lartë vërehet pisha e butë dhe shelgu ndërsa në bimësinë e ulët dallohen bimësia tipike e tokave të kripura si kripsi, pira, kallamioshtja etj. Vendi ku u morën mostrat ishte tokë aluvionale me dominancë rëre dhe me prani lagështire të lartë. Disa metra në të djathtë të pikës së marrjes së mostrës fillon laguna e Karavastasë.

VENDI	TREGU ESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Karavasta	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.82	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.63	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	1.08	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	3.65	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.91	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.91	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	38.5	-	-

▪ Stacioni i Liqenasit (KORÇË)

Kjo pikë gjendet në anën e djathtë të Fshatit Liqenas, në një fushë aluvionale në jug – lindje të liqenit të Prespës. Toka është me një strukturë të uniformizuar, skeletike me prezencë gurësh të vegjël. Bimësia është e kultivuar, parcela ku u morën mostra ishte e mbjellë me fasule. Bimësia përreth është shumë e larmishme, pasi kushtet dhe toka e lejonin këtë gjë. Në fund të parcelave të sistemuara fillojnë pyjet e ulta në dominancë dhe shkurret shumë vjeçare. Toka vjen në ngjyrë të errët dhe shtrihet në lartësinë 850 metra mbi nivelin e detit.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
LIQENAS	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.8	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.4	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.6	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.0	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.07	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.0	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	17.5	-	-

▪ Stacioni i Thethit (Shkodër)

Kjo pikë ndodhet në luginën e Thethit në pjesën veriore të saj, në të djathtë të lumit të Thethit në një tokë të sistemuar, në pjerrësi rreth 10 deri në 15 %.. Bimësia në pikën e marrjes së mostrës është tipike livadhore, përbri kemi toka gurishtore, të krijuara nga rrëshqitjet e vazhdueshme nga malet. Jo shumë larg nga pika e marrjes së mostrës fillojnë pyjet e larta kryesisht me Ah dhe më pishë të larta. Në zonën përreth kemi edhe bimë të kultivuar si qersh, kumbull apo dardhë. Lartësia mbi nivelin e detit e pikëmarrjes së mostrës është 944 metra.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
TETH	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.9	0.7	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.8	1.0	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.7	0.6	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.4	1.5	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	2.11	0.9	-

	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.6	1.1	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	23	34	-

▪ Stacioni i Butrintit, Sarandë

Kjo pikë ndodhet 106 metra mbi nivelin e detit, .në anën e majte të rrugës Sarandë – Ksamil, në anën me ekspozicion nga lindja dhe përballë Lagunës së Butrintit. Terreni është i pjerrët me prezencë shkurresh të ulta si shqop, bush, mështekna, muriz, kace, dëllinjë, pishë të butë etj dhe bimë barishtore si festuk, gram, sherebel, gjëmbaç etj.Formacioni është shkëmborë me prezencë të pakët dheu, vetëm në pjesën e sipërme të krijuar si rezultat i alterimeve të ndodhura ndër shekuj.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Butrint	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.15	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.48	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.50	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.20	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.8	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.33	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	14.2	-	-

▪ Stacioni i Sirian, Përmet

Kjo pikë ndodhet në krahun e djathtë të rrugës që të con për tek dogana e Tre Urave rreth 600 – 700 metra para. Pika ndodhet në fushë që aktualisht kultivohej dhe ishte e mbjellë me tërshërë, që ishte e korrur. Toka aluvionale e kuqëremtë me prani gurrësh është e sheshtë. Lartësia mbi nivelin e detit rreth 340 metra mbi nivelin e detit. Bimësia për rreth tipike e tokave aluvionale, me bimësi të egra

dhe të kultivuara që i lejon lartësia mbi nivelin e detit dhe temperaturat respektive të brezit klimatik. Bimësia e lartë është e përfaqësuar me shkurret e ulta tipike të zonës, që fillojnë që në fillimet e parcelave në anën veriore mbi rrugën nacionale që të çon tek dogana.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30- 60	60-100
Sirian	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.07	0.06	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.84	0.92	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.51	0.45	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	3.30	3.45	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.36	0.36	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.02	0.76	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	11.5	8.0	-

▪ Stacioni i Karaburunit

Kjo pikë është në Gadishullin e Karaburunit, në një tokë me më shumë formacion shkëmborë, tipik gëlqeror, karbonat dhe bikorbonat kalciumi. Bimësia e varfër, më shumë dominojnë bimësia graminore dhe sherebela, çaji i malit, trumza, etj. Ndërsa në bimësinë e lartë dominojnë shkurret e ulëta shumëvjeçare. Prania e dherave është me pakicë, krijuar nga alterimet për shumë e shumë vite, gjë që krijon pak mundësi për aftësi ujëmbajtëse, dhe për pasojë pak llojshmëri në bimësi. Mostrat janë marrë në dy thellësi në 0 – 30 cm dhe në 30 - 60 cm.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Karaburun	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.81	0.78	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.43	0.4	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.64	0.65	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.2	1.1	-

	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.7	1.8	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.2	2.1	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	17.8	17.85	-

▪ Stacioni i Kutës

Kjo pikë shtrihet në pjesën perëndimore dhe jug –perëndimore të fshatit Kutë të Mallkastrës, në afërsi të lumit të Vjosës. Tokat janë tipike aluvionale të sheshta pjellore dhe me aftësi të lartë ujëmbajtëse.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Kute	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.75	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.35	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.62	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.06	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.12	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.02	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	17.15	-	-

▪ Stacioni i Mirasit

Kjo pikë ndodhet në të dalë të fshatit Miras duke hyrë në fshatin Çetë, mbi rrugën nacionale, në veri të saj, në një pllajë të sistemuar dhe nën kulturë. Bimësia në vendin e marrjes ishte jonxhë dhe për rreth kishte parcela të mbjella me qershi, mollë dhe arra. Në distancë jo shumë të madhe në kodrat përreth dallohen pyje me dushk dhe më në lartësi pisha. Toka me ngjyrë të kuqerremtë në të murrme, duket se ka përmbajtje mesatarisht të lartë argjile. Mostrat u morën në thellësinë 0 – 30 cm.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.78	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.41	-	-

Miras	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.64	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.09	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.07	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.06	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	16.53	-	-

▪ Stacioni i Dritaj

Kjo pikë ndodhet jo shumë larg degëzimit që del nga Qukësi në drejtim të Mokrës, rreth 50 metra mbi rrugën Qukës – Qafë – Plloçë. Pika e marrjes së mostrës ndodhet në fund të një kodre shumë afër rrugës nacionale. Toka është një tokë tipike livadhore me ngjyrë të kuqëremt, pa prani gurësh, dhe me dominancë argjile. Bimësia për rreth pikës është tipikja e zonës, kemi dhe toka të kultivuara dhe pyje të ulta në afërsi dhe që vijnë me pyjet e larta në distancë. Mostra u mor në thellësinë 0 – 30 cm, në lartësinë 440 metra mbi nivelin e detit.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Dritaj	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.30	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.53	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.41	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	13.0	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.62	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.73	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	10.9	-	-

▪ Stacioni Ishull Lezhë

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMIT ET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Ishull Lezhë	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.78	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.95	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.28	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.35	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.49	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.22	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	5.1	-	-

Kjo pikë ndodhej në pothuajse në fund të rrugës që të con drejt ishull Lezhës, afër detit. Në dy anët e pikës kemi lagunën e ishullit të Lezhës. Për rreth pikës kemi bimësinë e lartë, pishë të butë dhe shelig, ndërsa bimësia e ulët është tipike e zonave moçalike, kallamishte etj. Toka është aluvionale me ngjyrë të errët dhe me përmbajtje të lartë të limit dhe rërës.Mostra u mor në thellësinë 0 – 30 cm.

▪ Stacioni i Klosit

Kjo pikë ndodhet në lindje të Klosit, në rrugën që të çon në fshatin Pleshë, në kthesën e dytë , poshtë rrugës rreth 50 m. Pika është në pyll, bimësia e ulët është tipike e një livadhi polifit dhe bimësia e lartë është dushk i lartë në formë lisi. Toka është me përmbajtje të lartë argjile, me ngjyrë të murrme dhe në thellësi më të kuqeremhtë, që tregon që në pjesën e sipërme kemi veprim dhe të faktorëve atmosferik. Mostra e tokës u mor me bel në thellësinë 0 – 30 cm.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.80	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.98	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.26	-	-

Klosi	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.3	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.55	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.25	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	5.3	-	-

▪ Stacioni Koplik

Kjo pikë ndodhej në pjesën perëndimore të Koplikut, afër fundit të rrugës malit Everest, në drejtim të liqenit të Shkodrës. Pika ndodhej në një parcelë të kultivuar, të mbjellë me jonxhë. Toka është skeletike, tipike e zonës së Koplikut, me prani gurrësh, nga formacione gëlqerore. Mostra në këtë pikë është marrë në thellësinë 0 – 30 cm.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60- 100
Koplik	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.75	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.35	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.62	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.06	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.12	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.02	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	17.15	-	-

▪ Stacioni Himarë

Kjo pikë ndodhet në të hyrë të Himarës kur vjen nga Vlora, poshtë kalasë së Himarës dhe kishës. Ajo ndodhet në një parcel të mbjellë me ullinj shekullor. Bimësia e ulët përfaqësohet nga graminoret, ferëzat e buta, çaj, sherebel etj. Në drurët e mëdhenj dallohet ulliri, lisi rapi, etj. Toka ishte me ngjyrë të errët dhe me përmbajtje të lartë humusi. Toka dukej e ekuilibruar në përbërjen mekanike mes argjilës dhe rërës. Pika e marrjes ndodhej rreth 15 metra mbi nivelin e detit.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Himara	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.80	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.98	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.26	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.3	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.55	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.25	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	5.3	-	-

▪ Stacioni Lapani

Kjo pikë ndodhet mbi urën e Lapanjtit, në anën e djathtë të lumit të Osumit, në një sipërfaqe të zhveshur dhe djerrë. Toka ishte deri diku skeletike, me ngjyrë të kuqeremhtë. Bimësia përreth në pikën e marrjes është bimësi e ulët e përfaqësuar nga bimët barishtore, graminore, ferëza, lakra të egra, gjëmbaçi, trumëza etj. Në afërsi të pikës shfaqen edhe bimësia e lartë e identifikuar me shkurret shumëvjeçare si shqopa, mareja, kaça, fera dëllinja etj. Pika e marrjes shtrihet në lartësinë rreth 400 metra mbi nivelin e detit.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Lapan	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.67	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.46	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.83	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.2	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.17	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.1	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	15.5	-	-

▪ Stacioni Goricë

Kjo pikë ndodhet në mes të një fushe të punuar, kultivuar dhe mbjell me fasule. Ajo ndodhet në lindje-perëndim të Fshatit Goricë, në afërsi të liqenit të Prespës. Toka ishte aluvionale e ekuilibruar, me prezencë edhe të gurëve dhe me ngjyrë të murme në të kuqeremtë. Bimësia në pikën e marrjes është fasule dhe përreth saj të gjitha bimësitë e kultivuara dhe të egra, tipike të brezit klimatik. Më në distancë aty ku fillon edhe ngritja drejt malit, ndodhen bimësia e shkurreve të egra shumëvjeçare, shqopë, mare, dëllinjë, mështekna dhe më në lartësi vjen, dushk, pishë dhe më në lartësi kullotë alpine.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Goricë	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.09	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.98	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.53	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.90	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.57	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.82	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	23.4	-	-

▪ Stacioni i Dajtit

Kjo pikë ndodhej në Malin e Dajtit, mbi lokalin Panorama pa vajtur në pikën e teleferikut, mbi rrugën nacionale afër pikës së vjetër të magazinave të pyjores. Toka ishte me pranitë e gureve mbi mesatare, me dominancë guri me përmbajtje magnezi dhe gëlqeror. Toka ishte me ngjyrë të errët, si rezultat i dekompozimeve në vite, të produkteve me prejardhje organike. Bimësia e ulët është bimësia tipike e livadheve polifit, ndërsa bimësia e lartë i ka të gjitha, nga shkurret shumëvjeçare deri tek ahu dhe pisha. Lartësia e pikës së marrjes së mostrës ishte rreth 1060 metra mbi nivelin e detit.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.12	-	-

Dajt	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.51	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.20	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	2.00	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.66	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.51	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	5.1	-	-

▪ Stacioni Rrotull (Durrës)

Kjo pikë ndodhej në gadishullin e Kepit të Rodonit në veri-perëndim të fshatit Shën Pjetër në fillimin e ngritjes së lartësisë nga niveli i detit rreth 20 m mbi nivelin e detit, në një bimësi me shkurre shumëvjeçare dhe bimësi barishtore graminore, gjëmbaçi etj. Toka ka ngjyrë të errët. Në këtë pikë janë marë dy mostra në thellësi 0 – 30 cm dhe 30 – 60 cm.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30-60	60-100
Rrotull	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	2.30	2.30	
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.22	1.12	
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.44	0.37	
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	2.63	2.3	
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.59	0.58	
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.21	1.12	
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	10.5	10.6	

▪ Stacioni Gjegjan

Kjo pikë ndodhet afër qendrës së Gjegjanit, mbi spitalin e zonës, në një parcelë të mbjellë me jonxhë dhe në afërsi të një blloku të vogël me mollë. Terreni është i rrafshët, i sistemuar. Toka është e ekuilibruar me ngjyrë të kuqëremtë. Pika ndodhet rreth 350 metra mbi nivelin e detit.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 – 60	60-100
Gjegja n	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.63	-	-
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.47	-	-
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	2.63	-	-
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	1.09	-	-
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	1.71	-	-
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	2.07	-	-
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	18.25	-	-

▪ Stacioni Tepelenë

Kjo pikë ndodhet në të djathtë të rrugës për në Përmet, sapo kalon urën e Leklit mbi lumin Drino në drejtim të Këlcyrës. Toka ku është pika e marrjes së mostrës është e punuar dhe e mbjellë me hasëlle. Është e sistemuar e sheshtë dhe me prezencë të lehtë gurësh. Ngjyra është e kuqëremtë në të errët, lartësia mbi nivelin e detit është rreth 150 metra. Bimësia e ulët përfshin pothuajse të gjitha bimët e kultivuara dhe ato të livadheve polifite. Bimësia e lartë fillon me shkurret shumëvjeçare, pemët frutore dhe me në lartësi me dushkun dhe pishën.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Tepelenë	Cd	mg/kg tokë e thatë	3	0.07	0.07	0.075
	Fe	mg/kg tokë e thatë	3	0.27	0.32	0.34
	Cu	mg/kg tokë e thatë	140	0.56	0.56	0.58
	Ni	mg/kg tokë e thatë	75	2.30	2.55	2.55
	Pb	mg/kg tokë e thatë	300	0.4	0.4	0.4
	Zn	mg/kg tokë e thatë	300	1.25	1.28	1.28
	Mn	mg/kg tokë e thatë	1000	12.6	12.4	13.4

▪ Stacioni Vodicë

Kjo pikë ndodhej në një parcel të mbjellur me misër dhe fasule, pranë një shtëpie private. Toka ishte me ngjyrë të kuqërremtë në të murrmë. Kishte prani gurësh në sasi jo shumë të madhe. Bimësitë janë si të kultivuara dhe të egra tipike të zonës. Ndërsa bimësia e lartë është shumë e larmishme, ku mund të përmendim të gjitha bimët frutore të kultivuara: ullinj, fik, arra, hardhi etj.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Vodicë	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.57	0.59	0.52
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.26	0.31	0.32
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.56	0.56	0.58
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	2.42	2.55	2.55
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.4	0.4	0.4
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.25	1.27	1.28
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	12.6	12.4	13.4

▪ Stacioni Dumre

Kjo pikë ndodhet afër Liqenit të Mesit, në anën jugore të tij, në një parcelë të mbjell me ullinj, në veri të Fshatit Çestije. Toka ishte me ngjyrë të kuqërremtë, me prezencë të vogël gurësh. Bimësia ishte e shumë larmishme si me bimë barishtore të kultivuara dhe të egra. Bimësia e lartë po ashtu ishte e shumëllojtë: ullinj, mollë, kumbulla etj nga të kultivuarat drizë, manafërë, dushk etj nga të egrat.Lartësia mbi nivelin e detit të pikëmarjes së mostrës 115 metra.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 – 30	30 - 60	60-100
Dumre	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.75	1.08	1.50
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.98	1.12	1.13
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.39	0.46	0.65
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	0.9	0.7	1.3
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.93	0.93	0.90

	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.98	0.57	0.57
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	8.5	6.3	9.5

▪ Stacioni Lin (Pogradec)

Kjo pikë ndodhej në gadishullin e vogël në lindje të fshatit Lin rreth 40 metra poshtë pikës arkeologjike të mozaikut. Ndodhej në një zonë të zhveshur dhe me ekspozicion mbi liqenin e Ohrit me pamje nga Struga dhe Ohri. Bimësia e ulët, graminoret e egra, trumza, tymthi etj. Bimësia e lartë, në afërsi të pikës, drurë frutor të ndryshëm dhe në të egrat përmendim dushkun, dëllënjën, shqopën etj.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60 - 100
Lin	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.75	1.08	1.50
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.16	1.18	1.19
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.39	0.46	0.65
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	0.9	0.7	1.3
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.93	0.93	0.90
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	0.98	0.57	0.57
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	8.5	6.3	9.5

▪ Stacioni Qarisht Librazhd

Kjo pikë ndodhet në afërsi të shkollës së Qarishtës, në një lëndinë të pa mbjellur dhe djerrë pothuajse livadh, por me prani gurësh. Toka është e kuqërremtë, me prani gurësh. Bimësia e ulët është tipike e livadheve polifite, me graminore, trumz, festukë, gjëmbaç etj. Ndërsa bimësia e lartë është nga shkurret shumëvjeçare deri tek pisha dhe ahu.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	0.57	0.59	0.52
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	1.66	1.71	1.72

Qarisht	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.74	0.75	0.78
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	4.42	4.55	4.55
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.4	0.4	0.4
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.22	1.22	1.23
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	14.6	14.4	14.4

▪ Stacioni Zogaj

Kjo pikë ndodhet në anën perendimore të Fshatit Zogaj, në një zonë me shkurre shumëvjeçare shqopë, mare, bush, dëllinj etj. por dhe me prani të lisit dhe ullinjve shumëvjeçarë. Toka është me ngjyrë të errët e kuqëremtë në të erët. Masivi është shkëmb gëlqeror dhe në afërsi të sipërfaqes, shumë hërë i dukshëm.

VENDI	TREGUESIT	NJ. MATJES	LIMITET	REZULTATET		
				0 - 30	30 - 60	60-100
Zogaj	Cd	mg/ kg tokë e thatë	3	1.47	1.49	1.44
	Fe	mg/ kg tokë e thatë	3	0.23	0.21	0.22
	Cu	mg/ kg tokë e thatë	140	0.56	0.56	0.58
	Ni	mg/ kg tokë e thatë	75	2.42	2.55	2.55
	Pb	mg/ kg tokë e thatë	300	0.35	0.37	0.38
	Zn	mg/ kg tokë e thatë	300	1.27	1.29	1.28
	Mn	mg/ kg tokë e thatë	1000	12.56	12.44	12.38

5.5 Vlerësim përmbledhës

Vlerësimi për mostrat në një thellësi:

Më poshtë paraqitet tabela përmbledhëse e disa pikave ku marrim mostra në një thellësi me treguesit përkatës të dalë pas kryerjes së analizave dhe limiteve të tyre sipas standarteve të lejuar.

Tabela 41 - Vlerësim për mostrat në një thellësi

Treguesit	Limiti	Himara	Liqenas	Gjegjan	Dajt	Goric	Lapan	Kute	Dritaj	Butrint
Cd	3	1.80	0.8	0.63	0.12	0.09	0.67	0.75	1.30	1.15
Fe	3	0.98	0.4	1.47	0.51	0.98	0.46	0.35	1.53	0.48
Cu	140	0.26	0.6	2.63	0.20	0.53	0.83	0.62	0.41	0.50
Ni	75	1.3	1.0	1.09	2.00	1.90	1.2	1.06	13.0	1.20
Pb	300	0.55	1.07	1.71	0.66	0.57	1.17	1.12	0.62	0.8
Zn	300	0.25	2.0	2.07	0.51	0.82	2.1	2.02	0.73	1.33
Mn	1000	5.3	17.5	18.25	5.1	23.4	15.5	17.15	10.9	14.2

Siç shikohet edhe nga tabela nuk kemi ndotje nga metalet e rënda në asnjë pikë të studiuar, janë të gjitha nën limite. Vetëm në disa pika, për disa element, janë afër ndotjes mesatare, siç është rasti i Cd në pikat Himarë, Dritaj dhe Butrint. Lidhur me elementin Fe, të gjitha pikat janë brenda limiteve të lejuar dhe afër mesatares së ndotjes, në pikat Gjegjan dhe Dritaj. Elementet e tjerë janë të gjitha brenda limiteve dhe me vlera shumë minimale.

Vlerësimi për mostrat në dy thellësi:

Tabela përmbledhese më poshtë paraqet rezultatet e treguesve për mostrat e marra në dy thellësi.

Tabela 42 - Vlerësimi për mostrat në dy thellësi

Treguesit	Limiti	Topojan		Theth		Sirian		Karaburun		Rrotull	
		0-30	30-60	0-30	30-60	0-30	30-60	0-30	30-60	0-30	30-60
Cd	3	1.90	2.01	0.9	0.7	0.07	0.06	0.81	0.78	2.30	2.30
Fe	3	1.73	2.34	0.8	1.0	0.84	0.92	0.43	0.4	1.22	1.12
Cu	140	0.9	0.9	0.7	0.6	0.51	0.45	0.64	0.65	0.44	0.37
Ni	75	3.8	4.4	1.4	1.5	3.30	3.45	1.2	1.1	2.63	2.3
Pb	300	1.91	2.08	2.11	0.9	0.36	0.36	1.7	1.8	0.59	0.58

Zn	300	1.71	1.9	1.6	1.1	1.02	0.76	2.2	2.1	1.21	1.12
Mn	1000	39.5	42.0	23	34	11.5	8.0	17.8	17.85	10.5	10.6

Referuar vlerave te treguesve sipas zonave, rezulton që nuk kemi ndotje mbi normë. Ndotje mbi mesatare kemi vetëm për Cd në pikën Rrotull me 2.3 mg/100gr tokë të thatë, por dhe kjo nën limitin prej 3 mg/100 gr tokë të thatë. Për elementin Fe po ashtu nuk kemi ndotje mbi limite por shkon drejt ndotjes mesatare vetëm në pikën Topojan të Dibrës me 1.73 deri në 2.34 në thellësinë 30 – 60 cm ndërsa pikat tjera janë nën limitet e lejuara me tregues shumë të lehtë ndotës.

Vlerësimi për mostrat në tre thellësi:

Për të parë diagramën e lëvizjes së treguesve në thellësi marrim parasysh rezultatet në tabelën përmbledhëse të mëposhtme e tre pikave dhe treguesve të dalë pas kryerjes së analizave, në tre thellësi.

Tabela 43 - Vlerësimi për mostrat në tre thellësi

Treguesit	Tepelena			Zogaj			Qarisht		
	0 - 30	30 - 60	60-100	0-30	30-60	60-90	0 - 30	30 - 60	60-100
Cd	0.07	0.07	0.075	0.47	0.49	0.44	0.57	0.59	0.52
Fe	0.27	0.32	0.34	0.23	0.21	0.22	0.66	0.71	0.72
Cu	0.56	0.56	0.58	0.56	0.56	0.58	0.74	0.75	0.78
Ni	2.30	2.55	2.55	2.42	2.65	2.65	4.42	4.55	4.55
Pb	0.4	0.4	0.4	0.35	0.37	0.38	0.4	0.4	0.4
Zn	1.25	1.28	1.28	1.27	1.29	1.28	1.22	1.22	1.23
Mn	12.6	12.4	13.4	12.56	12.44	12.38	14.6	14.4	14.4

Duke parë me kujdes tabelën e mësipërme, rezulton që nuk kemi ndotje të tokave të studiuara, me metalet e rënda. Ndërsa po të shohim ndryshimin e treguesve në thellësi, vërehet një rritje e lehtë të treguesve, gjë që tregon që prania e këtyre elementeve në tokë vjen nga tokformimi, pra rezultat i faktorëve antropogjen.

Diagrama e lëvizjes së elementeve
Tepelenë, Qarisht dhe Zogaj në tre thellësi




Figura 180 - Ndryshimi i përmbajtjes së elementeve në tre thellësi

5.6 Konkluzione

Referuar vlerave të treguesve të analizuar dhe krahasuar me limitet e tyre në përputhje me standartet e BE-së, rezulton se: Në të gjitha mostrat e analizuara në stacionet përkatëse, treguesit e analizuar janë nën limitet e ndotjes, gjë që tregon që nuk kemi ndotje, dhe nuk kemi rrezik as për ambientin dhe as për popullatën.

Duke parë me vëmendje treguesit e elementeve të veçantë shikojmë që në vende të veçanta kemi tregues të ndryshëm, psh. hekuri ka tregues më të lartë në pikat e monitorimit të Gjegjanit, Qarishtës, Dritajt dhe Linit edhe me sy të lirë toka në këto pika është e kuqërremtë e theksuar, në ndryshime në pikat e tjera.

Në rastet kur janë marrë dy apo tre thellësi, vërehet që treguesit edhe pse janë nën limitet dhe nuk përbëjnë rrezik, tregon se këto metale janë në tokë si rezultat i prezencës së tyre në shkëmbin amnor dhe të ngelur të pranishëm edhe pas fenomeneve tokëformues. Kjo vërtetohet edhe nga ndryshimi në thellësi me një tendencë minimale.

KAPITULLI 6

MBETJET

6.1 Burimi i të dhënave

Mbetjet kthehen në një burim me vlerë kur menaxhohen siç duhet. Zbatimi i hierarkisë së mbetjeve përmes parimit të 3R-ve (Reduktim, Ripërdorim, Riciklim) sjell përfitime ekonomike dhe mbron mjedisin si edhe shëndetin e njeriut.

Institucionet shtetërore, pavarësisht kufizimeve dhe vështirësive, janë të angazhuara për të grumbulluar dhe raportuar të dhënat për mbetjet. Institucionet kryesore të përfshira në sigurimin e të dhënave janë:

- Agjencia Kombëtare e Ekonomisë së Mbetjeve
- Njësitë e Qeverisjes Vendore
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Bazuar në informacionin e mbledhur, ky raport synon të ofrojë një pasqyrë më të plotë të transfertave, përbërjes dhe praktikave të menaxhimit të mbetjeve në të gjithë vendin.

6.2 Rëndësia

Mbetjet e ngurta janë materiale, produkte ose pjesë të tyre që nuk kanë më vlerë përdorimi për pronarin dhe ai ka ndërmend t'i hedhë. Këto materiale konsiderohen mbetje për aq kohë sa materialet e nxjerra ose energjia e prodhuar nuk përfshihen në procesin e prodhimit.

Menaxhimi i mbetjeve është një proces thelbësor për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut, i cili përfshin një zinxhir aktivitetesh që nga grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve, deri te trajtimi, riciklimi dhe asgjësimi i tyre.

Përveç aspekteve teknike, menaxhimi i mbetjeve lidhet ngushtë edhe me ndërgjegjësimin e publikut dhe kuadrin ligjor. Politikat e duhura dhe edukimi mjedisor janë elementë thelbësorë për të siguruar pjesëmarrje aktive dhe për të promovuar praktikatat më të mira të disponueshme dhe miqësore me mjedisin.

Një ekonomi qarkulluese mban burimet dhe materialet në përdorim për sa më gjatë që të jetë e mundur dhe mund të ulë ndjeshëm emetimet nga aktivitetet nxjerrëse, bujqësore dhe industriale.

6.3 Kontribuesit kryesor, presionet dhe ndikimi në mjedis/shëndet

Shkalla e lartë të nxjerrjes së materialeve/ burimeve kontribuon në humbjen e biodiversitetit, ekosistemeve dhe ndryshimin e përdorimit të tokës. Shkalla e lartë e gjenerimit të mbeturinave dhe riciklimi i ulët i tyre është faktor tjetër që ka efekt negativ në mjedis.

Shkalla e lartë e gjenerimit të mbeturinave dhe riciklimi i ulët i tyre është një tjetër faktor që ndikon negativisht në mjedis. Tendenca në rritje e gjenerimit të mbeturinave dhe pamundësia për t'i trajtuar të gjitha brenda vendit ka nxitur eksportimin e tyre për trajtim jashtë vendit.

Shkalla e lartë e konsumit të materialeve çon në rritje të gjenerimit të mbetjeve.

6.4 Vlerësimi i gjendjes

6.4.1 Treguesit e ekonomisë qarkulluese

AKEM është krijuar me VKM-ne Nr.132, date 6.3.2024 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së mbetjeve”, ndryshuar me VKM-ne Nr.228, datë 17.04.2025 "Për disa shtesa në vendimin nr.132, datë 6.3.2024", të Këshillit të Ministrave”.

Ky institucion koordinon dhe monitoron bashkitë për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane dhe grumbullon raportimet e tyre për sasinë e mbetjeve të gjeneruara dhe të grumbulluara, nëpërmjet sektorit të statistikave.

Shqipëria është në fazat e para të kalimit në ekonominë qarkulluese. Dokumenti i përgatitur nga OECD, “Roadmap towards Circular Economy in Albania”, synon të udhëzojë Shqipërinë në zhvillimin e politikave për një ekonomi qarkulluese, duke u fokusuar në forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe bashkëpunimin me palët e interesuara për të nxitur tranzicionin.

Dokumenti ka përcaktuar një sërë indikatorësh që paraqiten në Tabelën 1.

Tabela 44 - Treguesit e Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkulluese

Treguesi ¹	Përshkrim i	Lidhja me rekomandimin	Burimi ²	Vlera e treguesit – Shkurt 2024 (të dhënat e disponueshme)
Instrumentet ekonomike				
Të ardhurat nga taksat ose kursimet e gjeneruara nga instrumentet fiskale të lidhura me ekonominë qarkulluese	Shuma (ALL)	Zbatohet për të gjitha rekomandimet që lidhen me instrumentet fiskale	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nuk janë planifikuar të ardhura; Kostot janë: 29–44 mln euro/vit, 456 mln euro deri në vitin 2032 (RIA)
Norma e rikuperimit të mbetjeve të ambalazhit	Raporti i mbetjeve të ambalazhit të		INSTAT/Agjencia Kombëtare e Mjedisit	18.9% në vitin 2022

¹ Treguesit kryesorë të paraqitur në Tabelën 1 shërbejnë si pikë referimi kryesore për monitorimin e përparimit në zbatimin e rekomandimeve të propozuara. Treguesit e paraqitur në këtë tabelë janë plotësues ndaj atyre dhe kapin aspekte shtesë të zbatimit

² Kolona e burimit i referohet institucioneve që tashmë mbledhin të dhëna përkatëse ose atyre që mund të ngarkohen me mbledhjen e këtyre të dhënave në të ardhmen.

	përgatitur a për ripërdori m, riciklim ose rikuperim material ndaj mbetjeve të ambalazhi t të gjeneruara (%)			
Krijimi i një Fondi të Veçantë për Ekonominë Qarkulluese ³	Tregues specifik për monitorim in e krijimit të fondit (po/jo)		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit / Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Jo
Pjesa e të ardhurave të shpërndara në Fondin e Veçantë për Ekonominë Qarkulluese ³	Të ardhurat e mbledhur a nga fondi për zbatimin e Ligjit për EPR (% ose ALL)	Zbatim efektiv i skemave të kthimit sipas përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit (EPR)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit / Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Jo
Krijimi i një programi për mbështetjen e skemave të	Tregues specifik për monitorim	Zbatimi i skemave që ofrojnë shpërblime për	Ministria e Financave; autoritetet vendore	Jo

3

Krijimi i Fondit të Veçantë për Ekonominë Qarkulluese është një masë e parashikuar si pjesë e projektligjit për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit, i cili në momentin e hartimit ishte në konsultim publik, dhe për këtë arsye është subjekt i ndryshimeve.

kredive për ripërdorim dhe riciklim	in e krijimit të programit (po/jo)	largimin nga mbetjet bashkiake për riciklim/ripërdorim		
Landfille të paligjshme	Ndryshimi në numrin e landfillev të paligjshme, sasia e mbetjeve të hedhura në mënyrë të paligjshme (m³)		INSTAT	n/a
Të ardhurat nga taksa mbi landfillin	Shuma (ALL)	Zbatim i zbritjeve në taksën e landfillit për ndarjen më të mirë / rritjen e riciklimit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nuk ka zbritje në taksën e landfillit
Mbulimi me shërbime të grumbullimit të mbetjeve	Përqindja e familjeve që kanë akses në një shërbim të besueshëm grumbullimi të mbetjeve	Rishikimi i tarifave për mbetjet shtëpiake (rritje graduale të tarifave me zbritje për praktikatat e mira të menaxhimit të mbetjeve, promovoni skema me kosto të ulët “paguaj sa hedh” dhe përmirësoni zbatimin e tyre).	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; bashkitë	89,20%
Fushata sensibilizimi për tarifat e mbetjeve	Tregues specifik për monitorim in e zbatimit të		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit; autoritetet vendore	Nga GIZ – Fushata sensibilizimi (665,000 Euro)

	fushatave sensibilizuese kulturore të përshtatshme			
Gjenerimi i mbetjeve	Gjenerimi i mbetjeve bashkiake për frymë (kg për frymë); mbetje për njësi PBB pa përfshirë mbetjet minerale kryesore (kg për 1,000 EUR)		INSTAT	261
Grumbullimi i ndarë	Përqindja e mbetjeve bashkiake të grumbulluara të ndara ndaj totalit të mbetjeve (%); grumbullimi i letërs, metalit, plastikës, qelqit		INSTAT	25,20%

Përdorimi i kompostimit në shtëpi	Mat shkallën e kompostimit në shtëpi		Bashkitë; kërkohej anketime specifike	n/a
Të ardhurat nga taksat për kostot mjedisore dhe te infrastrukturës gjatë sezonit turistik	Përqindja e të ardhurave që mbulojnë kostot mjedisore shtesë (uji, mbetje etj.)	Futja e një takse turistike për kostot shtesë që nuk mbulohen nga taksat ekzistuese	Bashkitë	456 Milion Euro deri në 2032
Nxjerrja e lëndëve të para ne vend	Mijëra ton	Futja e taksave për nxjerrjen e materialeve/plasti kës	INSTAT	Të dhënat nuk janë të disponueshme
Konsumi i materialeve të virgjëra	Sasia e materialeve të virgjëra të përdorura direkt nga ekonomia (mijëra ton)		INSTAT	Të dhënat nuk janë të disponueshme
Prokurimi publik I gjelbër	Përqindja e prokurimit publik të gjelbër në totalin e kontratave (% në vlerë dhe volum)	Futja e prokurimit publik të gjelbër, me fokus në sektorët prioritarë	Zyra e Prokurimit Publik	n/a

Produkte/shërbime me kriterë minimale për përmbajtje të materialeve të ricikluar në prokurim publik	Numri	Futja e kërkesave për përmbajtje të materialeve të ricikluar (letër, plastikë)	Zyra e Prokurimit Publik	n/a
Modelet e biznesit ekonomi qarkulluese për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM-të)				
Buxheti i ndarë për projekte të ekonomisë qarkulluese në një program konkret	Shuma (ALL)	Hapja e thirrjeve për projekte me modele të biznesit ekonomi qarkulluese në kuadër të programeve ekzistuese dhe të reja të financimit që ofrojnë grante dhe kredi të buta. Mbështetja financiare duhet të shoqërohet me asistencë teknike dhe të tjera për NVM-të	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)	14.6 milionë euro nga GiZ
Kurse trajnimi mbi modelet e biznesit rrethor	Numri i aktiviteteve të organizuara;		AIDA	n/a
	numri i moduleve teknike të krijuara si pjesë e programeve të financimit.			
NVM-të që përfitojnë mbështetje financiare për krijimin e modeleve të reja të biznesit ekonomi qarkulluese	Numri i NVM-ve		AIDA	n/a
NVM-të që përfitojnë mbështetje jo-financiare për krijimin e modeleve të	Numri i NVM-ve		AIDA	n/a

reja të biznesit rrethor				
NVM-të që përkrahen nga programe financimi për të shkallëzuar modelet e biznesit ekonomi qarkuluese	Numri i NVM-ve	Marrja në konsideratë e krijimit të një programi të dedikuar për financimin e NVM-ve për të shkallëzuar modelet qarkuluese	AIDA	n/a
Krijimi i një platforme për ekonominë qarkuluese ⁴	Tregues specifik për monitorimin e krijimit të platformës (po/jo)	Krijimi i një platforme për aktorët/stakehold erët e ekonomisë qarkuluese për të forcuar bashkëpunimin, shkëmbimin e informacionit dhe të praktikave të mira ²	Institucioni koordinues (p.sh. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)	n/a
Numri i anëtarëve të platformës ⁴	Numri		Institucioni koordinues (p.sh. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)	n/a
Numri i eventeve/work shopeve të organizuara si pjesë e platformës ⁴	Numri		Institucioni koordinues (p.sh. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit)	n/a
Shpenzimet për kërkim-zhvillim dhe inovacion të	Shpenzimet bruto për kërkim dhe	Mbështetje për bashkëpunimin ndërmjet NVM-ve dhe	Tregues për t'u zhvilluar sipas Eurostat nga	n/a

⁴ Treguesit e lidhur me platformën e aktorëve të ekonomisë qarkuluese mund të ndryshojnë në varësi të formatit të platformës (online, fizike, hibride). Shënim: ALL – Lekë shqiptare.

lidhura me mjedisin nga sektori shtetëror dhe privat	zhvillim (GERD) (%)	akademisë, si dhe bashkëpunim rajonal e ndërkombëtar për kërkim dhe zhvillim (KZh) dhe inovacion ²	Agjencia për Kërkime, Teknologji dhe Inovacion; të dhënat nga Agjencia Kombëtare për Kërkime Shkencore dhe Inovacion ose AIDA	
Evente për ndërlidhje investitor-ndërmarrës	Numri i eventeve	Organizimi i takimeve për ndërlidhje ndërmjet investitorëve dhe sipërmarrësve	AIDA	n/a
Fushata sensibilizimi për ekonominë qarkulluese	Numri i fushatave	Rritja e ndërgjegjësimit për ekonominë qarkulluese dhe modelet qarkulluese të biznesit për NVM-të përmes fushatave shitesë informuese dhe programeve trajnuese, përfshirë shembuj të praktikave të mira dhe mundësi për akses në financime	AIDA, dhomat e tregtisë dhe industrisë	n/a
Ndërgjegjësimi i NVM-ve mbi modelet e biznesit ekonomi qarkulluese	Përqindja e NVM-ve që janë të vetëdijshme për ekonominë qarkulluese		Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (Anketa Balkan Barometer) ose anketë kombëtare	n/a

Fushata sensibilizimi për reduktimin e mbetjeve ushqimore në sektorin e turizmit	Numri i fushatave; numri i restoranteve/hot eleve të përfshira	Vazhdimi i shkëmbimit të praktikave dhe mësimit ndërmjet kolegëve, përfshirë zhvillimin ndër-sektorial të njohurive	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	n/a
Fushata për reduktimin e mbetjeve të tekstilit	Numri i fushatave; numri i bizneseve të përfshira		AIDA ose Ministria e Financave dhe Ekonomisë	n/a
Integrimi i edukimit mbi ekonominë qarkulluese në kurrikulat universitare	Tregues specifik për monitorimin e zbatimit të rekomandimit (po/jo)	Mbështetja e zhvillimit të kapaciteteve dhe aftësive sipërmarrëse si dhe formimit profesional për ekonominë qarkulluese	Ministria e Arsimit dhe Sportit	n/a
Plastika				
Futja e skemave të Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit (PZP) të planifikuara me ligj	Tregues specifik për monitorimin e zbatimit të skemave PZP (po/jo)	Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve në përgjithësi: grumbullimi i ndarë i plastikës (dhe mbetjeve të tjera të ambalazhit) dhe zbatimi i skemës së kthimit sipas përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit për ambalazhet, përfshirë	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	n/a

		ambalazhet plastike		
Numri i qëndrave për grumbullim	Numri i pajisjeve të instaluara për grumbullimin e plastikës	Marrja në konsideratë e futjes së një sistemi kthimi të ambalazheve	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	n/a
Grumbullimi i shisheve plastike	Përqindja e shisheve plastike të mbledhura veçmas ndaj totalit të shisheve njëpërdorimshe të hedhura në treg (%)	plastike me depozitë-rimbursim		n/a
Futja e ndalimit të të gjitha qeseve plastike njëpërdorimshe (harmonizim i plotë me Direktivën e BE për Plastikën Njëpërdorimshe)	Tregues specifik për monitorimin e zbatimit të ndalimit (po/jo)	Futja e taksave dhe/ose ndalimeve për disa produkte plastike njëpërdorimshe	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Po
Tarifat e eko-moduluara brenda PZP për ambalazhet	Tregues specifik për monitorimin e futjes së tarifave (po/jo)	Futja e tarifave të eko-moduluara për ambalazhet plastike	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	n/a
Financim dhe trajnime për teknologji të reja riciklimi	Numri i programeve për inovacion dhe kërkim-zhvillim në fushën e plastikës	Mbështetje dhe zgjerim i inovacionit për materiale plastike më të riciklueshme, teknologji dhe procese të riciklimit	Agjencia Kombëtare për Kërkime Shkencore dhe Inovacion, AIDA, Fondi i Inovacionit	n/a

Shpenzimet publike për kërkimet shkencore të lidhura me riciklimin e plastikës	Shuma (ALL)		Agjencia Kombëtare për Kërkime Shkencore dhe Inovacion	n/a
Aktivitetet sensibilizuese për reduktimin, ripërdorimin dhe riciklimin e plastikës për bizneset	Numri i aktiviteteve	Ndërgjegjësimi dhe edukimi i bizneseve, autoriteteve publike dhe familjeve për parandalimin e mbetjeve plastike, dizajnimi i modeleve të ekonomisë qarkulluese dhe ndotjen (fushata, katalogë, platforma online; integrimi i ekonomisë qarkulluese në programet shkollore)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	n/a
Fushata sensibilizuese dhe edukimi për mbetjet plastike dhe ndotjen detare	Numri i fushatave		Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	n/a
Platforma bashkiake ose rajonale online për parandalimin e mbetjeve plastike	Numri i platformave të krijuara; numri i materialeve dhe burimeve të disponueshme online; niveli i		Autoritetet rajonale ose bashkiake	0

	trafikut në platformë			
Numri i materialeve dhe burimeve online; niveli i trafikut në platformë				0
Numri i studentëve të edukuar/trajnuar në fushat e ekonomisë qarkulluese; numri i aktiviteteve të organizuara lidhur me aktivitetet pedagogjike të ekonomisë qarkulluese			Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë	Bachelori i parë në Ekonomi Qarkulluese në Universitetin e Durrësit – Aplikimi në proces – Përgjigjja pritë në korrik (30–35 studentë në vit)
Strategji me të gjithë elementët e nevojshëm e miratuar (afati kohor, buxheti, institucioni përgjegjës, procesi i konsultimit)	Tregues specifik për monitorimin e miratimit të strategjisë (po/jo)	Hartimi i një strategjie për të frenuar ndotjen nga plastika, përfshirë ndotjen detare nga plastika	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	

Sfidat e Shqipërisë drejt aplikimit të ekonomisë qarkulluese lidhen kryesisht me hartimin e kuadrit ligjor në përputhje me direktivat e BE-së, përdorimin e instrumentave ekonomikë, monitorimin e indikatorëve të ekonomisë

qarkulluese, mbështetjen dhe adoptimin e modeleve qarkulluese të biznesit, si dhe mbylljen e ciklit jetësor të plastikës, me fokus në mbeturinat detare.

Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve 2020-2035 ka përcaktuar si objektiv riciklimin e mbetjeve në 55% deri në vitin 2035. Vendi ynë ka bërë progres në rritjen e shkallës së riciklimit të mbetjeve, nga 18.1% në vitin 2020 në 18.9% në vitin 2022.

6.4.2 Mbetjet Bashkiake

Ky raport paraqet të dhënat e sasisë dhe përbërjes së mbetjeve të gjeneruara gjatë vitit 2024. Qëllimi kryesor i këtij raporti është realizimi i një analizë të thelluar të të dhënave vjetore të mbetjeve, duke identifikuar tendencat, sfidat dhe mundësitë në fushën e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri. Një aspekt i rëndësishëm është gjithashtu evidentimi i mangësive në procesin e mbledhjes dhe raportimit të të dhënave, me qëllim përmirësimin e saktësisë së raportimeve të ardhshme. Rritja e cilësisë së të dhënave është thelbësore për zhvillimin dhe zbatimin e politikave efektive dhe praktikave më të mira në menaxhimin e mbetjeve.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe kalimi në ekonomi qarkulluese mbeten një përparësi urgjente për Shqipërinë. Duke përdorur njohuritë e fituara nga Raporti Vjetor i Mbetjeve për vitin 2024, palët e interesuara në të gjitha nivelet mund të punojnë së bashku për të zhvilluar zgjidhje inovative në reduktimin e mbetjeve, për të promovuar riciklimin dhe efikasitetin e burimeve, dhe për të mbrojtur mjedisin për brezat e ardhshëm.

Për vitin 2024, të gjitha 61 bashkitë kanë raportuar menaxhimin e mbetjeve, ku theksojmë se ka pasur disa mospërputhje në të dhënat e raportuara, dhe kjo paraqet një mundësi për përmirësim në vitet në vijim. Vlerësohet angazhimi i bashkive për të raportuar të dhënat e nevojshme për këtë raport.

Në tabelën e mëposhtme jepet përmbledhje e të dhënave të mbetjeve për vitin 2024.

Tabela 45 - Të dhënat të përgjithshme për mbetjet urbane dhe inerte të menaxhuara

Nr	Bashkia	Totali i mbetjeve urbane (Ton)	Popullsia e rregjisitruar	Popullsia rezidente	% e Mbuluar me Shërbim	Sasia e Mbetjeve në kg/banor/vit	Mbetjet inerte (Ton)
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Shkodër-Lezhë							
1	Fushë Arrëz	2,801.50	10,169	5,000	33	1.54	10.00
2	Kurbin	13,245.00	72,520	49,800	90	0.73	
3	Lezhë	19,962.01	71,456			0.75	
4	Malësi e Madhe	2,679.00	56,123	21,684		0.13	
5	Mirditë	3,878.00	34,623	25,408	75	0.42	900.00
6	Pukë	2,000.00	14,400	6,000	70	0.91	400.00
7	Shkodër	36,666.98	214,270	102,434	98.5	0.98	
8	Vau i Dejës	3,617.96	52,601			0.05	
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Kukës							
9	Has	1,759.64	16,790	15,368	35.2	0.31	
10	Kukës	12,588.10	61,258		70	2.05	
11	Tropojë	2,215.55	28,216	14,189		0.43	

Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Dibër							
12	Dibër	9,425.00	76,143	75,442	81	0.34	857.00
13	Bulqizë	4,200.00	39,451	26,950	75	0.43	600.00
14	Klos	660.00	20,129	19,500	68	0.09	39.00
15	Mat	4,791.00	36,908	33,426	85	0.39	150.00
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Tiranë-Durrës							
16	Durrës	67,564.00	343,558	-	99.99	5.02	2,702.00
17	Kamëz	34,200.00	105,101	96,000		0.98	
18	Kavajë	33,704.00	84,250			0.88	
19	Krujë	21,900.00	45,000			0.71	
20	Shijak	7,800.00	48,654	33,700	99.9	0.63	10.00
21	Tiranë	257,829.00	598,176		100	14.52	
22	Vorë	14,078.00	40,981	25,301	97	1.52	
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Elbasan							
23	Belsh	2,538.60	17,123			0.17	
24	Cërrik	3,659.40	22,163			0.59	

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

25	Elbasan	31,037.30	216,904	170,440	100	0.5	47,381.11
26	Gramsh	2,266.20	33,997		60	0.03	550.00
27	Librazhd	2,877.08	43,646	43,646	73	0.18	
28	Peqin	3,587.10	38,950	27,230	65	0.36	220.90
29	Prrenjas	2,634.50	27,431			0.19	
30	Rrogozhinë	2,936.85	42,732	25,632		0.31	
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Fier							
31	Divjakë	5,610.00	56,401	38,740	95	0.4	
32	Fier	41,512.00	98,210	70,512	100	1.61	1,300.00
33	Lushnje	13,882.09	132,371	63,135		0.6	
34	Mallakastër	8,600.00	38,843	29,878	83.5	0.79	
35	Patos	3,848.19	41,956		80	0.27	237.00
36	Roskovec	3,557.96	32,916	16,332	96	0.6	352.00
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Berat							
37	Berat	20,231.00	99,745			1.68	
38	Dimal	6,679.00	40,398	40,398	95	0.45	162.00

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

39	Kuçovë	8,461.00	55,119	34,100	90	0.68	
40	Poliçan	1,168.00	16,028	8,000	70	0.4	30.00
41	Skrapar	1,521.00	9,267			0.26	
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve – ZM Korçë							
42	Devoll	3,685.00	40,699	-	100	1.09	855.00
43	Kolonjë	1,090.80	18,754	11,070		0.27	300.00
44	Korçë	20,130.00	129,065		95	0.43	108.00
45	Maliq	6,603.00	41,757			0.43	
46	Pogradec	13,243.40	59,834			0.87	
47	Pustec	694.00	5,076	1,843	98	1.03	2.00
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve – ZM Vlora Veri							
48	Selenicë	3,337.00	34,304	34,304		0.27	
49	Vlorë	53,407.00	146,681			1	
Zona e Menaxhimit të Mbetjeve - ZM Vlore Jug-Gjirokaster							
50	Delvinë	1,322.00	17,432	6,500	96	0.56	
51	Dropull	1,800.00	23,000		94	0.28	

52	Finiq	1,647.00	34,000	13,000		0.35	120.00
53	Gjiroka shtë	7,637.00	52,054	33,327	90	0.63	
54	Himarë	6,856.60	13,716			0.36	
55	Këlcyrë	1,209.50	11,138	8,875	64	0.37	300.00
56	Konispo l	1,460.00	13,540	9,843	90	0.41	300.00
57	Libohov ë	1,320.00	6,861	2,765	70	1.31	
58	Memalia j	750.00	18,840	7,000	50	0.29	
59	Përmet	2,520.00	19,272	13,230	68	0.52	
60	Sarandë	15,444.28	57,045	31,199	100	1.36	50,000 .00
61	Tepelen ë	2,555.00	15,111	11,175	82	0.63	400
Total		870,883.59	3,893,156	1,302,376			
Mesatare					82.05	0.92	

Në vitin 2024, janë menaxhuar rreth **870,883.59 ton mbetje**, një rritje krahasuar me vitin e kaluar (2023), ku ishin menaxhuar 820,322 ton mbetje.

Tre bashki urbane, përkatësisht Tirana, Fieri dhe Saranda, raportojnë se shërbimi i pastrimit të mbetjeve mbulon 100% të territorit. Ndërkohë, tre bashkitë rurale me mbulimin më të ulët të territorit me shërbim mbledhjeje mbetjesh janë Fushë-Arrëzi, Hasi dhe Memaliaj, përkatësisht me 22%, 35.2% dhe 50%.

Vetëm 26 bashki kanë raportuar mbi menaxhimin e mbetjeve inerte. Saranda, Elbasani dhe Durrësi janë bashkitë me sasitë më të mëdha të mbetjeve inerte nga ato që kanë raportuar. Bashkia e Tiranës nuk ka raportuar për mbetje inerte.

Sasitë e mbetjeve për çdo Zonë Mbetjesh

Tabela dhe grafiku i mëposhtëm ofrojnë një pamje të plotë, në nivel qyteti dhe zone, të flukseve të mbetjeve urbane në Shqipëri për vitin 2024, i përpunuar nga tabela e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM).

Tabela 46 - Mbetjet sipas zonës se mbetjeve (2024)

Nr.	Zona	Mbetje (t)	Pjesa në nivel kombëtar (%)
1	4. ZM Tiranë-Durrës	437,075.00	50.19%
2	1. ZM Shkodër-Lezhë	84,850.45	9.74%
3	6. ZM Fier	77,010.24	8.84%
4	9. ZM Vlorë Veri	56,744.00	6.52%
5	5. ZM Elbasan	51,537.03	5.92%
6	8. ZM Korçë	45,446.20	5.22%
7	10. ZM Vlorë Jug-Gjirokastrë	44,521.38	5.11%
8	7. ZM Berat	38,060.00	4.37%
9	3. ZM Dibër	19,076.00	2.19%
10	2. ZM Kukës	16,563.29	1.90%

Të dhënat për mbetjet sipas zonave të menaxhimit të mbetjeve për 2024-ën janë paraqitur grafikisht:




Figura 181 - Paraqitja grafike te mbetjeje per zonat e manaxhimit te mbetjeje

Kryeqyteti Tirana gjeneron 29.61% të sasisë së mbetjeje, dhe së bashku me 9 qytetet kryesore, gjenerojnë 68.67% të sasisë totale të mbetjeje.

Tabela 47 - Të dhëna per 10 bashkitë që kanë gjeneruar më shumë mbetje. (2024)

Nr.	Bashkia	Mbetje (t)	Pjesa në nivel kombëtar (%)
1	Tiranë	257,829	29.61%
2	Durrës	67,564	7.76%
3	Vlorë	53,407	6.13%
4	Fier	41,512	4.77%
5	Shkodër	36,666	4.21%
6	Kamëz	34,200	3.93%
7	Kavajë	33,704	3.87%
8	Elbasan	31,037	3.56%
9	Krujë	21,900.00	2.51%
10	Berat	20,231.00	2.32%
11	Të tjera	272,832.31	31.33%

Dhjetë bashkitë që kanë menaxhuar me shumë mbetje gjatë 2024
(nga totali 61 bashki të shqiperise)




Figura 182 - Dhjetë bashkitë që kanë gjeneruar më shumë mbetje

Tabela 48 - Bashkitë dhe zonat e mbetjeve që kanë menaxhuar me shumë dhe me pak mbetje, 2024

Tregues	Vlera
Totali i mbetjeve urbane të menaxhuara (2024)	870,884 t
Bashkia që ka menaxhuar me shumë	Bashkia Tiranë – 257,829 t (≈ 30 % e totalit kombëtar)
Zona e mbetjeve që ka menaxhuar me shumë	Zona 4 (Tiranë–Durrës) – 437,075 t (50.2 %)
Bashkia që ka menaxhuar me pak	Bashkia Klos - 660 t (≈ 0.07 % e totalit kombëtar)

Zona e mbetjeve qe ka menaxhuar me pak	Zona 2 (Kukes) –16,563 t (1.9 %)
--	----------------------------------

Tirana është bashkia me gjenerimin më të lartë të mbetjeve, duke arritur në 257,829 tonë, shumë më tepër se bashkia e dytë, Durrësi, me 67,564 tonë. Kjo tregon një përqendrim të lartë të gjenerimit të mbetjeve në kryeqytet dhe në Durrës, si zona me aktivitetin më të madh ekonomik në vend. Vlora, Fieri dhe Shkodra janë tre bashkitë e tjera që kanë nivele të konsiderueshme të gjenerimit të mbetjeve, ndonëse më të ulëta se Durrësi. Kjo përkon me faktin se këto bashki kanë një aktivitet ekonomik më të zhvilluar krahasuar me pjesën tjetër të vendit.

Sasitë e mbetjeve për banorë

Përsa i përket sasive të mbetjeve për banore në ditë (kg/banorë/ditë), Tirana rezulton si bashkia me gjenerimin më të lartë për frymë, me 14.52 kg/person/ditë, ndjekur nga Durrësi me 5.02 kg/person/ditë. Të dyja vlerat janë shumë mbi mesataren e çdo vendi europian (1,3 – 1,8 kg/person/ditë). Në tabelën e mëposhtme jepen sasitë e mbetjeve kg/banorë/vit për dhjetë bashkitë që kanë gjeneruar me shume mbetje gjate 2024.

Tabela 49 - Dhjetë bashkitë me gjenerimin më të lartë të mbetjeve për frymë në vit

Nr	Bashkia	Sasia e mbetjeve per kg/banore/vit
1	Tiranë	14.52
2	Durrës	5.02
3	Vlorë	1.00
4	Fier	1.61
5	Shkodër	0.98
6	Kamëz	0.98
7	Kavajë	0.88
8	Elbasan	0.50

9	Krujë	0.71
10	Berat	0.60

● **Tendenca e gjenerimit të mbetjeve bashkiake**

Trendi në 5 vitet e fundit i gjenerimit të mbetjeve paraqet një përmbledhje të sasisë totale të mbetjeve urbane të menaxhuara në Shqipëri gjatë kësaj periudhe, bazuar në raportet vjetore të INSTAT për vitet 2020–2023, si dhe në të dhënat për vitin 2024, të mbledhura nga bashkitë.

Tabela 50 - Trendi i gjenerimit të mbetjeve urbane në Shqipëri gjatë periudhës 2020–2024

Viti	Mbetje Urbane të Menaxhuara (në ton)
2020	1,170,000
2021	875,105
2022	820,322
2023	844,157
2024	870,883




Figura 183 - Gjenerimi i mbetje bashkiake gjatë 5 viteve

Këto shifra tregojnë një tendencë të përgjithshme të uljes së sasisë së mbetjeve urbane të menaxhuara nga viti 2020 deri në vitin 2022, ndjekur nga një **rritje e lehtë** në vitin 2023, e cila ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024.

Nuk janë raportuar të dhëna mbi përbërjen e mbetjeve për vitin 2024.

6.4.3 Mbetjet industriale

Transferimi i mbetjeve përfaqëson një hallkë shumë të rëndësishme në zinxhirin e aktiviteteve për menaxhimin e mbetjeve, sepse mundëson kalimin e mbetjeve nga pika e grumbullimit fillestar tek pikat e ndërmjetme dhe deri në trajtimin përfundimtar. Menaxhimi i transferimit të mbetjeve është një proces që kërkon planifikim të kujdesshëm për të garantuar ruajtjen dhe transportin e sigurt të tyre, në përputhje me standardet teknike dhe kërkesat ligjore. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) mban dhe përditëson Regjistrin e Transfertave të Mbetjeve për subjektet që janë të pajisura me Kod Unik. Gjatë vitit 2024, Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka grumbulluar të dhëna për regjistrin e transfertave të mbetjeve të kompanive që janë të pajisura me Kod Unik.

Përgjatë këtij viti, janë krijuar dhe transferuar gjithsej **rreth 6,271,508 tonë mbetje industriale**, nga të cilat 5,215,491 tonë janë mbetje të rrezikshme dhe 1,056,017 tonë janë mbetje të parrezikshme. Sasinë më të madhe të mbetjeve të rrezikshme e përbëjnë mbetjet me **kodin 13 05 08*** (Përzierje mbetjesh nga separatorët ujë/naftë), me një total prej 5,154,337 tonësh, të gjeneruara nga industria e nxjerrjes së naftës. Kjo sasi mbetjesh e transferuar gjatë vitit 2024 është ndjeshëm më e lartë krahasuar me vitin 2023, kur janë transferuar rreth 72,230 tonë.

6.4.4 Mbetjet nga bujqësia

Raportimi i mbetjeve në sektorin bujqësor është një detyrim ligjor dhe një raportim shumë i rëndësishëm për të garantuar sigurinë ushqimore dhe mbrojtjen e mjedisit. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen dhe kontrollin e mbetjeve që lidhen me prodhimin bujqësor dhe blegtorial.

Sipas të dhënave të raportuara nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), gjatë vitit 2024 janë gjeneruar rreth 1,993 ton mbetje dhe 635,221 litra mbetje. Nga kjo sasi 15.2 % janë depozituar në landfill.

Tabela 51 - Raportimi vjetor nga AKU për sasine e mbetjeve për vitin 2024

Të dhënat e informacionit	Kodi I katalogut Shqiptar	Tiranë	Durrës	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Korçë	Fier	Gjirokastrë	Lezhë
Sasia e mbetjeve nga plehra kimike dhe pesticideve të skaduara nga përdorimi në bujqësi .Kg/ton në vit	20 01 19*	0.96 ton PMB	3.527 ton PP				0.06 ton + 120 lit PMB	0.00757 ton + 0.3 lit. PMB		0.005 ton + 3 lit. PMB
Sasia e mbetjeve bimore dhe shtazore e pakompostuar	19 05 02	1492.9305092 Ton/ 387104.089 Litra Produkte ushqimore / Pije Freskuese / 21.9 Ton Fruta dhe perime	198.948547 Ton Produkte ushqimore	9.79 Ton Produkt e Ushqimore	30 Cope Produkte Ushqimore / 0.105 Ton Fruta	0.047 ton produkt e ushqimore / 0.015 ton Bizele / 0.022 Ton Fruta	7.140518 Ton / 2821.16 Litra produkt e ushqimore/ Pije freskuese	25.878353 Ton / 5797.75 Litra produkte ushqimore/ Pije alkalike / 20.482 Ton Fruta	82.536 Ton / 234747.554 Litra produkte ushqimore/ Pije freskuese	0.181 Ton / 4496 Litra produkte ushqimore / Pije
Sasia e mbetjeve farmaceutike bujqësore kg/ton Vit	16 05 08*	0.9612 ton + 8.9 lit. PMB					0.06 ton + 120 lit PMB	0.00757 ton + 0.3 lit PMB		0.005 ton + 3 lit PMB
Sasia e mbetjeve te depozituara ne Landfill Ton/Litra/ Kokrra veze/Vit		0.438 ton Duhan	151.65 Grure							

PMB-Produkte per mbrojtjen e bimeve (pesticide)

PP-Produkte pleheruese (plehera kimike)

Ton-Produkte me origjine shtazore dhe jo shtazore te asgjesuara ne landfill

Litra-Produkte me origjine shtazore dhe jo shtazore te asgjesuara ne landfill

● Mbetjet nga nënproduktet shtazore

Referuar të dhënave të raportuara nga Agjencia Kombëtare e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve rezulton se në vitin 2024, sasia e mbetjeve nga indet e kafshëve është rreth **2,850,359.7 kg/vit.** Sasia më e madhe e gjenerimit të mbetjeve nga indet e kafshëve rezulton në qarkun Tiranë me 1,210,904 kg/vit.

6.4.5 Mbetjet spitalore

Tabela më poshtë përmban të dhëna mbi sasitë vjetore të mbetjeve spitalore të gjeneruara nga spitalet shtetërore dhe private dhe qendrat e kujdesit shëndetësor për 12 qarqet e Shqipërisë. Ajo gjithashtu jep informacion mbi pesë kompani private që ofrojnë shërbimin e trajtimit të mbetjeve shëndetësore përmes autoklavës, incinerimit ose depozitimit në landfill.

Tabela 52 - Mbetjet Shëndetësore sipas Ministrisë së Shëndetësisë

Qarku	Spitali publik	Sasia (kg)	Subjekti që trajton mbetjet
Berat	Berat/ Njesia Kuçovë	18.618,00	VALE Recycling , Eco Riciklim
	Spitali Skrapar	673,40	PURA MEDICAL
Dibër	Spitali Dibër	11.522,10	Vale Recycling,
	Spitali Bulqizë	3,10	MEDI – TEL,
	Spitali Mat	3.900,00	VALE RECYCLING

Durrës	Spitali Durrës	33.019,30	Vale Recycling, Eco Riciklim
	Spitali Krujë	2.980,00	V.A.L.E RECYCLING
Elbasan	Spitali Elbasan	21.593,65	“ECO Riciklim”
	Psikiatri Elbasan	293,10	ECO RECIKLIM
	Spitali Gramsh	3.300,00	“Pura Medical Shpk”
	Spitali Peqin	394,80	“Pura Medical Shpk”
	Spitali Librazhd	2.411,90	V.A.L.E Recycling
Fier	Spitali Fier	35.302,00	ECO-RICIKLIM
	Spitali Lushnjë	3.498,00	MEDI TEL
	Spitali Mallakaster	1.300,00	V.A.L.E RECYCLING
	Spitali “Memorial”	26.406,00	ECO Riciklim
Gjiroka stër	Spitali Gjiroka stër	17.894,70	“V.A.L.E RECYCLING”
	Spitali Përmet	2.036,00	PURA MEDICAL
	Spitali Tepelenë	1.149,00	<u>Medi –Tel</u>
Korçë	Spitali Korçë	10.600,00	MEDI – TEL” shpk, “Vale Riciklim”.

	Spitali Devoll	1.200,00	MEDI-TEL
	Spitali Kolonjë	1.278,50	MEDI – TEL
	Spitali Pogradec	8.583,23	V.A.L.E Recycling
Kukës	Spitali Kukës	15.000,00	:“V.A.L.E. RECYCLING”
	Spitali Has	820,90	V.A.L.E. RECYCLING
	Spitali Tropojë	2.000,00	V.A.L.E. RECYCLING
Lezhë	Lezhë	6.865,00	Meditel, V.A.L.E Recycling
	Laç	7.294,30	V.A.L.E RECYCLING
	Mirditë	2.689,50	“V.A.L.E RECYCLING”
Tiranë	Qendra Spitalore Universitare "Nënë Tereza"	137.389,52	Autoklava, “Eco Riciklim”
	Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Nëna Mbretëreshë"	20.085,65	ECO RICIKLIM
	Spitali Universitar Obstetrik - Gjinekologjik "Koço Glozheni"	23.445,90	VALE RECYCLING, ECO RICIKLIM

	Qendra Spitalore Rajonale "Shefqet Ndroqi"+ Spitali Kavajë	1.754,90	VALE RECYCLING
	Spitali Universitar i Traumës	74.483,00	ECO RICIKLIM
	Qendra Kombëtare e Transfuzionit te Gjakut, Tiranë	12.169,70	Medi –Tel
Shkodër	Spitali Shkodër	89.531,00	Autoklavim, V.A.L.E Recycling dhe Karl Gega Konstruksion
	Spitali Malësi e Madhe	226,00	VALE Recycling
	Spitali Pukë	4.000,00	V.A.L.E RECYCLING
Vlorë	Spitali Vlorë	26.271,65	MEDI-TEL, EKO-RICIKLIM
	Spitali Psikiatrik Vlorë	1.650,40	Meditel shpk

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

	Spitali Delvinë	1.900,00	V.A.L.E RECYCLING
	Spitali Sarandë	8.048,80	V.A.L.E Recycling
			ECO Riciklim
Total		643.583,00	

Qarku	SPITALET PRIVATE	Sasia (kg)	Subjekti që trajton mbetjet
Tiranë	Spitali Amerikan I	19.838,00	ECO RICIKLIM
	Spitali Amerikan II	51.754,50	ECO RICIKLIM
	Spitali Amerikan III	53.411,00	ECO RICIKLIM
	Spitali Hygeia	126.915,00	ECO RICIKLIM
Durrës	Spitali Amerikan	37,05	ECO RICIKLIM
Gjirokastrë	Spitali Amerikan	15,72	ECO RICIKLIM
Fier	Spitali Amerikan	31,64	ECO RICIKLIM
Tiranë	Spitali Gjerman	8.923,00	Medi –Tel
Tiranë	Family Hospital	246,17	Medi –Tel
Tiranë	Amavita	2.391,00	ECO RICIKLIM
Tiranë	Spitali European	17.508,10	Medi –Tel, PURA MEDICAL
Tiranë	Spitali Salus	10.111,30	Medi –Tel
Total		291.182,47	

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

Total SPITALET PRIVATE		643.583,00	
Total SPITALET PUBLIKE		291.182,47	
Total		934.765,47	

NJKV SH (QSH)	Sasia e prodhuar (kg)	Kontratë me subjektet e licensuar për trajtimin e mbetjeve spitalore	Sasia (kg)	Trajtuar nga QSH
Berat	2.297,90	MEDI-TEL shpk, Pura Medical shpk	119,00	Autoklave, djegie
Durrës	8.985,29	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk, ECO RICIKLIM shpk		
Elbasan	8.813,30	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk, Pura Medical shpk, ECO RICIKLIM shpk	44,00	gruposje
Fier	6.943,30	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk, Pura Medical shpk	532,50	---
Gjirokastrë	1.762,50	MEDI-TEL shpk		
Korçë	2.308,77	MEDI-TEL shpk		

Vlorë	5.616,43	MEDI-TEL shpk, Pura Medical shpk, ECO RICIKLIM shpk		
Tiranë	34.740,13	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk, ECO RICIKLIM shpk, Pura Medical shpk		
Lezhë	3.081,90	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk		
Shkodër	2.544,47	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk, Pura Medical shpk, ECO RICIKLIM shpk	55,60	djegje
Kukës	1.152,50	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk		
Dibër	1.240,35	MEDI-TEL shpk, VALE Recycling shpk		
Total	79.486,84		751,10	0,94%

Në total, 934.765,47 kg mbetje spitalore, të gjeneruara nga spitalet publike dhe private së bashku, janë prodhuar në vitin 2024. Kompanitë private raportuan se nga 79.486,84 kg mbetje spitalore, vetëm 0,9%, e barabartë me 751,1 kg, janë trajtuar sipas standardeve ndërkombëtare.

6.4.6 Mbetjet detare

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkepunim me GIZ ka kryer një studim të monitorimit të rrjedhjeve të plastikës në Shqipëri duke përdorur diagramin e rrjedhjes së mbeturinave.

Qëllimi i studimit është të mbështetë vendimarrjen dhe hartimin e politikave të bazuara në prova në Shqipëri për të trajtuar në mënyrë efektive dhe efikase mbeturinat detare. Të propozojë dy modele për të vlerësuar rrjedhjet kombëtare të plastikës për Shqipërinë:

- 1. Një Model Kombëtar Monitorimi: për të vlerësuar rrjedhjet mesatare të plastikës për frymë nga burimet e menaxhimit të mbetjeve të ngurta
- 2. Një Model Vlerësimi i Ndikimit: për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve në rrjedhjet e plastikës.

Përfitimet e këtij studimi përfshijnë:

- 1. Kontributi në Mangësitë e të Dhënave: Të dhënat janë baza për të marrë vendime të informuara mbi ndërhyrjet për të trajtuar mbeturinat detare. Modeli jo vetëm që do të mbështesë mbledhjen e të dhënave bazë, por do të mbështesë edhe krijimin e një baze të dhënash e cila mund të përditësohet vazhdimisht dhe të përdoret për qëllime raportimi.
- 2. Vendimarrje e Informuar: Vendimarrësit mund të identifikojnë ndërhyrjet me ndikimin më të lartë potencial dhe të bëjnë zgjedhje të informuara mbi ndërhyrjet, duke marrë parasysh si ndikimin e tyre mjedisor ashtu edhe implikimet financiare.
- 3. Planifikimi Afatgjatë: Duke parashikuar progresin dhe duke vlerësuar ndikimin afatgjatë të ndërhyrjeve, modeli mbështet investimet strategjike, të qëndrueshme dhe të orientuara drejt së ardhmes në menaxhimin e ndotjes nga plastika.

Rezultatet kryesore paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela 53 - Rryma e mbetjeve, 2011 - 2021 - Skenari ideal

Rryma e mbetjeve	2011(historik)	2021 (vit bazë)	Skenari ideal
Rrjedhjet totale plastike(ton/vit)	53,043	10,861	4,516

Rrjedhjet totale plastike në sistemet ujore (ton/vit) % e rrjedhjeve totale plastike	24,000 (45%)	4,569 (42%)	2,150 (48%)
% e reduktimit të rrjedhjeve plastike në sistemet ujore		81%	53%
Shkalla e rrjedhjeve plastike ne sistemet ujore (kg/person/vit)	11.7	1.7	0.77

Për vitin 2011, modeli i ndikimit vlerëson se 24,000 ton plastikë kanë rrjedhur në sistemet e ujit nga Shqipëria, që korrespondon me 11.7 kg/banor/vit. Shkaqet janë një shkallë e ulët e mbledhjes së mbeturinave dhe praktikat e dobëta të asgjësimit krahasuar me situatën e sotme.

- Për vitin 2021, vlerësimi bazë (me të dhëna për popullsinë dhe gjenerimin e mbeturinave nga viti 2018) tregon një ulje të konsiderueshme prej 81% krahasuar me vitin 2011, pasi 4,569 ton ose 1.7 kg/banor/vit plastikë kanë arritur në sistemet ujore. Kjo është një ulje e lavdërueshme, që tregon rëndësinë e shërbimeve të përmirësuara të mbledhjes dhe asgjësimit. Megjithatë, nevojitet përmirësim i mëtejshëm për t'iu afruar një niveli të dëshiruar nën 0.57 kg/banor/vit, i cili do të ishte i krahasueshëm me nivelet në BE.

- Përdorimi i një skenari të idealizuar që supozon mbulim mbledhjeje prej 95% për Shqipërinë dhe emetime të ulëta të plastikës nga mbledhja dhe asgjësimi tregon se rrjedhja e plastikës mund të reduktohet më tej. Për këtë skenar, vlerësohet se 2,150 ton plastikë, ekuivalente me 0.77 kg/banor/vit, do të rrjedhin në sistemet e ujit nga Shqipëria, çdo vit.

- Ky model mund të jetë potencialisht i dobishëm në mbështetjen e njëmjeti kombëtar për monitorimin e rrjedhjeve të plastikës, për shkak të lehtësisë së përdorimit dhe riprodhimit të lehtë. Modeli është dinamik dhe të dhënat e reja mund të përdoren për të gjeneruar rezultate të përditësuara.

Studimi tregon përparimin e bërë gjatë dekadës së fundit, por gjithashtu tregon se nevojiten veprime të mëtejshme për të frenuar sasitë e plastikës që rrjedhin në mjedis nga bashkitë. Drejtimi aktual strategjik i futjes së skemave të Përgjegjësisë të Zgjeruar të Prodhuesit do të zvogëlojë rrjedhjet e plastikës me

rreth 29%, megjithatë do të kërkojen përmirësime dhe masa të mëtijshme për t'iu afuar nivelit të dëshiruar të rrjedhjeve (nën 0.5 kg/banor/a) deri në vitin 2030.

Studimi për rrjedhjet e plastikës në sistemet ujore sugjeron që Shqipëria duhet:

- **Të vazhdojë të rrisë normat e mbledhjes së mbeturinave** dhe të përmirësojë normën e depozitimit të kontrolluar.
- **Të prezantojë skema të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit**, veçanërisht për paketimin sa më shpejt të jetë e mundur, duke u përpjekur të synojë objektivat e vitit 2030 sipas rregulloreve të BE-së.
- **Të shqyrtojë dhe zbatojë masa shtesë** që frenojnë më tej përdorimin dhe ndotjen e plastikës, të tilla si kufizimi i përdorimit të plastikës njëpërdorimëshe, si dhe stimuj dhe rregullore ekonomike që stimulojnë përdorimin e reduktuar dhe rritjen e riciklimit të plastikës.
- **Të investojë në krijimin e një sistemi të formalizuar monitorimi** (i cili mund të ndërtohet mbi modelin e përdorur në këtë studim) për të ndjekur zhvillimin, për të raportuar progresin dhe për të vlerësuar opsionet e ardhshme për frenimin e ndotjes nga plastika.

6.5 Treguesit Kryesorë të Performancës (KPI)

VKM nr. 538, datë 22.09.2021 “Për miratimin e rregullave për ruajtjen, përditësimin dhe publikimin e statistikave për mbetjet”, përcakton treguesit kryesorë të performancës (KPI) për vlerësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve nga bashkitë.

Projekti “BE për Ekonominë Qarkulluese dhe Qytete të Jetueshme”, i zbatuar nga GIZ në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM), po mbështet 15 bashki partnere në zbatimin e KPI-ve për të përmirësuar performancën bashkiake dhe për të matur përparimin në vijimësi në menaxhimin e mbetjeve.

15 bashkitë partnere janë: Shkodër, Lezhë, Kukës, Cërrik, Belsh, Roskovec, Gramsh, Prenjas, Pogradec, Himarë, Sarandë, Përmet, Këlcyrë, Tepelenë dhe Gjirokastrë.

6.5.1 Përmbledhje e Treguesve të Performancës për vitin 2024

Grupi i të dhënave përfshin treguesit e mëposhtëm:

- C1: Mbulimi i territorit me shërbimin e mbetjeve
- C2: Pastërtia e territorit
- C3: Kënaqësia e publikut ndaj shërbimit
- D1: Mbetjet e grumbulluara të ndara
- D2: Përputhshmëria ligjore e trajtimit të mbetjeve
- E1: Rikuperimi i kostove
- E2: Efienca e mbledhjes së tarifave
- Kosto për ton dhe për frymë
- G: Cilësia e ofrimit të shërbimit

Zgjerimi i përdorimit të KPI-ve, bazuar në përvojat e 15 bashkive partnere dhe përkthimi i tyre në masa politike, mund të shërbejë si një mjet krahasimi shumë i vlefshëm për përmirësimin e shërbimeve në nivel lokal dhe si bazë për reforma legjislative e administrative si në nivel lokal ashtu edhe kombëtar.

Zgjerimi i këtij lloji analize në të gjitha bashkitë do të krijonte një bazë të qëndrueshme për përputhjen me legjislacionin e BE-së dhe për avancimin e reformave në sektor.

6.5.2 Performuesit më të mirë në vitin 2024

Bazuar në analizën për çdo tregues dhe mesataren e performancës për të gjithë treguesit, bashkitë më të suksesshme janë:

- Shkodra, kryeson për mbulim (100.6%), kënaqësi (100%), pastërti (75.0%) dhe cilësi (91.7%), ndërsa mban kostot të moderuara (5,801 lekë/ton, 1,564 lekë/frymë).
- Lezha, ka vlerësime të larta për trajtimin (100%), cilësinë (79.2%), kënaqësinë (100%) dhe rikuperimin (92.3%), me kosto të kontrolluara (6,241 lekë/ton, 1,743 lekë/frymë).

6.5.3 Sektorët me shqetësim të lartë

Bazuar në analizën për çdo tregues dhe mesataren e performancës, bashkitë me rezultatet më të dobëta janë:

- Himara, megjithëse ka mbulim 96.1% dhe kënaqësi të lartë publike, kostoja për frymë (8,098 lekë) dhe efikasiteti i mbledhjes së tarifave (49%) tregojnë stres të lartë financiar. Edhe pse ekziston potencial dhe infrastrukturë e ndërtuar, aktivitetet e ndarjes dhe trajtimit mbeten shumë të kufizuara.
- Këlcyra, ka vetëm 40.0% pastërti, 0% kënaqësi publike dhe 9.0% rikuperim kostosh – sistemi paraqet mospërputhje në të gjitha dimensionet.
- Tepelena, raporton 76.0% mbulim dhe 29.2% cilësi, por përballat me kosto të lartë për frymë (3,122 lekë), mungesë të dhënash për kënaqësinë e publikut dhe mungesë ndarjeje apo trajtimi të mbetjeve.
- Gjirokastra, ndonëse ka pastërti të lartë (85.0%), nuk ka ndarje, trajtim apo rikuperim të kuptueshëm të kostove. Kërkon përmirësim të infrastrukturës dhe shërbimeve.

6.5.4 Bashki me përpjekje për ndarje dhe trajtim në burim

Siç pritej, vetëm një grup i vogël bashkish (5), ku projekti ka financuar sisteme për ndarjen e mbetjeve dhe njësi trajtimi, po e kryejnë këtë shërbim. E vetmja që e mbarëvajt procesin në mënyrë të qëndrueshme, nga mbledhja e veçuar deri te trajtimi dhe shitja e materialeve, është Himara.

Konkretisht:

- Roskoveci mbetet më aktiv në ndarjen e mbetjeve, duke u fokusuar kryesisht te mbetjet e gjelbra që trajtohen në impiantin e kompostimit. Së bashku me sasitë e riciklueshme të përpunuara në vend, ka një rritje nga 14.1% në 2023 në 15.5% në 2024. Kjo rritje e vogël, por e qëndrueshme, sugjeron një sistem pilot funksional.
- Belshi raportoi ndarje 8.8% në 2023 dhe 8.0% në 2024. Edhe pse me rënie të lehtë, tregon vazhdimësi në përpjekje. Rekomandim: të vlerësohen boshllëqet operationale dhe të riangazhohen aktorët lokalë.
- Cërriku raportoi një rënie të lehtë nga 18% në 2023 në 16.2% në 2024, por mbetet ndër të vetmet bashki që raportojnë mbi 10%. Plani për të ndryshuar teknologjinë e kompostimit nga furra natyrore (windrows) në grumbuj me ajrim të kontrolluar (aerated piles) parashikon rritje të

materialeve të mbledhura dhe të përpunuara – ndryshim që do të vlerësohet deri në fund të vitit 2025.

- Saranda raporton ndarje minimale por të qëndrueshme (më pak se 1%). Edhe pse në vlerë nominale është e fundit, duke pasur parasysh që trajton ambalazhe të riciklueshme me vlerë, të grumbulluara në burim, rënditet në krye të listës për përpjekjet në riciklim.
- Prrenjasi kaloi nga 0.1% në 0.4% – përpjekje minimale, por tregon nisjen e procesit.

	Belsh	Cerrik	Gjrokastrë	Gramsh	Himara	Kalçyra	Kukës	Lezhe	Permet	Rostovec	Saranda	Shkoder	Prrenjas	Pogradec	Tepelene
	62.7%	95.9%	97.2%	58.0%	96.1%	72.6%	110.7%	98.0%	94.5%	80.7%	96.4%	100.6%	70.3%	83.2%	76.0%
Treguesi C1. Mbulimi i shërbimit të mbetjeve (në %)	70.0%	70.0%	85.0%	50.0%	75.0%	40.0%	50.0%	90.0%	70.0%	70.0%	70.0%	75.0%	65.0%	65.0%	70.0%
Treguesi C2. Pastërtia e territorit	100.0%	66.7%	90.7%	100.0%	0.0%	0.0%	100.0%	100.0%	89.3%	66.7%	97.6%	100.0%	100.0%	0.0%	0.0%
Treguesi C3. Kënaqësia e publikut me ofrimin e shërbimit	8.0%	16.2%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	15.5%	0.7%	0.3%	0.4%	0.0%	0.0%
Treguesi D1. Mbledhurat e mbledhura veçmas	95.3%	100.0%	0.0%	100.0%	100.0%	77.3%	0.0%	100.0%	0.0%	76.8%	102.7%	100.0%	100.0%	100.0%	0.0%
Treguesi D2. Niveli i trajtimit të mbetjeve sipas legjislacionit	42.1%	50.8%	40.7%	25.9%	40.3%	9.0%	94.9%	92.3%	38.9%	36.0%	76.0%	60.2%	39.9%	73.0%	22.9%
Treguesi E1. Rikuperimi i kostos	60.8%	102.4%	78.3%	61.1%	49.0%	83.8%	132.0%	109.1%	108.0%	85.7%	79.6%	92.2%	87.6%	77.9%	177.4%
Treguesi E2. Efikasiteti në mbledhjen e tarifave	7939.4	10599.3	12432.1	14074.3	14860.2	9442.6	2656.1	6241.3	12747.6	12128.7	11687.6	5801.0	12674.6	11106.1	13656.3
Treguesi G. Cilësia e ofrimit të shërbimit	1094.3	1816.3	2847.4	1220.7	8098.4	1836.9	967.3	1743.6	2023.4	2019.3	5665.0	1564.2	1408.0	2417.2	3122.3
	70.8%	45.8%	54.2%	33.3%	62.5%	20.8%	33.3%	79.2%	33.3%	66.7%	75.0%	91.7%	45.8%	16.7%	29.2%

Figura 184 - Përmbledhje e treguesve për çdo bashki

6.6 Rekomandimet kryesore për përmirësim

Duke analizuar situatën aktuale dhe tendencat e performancës në të gjithë treguesit, identifikohen disa rregullime kyçe në politikat publike, të cilat janë thelbësore për përmirësimin e performancës së bashkive, veçanërisht në ato fusha ku progresi ka qenë i kufizuar ose është vërejtur regres. Këto janë masa të drejtpërdrejta përmirësimi që mund t’u komunikohen bashkive, me masa specifike që duhen zhvilluar dhe zbatuar për të adresuar boshllëqet e identifikuara.

- Belshi të forcojë mekanizmat e faturimit dhe të ruajë përmirësimet e fundit në pastërti përmes angazhimit të komunitetit.

- Cërriku të forcojë kontaktin me qytetarët për të rikthyer kënaqësinë publike dhe të analizojë rritjen e kostove operacionale për të përmirësuar efijencën.
- Gjjirokastra të prioritizojë investimet në infrastrukturën e trajtimit dhe të nisë programe bazë për ndarjen në burim.
- Gramshi të përmirësojë oraret e pastrimit dhe të rishikojë mekanizmat financiarë për të kontrolluar kostot.
- Himara të auditojë sistemet e mbledhjes së të ardhurave dhe të rivlerësojë strukturën e kostove për qëndrueshmëri.
- Këlcyra të nisë një sondazh për kënaqësinë e qytetarëve për të identifikuar shqetësimet publike dhe të planifikojë përmirësimin e rikuperimit të kostove.
- Kukësi të nisë investime graduale në infrastrukturë për ndarjen dhe përputhshmërinë me ligjin.
- Lezha të mbajë cilësinë e shërbimit dhe të zgjerojë programet për ndarjen e mbetjeve duke u mbështetur në bazën e fortë ekzistuese.
- Përmeti të shfrytëzojë suksesin e fundit në kënaqësinë e publikut për të krijuar vrull në ndërtimin e infrastrukturës së trajtimit dhe ndarjes.
- Roskoveci të synojë fushata komunikimi për të rindërtuar besimin dhe të eksplorojë mënyra për uljen e kostos për frymë.
- Saranda të forcojë efikasitetin operativ dhe të zgjerojë ndarjen e mbetjeve nga institucionet dhe hapësirat publike.
- Shkodra të ruajë vrullin pozitiv përmes programeve pilot për ndarjen lokale dhe institucionalizimit të praktikave më të mira.
- Prrenjasi të vazhdojë përmirësimet graduale në infrastrukturë dhe të standardizojë proceset e faturimit.
- Pogradeci të prioritizojë mekanizmat për marrjen e feedback-ut nga komuniteti dhe të nisë infrastrukturë minimale për trajtim dhe ndarje.
- Tepelena të zhvillojë një plan tërësor për rikuperimin me asistencë teknike, të prioritizojë përputhshmërinë e trajtimit, dhe të ndërtojë një plan ndërgjegjësimi lokal të ri.

6.7 Progresi mbi Rekomandimet e vitit 2024 dhe Rekomandime të reja për vitin 2025 në Kapitullin për Mbetjet

Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) njeh rëndësinë e përputhjes me standardet e Bashkimit European (BE) për raportimin mjedisor dhe përfitimet e një qasjeje të centralizuar përmes një Sistemi të Integruar të Informacionit Mjedisor të zhvilluar nga AKSHI. Ky sistem do të lehtësojë grumbullimin, analizimin dhe raportimin e të dhënave, duke mundësuar një kuptim të plotë të trendeve mjedisore dhe duke nxitur transparencën.

- AKSHI ka kontraktuar një kompani që po zhvillon Sistemin e Integruar të Informacionit Mjedisor (SIMM), i cili do të jetë funksional në vitin 2025.

Për të përmirësuar menaxhimin mjedisor, bashkëpunimi mes bashkive, ministrive përkatëse dhe organizatave joqeveritare (OJQ) është thelbësor për shkëmbimin e të dhënave dhe praktikave më të mira. Ky bashkëpunim do të harmonizojë përpjekjet drejt një ekonomie qarkulluese, duke trajtuar mbetjet si burime të vlefshme dhe duke i reintegruar ato në ciklin ekonomik.

- MTM, në bashkëpunim me partnerët e huaj, është në proces hartimi të Ligjit të ri për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve.

Mekanizmat e standardizuar të raportimit dhe përmirësimi i aksesit në të dhëna janë thelbësore për të përmbushur pritshmëritë ndërkombëtare. Iniciativa si SIMM janë në përputhje me direktivat e BE-së dhe adresojnë prioritetet vendase.

- AKSSHI, në bashkëpunim me sektorët përkatës në AKM, ka strukturuar dhe integruar në SIM të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi menaxhimin e mbetjeve.

Monitorimi i progresit përmes treguesve kryesorë, siç është rekomanduar nga Komisioni European, i mundëson politikëbërësve të vlerësojnë performancën dhe të identifikojnë fushat ku nevojiten ndërhyrje. Një strukturë me dy nivele,

me tregues për të gjithë ekonominë dhe për fusha prioritare të caktuara, ofron një qasje strategjike.

- AKEM_i ka krijuar lidhje me bashkitë dhe ka mbledhur të dhëna mbi sasinë e mbetjeve urbane nga të gjitha 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Një strategji kombëtare për ekonominë qarkulluese duhet të ketë prioritet prodhimin dhe konsumin e qëndrueshëm, parandalimin e mbetjeve dhe mbështetjen për ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve komunale, me fokus të veçantë në parandalimin e mbetjeve ushqimore dhe kufizimin e plastikës njëpërdorimshe (PNJP). Duhet të rriten ndjeshëm objektivat për riciklimin e mbetjeve të ambalazheve për periudhën 2025–2030, si dhe të vendosen objektiva shtesë për ripërdorimin, riciklimin dhe uljen e depozitimit në landfill. Vendosija e skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhueseve (PZP) për ambalazhet, Pajisjet Elektrike dhe Elektronike (PEE), dhe kategori të tjera, është thelbësore për organizimin, zbatimin dhe financimin e grumbullimit dhe riciklimit të mbetjeve prioritare si letra dhe kartoni, plastika, qelqi, metalet, PEE, bateritë, tekstilet.

- Ministria, në bashkëpunim me partnerët e huaj (OECD), ka prezantuar Udhërrefyesin për Ekonominë Qarkulluese. Ligji për PZP-ne është konsultuar me palët e interesuara dhe është dërguar nga qeveria për miratim në Kuvend.

Duhet të jepet përparësi grumbullimit të ndarë të mbetjeve organike, kompostimit dhe tretjes anaerobe, të mbështetur nga mekanizma financimi. Shërbimet e grumbullimit të mbetjeve bashkiake duhet të shtrihen në 95% të popullsisë deri në vitin 2025 për të reduktuar hedhjen e paligjshme të mbetjeve. Përdorimi i instrumenteve ekonomikë, si taksa për landfillet që nuk përmbushin standardet, mund të mbështesë parandalimin e mbetjeve, ripërdorimin dhe riciklimin. Duhet të përmirësohet kapaciteti i autoriteteve kombëtare me burime të mjaftueshme për të zbatuar kërkesat ligjore dhe për të pajisur nivelin vendor për të organizuar sisteme efektive të menaxhimit të mbetjeve.

- Gjatë vitit 2024, bashkitë raportuan se kanë në funksion qendra kompostimi për mbetjet organike, si në Cërrik, Belsh dhe Roskovec.

Rekomandime shtesë për vitin 2025, objektivat për riciklimin e mbetjeve të ambalazheve duhet të rriten ndjeshëm për periudhën 2025–2030. Duhet të vendosen gjithashtu objektiva shtesë për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklim si dhe për shmangien e depozitimit në landfill të mbetjeve bashkiake.

Vendosja sa më parë e skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuarit (PZP) për ambalazhet, pajisjet elektrike dhe elektronike (PEE) dhe kategori të tjera produktesh. Skemat PZP konsiderohen si instrumenti kryesor për të organizuar, zbatuar dhe financuar mbledhjen e veçuar dhe riciklimin e rrymave prioritare të mbetjeve, si: letër dhe karton, plastikë, ambalazhe xhami dhe metali, PEE, bateri dhe akumulatore. Duhet të merren në konsideratë gjithashtu tekstilet dhe disa kategori plastikash njëpërdorimshe (PNJP).

Rritja e ndarjes në burim, kompostimit dhe fermentimit anaerobik të mbetjeve bio. Riciklimi i mbetjeve bio duhet të bëhet një prioritet, dhe duhet të vendosen mekanizma të përshtatshëm financimi për të mbështetur ngritjen e infrastrukturës për kompostim dhe fermentim anaerobik.

Përdorimi i instrumenteve ekonomikë për të mbështetur parandalimin, ripërdorimin dhe riciklimin e mbetjeve. Duhet të shqyrtohet përdorimi i instrumenteve ekonomikë si taksat për landfill-et (për ato që nuk përputhen me kërkesat ligjore) për të nxitur parandalimin, ndarjen në burim, ripërdorimin dhe riciklimin.

Rritja e kapacitetit të autoriteteve kombëtare për të raportuar mbi Udhërrefuesin për Ekonominë Qarkulluese. Autoritetet kombëtare duhet të pajisen me burime njerëzore dhe teknike të mjaftueshme për të planifikuar, hartuar, organizuar dhe zbatuar kërkesat ligjore në sektorin e mbetjeve. Në veçanti, AKEM duhet të nisë rishikimin e studimeve të fizibilitetit për zonat e mbetjeve, për të garantuar që infrastruktura e planifikuar të përmbush kërkesat e procesit të anëtarësimit në BE. Duhet të sigurohen kapacitete dhe financime të mjaftueshme në nivel vendor, për të organizuar një sistem modern të menaxhimit të mbetjeve.

KAPITULLI 7

PYJET E BIODIVERSITETIT

7.1. Burimi i të dhënave

Agjencia Kombëtare e Pyjeve ka kryer monitorimin e burimeve gjenetike pyjore në habitatin e llojit Dushk dhe Gështënjë, gjendja e shëndetit dhe vitalitetit në pyjet e vendit tonë, vlerësimi i llojeve drunore dhe bimëve aromatiko-mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje.

7.2. Rëndësia

Pyjet janë ekosistemet më të përparuara natyrore dhe kanë rëndësi shumë të madhe sepse ato janë ekosisteme me biodiversitet shumë të pasur. Pyjet janë rregullatorët natyrore të klimës, ruajnë cilësinë e ujit, ajrit, ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe nga shpërlarja e shtresës produktive të tokës. Pyjet po ashtu, janë akumuluesit më të mëdhenj të sasisë së CO₂ në tokë dhe furnizuesit kryesorë të atmosferës me oksigjen. Janë resurse natyrore të ripërtitshme, produktet e të cilit mund të shfrytëzohen në industri, për djegie dhe për qëllime tjera. Pyjet janë ekosisteme në të cilat rriten një numër i madh i llojeve bimore dhe shtazore me rëndësi ushqyese dhe mjekësore për njeriun. Pyjet përveç se pengojnë erërat e fuqishme janë edhe ambient relaksimi dhe çlodhës për njeriun.

Në vitet e fundit, pyjet kanë zënë një vend gjithmonë në rritje në axhendën politike dhe prioritetet e qeverisjes, duke kuptuar rëndësinë e pyjeve për cilësinë e jetës, zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit dhe ekuilibrat natyror. Në Shqipëri megjithë dëmtimet e mëdha që kanë pësuar grumbujt pyjor, ende ekzistojnë mundësit për të ruajtur diversitetin gjenetik në brendësi të tyre. Në total janë rreth 1000 hektarë pyje me llojet autoktone që trajtohen me metoden e konservimit “in-situ”, respektivisht për prodhimin e farërave aq të domosdoshme për të ruajtur strukturën gjenetike të llojeve pyjore.

7.3. Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis/shëndet

Faktori kryesor që ka shkaktuar kërcënime serioze për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore padyshim është faktori njeri dhe aktivitetet e tij, ndërkaq shpyllëzimet masive, zjarret pyjore, shfrytëzimi intensiv i tokës, tharja e moçaleve, ndotja e tokës, ajrit dhe ujit dhe gjuetia e pakontrolluar janë vetëm disa nga faktorët që vazhdojnë të rrezikojnë dhe përkeqësojnë gjendjen e biodiversitetit në vendin tonë. Humbja e Biodiversitetit përbën aktualisht një ndër problemet më të mëdha në botë prandaj nevojitet një përkushtim më i madh i faktorit njeri që këto trende të ngadalësohen e të kontrollohen deri në ndalimin e plotë të tyre. Njeriu është nxitësi kryesor i ndikimeve afatgjata në mjedis, ku me anë të ndotjes së ajrit, ndikimit në ndryshimin e klimës ose ekspozimit të pyjeve ndaj rreziqeve më të rënda, probleme këto që ndikojnë mbi shëndetin dhe vitalitetin e drurëve duke krijuar një seri efektesh të dëmshme të cilat bëhen pengesë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Njohja e gjendjes së llojeve drunore të kërcënuara ose në rrezik zhdukjeje, nëpërmjet eksplorimit, verifikimit dhe grumbullimit të dhënave për çdo grumbull ose individ (ekzemplar) drurësh të llojeve të sipërpërmendur është procesi i zbulimit të ndryshimeve, vënies në pah të drejtimeve, trendeve që kanë këto lloje. Shpesh herë ky ndryshim është i lidhur ngushtë me politikat dhe praktikatat ekstensive dhe intensive të zhvillimit. Aktiviteti njerëzor edhe në vendin tonë ka patur dhe akoma ushtron një ndikim të fortë në ekosistemet natyrore dhe gjysëm natyrore, duke bërë që një pjesë e bimëve dhe kafshëve të jenë zhdukur, një pjesë e konsiderueshme llojesh bimore e shtazore janë të rallë e që mund të rrezikohen për tu zhdukur në të ardhmen dhe një numër edhe më i madh llojesh të konsiderohen të rralla e në gjendje të keqësuar, pra të konsiderohen lloje të kërcënuara. Njohja e gjendjes aktuale në të cilat ndodhen taksonet drunore tashmë të identifikuar si të rrezikuara, ka nevojë për marrjen e masave mbrojtëse. Kjo, pa dyshim shoqërohet me një vendosje të kriterëve, vlerësim të treguesve të ndryshëm për të mbajtur nën kontroll ecurinë e këtyre llojeve drunore dhe bimëve aromatiko-mjekësore të kërcënuara për zhdukje.

7.4 Standartet e besueshmerisë

Zhvillimi i treguesve pyjor dhe biodiversitetit në kuadrin e “Programit Kombëtar të Monitorimit” të AKP, është konceptuar në përputhje të plotë me standartet që ofrojnë:

Kriteret Pan - Europiane të monitorimit, për menaxhimin e qendrueshëm të pyjeve sipas procesit “FOREST EUROPE”.

7.5 Vlerësimi i gjendjes për pyjet

7.5.1 Gjendja e shëndetit dhe vitalitetit në pyjet e vendit tonë.

Për vitin 2024, monitorimi është kryer brenda rrjetit të konservimit të burimeve gjenetike të llojeve; pishë e zezë, pisha mesdhetare, arnen, hormoq, hartinë, bredh i bardhë, rrobull, ah, gështenjë, llojeve të dushqeve si dhe vlerësimi i sëmundjeve dhe dëmtuesve që kanë prekur llojet pyjore në masive të ndryshme në shkallë kombëtare. Ky monitorim është përqëndruar në bashkitë me sipërfaqe më të madhe të fondit pyjor: Berat, Poliçan, Skrapar, Dibër, Bulqizë, Mat, Klos, Krujë, Elbasan, Gramsh, Librazhd, Prenjas, Belsh, Peqin, Divjakë, Lushnje, Mallakastër, Gjirokastër, Libohovë, Tepelenë, Memaliaj, Përmet, Këlcyrë, Pogradec, Korçë, Maliq, Pustec, Kolonjë, Kukës, Has, Tropojë, Lezhë, Mirditë, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Fushë-Arrëz, Vau i Dejës, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Selenicë, Himarë, Delvinë, Finiq, etj.

Nëpërmjet vrojtimeve të kryera në terren në drurët e kontrollit, është përcaktuar kryesisht përqindja e masës së halave të ç’ngjyrosura, përqindja e masës së gjethëve të ç’ngjyrosura, përqindja e humbjes së halave, përqindja e humbjes së gjethëve, si dhe dëmtuesit e sëmundjet më kryesoren që prekin llojet pyjore të sipërpërmendura.

Tabela 54 - Shkalla e fenomeneve të gjendjes shëndetësore sipas klasave të vlerësimit

Klasat	Shkalla e çgjethtëzimit (ç’halëzimit)	Çngjyrosja	Dëmtuesit	Sëmundjet	Përqindja
0	Të pa çhalëzuara	Nuk ka çngjyrosje	Nuk janë prekur	Nuk janë prekur	0-10 %
1	Lehtësisht të çhalëzuara	Çngjyrosje e lehtë	Prekje e lehtë	Prekje e lehtë	11-25%
2	Mesatarisht të çhalëzuara	Çngjyrosje e mesme	Prekje e mesme	Prekje e mesme	26-60 %

3	Shumë të çhalëzuara	Çngjyrosje e shkallës së lartë	Prekje e shkallës së lartë	Prekje e shkallës së lartë	61-100%
4	Komplet të çhalëzuara	Komplet e çngjyrosur	Komplet të prekur	Komplet të prekur	100%

• Rënia e halave/gjetheve

Vëzhgimet e kryera ndaj fenomenit të rënies së halave për llojet e halorve dhe rënia e gjetheve për llojet fletorë, tregojnë se ka rritje të këtij fenomeni gjatë këtij viti, këto janë argument për të treguar një përkeqsim në gjendjen e kurorave të drurëve. Këto reagime të drurëve kanë ardhur si rezultat i ndikimit nga thatësira, mungesa e lagështirës ajrore dhe ujit, të cilat kanë shkaktuar rënien e halave e gjetheve.

▪ Fenomeni i çhalëzimit për llojet halorë




Figura 185 - Fenomeni i ç'halëzimit halorët 2024




Figura 186 - Fenomeni i ç'halëzimit halorët 2023

- **Për llojin pishë e zezë**, përqindja e rënies së halave në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 11.75%, kurse në vitin 2024 është 12.64% pra kemi një rritje 0.89%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve). Ky fenomen është takuar më së shumti në masivet e pyllëzuar jashtë arealit të vet dhe në terrene të eroduara e që janë shumë të cekëta. Faktor tjetër që ka ndikuar në këtë gjendje është, shkalla e nga dëmtuesi i procesonaries së pishës dhe temperaturat e larta.

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 10.57%, në vitin 2024 është 10.85 %, pra kemi një rritje 0.10%, kurse në klasën e katërt nuk kemi .

- **Për llojin bredh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 8.44%, në vitin 2024 është 9.09 %, pra kemi një rritje 0.65% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-**Për llojet halorë e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 10.55%, kurse në vitin 2024 është 10.95% pra kemi një rritje 0.40% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- Fenomeni i çgjethëzimit për llojet fletorë




Figura 187 - Fenomeni i ç'gjethëzimit fletorët 2024




Figura 188 - Fenomeni i ç'gjethëzimit fletorët 2023

- **Për llojin ah dhe mështeknë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 12.29%, në vitin 2024 është 12.59 %, pra kemi një rritje 0.30%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojet e dushqeve dhe gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 10.41%, kurse në vitin 2024 është 10.86 %, pra kemi një rritje 0.45%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 10.68%, kurse në vitin 2024 është 11.55 %, pra kemi një rritje 0.87%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

Çngjyrosja e halave/gjethëve

▪ Llojet halorë




Figura 189 - Fenomeni i ç'ngjyrosjes halorët 2024




Figura 190 - Fenomeni i ç'ngjyrosjes halorët 2023

- **Për llojin pishë e zezë**, përqindja e ç'ngjyrosja e halave në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 8.93%, kurse në vitin 2024 është 10.73 %, pra kemi një rritje 1.80%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 7.70%, kurse në vitin 2024 është 8.50 %, pra kemi një rritje 0.80%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për llojin bredh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 8.10%, kurse në vitin 2024 është 9.45 %, pra kemi një rritje 1.35% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-**Për llojet halorë e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 12.06%, kurse në vitin 2024 është 12.95 %, pra kemi një rritje 0.89% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

• Llojet fletorë




Figura 191 - Fenomeni ç'ngjyrosjes fletorët 2024




Figura 192 - Fenomeni ç'ngjyrosjes fletorët 2023

Për llojin ah, mështeknë kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 13.35%, kurse në vitin 2024 është 14.15 %, pra kemi një rritje 0.80%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë,** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 11.06%, kurse në vitin 2024 është 12.06 %, pra kemi një rritje 1.00%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për fletorët e tjerë,** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 13.29%, kurse në vitin 2024 është 14.09 %, pra kemi një rritje 0.80%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

• **Dëmtimi nga insektet dhe sëmundjet**

Dëmtimet e insekteve dhe sëmundjeve kërpudhore, në kombinim me rritjen e vulnerabilitetit të shkaktuar nga ngarkesat e depozitimit, kushtet e motit, dhe faktorë të tjerë antropogjenë, të cilat janë të lidhura ngusht me këto trende. Si rrjedhojë e këtyre ndikimeve kemi një përkeqësim në llojin bush si pasojë e shkallës së lartë të prekjës nga dëmtuesit dhe sëmundjet kemi një tharje masive si lloj në të gjithë arealin e përhapjes së tij, një fenomen i veçantë këtë vit ishte edhe prekja e llojit gështenjë nga dëmtuesi i grerëzës Aziatike e cila preku të gjitha grumbujt me llojin gështenjë në të gjithë territorin.

Tabela 55 - Dëmtuesit dhe sëmundjet e llojeve halorë dhe fletorë

Lloji	Dëmtuesit	Sëmundjet
Pishë e zezë	Procesionaria e pishës (<i>Thaumetopoea pityocampa</i> , Den and Schiff) më problematike paraqitet në bashkitë; Pukë, Fushë – Arrëz, Kukës, Mirditë, Bulqizë, Kolonjë, Pogradec, Korçë, Peshkopi, Mat, Klos,	Shyta e zakonshme (<i>Lophodermium pinastri</i>) në bashkitë, Pukë, Kukës, Gramsh, Pogradec, Kolonjë, Dibër, Korçë.

	Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Vlorë, Librazhd, Prenjas, Pogradec, Gramsh dhe Elbasan, etj.	Ndryshku i halave (<i>Cronartium ribicola</i> Fisch); i përhapur në të gjithë territorin e vendit.
	Biskpërdredhësi i pishës (<i>Rhyacionia boliana</i> , Den and Schiff) më problematike paraqitet në bashkitë; Skrapar, Berat, Vlorë, Pukë, Shkodër , Mat.	Ç'ngjyrosja e halave (<i>Diplodia mutila</i>); në shkallë vendi, më e theksuar është në objektet e pyllëzuara
	Kuqeziu i halave (<i>Haematoloma darsatum</i> Ahrens), ka një përhapje në habitatet e pishave në të gjithë territorin e vendit.	
	Piralida e pishës (<i>Dioryctria sylvestrella</i> Ratz), problematike në bashkitë; Pukë, Dibër, Mat	
	Nematoda (<i>Bursaphelenchus xylophilus</i> et Buhner), në bashkitë; Shkodër, Pukë, Kukës, Mat, Bulqizë, Gramsh, Kurbin, Durës, Kavajë dhe Korçë.	
	Krasitësi (<i>Tonicus Minor</i> Htg), në bashkitë: Skrapar, Berat, Vlorë Përmet, Mat, Fier, Lushnjë	
	Skolitet e pishës (<i>Ips sexdentatus</i> Berner), në bashkitë: Skrapar, Tiranë, Vlorë, Berat.	

Pisha Mesdhetare	Hundëgjati i pishës (<i>Pissodes castaneus</i> De Geer), ku më i atakuar është në zonën e pishës së detit dhe pishës së egër në zonën bregdetare.	
	Nematoda (<i>Bursaphelenchus xylophilus</i> et Buhner), në bashkitë; Shkodër, Kurbin, Durës, Kavajë	
	Breshkëza e pishës së butë (<i>Toumeyella parvicornis</i> Cockerell), në bashkitë: Shkodër, Kurbin, Durës, Kavajë, Fier, Vlorë, etj.	
Bredh	Skolitet e trungut dhe degëve të bredhit (<i>Cryphalus piceae</i> Ratz dëmtues ky i gjendur në bashkitë: Vlorë, Tropojë, Berat, Skrapar, Kolonjë, Korçë dhe Përmet.	Rrëzimi i halave të bredhit (<i>Lophodermium nervisequum</i> D.C) në bashkitë: Tropojë, Vlorë, Kolonjë, Përmet etj. Nxirja e halave (<i>Trichosphaeria parasitica</i> Hartig në bashkitë: Tropojë, Pukë Korçë. Ndryshku kërpudhor i halave (<i>Hrysomya rhodendria</i>), i përhapur në të gjithë vendin.
	Turigjati i bredhit (<i>Pissodes piceae</i>), ku më i përhapur është në bashkitë; Përmet, Tropojë, Kolonjë.	
Selvi	Morri i selvisë (<i>cinara cupressi</i> Buckson në bashkitë; Berat, Vlorë, Përmet.	Kanceri i selvisë (<i>Seiridium cardinale</i>), në bashkitë: Berat, Përmet, Vlorë.
	Skolitet e selvisë (<i>Phlesinus aubie, thuyae</i> Pires), në bashkitë; Berat, Vlorë, Përmet.	

Ahu	Miza e Ahut (<i>Micola fagi</i> Hartig), në bashkitë; Tropojë, Kukës, Has, Pukë, Shkodër, Librazhd, Kolonjë, Korçë, Pogradec	Kanceri i ahut (<i>Nectia dittisima</i>), në të gjitha ahishtet e moçme
	Turigjati i ahut (<i>Rhynchaenus fagi</i> L.); në sipërfaqet monitoruese të bashkive; Kukës, Tropojë, Shkodër, Korçë, Fushë - Arrëz.	Vrugu i Ahut (<i>Phytophthora fagi</i>), në bashkitë: Shkodër, Kukës, Has
	Morri i ahut (<i>Phyllaphis fagi</i> L), është i përhapur në të gjitha sipërfaqet e monitorimit në shkallë vendi.	Kalbëzimi i ahut (<i>Fome fomentarius</i>), Librazhd, Has, Prrenjas (sipërfaqet e pa shfrytëzuara)
	Breshka e lëvores së Ahut (<i>Cryptococcus fagisuga</i> Lindinger); e përhapur në të gjitha ahishtet e moçme	
Dushqet	Vemja e dushkut (<i>Limantria dispar</i> L) në bashkitë: Maliq, Kukës, Has, Pukë, Shkodër, Mirditë, Librazhd, Pogradec, Gramsh, Librazhd dhe Kolonjë.	Hiri i dushkut (<i>Microsphaera alphetoides</i>), në bashkitë; Kukës, Has, Shkodër, Mat, Mirditë, Klos, Librazhd, Maliq, Pustec, Kolonjë, Korçë etj.
	Gjethpërdredhësja e dushkut (<i>Tortrix viridana</i> L), në bashkitë: Maliq, Pustec, Has, Mirditë, Mat, Kukës, Shkodër dhe Gramsh.	Kanceri i dushkut (<i>Cryphonectria parasitica</i>); në të gjitha dushkajat e trajtuara për dru zjarri në të gjithë territorin e vendit.
	Krizomela e dushkut (<i>Altica quercetarum</i>) në të gjitha dushkajat ku gjendet lloji Bulger.	Tharja e majave të lisit (<i>Botryosphaera sterensi</i>) në bashkitë; Kukës, Kolonjë, Mirditë, Mat etj.

	Procesionaria e dushkut (<i>Thaumetopoea processionea</i> L), në bashkitë; Pogradec, Maliq, Vlorë, Tiranë, Berat dhe Has. Matësi skeletues (<i>Erannis defoliaria</i> Cleave), në bashkitë; Kukës, Has, Pukë, Mirditë, Dibër. Skolitet e dushqeve (<i>Scolitus inricatus</i> Ratz.), në gjitha sipërfaqet e dushqeve në shkallë vendi.	Eshka e dushkut (<i>Polyperus dryophilus</i>); në dushkajat që kanë kaluar moshën e shfrytëzimit. Kalbëzimi i dushkut (<i>Armillaria mellea</i>), në bashkitë; Librazhd, Berat, Shkodër, Kukës etj
Gështenja	Krimbi i gështenjës (<i>Carpocapsa Splendona</i> Hb), në bashkitë: Tropojë, Shkodër, Kukës, Pukë, Tiranë, Pogradec.	Kanceri i gështenjës (<i>Cryphonectria parasitica</i>), e përhapur në të gjithë territorin e vendit.
	Turigjati i gështenjës (<i>Corculio elephas</i> Gyll) në bashkitë: Shkodër, Kukës, Mat, Librazhd, Korçë	Sëmundja e bojës (<i>Phytophthora cambirora</i>) e përhapur në të gjithë territorin e vendit.
	Minusja e gjetheve të gështenjës (<i>Titischeria complonella</i> Hb) në bashkitë: Shkodër, Kukës, Pukë, Pogradec.	Ndryshku i gështenjës (<i>Mycosparella maculiformis</i>, problematike për të gjitha masivet me gështenjë në vendin tonë.
	Grerëza aziatike e gështenjës, e përhapur në të gjithë territorin e vendit sidomos në masivet me gështenjë në: Tropojë, Shkodër, Malësi e Madhe, Pukë, Pogradec, etj.	

▪ *Shkalla e prekjës nga dëmtuesit për llojet halorë*




Figura 193 - Shkalla e prekjës nga dëmtuesit haloret 2024




Figura 194 - Shkalla e prekjës nga dëmtuesit haloret 2023

Për llojin pishë e zezë, përqindja e prekjës nga dëmtuesit, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 10.03%, kurse në vitin 2024 është 11.04 %, pra kemi një rritje 1.01%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojin e pishave mesdhetare,** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 5.89%, kurse në vitin 2024 është 6.44 %, pra kemi një rritje 0.55%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për llojin brendh,** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 5.03%, kurse në vitin 2024 është 5.48 %, pra kemi një rritje 0.45% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-**Për llojet halorë e tjerë,** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 8.02%, kurse në vitin 2024 është 8.31 %, pra kemi një rritje 0.29% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

▪ *Shkalla e prekjës nga dëmtuesit për llojet fletorë*




Figura 195 - Shkalla e prekjës nga dëmtuesit fletore 2024




Figura 196 - Shkalla e prekjës nga dëmtuesit fletoret 2023

- **Për llojin ah, mështëknë** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 8.75%, kurse në vitin 2024 është 8.88 %, pra kemi një rritje me 0.13%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 14.51%, kurse në vitin 2024 është 14.69 %, pra kemi një rritje 0.18%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 17.20%, kurse në vitin 2024 është 17.94 %, pra kemi një rritje 0.74%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

▪ ***Shkalla e prekjës nga sëmundjet për llojet halorë***




Figura 197 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet haloret 2024




Figura 198 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet haloret 2023

- **Për llojin pishë e zezë**, kemi, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 6.01%, kurse në vitin 2024 është 6.70 %, pra kemi një rritje 0,69%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojin e pishave mesdhetare**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 13.00%, kurse në vitin 2024 është 13.23 %, pra kemi një rritje 0.23%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për llojin bredh**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2022 ishte 8.94%, kurse në vitin 2023 është 9.44 %, pra kemi një rritje 0.50% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

-**Për llojet halorë e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 12.81%, kurse në vitin 2024 është 13.06 %, pra kemi një rritje 0.25% kurse në klasën e katërt nuk kemi.

▪ *Shkalla e prekjës nga sëmundjet për llojet fletorë*




Figura 199 - Shkalla e prekjës nga sëmundjet fletoret 2024




Figura 200 - Shkalla e prekjes nga sëmundjet fletoret 2023

- **Për llojin ah, mështeknë** kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 12.87%, kurse në vitin 2024 është 13.55%, pra kemi një rritje me 0.68%, kurse në klasën e katërt nuk kemi (fenomenin e tharjes komplet të drurëve).

- **Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 14.82%, kurse në vitin 2024 është 15.10 %, pra kemi një rritje 0.28%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

- **Për fletorët e tjerë**, kemi ndryshime të vlerave në krahasim me vitet e mëparshme, në klasën e tretë (61-100%) në vitin 2023 ishte 12.76%, kurse në vitin 2024 është 13.84 %, pra kemi një rritje 1.08%, kurse në klasën e katërt nuk kemi.

• Problematikat e hasura

Bazuar në gjendjen problematike që është parë vitet e fundit për llojin rrap (*Platanus orientalis*), në shtretërit e lumenjve; Shkumbin, Mat, Vjosë dhe Drino, janë kryer verifikime në terren të gjendjes së llojit rrap që shtrihet përgjatë brigjeve të këtyre lumenjve.

Në këto basene ujëmbledhës fenomeni i tharjes së llojit rrap ka disa vite që është çfaqur si fenomen;

Kjo tharje vërehet gjatë gjithë gjatësisë së shtreteve të lumenjve, ku janë të pranishëm drurë të tharë komplet, drurë të tharë rreth 50% të mass së tyre dhe drurë tek të cilët ka nisur tharja.

Fenomeni vërehet edhe në drurët që janë shumë pranë njëri tjetrit, një është i tharë kurse tjetri është në gjëndje të mirë vëgjetative.

Dëmtues më kryesor të konstatuar në këtë sipërfaqe monitoruese do të përmendim;

- Minuesja e gjetheve të rrapit (*Lithocolletis platania*. Stainton), Anekroza e rrapit (*Gnomonia veneta*.Kleb), (*Genomonion platani*.Kleb) dhe (*Gloeosporium platania*).

Një sëmundje tjetër e hasur në llojin bush është tharja e këtij lloji. Gjatë monitorimeve të kryera në terren, pothuajse në të gjithë arealin e përhapjes së llojit bush, është takuar tharja e këtij lloji. Ky fenomen është gjerësisht i përhapur në territoret e bashkisë Gramsh, Shkodër, Burrel, Vlorë, Maliq, Librazhd, etj.

Fenomeni i tharjes masive të llojit bush është i pranishëm në të gjitha sipërfaqet ku rritet, që nga pjesët e luginave të lumenjve Mat dhe Shkumbin edhe në lartësitë e masiveve qoftë si lloj më vete edhe si nën pyll.

Fenomeni i tharjes së llojit Hormoq në luginën e Valbonës është një fenomen që u konstatua gjatë këtij viti dhe është vetëm në drurë të veçantë.

Fenomeni i prekjes së llojit gështënjë nga grerëza Aziatike është i përhapur në të gjithë masivet me gështënjë, është një fenomen që është shfaqur para disa viteve por këtë vit pati shumë dëmtime në prodhimtarinë e llojit.

Fenomeni i prekjes se grumbujve pyjor të llojit pishë butë (*Pinus pinea* L), nga breshkëza e pishës së butë (*Toumeyella parvicornis*. Cockerell), në qarqet dhe bashkitë ku ky lloj zë një sipërfaqe të konsiderueshme, si zona bregdetare.

Për përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë fenomenin e tharjes dhe prekjën nga dëmtues dhe sëmundje të ndryshme mendojmë se duhet ndërmarë një studim më i hollësishëm. Për realizimin e këtij studimi duhet të bashkëpunohet me Universitetin Bujqësor; Fakultetin e Shkencave Pyjore, Fakultetin e Bujqësisë dhe Mjedisit (Departamenti i Mbrojtjes së Bimëve) dhe Fakultetin e Shkencave të Natyrës Tiranë.

Shkaqet kryesore që kanë ndikuar në gjëndjen shëndetësore të fondit pyjor janë;

1. Temperaturat ekstreme të ulta dhe të larta kane patur ndikimin e tyre në fenomenin e çngjyrosjas dhe të çhalëzimit si dhe atë të zjarreve të rëna para fillimit të vegetacionit.
2. Shkalla e prekjës nga dëmtuesit dhe sëmundjet ka qënë në varësi të ciklit biologjik të zhvillimit të tyre ku dëmtuesi i procesionares së pishës është shfaqur gjatë fundit të vitit kurse kanceri dhe hiri kanë qënë të favorshëm deri në fillimin e muajit korik.
3. Shfaqja e dëmtuesve të fletorve ka qënë në nivele më të ulta se ato të një viti më parë.
4. Ndikimi i faktorëve klimaterikë dhe petologjikë, si lagështira dhe temperaturat kanë qënë të favorshme për zhvillimin normal të drurëve.
5. Sipërfaqet e përshkuara dhe djegura nga fenomeni i zjarreve gjatë vitit 2023 ka qënë në vlera më të ulta si përse i përket sipërfaqeve të përshkuara dhe atyre të djegura pasi ky fenomen u përhap më shumë para se të fillonte vegetacioni.
6. Vazhdimi i fenomenit të tharjes të llojit rrap në luginën e Vjosës, Drinos, Shkumbinit dhe Mati ka qënë prezent.
7. Fenomeni i tharjes së llojit ekualipt, palmave dhe mimozave në vitin 2024 nuk ka qënë i pranishëm, kjo ka qënë edhe në varësi të temperaturave ekstreme të cilat këtë vit nuk ishin në nivele kritike.
8. Këtë vit patëm të pranishëm fenomenin e tharjes së llojit bush ne po thuaj në të gjithë arealin e tij si në sipërfaqet vetëm me këtë lloj por edhe në sipërfaqet ku vegjeton si nëngrumbull.
9. Fenomeni i prekjës së llojit gështënjë nga grerza aziatike e cila preku të gjitha masivet më këtë lloj, kjo prekje solli edhe uljen e prodhimitarisë së frutave për këtë vit.
10. Këtë vit për herë të parë u shfaq edhe fenomeni i tharjes të llojit hormoq në luginën e Valbonës.

7.5.2. Llojet drunore dhe bimët aromatiko mjekësore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje

Gjatë vitit 2024 është kryer monitorimi i llojeve drunore të këcënuara dhe në rrezik zhdukjeje të tilla si; Rrobulli (*Pinus heldreichii* Crist), Arneni (*Pinus peuce* Gris), Ilqja (*Quercus ilex* L), Rrenja (*Quercus robur* L), Lajthia e egër (*Corylus colurna* L), Mallagjeri (*Arbutus andrachne* L), Caraca e turnefortit (*Celtis turnefortii*), Venja (*Juniperus exelsa*), Mështekna (*Betula Pendula*), Valanidhi (*Quercus aegilops* L) dhe Gështenja e Kalit (*Aesculus hippocastanum*).

Të dhënat janë grumbulluar gjatë vizitave të kryera në terren gjatë periudhës së vegjetacionit, në gjithë territorin e vendit.

Tabela 56 - Vlerësimi për llojet drunore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje.

Statusi	Lloji pyjor	Bashkia	Ekonomia Pyjore	Vlerësimi
Vu D2	Rrobull	Bulqizë Dibër Gramsh	Liqeni i Zi Lurë Sogor, Mali i Grabovës, Holtë- Lukovë	Lartësia mesatare e grumbullit është 18 metra. Nënpylli përbëhet nga lloji dëllinjë, ndërsa si bimë barishtore takohen graminacet dhe leguminoset.. Në përgjithësi në të gjitha sipërfaqet e monitorimit, lloji ka një gjendje të mirë fitosanitare dhe vegjetative.
EN A1b	Arnen	Tropojë Dibër	Çerem Dragobi Lurë	Lloji është i përzier me llojin mështekën dhe ka drurë të rrallë të shpërndarë kryesisht rreth liqenit dhe në çelirat e rrugëve. Në këtë sipërfaqe lloji arne, bashkëshoqërohet me llojet bredh dhe ah. Nënpylli mungon.

EN A1b	Ilqe	Vlorë	Llogara	Grumbulli është në gjendje shumë të mirë vegetative. Ilqja në këtë sipërfaqe është e përzier me llojet qarr, mare, lofatë dhe shqopë dhe dëllinjë kokërrmadhe.
Vu A1b	Rrenjë	Fier	Kunorë	Lloji paraqitet në gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare.
EN A1b	Lajthi e egër	Korçë Has Libohovë	Gollomboc Tej drini i bardhë Çajup	Gjendja vegetative e drurëve është mesatare dhe 80% e tyre kanë majat e thara. Në Ekonominë pyjore “Tejdrini i Bardhë”, në lartësinë 950 metra mbi nivelin e detit janë takuar drurë të rrallë të llojit lajthi e egër me lartësi 3-5 metra. Llojet e tjera pyjore pjesëmarrëse janë, bunga, frashëri, krekëza, dëllinja, shkoza si dhe panjë mali.
Vu	Caraca e Tournefortit	Pustec	Gollomboc	Ky lloj ndodhet vetëm në këtë territor dhe numri i drurëve është shumë i vogël. Llojet e tjera pyjore me të cilat shoqërojnë caracën e Kaukazit janë; frashëri, fiku i egër, bulgeri, dëllinja etj. Bimësia barishtore është e familjes graminace dhe leguminose. Gjendja vegetative e këtij lloji duket e mirë.
CR 1b	Venja	Libohovë	Sheper Çajup	Drurët janë të rrallë të shpërndarë, në gjendje mesatare vegetative dhe ndonjë dru është i prekur nga tharja e majave. Ne Sheper, lloji paraqitet në gjendje të mirë vegetative,

Vu A2b	Drunakuqja	Përmet	Petran – Çarshovë, Petran-Zavalan, Ali Bostivan, Pagri	Gjendja vegetative e grumbullit të drunakuqes është e mirë, gjithashtu lloji ka gjendje të mirë fitosanitare.
CR B2e	Mështekën	Dibër Kukës	Kastriot-Sillovë Shishtavec-Zapod	Lloji i mështeknës është në gjendje të mirë vegetative.
CR A1a	Gështenjë e Kalit	Librazhd Tepelenë	Stravaj Kurvelesh	Drurët janë në gjendje të mirë vegetative dhe fitosanitare. Llojet pyjore të tjera të cilat bashkëshoqërojnë gështenjën janë; ah, frashëri, shkoza, lajthia, ndërsa si bimë barishtore kryesojnë llojet e familjes graminace, fieri etj
CR A1b	Hartina	Gramsh	Sogore-Mali I Graboves	Gjendja vegetative e grumbullit është shumë e mirë dhe arrin lartësinë mesatare 16.5 metër..
VU A1b	Tisi	Librazhd	Shebenik	Druri i Tisit gjendet mbi një tokë shkëmbore. Lloji Tis bashkëshoqërohet nga lloji Ah.
CR A1b	Valanidhi	Himarë	Borsh Pilur	Gjendja vegetative dhe fitosanitare është shumë e mirë ne Borsh. Valanidhi bashkëshoqërohet nga llojet prrall, shpatore dhe sherebelë e egër. Vegetacioni në Pilur është në kushte eksteme për shkak të mungesës së reshjeve, sidomos gjatë periudhës së verës.

Për disa prej llojeve si; Caracën e Kaukazit (*Celtis Tourneforti*), Rrenjën (*Quercus robur L*), Gështenjën e kalit (*Aesculus hippocastanum*), Lajthinë e egër

(*Corylus colurna L*) etj që janë në kufijtë ekstrem të rrezikimit, është e nevojshme ngritja e rrjetit të konservimit, ‘in-situ’ dhe, ‘ex-situ’ për këto lloje.

Shkaktarët për kërcënimin për zhdukje për llojet e mësipërme janë të ndryshëm dhe kryesisht si pasojë e ndryshimeve të treguesve klimatike apo prishjes së habitatit të tyre. Kërcënimi vjen edhe si pasojë e shfrytëzimit pa kriter të ndodhura në vitet e mëparshme apo zjarreve të shfaqura në arealin e vendndodhjes së tyre.

Duke patur parasysh rëndësinë që kanë këto lloje drunore, si dhe të rrezikuar për zhdukje, duhet në përkujdesje e veçantë për këto lloje drunore. Sensibilizimi i komunitetit rural për llojet e kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje, në vendet ku takohen këto lloje duke propaganduar vlerat e tyre dhe rrezikun që u kanoset, do të ishte tepër i nevojshëm, pasi do të ndikonte tek komuniteti për të treguar më tepër kujdes ndaj këtyre llojeve.

• Vlerësimi për bimët aromatike-mjekësore

Monitorimi është zhvilluar në sipërfaqe dhe potencial të madh prodhues në shkallë vendi si: Berat, Poliçan, Skrapar, Gjirokastrë, Libohovë, Dropull, Përmet, Korçë, Devoll, Maliq, Pogradec, Kolonjë, Kukës, Tropojë, Has, Shkodër, Pukë, Fushë-Arrëz, Malësi e Madhe, Vlorë, Himarë, Sarandë, Finiq, Konispol, Delvinë. Është kryer ngritja e siperfaqeve monitoruese në ato vende ku këto lloje kanë një shkallë mbulimi prej 15 %, ku madhësia e tyre varjon nga 25 m² për llojet Salep, (*Orchis. Ssp*) dhe Xhirokull, (*Colchicum autumnale*) deri në 50 m² për llojin e Çajit te malit (*Sideritis roesseri*), Sanzit, (*Gentiana lutea*), Boronica (*Vaccinium myrtillus*) dhe Sherbelës, (*Salvia officinalis*).

Sherebela




Figura 201 - Shpërndarja e sherebelës në Shqipëri

Meqënëse lloji i Sherebelës është një ndër bimët më kryesore aromatiko-mjekesore të vendit tonë dhe është mjaft e kërkuar nga tregu vendas dhe ai i huaj janë ngritur sipërfaqe në disa bashki. Për të bërë të mundur monitorimin e kësaj kulture, përveç kontrollit të sipërfaqeve të ngritura gjatë viteve paraardhëse, gjatë këtij viti janë ngritur dhe disa sipërfaqe të tjera në rajone të ndryshme të vendit tonë.

Gjëndja vegjetative dhe fitosanitare e sherbelës paraqitej shumë e mire. shqetësimi për informacionin e pakët që kishin Grumbulluesit e këtyre bimëve kanë informacion të pakët në lidhje me teknikat dhe kushtet e shfrytëzimit racional të kësaj pasurie. Ky është dhe një ndër problemet kryesore i cili po

ndikon mjaft negativisht dhe po bën të mundur që një pjesë e kësaj bimësie të rrezikohet për tu zhdukur.

Çaji i malit (*Sideritis roheseri*)

Nga verifikimi i bërë në terren, themi se numri i bimëve brenda sipërfaqes është i lartë dhe përsa i përket gjëndjes fitosantare dhe vegjetative, paraqiten shumë mirë. Megjithëse kjo zonë bën pjesë në kategorine e dytë të I.U.C.N, kategori e cila i takon statusit të Parkut Kombëtar, është vënë re se grumbullimi i llojit të Çajit të malit kryhet masivisht, pasi ai kërkohet mjaft si nga tregu vendas ashtu dhe nga tregu i huaj. Nga kontrolli dhe verifikimi i numurit të bimëve të bëra brenda kësaj sipërfaqeje rezultoi se ka gjendje të mirë fitosanitare.

Salepi (*Orchiss. sp*)

Nga kontaktet e kryera me specialistët e Shërbimit Pyjor pranë Bashkisë dhe me grumbullues të këtij lloji rezulton se kjo kulture sa vjen dhe po rrezikohet. Kjo gjë u vu re edhe në sipërfaqen e ngritur pasi rezultoi se kishim një numër bimesh të pa ndryshuar nga viti kaluar dhe një gjëndje vegjetative e cila është më e dobët se në vitin parardhës, gjë kjo e cila vinte si pasojë e mos zbatimit të rregullave të grumbullimit nga ana e personave të palicensuar.

Xhirokulli (*Colchicum autumnale*)

Për të bërë të mundur monitorimin e këtij lloji në rajonin e marrë në studim është bërë verifikimi i sipërfaqes monitoruese të ngritur në zonën e Ballabanit (Përmet), ku paraqitet kjo situatë. Përsa i takon gjëndjes vegjetative të bimëve, themi që kanë një gjëndje të mirë vegjetative dhe se ka një rritje të lehtë të numrit të bimëve.

Boronicë (*Vaccinium myrtillus*)

Është kryer verifikimi në sipërfaqen monitoruese me boronicë në Tropojë, Kukës dhe Bulqizë. Gjëndja vegjetative dhe fitosanitare e boronices në këtë sipërfaqe monitoruese paraqitet shumë e mire, kjo si pasojë e ndërhyrjes së ulët të faktorit human dhe klimës së përshtatshme.

7.5.3. Mirëmbajtja, Konservimi dhe Përmirësimi i Diversitetit Biologjik të Ekosistemeve Pyjore në habitatin e dushk dhe gështenjë

Dushqet : Ne vendin tone per nga perhapja dhe madhesia e siperfaqes dushqet jane llojet qe zene vendin e pare 32% te siperfaqes totale te fondit pyjor, ndersa rritja ne volum e tyre eshte mjaft e ulet ($47\text{m}^3/\text{ha}$). Kjo prodhimtari kaq e ulet shpjegohet me lartesine e vogel hipsometrike qe ze lloji me qenien pran qendrave te banuara si dhe me krasitjen per gjeth dhe kullotja e vazhdueshme si rrjedhoje popullatat e dushqeve pothuajse jane totalisht te shfrytëzuara dhe ne shumicen e rasteve te degraduara.

Në vendin tone, dushkaja gjetherënëse (Bungebuta) eshte e perhapur ne Çermenik, Gramsh, Permet, Tepelene etj por si rezultat i prerjes e kullotjes pa kriter paraqitet me pamje te degraduar. Nga 332,000 ha qe zene dushqet sot vetem 81.4 mijë ha jane trungshte ne te cilat nderhyrja e njeriut eshte ne shkallen maksimale. Ne teresi trungshtet e lisit jane me moshe te re rreth 60 vjeçare (58%) ndersa me moshe mbi 100 vjeç jane vetem 7% e tyre.

Ne gjendjen qe jane sot pyjet e lisit eshte e veshtirë te thuhet e te mendohet per te konservuar popullatat me te mira, qendrat ku dushkajat manifestojne rritje te bujshme nuk japin optimumin e pontencialit te tyre biologjik, per shkak te shkalles se larte te demtimit e degradimit te tyre.

Përsa i përket burimeve gjenetike dhe konservimit, jane verifikuar ne terren grumbujt pyjore te llojit dushk ne ekonomite pyjore Perrenjas-Katerlis te Gramshit, Lepushe dhe Kuterman te Librazhdit, Gorice-Korce etj.

Gjate ekspeditave te kryera ne terren jane grumbulluar te dhena si vendi ku rritet specia, koha e lulezimit dhe frutifikimit, preferencat e habitatit duke perfshire ketu preferencat per topografinë, pedologjinë dhe gjeologjinë, sistemi i shumezimit dhe statusi i konservimit;

Gështenja : Gështenja (*Castanea sativa* Mill) arrin një lartësi prej 20-35 metrash me një diametër në trung që shpesh shkon në 2 metra. Aktualisht në Shqipëri grerëza aziatike e gështenjës ka bërë dëme të mëdha në zonën Shkodër-Tropojë (duke filluar nga zona e Reçit në Malësinë e Madhe) insekti është konstatuar në Shqipërinë e Mesme dhe duhen studime të mëtejshme nëse insketi dëmtues ka

arritur në kufirin më jugor të kultivimit të gështenjës që është Qafë-Muzinë, bashkia Sarandë.

7.5.4. Treguesit e fondit pyjor, kullosor dhe bimët aromatike mjekësore

7.5.4.1. Fondi pyjor

Fondi pyjor (sipas pronësisë, formës së qeverisjes, sipas llojeve, volumeve).

Bazuar në të dhënat kadastrale te vitit 2024 pyjet në Shqipëri shtrihen në një sipërfaqe 1.146.725 ha që përfaqëson 67 % të fondit pyjor dhe kullosor. Kullotat dhe livadhet zenë një sipërfaqe 449.175 ha ose 26 % të fondit pyjor dhe kullosor. Sipërfaqet më bimësi pyjore dhe inproduktive që janë pjesë e fondit pyjor zënë një sipërfaqe 121.351 ha ose 7,0 % të këtij fondi.

Tabela 57 - Shpërndarja sipas mbulesës së tokës

Viti	Pyje		Kullota		Sipërfaqe me bimësi pyjore		Djerr + Sip. inproduktive		Gjithsej	
	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%	Sip.Ha	%
2024	1,146,725	66.2	449,175	25.9	74,158	4.3	61,844	3.6	1,731,901	100

Në mbështetje të legjislacionit në fuqi fondi pyjor është i ndarë në: pyje publike (që përfshijnë pyjet që menaxhohet nga shteti dhe nga Njësitë e vetqeverisjes vendore) dhe pyje privatë (që janë në pronësi të privatëve).

Tabela 58 - Shpërndarja e pyjeve sipas pronësisë

Pronesia	Sipërfaqja ha	% ndaj totalit	Volumi	% ndaj totalit
Pyje publike	1,117,945	97	50,816	94

Pyje private	28,780	3	3,247	6
Total	1,146,725	100	54,063	100

Fondi pyjor sipas formës së qeverisjes

Në raport me sipërfaqen pyjore, cungishtet zënë 46% të sipërfaqes së fondit pyjor, por në raport me volumin në këmbë zënë vetëm 18% (10 Milion metër kub). Kjo për shkak të gjendjes së dobët të zhvillimit dhe dominimit të grumbujve me moshë të re. Në pyjet trungishte (halorë dhe fletorë), grumbulli e ka origjinën nga fara (natyralë ose të mbjellë) dhe periudha e rrotacionit ndryshon sipas klasës së prodhimit (80-105 vjet). Në cungishte, rigjenerimi i specieve fletore ndodh nga lastarët që dalin nga cungjet e drurëve dhe periudha e rrotacionit është më e shkurtër (40-50 vjet).

Pyjet trungishte megjithëse zënë 35% të sipërfaqes pyjore kanë peshën kryesore të volumit në këmbë me rreth 83%, ekuivalent me një volum në këmbë prej 45 Milion metër kub.

Pyjet cungishte zënë 41% të sipërfaqes pyjore ose 41% te pyjeve, ekuivalent me një volum në këmbë prej vetëm 5 Milion metër kub, shifer kjo tejet e ulët krahasuar me trungishtet.

Ndërsa shkurret, të njohura për diversitetin e tyre llojor, zënë 24% të sipërfaqes totale pyjore dhe në raport me volumin kanë një peshë më të vogël se dy format e tjera të menaxhimit duke zënë vetëm 4% të volumit në këmbë, ekuivalent me rreth 4 Milion metër kub.

Vleresimi i materialit drusor te klasifikuar sipas formave te menaxhimit te pyjeve eshte gur themeli per zbatimin dhe vleresimin e teknikave per menaxhimin e qëndrueshem të pyjeve. Shpërndarja e volumeve për format e qeverisjes së pyjeve është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 59 - Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumit në bazë të formës së qeverisjes

Forma e qeverisjes	Sipërfaqia		Volumi	
	(1000 ha)	Përqindja	(milion m³)	Përqindja
Trungishte	402	35	45	83

Cungishte	471	41	5	9
Shkurre	273	24	4	7
Totali	1,147	100	54	100

Kjo shpërndarje e fondit pyjor në raport me sipërfaqen dhe volumin në këmbë duhet të merret në konsideratë nga politik-bërësit gjatë përgaditjes së dokumentit të strategjisë së zhvillimit të sektorit pyjor apo edhe të programit për zhvillimin e këtij sektorit për të rritur sipërfaqen me trungishte si forma e qeverisjes me potencial më të lartë të prodhimtasisë.

Fondi pyjor sipas llojeve

Vlerësimi i shtrirjes dhe volumit që mbartin pyjet sipas përberjes llojore na lejon të llogarisim disponibilitetin e tyre për furnizimin me produkte pyjore duke ruajtur ekuilibrat natyrore të shtimit të tyre.

Tabela 60 - Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve bazuar në përbërjen llojore.

Përbërja llojore	Sipërfaqja		Volumi	
	(1000 ha)	Përqindja	(milion m³)	Përqindja
Halorë	135	11	12	21
Shoqërimet pyjore të dominuara nga halorët	39	4	4	7
Shoqërime pyjore të dominuara nga fletorët	57	5	4	7
Fletorë/gjethegjerë	916	80	34	64
Totali	1,147	100	54	100

Pyjet e Shqipërisë dominohen si në sipërfaqe ashtu edhe në volum nga pyjet fletorë dhe kjo është e lidhur ngushtësisht me pozicionin gjeografik dhe ekologjik të vendit. Kështu me shumë se 80% e pyjeve të vendit tonë kanë në përbërjen e tyre llojet fletore të cilët kanë mbi 70% të volumit drusor.

Fondi pyjor sipas tipeve të pyllit

Klasifikimi i pyjeve sipas tipeve është shumë i rëndësishëm për raportimin dhe monitorimin lidhur me menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve”.

Tabela 61 - Shpërndarja e sipërfaqeve/zonave pyjore sipas tipit

Tipi i pyllit		Sipërfaqia	
		(1000 ha)	Përqindja
Pyje qarri, pyje shparthi, pyje bunge	THO	231	22
Pyje bunge, pyje shkoze	SOH	128	13
Pyje malorë ilirikë ahu	IMB	125	10
Pyje të tjerë termofilë gjetherënës	OTD	118	10
Pyje të tjerë sklerofitë, karakterizuar nga një vegetacion me mbizotërim dafine(<i>lauriphyllus</i>)	MSO	95	8
Pyje me pishë të zezë mesdhetarë dhe të Anadollit	MAP	87	7
Pyje të tjera mezofitë gjetherënës	OMD	73	6
Pyje Moezianë malorë ahu	MMB	64	5
Pyje me dushqe mesdhetarë përherë të blertë	MEO	58	5
Pyje dëllinjash mesdhetare	MJU	29	2
Pyje me pishë mesdhetare	MPF	28	2
Tipe të tjera pyjesh (ASP, BE, TD, MAF, PNS, RIF, FLF, SAM, PNN, CM, FP, AC)		103	10
Totali i përgjithëm		1147	100

Është për tu marrë në konsideratë gjatë fazës së planifikimit se 10% e sipërfaqes së mbuluar nga pyjet e ahut kanë rreth 40% të lëndës drusore (rreth 23 milion m³) dhe 14% të sipërfaqes të mbuluar me pyje halorë që zotërojnë rreth 24% të lëndës drusore (afërsisht 15 milion m³).

Shpërndarja e sipërfaqes pyjore dhe volumit për klasat e moshës

Analizimi i klasave të moshës ndarë sipas forms së qeverisjes është shumë e rëndësishme për tu analizuar mbasi ky tregues ka të bëjë me shpërndarjen diametrike të drurëve në pyje sipas formës menaxhese, dy elemnte që shërbejnë për përcaktimin e disponueshmerisë së pyllit për lëndë druri aq me tepër si rregullatore për normalizimin e ciklit të prodhimit të grumbujve pyjorë.

Për trungishtet

Tabela 62 - Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës të trungishteve

Sistemi i qeverisjes	Klasat e moshës	Sipërfaqia		Volumi	
		(1000 ha)	Përqindja	(milion m³)	Përqindja
Trungishte	0-20 vite	15	4	0	1
	21 - 40 vite	79	20	4	22
	41 - 60 vite	98	24	6.8	28
	61 - 80 vite	77	19	8.4	19
	81 - 100 vite	69	17	8.7	15
	101 - 120 vite	34	8	6.2	8
	121 - 140 vite	13	3	3	3
	141 - 160 vite	7	2	2.1	2
	>160 vite	10	2	3.2	2
	Grand Total	402	100	42.4	100

Nga sipërfaqia totale rreth 402 mijë ha janë trungishte, 67% e trungishteve janë pyje të rinj (më pak se 81 vjeçarë) dhe vetëm 34% janë pyje të pjekur/të arrirë (më të vjetër se të 80 vjeçarë). Nga pyjet e pjekur vetëm 17% janë mbi 100

vjeçarë. Disponueshmeria e furnizimit me lëndë druri është vetëm në 34% të pyjeve me regjim trungishteje.

Paraqitja grafike jep një konfigurim të qartë të shpërndarjes së klasave të moshës në trungishte ku vihet re përqëndrimi i volumit në moshat e reja apo klasat e ulëta të moshës, si dhe një shpërndarje jouniforme e volumit të lëndës drusore në kategoritë e klasave të moshës.

Për cungishte.

Nga sipërfaqia totale e rreth 471,000 ha pyje cungishte, 96% janë më të reja se 40 vjeç dhe vetëm 4% e tyre janë pyje cungishte të pjekur/të arrirë. Disponueshmeria e furnizimit me lëndë është vetëm në 4% të pyjeve me regjim cungishteje, shifër kjo tejet e ulët.

Tabela 63 - Shpërndarja e sipërfaqes dhe volumit për klasat e moshës për pyjet cungishte.

Sistemi i qeverisjes	Klasat e moshës	Sipërfaqia		Volumi	
		(1000 ha)	Përqindja	(milion m3)	Përqindja
Cungishte	0 -10 vite	33	7	0	0.2
	11 -20 vite	207	44	1.7	22.8
	21 -30 vite	160	34	4	46
	31 - 40 vite	50	11	3	23
	41 - 50 vite	16	3	1	6
	>50 vite	5	1	0.3	2
	Totali	471	100	10	100

Paraqitja grafike jep një konfigurim të qartë të shpërndarjes së klasave të moshës në cungishte ku vihet re përqëndrimi i volumit në moshat e reja apo klasat e ulëta të moshës. Grafiku i shpërndarjes së klasave të moshës në cungishte.

Për shkurret

Tabela 64 - Shpërndarja e sipërfaqeve dhe volumeve për klasat e moshës për shkurret

Sistemi i qeverisjes	Klasat e moshës	Sipërfaqia		Volume	
		(1000 ha)	Përqindje	(milion m3)	Përqindje
Shkurrë	0 - 5 vite	5	2	0	1
	6 - 10 vite	44	14	0.4	4
	11 - 15 vite	98	37	1.9	13
	16 - 20 vite	93	35	2.1	60
	21 - 25 vite	25	9	0.8	15
	26 - 30 vite	2	1	0	1
	>30 vite	6	2	0.1	6
	Grand Total	273	100	5.3	100

Nga sipërfaqia totale e rreth 273.300 ha shkurre, 88% janë më të reja se 20 vjeç dhe vetëm 12% janë më të pjekura/të arrira. Kjo do të thotë që: Pyjet e Shqipërisë kanë një strukturë të çrregullt lidhur me klasat e moshës, dhe kjo përbën një sfidë për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve. Edhe pse Shqipëria është një vend i pasur me pyje, nuk disponon shumë zona për shfrytëzim. E fundit por jo më pak e rëndësishme, pyjet e Shqipërisë nuk janë në një fazë intensive rritjeje.

Rritja vjetore në pyje sipas mënyrës së qeverisjes dhe sipas llojeve.

Rritja vjetore në pyje sipas mënyrës së qeverisjes

Të dhënat e strukturës së moshës në raport me volumin në këmbë treguan se në të tre format e menaxhimit kemi një dominim të grumbujve të rinj. Për rrjedhojë pritet që rritja e këtyre grumbujve të jetë e lartë për shkak se shumica e grumbujve pyjore bëjnë pjesë në fazën e rinisë dhe të maturimit. Llogaritja e

rritjes sipas formave të menaxhimit shërben për të llogaritur edhe mundësinë vjetore të shfrytëzimit ose prerjen e lejuar vjetore të pyjeve në Shqipëri.

Tabela 65 - Rezultatet e rritjes mesatare në volum per tre format e qeverisjes

Forma e qeverisjes	Klasat e moshes	Siperfaqja ne ha	Vellimi ne m ³	Rritja mesatare ne volum (m ³)	Volumi mesatar per ha
Trungishte	0-20 vjet	13267.5	43602.7	4360.3	3.3
	21 - 40 vjet	76951.4	3950677.3	131689.2	51.3
	41 - 60 vjet	92872.4	6814780.6	136295.6	73.4
	61 - 80 vjet	74828.7	8439503.8	120564.3	112.8
	81 - 100 vjet	65276.1	8684408.9	96493.4	133.0
	101 - 120 vjet	34495.5	6193953.4	56308.7	179.6
	121 - 140 vjet	12736.8	3040146.4	23385.7	238.7
	141 - 160 vjet	7429.8	2059485.6	13729.9	277.2
	>160 vjet	10083.3	3174381.9	19839.9	314.8
Total		387,941.4	42,400,940.3	602,667.0	109.3

Forma e qeverisjes	Klasat e moshes	Siperfaqja ne ha	Vellimi ne m ³	Rritja mesatare ne volum (m ³)	Volumi mesatar per ha
	0 -10 vjet	33434.1	43502.1	8700.4	1.3

Cungishte	11 -20 vjet	247306	1683344.5	112223.0	6.8
	21 -30 vjet	180437.9	4001279.9	160051.2	22.2
	31 - 40 vjet	70052.4	3028202.9	86520.1	43.2
	41 - 50 vjet	16451.7	1014895.4	22553.2	61.7
	>50 vjet	5307	260930.6	5218.6	49.2
Total		552,989	10,032,155.4	395,266.5	18.1

Forma e qeverisjes	Klasat e moshes	Siperfaqja ne ha	Vellimi ne m³	Rritja mesatare ne volum(m³)	Volumi mesatar per ha
Shkurre	0 - 5 vjet	4776.3		-	-
	6 - 10 vjet	36618.3	408267.7	54435.7	11.1
	11 - 15 vjet	93403.1	1882560.3	150604.8	20.1
	16 - 20 vjet	91280.3	2126387.6	118132.6	23.3
	21 - 25 vjet	22820.1	779369.5	33885.6	34.1
	26 - 30 vjet	1592.1	39872.3	1424.0	25.0
	>30 vjet	5837.7	60978.4	2032.6	10.4
Total		256,327.9	5,297,435.8	360,515.4	20.6

Rritja vjetore totale e pyjeve në shkallë kombëtare nga llogaritjet rezultoi 1,36 milion metër kub në vit. Nëse bëjmë një bilanc midis rritjes vjetore të pyjeve (1,36 milion m³) e llogaritur nga IKPK 2021. Në mënyrë që të kemi një akumulim të volumit në këmbë të materialit drusor duhet që çdo vit të vilet një sasi materiali drusor e cila të jetë më e vogël se rritja vjetore në volum psh; 80-

85% e kësaj rritje. **Rritja mesatare ne volum (m³/vit): 1358449 m³/vit (602667+395267+360515).**

Rritja vjetore në pyje sipas llojeve.

Mbështetur në të dhënat që disponon AKP-ja: si dhe të dhënat e kadastrës dhe ato të studimeve të kryera nuk ka të dhëna të plota për rritjen vjetore të secilit lloj pyjor, kjo është e lidhur edhe me mungesën e hartimit të planeve të menaxhimit të pyjeve dhe kullotave në shkallë kombëtare.

- **Sasia vjetore e vjeljes, shfrytëzuar, ndarë në lëndë punimi e dru zjarri.**

Mbështetur në të dhënat që disponon AKP-ja: si dhe të dhënat e mara nga MTM-ja sipas mundësisë vjetore të miratuar për secilën bashki për plotësimin e nevojave me dru zjarri për entet dhe komunitetin, për vitin 2024 janë prodhuar ose siguruar nëpërmjet të prerjeve rigjeneruese rreth 56 mijë m³ lëndë drusore në këmbë dhe kjo e detajuar në lëndë ndërtimi dhe dru zjarr jepet si më poshtë: lëndë ndërtimi 1965 m³ dhe dru zjarri 53187 m³

- **Sasia e biomasës në pyje**

Biomasa e pyjeve është një variabël i rëndësishëm për vlerësimin e sekuestrimit të karbonit. Në kuadrin e IKPSH nuk janë bërë studime të veçanta për vlerësimin direkt të biomases. Gjithashtu nuk kanë qenë të disponueshme studime të kryera në Shqipëri që mund të lejonin nxjerrjen e faktoreve të konversionit. Për të vlerësuar me përafërsi biomason totale të pyjeve të Shqipërisë janë përdorur faktoret e konversionit nga studimet e AUCLAIR në Francë. Për drurë të veçante funksionet janë:

$$\begin{aligned} B &= 0.729 * V - 3.3 && \text{për pyjet e larte, dhe} \\ B &= 0.569 * V + 7.9 && \text{për cungishtet} \end{aligned}$$

Ku: B= biomasa në kg

V= vëllimi i drurit në dm³ (deri në diametrin minimal 7 cm)

Në interpretimin e rezultateve duhet të mbahet parasysh që këto shifra nuk janë saktësisht rezultate të inventarizimit, por janë bazuar në vëllimin drusor të nxjerre nga inventarizimi i pyjeve në Shqipëri dhe studimet nga Franca japin vetëm një vlerësim të biomases. Ndarja e biomases në tipet e pyjeve është vetëm

nje vleresim i bazuar ne numrin e siperfaqeve prove qe bien brenda nje tipi te dhene pylli, i cili ne disa raste eshte mjaft i ulet.

Burimi: t/ha nga punimet fushore te inventarizimit (Volumi/ha) dhe te dhenat e literatures, siperfaqja e llogaritur si perqindje e tipit te pyllit te siperfaqes prove nga punimet fushore te terrenit, siperfaqja pyjore nga SKMT

Biomasa totale e pyjeve eshte rreth 53 milion ton, nga e cila 84 % gjendet ne siperfaqen e pyjeve te larte. Ne pyjet e larte biomasa per hektar eshte 96 t/ha, ne cungishtet 13 t/ha dhe ne siperfaqen me shkurre 0.27 t/ha. Biomasa mesatare per hektar, e llogaritur per krejt siperfaqen e pyjeve eshte 34 t/ha.

• **Pyjet dhe kullotat si sekuestrues të karbonit**

Mbështetur në formulat dhe ekuacionet standarte është kryer përlllogaritja e biomasës që kanë pyjet dhe kullotat në shkallë vëndi. Po dhe për llogaritjen e sekuestrimit të karbonit u krye llogaritja për karbonin e sekuestruar nga pyjet dhe kullotat si dhe karboni i sekuestruar ne tokë.

Në mënyrë të detajuar të dhënat e përlllogaritura rezultatat jemen në tabelën e më poshtëme.

Tabela 66 - Siperfaqja dhe vellimi i pyjeve për sekuestrimin e karbonit

Forma e menaxhimit	Siperfaqja ne ha	Siperfaqja ne %	Volumi ne (m³)	Bt = 0.729*V-3.3 (t); Bc = 0.569*V+7.9 (t)	Ton C	Ton Co2	Karbon ne toke (ton/ha)	Karbon ne toke	Total
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
Trungishte Fletore	235100	13.8	27475582	20029696	10014848	36654344	75.48	17745348	27760196
Trungishte Halore	152841	9.0	14925358	10880583	5440291	19911466	13.87	2119905	7560196
Cungishte	552989	34.4	10032155	5708304	2854152	10446196	75.48	41739610	44593762
Shkurre	256328	13.0	5297436	3014249	1507124	5516075	65.13	16694643	18201767
Rangelands	30781	2.2	77555	44137	22068	80770	10.5	323201	345269
Kullota verore	438889	26.2	164587	119981	59990	219565	5.0	2194445	2254435
Kullota dimerore	36618	1.4	49263	28039	14019	51311	5.0	183090	197109
Totali	1703546	100.0	58021936	39824987	19912494	72879727		81000241	100912734

Pyjet janë ekosistem i madh i kapjes së karbonit. Sasia e karbonit stokohet jo vetëm në pyll, tokë, por edhe në produktet drusore. Nga llogaritjet rezultoi se sasia e C e stokuar në pyjet në Shqipëri është 100.9 milion ton C dhe 80% e kësaj

sasie ekuivalente me 81 milion ton C stokohet në tokat pyjore dhe 20% (19.9 milion ton C) stokohet në biomasën pyjore.

Pyjet trungishte japin kontributin kryesor në stokimin e C me 78% e ndjekur nga cungishtet që stokojnë rreth 14% të sasisë së C dhe vetëm 8% e C stokohet nga shkurret. Pyjet trungishte fletorë kontribojnë me 51% (10 milion ton) në stokimin e karbonit, kurse pyjet trungishte halorë stokojnë 27% të C (5.4 milion ton).

• **Mundësia vjetore e shfrytëzimit.**

Për llogaritjen e mundësisë së shfrytëzimit janë përdorur dy metoda silvikulturore dhe kameraliste pasi këto janë më të sakta dhe që përshtaten më shumë me natyrën e pyjeve në vëndin tonë. Metoda silvikulturore mer në konsideratë 80% kundrejt rritjes mesatare në volum, metoda kameraliste mer si mundëi shfrytëzimi 85% kundrejt rritjes mestare në volum.

Tabela 67 - Mundësia vjetore e shfrytëzimit.

	Mundësia e shfrytezimit	
	Metoda Silvikulturore	Kameraliste
Trungishte	723398.4	514497
Cungishte	215201.4	245945
Shkurre	150330.4	400881
Mundësia vjetore totale	1088930.2	1161323
Përqindja kundrejt rritjes mesatare në volum	80%	85%

Midis të dyja metodave te perlllogaritjes se mundesise së shfrytëzimit kemi një diferencë afërsisht 80000 m³. Ndryshime ka edhe midis formave të menaxhimit.

7.5.4.2 *Fondi kullosor*

Fondi kullosor sipas pronësisë

Kullotat, sipas periudhes kur ato kulloten me intensivisht, është ne vartesi: te relievit, klimes dhe lartesisë mbi nivelin e detit. Mbështetur në dokumentacionin që disponohet rreth 90% e sipërfaes kullosore është në pronësi publike dhe vetëm 10% është në pronësi private.

Tabela 68 - Fondi kullosor sipas pronësisë

Pronësia	Sipërfaqja, ha	% ndaj totalit
Kullota publike	455.658	90
Kullota private	50,629	10
Total	506.287	100

Sipërfaqja e kullotave sipas tipit të kullotjes.

Kullotat, zënë një sipërfaqe totale që është rreth 506287 ha, e shpërndarë në format e përdorimit siç paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 69 - Sipërfaqja e kullotave sipas tipit të kullotjes.

Sipërfaqja e kullotave sipas tipit të kullotjes	Sipërfaqe (ha)	Sipërfaqe
Verore	321.604	63.5%
Dimrore	184.683	36.5%
Total	506.287	100 %

Kullotat verore janë një burim i rëndësishëm të ardhurash nëse ato përdoren në një mënyrë të qëndrueshme kur bëhet shtegëtimi i bagëtive në këto kullota gjatë verës, siç është bërë tadicionalisht vite më parë.

Kapaciteti mbajtës i fondit kullosor.

Mbështetur në të dhënat që disponon AKP-ja nga monitorimet e realizuara në terren, si dhe të dhënat e raportuara nga strukturat e pyjeve pranë Njësisë të

Vetqeverisje Vendore për vitin 2024 si dhe inventari i kullotave te realizuar vite më parë rezulton se: kapaciteti mbajtës është afërsisht 1,518,861 krerë pa llogaritur kullotjen e bagëtive të dhirta edhe në fondin e pyjeve me shkure.

Përbërja floristike e kullotave

Mbështetur në të dhënat që disponon AKP-ja nga monitorimet e realizuara në terren, si dhe të dhënat e raportuara nga strukturat e pyjeve pranë Njësive të Vetqeverisje Vendore për vitin 2024 si dhe inventari i kullotave te realizuar vite më parë rezulton se:

Përbërja e specieve është vlerësuar/përcaktuar për tre grupe kryesore bimore (Graminore, Bishtajore dhe të ndryshme) në sipërfaqen provë 25m²,me rreze 2.82 metra, kundrejt mbulesës bimore.

Tabela 70 - Sipërfaqja e kullotave sipas grupit të specieve bimore.

Sipërfaqja e kullotave sipas grupit të specieve bimore	Sipërfaqe (ha)	Sipërfaqe %
Mbulesë me graminore	335.508	66.3%
Mbulesë me leguminose	129.188	25.5%
Mbulesa me lloje te tjera	41.591	8.2%
Total	506.287	100 %

Gjëndja shëndetësore në fondin kullosor.

Mbështetur në të dhënat që disponon AKP-ja nga monitorimet e realizuara në terren, si dhe të dhënat e raportuara nga strukturat e pyjeve pranë Njësive të Vetqeverisje Vendore për vitin 2024 si dhe inventari i kullotave te realizuar vite më parë rezulton se: bimësia e fondi kullosor nuk është e prekur nga dëmtues dhe sëmundje të ndryshme.

7.5.4.3 Sipërfaqja e djegur nga zjarret në fondin pyjor dhe kullosor.

Të dhënat e sipërfaqeve të prekura nga zjarret per vitin 2024 janë grumbulluar nga 61 bashkitë nëpërmjet informacionit të raportuar nga bashkitë bazuar në vlerësimet e specialistëve të sektorit të pyjeve. Në fondin pyjor/kullosor në administrimin e Bashkive ka pasur në total 269 raste zjarret, nga të cilat:

- 213 raste zjarresh në fondin pyjor
- 56 raste zjarresh në fondin kullosor

Viti 2024 është karakterizuar nga një situatë me raste te shumta dhe sipërfaqe të konsiderueshme të zjarreve kryesisht gjate muajve korrik, gusht dhe shtator ku;

- Sipërfaqja totale e përshkuar nga zjarret në pyje dhe kullota -12.435 ha
- Sipërfaqja totale e djegur nga zjarret në pyje dhe kullota- 6.127 ha
- Sipërfaqja totale e prekur nga zjarret në rang vendi në pyje dhe kullota -18.562 ha

Tabela 71 - Numri i zjarreve, sipërfaqet e përshkuara dhe të djegura pyje/kullota , 2024

Nr. i zjarreve në pyje dhe kullota	Sip. e përshkuar në pyje, ha	Sip. e përshkuar në kullota, ha	Sip. e djegur në pyje, ha	Sip. e djegur në kullota, ha	Dru i djegur plotesisht m ³	Dru i djegur por perdorshe m m ³
269	4018	8417	4018	2109	1420	1977

Sipërfaqet e dëmtuara nga faktorët të tjerë atmosferikë, si fortuna, dëbora etj.

Mbështetur në të dhënat që disponon AKP-ja nga monitorimet e realizuara në terren, si dhe të dhënat e raportuara nga strukturat e pyjeve pranë Njësive të Vetqeverisje Vendore për vitin 2024 rezulton se: nuk kemi pasur sipërfaqe të prekura nga faktorët atmosferikë si fortunat dhe dëbora.

Krahasimi me vitin 2023 i zjarreve dhe sipërfaqeve të përshkuara dhe të djegura në pyje/kullota paraqitet në tabelën në vijim.

Viti	Nr. i zjarrev e në pyje dhe kullota	Sip. e përshk uar në pyje, ha	Sip. e përshkr uar në kullota, ha	Sip. e djegur në pyje, ha	Sip. e djegur në kullota , ha	Dru i djegur plotesi sht m³	Dru i djegur por perdorshe m m³
2023	150	1563	438	307	521	2722	5938
2024	269	4018	8417	4018	2109	1420	1977

Gjatë 2024, kemi rritje të numrit të zjarreve dhe sipërfaqes të pëshkruar dhe të djegur në pyje dhe kullota.

7.5.4.4 Bimët aromatike mjekësore

Prodhimet e dyta të bimeve mjekësore aromatike

Mbështetur në dokumentacionin e inventareve të bimëve aromatike dhe mjeksore të realizuara në vitet e mëparshme dhe të përditësuara rezulton: Në shkallë vëndi rriten 252 lloje bimësh mjeksore dhe aromatike ku vetëm drunore janë 66 lloje. Sipërfaqja ku shtrihen këto bimë është 591908 ha dhe drunoret zënë 342049.2 ha ne total **933,957 ha**.

Tabela 72 - Prodhimi i përgjithshëm bruto sipas inventarit dhe sasia e grumbulluar ne vitin 2024

Lule	Gjethe	Herba	Fruta	fara	esenca te ndryshme	bime te ndryshme	Levore	Rrenj+ Tub	Bis+ sytha	Myshk	Totali prodhim, eksport	
1879	10494.3	5190.2	7216.9	106.1			2938.61	75297.8	36202	853.2	140178	Prodhim(ton)
272254	773186	5815485	467488	34244	29197	5019618	32465	21401	2600	0	12467938	Eksport (Kg)

Tabela 73 - Llojet e bimeve medicinale dhe mjeksore me kryesoret qe grumbullohen.

NR	EMRI LATINISHT	EMRI SHQIP	SIP HA	Sasia qe grumbullohet (ton)
1	Arbutus unedo	Mareja	55497	32446.0
2	Asparagus officinalis	Ferremane	10829	206.3
3	Bellis perennis	Luleshqera	3141	152.7
4	Castanea sativa	Gështenja	10517	6940.0
5	Cichorium intybus	Çikore	46795	269.2
6	Colchicum automnale	Xhironkulli	1324	11.2
7	Cornus mass	Thanë	21494	481.0
8	Corylus colurna	Lajthia	12834	171.3
9	Cotinus Coggygria	Cermedelli	18304	77.1
10	Crataegus monogyna	Murrizi njbërthamësh	29270.3	473.7
11	Cynedon dactylon	Grami	34025	993.3
12	Fragaria vesca	Luleshtrydhja	5349	408.7
13	Hypericum perforatum	Lulja e balsamit	1233	179.3
14	Juniperus communis	Dëllenja e zezë	12662	330.0
15	Juniperus oxycedrus	Dëllinjë e kuqe	58022	395.5
16	Laurus nobilis	Dafina	788	254.4
17	Malus sylvestris	Molla e eger	5695.9	253.1
18	Malva sylvestris	Mëllagë e egër	46415	52.6
19	Matricaria chamomilla	Kamomili	332	0.0
20	Melilotus officinalis	Jonxha e egër	494	96.5
21	Melissa officinalis	Bar blete	575	301.5
22	Mentha longifolia	Mendra gjethegjate	29208	102.0
23	Mentha pulegium	Mendra pulege	49400	195.5
24	Myrtus communis	Mersina	2593	156.5
25	Ononis spinosa	Gjuhë nuse	1985	329.9
26	Origanum Vulgare	Rigoni I kuq	23.564	200.3
27	Origanum vulgare vavirride	Rigoni i bardhe	20190	286.0
28	Paliuris Spinachristi	Driza	5267	842.0
29	Papaver rhoeas	Lulëkuqja	11935	56.7
30	Pistacia lentiscus	Xina	1500	0.0

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

31	Plantago major	Gjethedelli i madh	22051	47.0
32	Plantago media	Gjethedelli i ndërmjetëm	19096	53.5
33	Primula officinalis	Agulice	1940	70.8
34	Prunus spinosa	Kulumbria	4765	133.3
35	Punica granatum	Shega e egër	1180	144.8
36	Quercus aegilops	Valanidhi	5767	600.0
37	Robinia Pseudoacacia	Akacia	4562	381.0
38	Rosa canina	Trëndafili i egër	6216	920.5
39	Rubus ideaus	Mjedra	2689	469.9
40	Salix alba	Shelgu i bardhë	307	1917.5
41	Salvia officinalis	Sherebela	26207	2389.5
42	Salvia sclarea	Shengjini	433	35.4
43	Sambucus ebulus	Shtog	351	51.1
44	Sambucus nigra	Shtog i zi	468,05	108.1
45	Sambucus obulus	Qingel	634	147.2
46	Satureia montana	Trumza	23324	887.8
47	Scilla maritima	Qepë deti	2867	84.8
48	Sideritis roesseri	Çaji I malit	13765	91.7
49	Silybium marienum	Gjemb gomari	21436	61.7
50	Tercium polium	Bar majaselli	14492	275.8
51	Teucrium chamaedrys	Arrësi dushkvogël	11950	261.0
52	Thymus vulgaris	Timusi	5513	242.0
53	Tilia Argentea	Bliri i Argjendtë	666	42.0
54	Tilia platyphyllos	Bliri gjethevogël	386	80.9
55	Trifolium arvense	Terfili I bardhe	1329	84.5
56	Trifolium pratense	Terfili I kuq	1656	114.6
57	Tussilago farfara	Thundërmushka	23217	286.0
58	Vaccinium myrtillus	Boronica	14352	392.4
	Totali		693882.564	57037.2

Shënim: Burimi i të dhënave të inventari i viteve te meparshem per bimet mjekësore dhe aromatike.

Tabela 74 - Numri total i llojeve te mbrojtura sipas kategorive

Nr	Kategoria	Emertimi i kategorisë	nr. i llojeve
1	EX	Lloje te zhdukura	0
2	EË	Lloje te zhdukura si gjendje spontane	0
3	CR	Lloje te rrezikuara ne menyre kritike	54
4	DD	Lloje me te dhena te pamjaftueshme	30
5	EN	Lloje te rrezikuara	118
6	LR	Lloje pak te rrezikuara	60
7	NE	Lloje jo te vleresuara	3
8	VU	Lloje te perkeqesuara	96
	TOTAL	Gjithsej te listuara	361

Tabelë - Numri i llojeve te rrezikuara te bimëve mjekësore aromatike

Nr	Kategoria	Emertimi i kategorisë	nr. i llojeve
1	EX	Lloje te zhdukura	0
2	EË	Lloje te zhdukura si gjendje spontane	0
3	CR	Lloje te rrezikuara ne menyre kritike	8
4	DD	Lloje me te dhena te pamjaftueshme	0
5	EN	Lloje te rrezikuara	10
6	LR	Lloje pak te rrezikuara	4
7	NE	Lloje jo te vleresuara	0
8	VU	Lloje te perkeqesuara	8
	TOTAL		30

7.6 Vlerësimi për biodiversitetin

Pyjet e larta ruajnë komunitetet e gjitarëve të mëdhenj si ujku, ariu, rrëqebulli dhe dhia e egër, si dhe komunitetet e shpendëve karakteristike, të cilat janë të lidhura me pyjet e virgjër. Lagunat bregdetare dhe liqenet e mëdha brenda vendit janë vendbanime të rëndësishme, veçanërisht për dimërimin e shpendëve migratore. Ka vite që aty hasen rreth 70 lloje shpendësh uji me një popullatë që

arrin deri në 180.000 individë gjatë dimrit. Shqipëria, është gjithashtu një kryqëzim i rrugëve të rëndësishme për migrimin e shpendëve dhe insekteve.

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të ekosistemeve dhe habitateve. Brenda territorit të saj gjenden ekosisteme detare, zona bregdetare, liqene, lumenj, shkurret me gjelbërim të përhershëm apo gjetherënëse, pyje gjethegjere dhe pyje halorë, kullota alpine e subalpine dhe livadhe, si dhe ekosisteme të larta malore. Shqipëria është e pasur në burime pyjore dhe kullosore. Pyjet mbulojnë rreth 1.041,000 ha ose 33 % të territorit të vendit, ndërsa kullotat rreth 400,000 ha ose 15 %, por këto shifra duhet të përditësohen. Përafërsisht 60 % (244,000 ha) e kullotave janë kullota alpine e subalpine dhe livadhe. Pyjet dhe kullotat kanë një larmi të llojeve, formacioneve dhe komuniteteve bimore dhe shtazore. Përgjatë bregdetit të vendit ka shumë ekosisteme të rëndësishme në rajonin e Mesdheut, si lagunat, sistemet ligatinore, dunat ranore, deltat e lumenjve, pyjet dhe hygrophilet. Komunitetet bregdetare dhe infralitorale me origjinë mesdhetare përgjatë bregdetit shkëmbor janë mjaft të ndryshme dhe të ruajtura mirë.

Shqipëria shquhet për një diversitet të lartë të burimeve gjenetike, llojeve dhe ekosistemeve. Në një vështrim të përgjithshëm, llojet bimore i përkasin 168 familjeve dhe rreth 900 gjinive. Në vendin tonë rriten rreth 400 lloje bimore të cilat janë Ballkanike. Duke marrë parasysh informacionin ekzistues, Shqipëria ka një larmi të pasur të florës dhe faunës me rreth 3976 taxa të bimëve të larta dhe 756 lloje rruazore. Përafërsisht 32 % e florës europiane ndodhet në Shqipëri, kurse pyjet e larta të Shqipërisë janë habitate të rëndësishme për gjitarët si: ariu i murrmë, derri i egër, dhia e egër, etj., si dhe shumë lloje të shpendëve. Flora e pasur detare dhe komunitetet e faunës janë një tregues i nivelit të lartë të ruajtjes dhe cilësisë së këtyre komuniteteve në Shqipëri.

7.6.1. Llojet invazive

Llojet invazive janë bimë ose kafshë që nuk janë vendas në një vend të veçantë (një hyrje e re); dhe kanë tendencë për tu përhapur dhe të shkaktojnë dëmtimin e mjedisit dhe biodiversitetit, ekonominë e njerëzve dhe/ose shëndetin e njerëzve.

Vendimi Nr. 477, datë, 30.7.2021 Për miratimin e listës së llojeve të huaja invazive dhe përcaktimin e procedurave për ndalimin dhe/ose futjen e tyre në

pikat doganore të vendit. Ka miratuar listën së llojeve të huaja invazive, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet vendimit dhe është pjesë përbërëse e tij. Ky vendim, ndalon futjen në territorin e Republikës së Shqipërisë të të gjitha llojeve të huaja invazive si dhe të ekzemplarëve të rinj të llojeve të huaja invazive, që kanë shkallën 3 të invazionit, Ekzemplarët e rinj të llojeve të huaja invazive për t'u futur në territorin e Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen vlerësimit të rrezikut, si pjesë e vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të provuar se lloji i huaj invaziv nuk do të ndikojë negativisht në mjedis, në shëndetin e njeriut dhe në zhvillimin e qëndrueshëm.

7.6.2. Biodiversiteti detar dhe bregdetar

Ekosistemet detare dhe bregdetare të Shqipërisë janë të pasura me tipologjitë e habitateve, komuniteteve bimore dhe llojeve shtazore. Ato përfaqësojnë një pjesë të rëndësishme të trashëgimisë së natyrës jo vetëm për vendin, por edhe për rajonin e Mesdheut, në tërësi. Bimësia bregdetare është e përfaqësuar kryesisht nga shkurre me gjelbërim të përhershëm dhe pjesërisht nga shkurre gjetherënëse; ndërsa përgjatë bregdetit Adriatik, kryesisht në Divjakë (Lushnje), dhe Pishë Poro (Vlorë), nga pyjet me pisha mesdhetare. Në ligatinat bregdetare dhe dunat ranore rriten lloje halophyte, psamophyte dhe organizma të tjerë të ujërave të njelmët dhe të ujërave të ëmbël.

Flora detare (Barërat e detit dhe algat) Sipas të dhënave janë regjistruar rreth 186 lloje dhe taksonë infraspecifike e makroalga si dhe barëra të detit, të cilat i përkasin 63 familjeve dhe 112 gjinive, si vijon: 40 Phaeophyta, 101 Rhodophyta, 39 Chlorophyta dhe 6 barëra, ose fanerogameve detare (Tabela 6). Sigurisht, studime të mëtejshme, veçanërisht për zona detare të pashkelura deri më tani, apo zona të veçanta gjeografike do të nxjerrin një listë më të madhe të llojeve. Lloje të rëndësishme janë breshka e Adriatikut (*Fucus virsoides*) dhe alga kafe endemike e pjesës lindore të detit Adriatik, e lokalizuar në biocenoza dhe shkëmbinj të ulët mediolittoral. Ajo e ka origjinën nga zona boreale dhe konsiderohet si relike e para Miocenit ndërsa popullata e vetme e *Fucus* gjendet në Mesdhe (RAC / SPA 2011).

Studimet tregojnë se, prej 14 llojeve të rrezikuara në Mesdhe (Aneksi II i Konventës së Barcelonës, 1995), 6 janë raportuar në Shqipëri: dy Magnoliophyta (*Posidonia oceanica*, *Zostera noltii*), dy Phaeophyta (*Cystoseira amentacea* dhe *Cystoseira spinosa*), dhe dy Rhodophyta (*Lithophyllum bysoides* dhe

Lithophyllum trochanter (si Goniolithon byssoides). Studimet u përqendruan tek algat mikroskopike (fitoplankton ose periphyton) ndërsa përsa i përket ligatinave bregdetare shqiptare dhe habitateve detare studimet kanë filluar vetëm tri dekadat e fundit, kryesisht në lagunën e Butrintit, Nartës, Karavastasë dhe Patokut. Më shumë se 930 taksone të algave mikroskopike janë të njohura tashmë.

7.6.3 Fauna bregdetare dhe detare

Niveli i njohurive mbi faunën e habitateve detare në Shqipëri, kohët e fundit është në rritje, por ajo është ende e kufizuar. Grupet më të studiuara të jovevertebrorëve janë ato ekonodermatëve (53 lloje), krustaceve (147 lloje) dhe molusqeve (385 lloje).

Të dhënat për sfungjerët dhe grupe të tjera si cnidarians, bryozoans, annelids dhe ascidians janë të varfëra dhe të mbledhura vetëm kohët e fundit. Disa grupe bentike janë pothuaj tërësisht të pa studiuara. Sipas listës më të fundit të iktiofaunës detare, janë regjistruar më shumë se 260 lloje dhe nënlloje peshqish, përfshirë 28 lloje peshkaqenësh, nga të cilat disa janë të kërcënuar globalisht dhe janë të përfshirë në Listën e Kuqe të IUCN-ësë

Ujërat detare të Shqipërisë vizitohen shpesh nga vertebrorët të mëdhenj detarë të tilla si breshkat e detit (*Caretta caretta*), tre lloje të delfinëve (*Tursiops truncatus*, *Delphinus Delphi* dhe *Stenella coeruleoalba*), ndërsa (*Monachus monachus*) dhe balenat (*Ziphius cavirostris* dhe *Physeter catodon*) janë vizitorë të rastit. Lagunat bregdetare dhe grykëderdhjet e lumenjve janë qendra të rëndësishme për dimërimin e shpendëve migratorë të ujit, në të cilat janë regjistruar rreth 70 lloje të shpendëve të ujit. Shqipëria paraqet një rëndësi të veçantë për pelikanin dalmat (*Crispus crispus*), dhe pelikanin xhuxh (*Phalacrocorax pygmaeus*). Një listë e plotë e llojeve detare, me interes ndërkombëtar, të listuara në Konventat ose direktivat më të rëndësishme të natyrës të pranishme në Shqipëri.

Vendim Nr. 760, datë 9.12.2021 Për miratimin e listës së llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës të vendit ka Miratuar listën e llojeve të mbrojtura të bimëve/florës dhe kafshëve/faunës së vendit dhe në këtë listë bëjnë pjesë edhe vertebrorët të mëdhenj detarë të cilët mbrohen edhe nga konventa të ndryshme të cilat Shqipëria i ka aderuar.

7.6.4. Veçoritë e biodiversitetit:

- *Taksonet endemike dhe subendemike*

Relievi i Shqipërisë ka krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të llojeve endemike dhe subendemike. Në Shqipëri rriten rreth 32 lloje bimësh endemike dhe rreth 110 bimë të tjera subendemike, të cilat ndajnë habitatet midis Shqipërisë, Kosovës, Malit të Zi, Kroacisë dhe Greqisë. Shumë lloje të reja të algave mikroskopike janë hasur gjatë dekadave të fundit, të tilla si *Aneumastus albanicus*, *A. humboltianus*, *A. rosettae*, *Cymboplectra albanica*, *C. lata* var. *lura*, *C. lura*, *Navicula pseudopugnata*, *N. hastatula*, *N. parahasta*, *Placoneis neoexigua* dhe *P. juriljii*. Ndërkohë janë rreth 80 lloje të reja të hasur në 15 vitet e fundit, kryesisht në Liqenin e Ohrit, që ndajnë të njëjtin habitat në mes të dy vendeve.

Nga pikëpamja e ruajtjes, llojet të cilat i takojnë periudhës akullnajore dhe reliket janë të një rëndësie të veçantë. Disa lloje kanë origjinën nga periudha akullnajore dhe janë të kufizuara në malet e larta, rreth maleve kryesisht të larta glaciale (*Arctostaphylos alpinus*, *Aster alpinus*, *Androsace villosa*, *Dryas octopetala*, *Geum montanum*, *Heliosperma macrantha*, *Potentilla crantzii*, *Parnassia palustris*, *Pedicularis verticillata*, *Petasites doerfleri*, *Poa alpina*, *Luzula spicata*, *Salix herbacea*, *S. reticulata*, *Saxifraga oppositifolia*, *Selaginella selaginoides*, *Trollius europaeus*, *Ëulfenia baldaccii* etj.), ndërsa disa të tjera janë relike nga periudha e terciarit, të izoluar në gryka dhe kanione të thella.

Nga reliket që vijnë nga kjo kohë mund të përmenden *Pinus heldreichii*, *Aesculus hippocastanum*, *Buxus sempervirens*, *Pinus peuce*, *Ilex aquifolium*, *Quercus ithaburensis* subsp. *macrolepis*, *Laurus nobilis*, *Ramonda serbica*, *Taxus baccata*, *Viola kosaninii*, *Narthecium scardicum*, *Acer heldreichii*, *Jasione orbiculata*, *Taxus baccata*, *Viola kosaninii*, *Narthecium scardicum*, *Acer heldreichii*, *Jasione orbiculata*, *Silene astartias*, etj).

Në krahasim me florën, fauna shqiptare është më pak e njohur dhe e studiuar. Ajo ka një numër të konsiderueshëm të llojeve endemike dhe të lashta. Liqeni i Ohrit është ekosistemi më i njohur në vend në drejtim të faunës endemike: mbi 40 lloje molusqesh dhe dy lloje peshqish janë endemikë. Insektet janë të përfaqësuara nga 16 lloje (11 lloje të Hemiptera dhe pesë lloje të fluturave).

Megjithatë, shumë insekte endemike mendohet që ndodhen në Shqipëri, vetëm brenda krahfortëve (beetles) mendohet se janë më shumë se 35 lloje endemike. Studime të mëtejshme të faunës së vendit, sidomos studime të veçanta biospeleologjike, do të ndihmojnë në gjetjen e endemizmeve të reja në vend.

7.6.5. Kuadri ligjor dhe i politikave

Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm në përafrimin e politikave të saj kombëtare për biodiversitetin me direktivat e Bashkimit Evropian, duke krijuar një themel të fortë për arritjen e objektivave të Kornizës Globale për Biodiversitetin (GBF). Duke miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin (BSAP) dhe duke zbatuar ligje të rëndësishme, Shqipëria ka treguar përkushtimin e saj për mbrojtjen e biodiversitetit. Megjithatë, ende ekzistojnë probleme me zbatimin e plotë të këtyre ligjeve, ndërtimin e kapaciteteve institucionale, menaxhimin e të dhënave dhe përfshirjen e publikut, të cilat duhet të adresohen.

Për t'u përafruar plotësisht me GBF-në dhe për të mbrojtur në mënyrë efektive biodiversitetin, Shqipëria duhet të përqendrohet në përfundimin e zbatimit të ligjeve, përmirësimin e aftësive të institucioneve të saj, ngritjen e sistemeve gjithëpërfshirëse të monitorimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërmjet organizatave të ndryshme. Për më tepër, rritja e financimit nga qeveria dhe ndërgjegjësimi publik janë thelbësore për ruajtjen e përpjekjeve për biodiversitetin.

Ruajtja efektive e biodiversitetit kërkon një qasje të integruar që tejkalon sektorët dhe institucionet individuale. Shqipëria ka njohur nevojën për integrimin e çështjeve të biodiversitetit në të gjitha departamentet qeveritare, me qëllim sigurimin e një qeverisjeje mjedisore koherente dhe të qëndrueshme. Ky kapitull shqyrton mundësitë për përmirësimin e integritetit të biodiversitetit në kuadrin qeveritar të Shqipërisë dhe përshkruan strategjitë e zhvilluara për të promovuar një qasje gjithëpërfshirëse të qeverisë, të orientuar drejt natyrës dhe pozitive për mjedisin, nëpër sektorë të ndryshëm. Gjithashtu, integrimi efektiv i biodiversitetit kërkon sisteme të forta për menaxhimin e të dhënave dhe monitorimin.

Duke adresuar këto sfida dhe duke ndjekur strategjitë e rekomanduara, Shqipëria mund të përparojë ndjeshëm në përpjekjet për të ruajtur biodiversitetin, duke

kontribuar në objektivat globale për biodiversitetin dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

- *Sfidat, pengesat dhe vështirësitë e identifikuara për biodiversitetin:*

Pengesa institucionale dhe administrative

- **Kufizime kapacitetesh:** Burimet njerëzore dhe ekspertiza teknike të kufizuara brenda institucioneve kyçe kufizojnë aftësinë për të monitoruar dhe zbatuar në mënyrë efektive politikat për biodiversitetin.
- **Mungesa të financimit:** Varet nga financimet e donatorëve pa alokime të konsiderueshme nga buxheti i shtetit, gjë që minon qëndrueshmërinë e iniciativave për biodiversitetin.

Mangësi në të dhëna dhe monitorim

- **Të dhëna të pamjaftueshme për biodiversitetin:** Inventarizime të kufizuara dhe të dhëna të shpërndara mbi shpërndarjen e specieve dhe gjendjen e habitatit pengojnë marrjen e vendimeve të informuara dhe monitorimin efektiv.
- **Mungesa e sistemeve të integruara të informacionit:** Mungesa e sistemeve gjithëpërfshirëse për menaxhimin e të dhënave pengon ndjekjen e indikatorëve të biodiversitetit dhe ndikimit të politikave.

Angazhimi publik dhe ndërgjegjësimi

- **Ndërgjegjësim i ulët publik:** Fushata minimale ndërgjegjësimi dhe iniciativa edukative për publikun ulin përfshirjen e komunitetit dhe mbështetjen për ruajtjen e biodiversitetit.

- **Pjesëmarrja e aktorëve të interesit:** Pjesëmarrje e kufizuar e komuniteteve lokale, sektorit privat dhe organizatave të shoqërisë civile në formulimin dhe zbatimin e politikave për biodiversitetin.

7.7 Rekomandime

Gjendja shëndetësore e pyjeve

- Mbajtja nënkontroll e sëmundjeve dhe dëmtuesve, ku shkalla e prekjës është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.
- Kryerja e një studimi të hollësishëm për të përcaktuar të gjitha sipërfaqet dhe drurët e tharë nga ekstremet e temperaturave për llojet ekualipt, palma dhe mimosa si dhe rekomandimin e duhur për zvëndësimin e këtyre drurëve të tharë.
- Marja e një studimi të hollësish për përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë fenomenin e tharjes së llojit rrap, dushk dhe plep.
- Identifikimi i të gjitha sipërfaqeve të llojeve të pishëve mesdhetare të prekura nga dëmtuesi i procesionares së pishës si dhe marja e masave për mbajtjen nën kontroll të këtij dëmtuesi.
- Marrja e një studimi të hollësish për përcaktimin e mundësisë së rehabilitimit të sipërfaqeve të përshkuar dhe të djegura nga zjaret në vitete e mëparshme që nuk kanë mundësi të ripërtëriten në mënyrë natyrale.
- Marrjen e masave për parandalimin e fenomeneve të zjareve si; ndërgjegjësimin e komunitetit, ndërtimin e brezave mbrojtës, vënia parapërgjegjësisë të gjithë kundravajtësit që shkaktojnë zjaret, etj.

Bazuar në gjëndjen shëndetësore të fondit pyjor me llojin pishë e zezë, rekomandojmë;

- Identifikimi i të gjitha sipërfaqeve të llojeve të pishave të prekura nga dëmtuesi i procesionares së pishës si dhe marrja e masave për mbajtjen nën kontroll të këtij dëmtuesi Mbajtjen nën kontroll të sëmundjeve dhe

dëmtuesve, ku shkalla e prekjës është më e madhe se kufijtë kritikë të lejueshëm.

- Aplikimi i luftimit të integruar (metoda mekanike me atë biologjike, i kombinuar kjo me ruajtjen e parazitëve dhe larvave të dëmtuesit. Në këtë rast, do të priten vetëm qeskat me larva, të cilat dallohen qartë nga ngjyra e bardhë karakteristike e gjendjes së tyre.
- Nisur nga dëmi që ka shkaktuar dëmtuesi i procesonaries së pishës, sugjerojmë se duhet të ndërhyhet me metodën biologjike të luftimit të këtij dëmtuesi.
- Në këрто kushte del e nevojshme riprodhimi në masë të insektit që ushqehet me larvën e dëmtuesit (koleopterit Calosoma sycophanta), në kuadrin e luftës biologjike ndaj procesonares.
- Aplikimi i luftimit të integruar (metoda mekanike me atë biologjike, i kombinuar kjo me ruajtjen e parazitëve dhe larvave të dëmtuesit për luftimin e dëmtuesit të grerzës aziatike që dëmton gështënjën.
- Aplikimi i luftimit të integruar (metoda mekanike me atë biologjike, i kombinuar) për luftimin e dëmtuesve dhe sëmundjeve të llojit bush.
- Përcaktimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve që kanë sjellë fenomenin e tharjes së llojit hormoq.

Llojet drunore dhe bimët aromatiko-mjekësore të rrezikuara e kërcënuara

- Grumbullimi i farave nga pikat e monitorimit për llojet drunore dhe prodhimi i fidanëve për pyllëzim të këtyre llojeve në arealin e përhapjes së tyre, do të ndihmonte në ruajtjen dhe shtimin e këtyre llojeve në të ardhmen
- Mbrojtja më e mirë ndaj pakësimit të shumllojshmërisë biologjike është futja e konservimit ,‘in situ‘, dhe ‘‘ex situ‘‘
- Nga verifikimet e ushtruara në terren gjatë këtij viti, janë marrë të dhënat mbi karakteristikat e terrenit si dhe është bërë evidentimi i shkaqeve kryesore që kanë çuar në pakësimin e numrit të rrënjëve dhe në disa areale të veçanta deri në zhdukjen e ekzemplarëve. Nisur nga kjo situatë, rekomandojmë kufizimin e grumbullimit të tyre, në mënyrë që këto bimë ti kemi në vazhdimësi edhe në të ardhmen.

- Sensibilizimi i komunitetit ku grumbullohen këto bimë, përmes vendosjes së tabelave në vendet ku rriten këto bimë për rëndësinë e tyre dhe shkallën e kërcënimit për zhdukje.
- Hartimi i një strategjie për ruajtjen dhe përdorimin e burimeve bimore lokale në shkallë kombëtare dhe sidomos i atyre specieve që janë në rrezik zhdukjeje. Nëpërmjet kësaj strategjie duhet të parashikohet grumbullimi, mbrojtja, studimi, ruajtja in situ dhe përdorimi i burimeve gjenetike bimore. Në këtë drejtim merr rëndësi kombinimi i teknikave të ruajtjes së burimeve gjenetike: në bankat gjenetike (ex situ) dhe në vendorigjinë (in situ).

Biodiversiteti

- **Transpozimi i plotë i Direktivave të BE-së:** Prioritet të ketë transpozimi i plotë i direktivave dhe rregulloreve që ende janë në pritje, për të eliminuar boshllëqet ligjore dhe për të siguruar mbrojtje gjithëpërfshirëse të biodiversitetit.
- **Zhvillimi i akteve nënligjore specifike:** Hartimi i akteve të detajuara nënligjore për rregullore si Direktiva për Kopshtet Zoologjike dhe Rregullorja për Speciet Invasive të Huaja, për të lehtësuar zbatimin dhe mbikëqyrjen efektive.
- **Biodiversitet (diversitet biologjik) ose larmi biologjike**” e cila është shumëllojshmëria e organizmave të gjallë të të gjitha llojeve, duke përfshirë, ndër të tjera, ekosistemet tokësore, detare dhe ekosistemet e tjera ujore, si dhe komplekset ekologjike, ku ato bëjnë pjesë. Ky term përfshin shumëllojshmërinë brenda dhe ndërmjet llojeve dhe shumëllojshmërinë e ekosistemeve.
- Ekosistemi është një kompleks dinamik, i përbërë nga komitete të bimëve, kafshëve e mikroorganizmave, si dhe mjedisi jo i gjallë, të cilat ndërveprojnë ndërmjet tyre si një njësi funksionale.

KAPITULLI 8

ZONAT E MBROJTURA

8.1 Burimi i të dhënave

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni qendror shtetëror përgjegjës për zonat e mbrojtura dhe ka për detyrë administrimin dhe kontrollin e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8.2 Rëndësia

Zonat e mbrojtura janë vende që marrin mbrojtje për shkak të vlerave të tyre të njohura natyrore ose kulturore. Ato janë ato zona në të cilat prania njerëzore ose shfrytëzimi i burimeve natyrore (p.sh. dru zjarri, produkte pyjore jo-drusore, ujë etj) është i kufizuar. Zonat e mbrojtura zbatohen për ruajtjen e biodiversitetit, shpesh duke siguruar habitat dhe mbrojtje nga gjuetia për speciet e kërcënuara dhe të rrezikuara. Mbrojtja ndihmon në ruajtjen e proceseve ekologjike në shumicën e peizazheve tokësore dhe detare të menaxhuara.

Zonat e mbrojtura të menaxhuara në mënyrë efektive janë një mjet kritik për mbrojtjen e biodiversitetit, ruajtjen e ekuilibrit të ekosistemit, ruajtjen e habitateve të rëndësishme, ndërtimin e qëndrueshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike, sigurimin e sigurisë ushqimore, ruajtjen e cilësisë së ujit, ruajtjen e burimeve natyrore, si dhe nxitjen e suksesit ekonomik.

Gjithashtu këto zona lehtësojnë efektet e ndryshimeve klimatike në një sërë mënyrash ku mund të përmendim;

- Ndalimi i aktiviteteve degraduese duke përfshirë: peshkimin, gjuetinë, zhvillimin, bujqësinë, minierat, prerjen e pyjeve.
- Zvogëlimi i ndryshimeve në shpërndarjen e specieve, intensitetit të stuhive dhe ndikimeve të rritjes së nivelit të detit.
- Rritjen e popullatave, qëndrueshmërinë e specieve, diversitetin gjenetik dhe potencialin për përshtatje, duke ulur rrezikun e zhdukjes.

8.3 Kontribuesit e ndotjes dhe kërcënimet ndaj zonave të mbrojtura

Ndotësit kryesore brenda zonës së mbrojtur përfshijnë ujërat e ndotura urbane nga objektet e zonës së mbrojtur (p.sh. tualete, hotele), mbetjet dhe shkarkimet industriale, mbetjet bujqësore dhe pyjore (p.sh. plehra ose pesticide të tepërta;); mbeturinat dhe mbetjet e ngurta, ndotësit e ajrit

Zhvillimi rezidencial dhe tregtar brenda një zone të mbrojtur përfshin kërcënimet nga vendbanimet njerëzore ose përdorime të tjera jo-bujqësore të tokës si zonat tregtare dhe industriale si dhe infrastruktura turistike dhe rekreative.

Ndryshimi i klimës dhe moti i ashpër përfshin kërcënimet nga ndryshimet klimatike afatgjata ku mund të përmendim zhvendosja dhe ndryshimi i habitatit; thatësit; ekstremet e temperaturës; stuhitë dhe përmbytjet.

Burime ndotëse të tjera janë : zjarri dhe shuarja e zjarrit (përfshirë zjarrvënien), shpyllëzimi, gjenerimi i energjisë nga digat e hidrocentraleve, digat pa kalime efektive të jetës së egër ujore që çon në humbje të specieve kryesore.

Përdorimi dhe dëmtimi i burimeve biologjike brenda një zone të mbrojtur përfshin kërcënimet nga gjuetia e kafshëve tokësore, mbledhja e bimëve tokësore ose produkteve bimë , prerja e drurëve dhe peshkimi.

Bujqësia dhe akuakultura brenda një zone të mbrojtur, përfshin kërcënimet nga bujqësia dhe kullotja si rezultat i zgjerimit dhe intensifikimit bujqësor, kultivimi i kulturave jo-drusore, blegtoria dhe kullotja, akuakultura detare dhe e ujërave të ëmbla.

8.4 Vlerësimi i gjendjes

8.4.1. Zonat e mbrojtura

Referuar VKM nr. 31, datë 20.1.2016 “Për miratimin e Dokumentit të Politikave Strategjike për Mbrojtjen e Biodiversitetit”, sistemi i vetëm i Kodeve për Sistemin e Zonave të Mbrojtura Mjedisore është ai sipas Rrjetit të Zonave Emerald për Shqipërinë duke identifikuar 25 Zona të Mbrojtura si potenciale për

tu përfshirë në Rrjetin Emerald. Të dhënat e detajuara jepen në tabelën e mëposhtme:

Tabela 75 - Rrjeti i Zonave Emerald për Shqipërinë

Kodi	Emri	Kategoria sipas IUCN	Territori
AL0000001	Parku Kombëtar Llogara	II	1.010
AL0000002	Parku Kombëtar Pisha e Divjakës	II	1.250
AL0000003	Parku Kombëtar Prespë	II	27.750
AL0000004	Parku Kombëtar Butrint	II	2.500
AL0000005	Rezervë Strikte Natyrore Allamani	I	1.650
AL0000006	Parku Kombëtar Tomorr	II	4.000
AL0000007	Parku Kombëtar Dajç (i zgjeruar)	II	29.347
AL0000008	Peisazh i Mbrojtur Vjosë – Nartë	V	19.412
AL0000009	Rezervat Natyror i Menaxhuar, Liqeni Shkodrës	IV	26.535
AL00000010	Parku Kombëtar i Alpeve (i propozuar)	II	77.458
AL00000011	Parku Kombëtar Kurora e Lurës - Kunorë - Valmore - Zall Gjoçaj (i propozuar)	II	16.596
AL00000012	Parku Kombëtar Bredhi i Hotovës-Dangëlli	II	14.973
AL00000013	Peizazh i Mbrojtur i Moravës (i propozuar)	V	29.155
AL00000014	Parku Kombëtar Karaburun - Orikum - Dukat (i propozuar)	II	33.036

AL00000015	Peizazh i Mbrojtur Bizë - Brosh - Bërdhet (i propozuar)	V	4.594
AL00000016	Parku Kombëtar Karavasta (i propozuar)	II	19.677
AL00000017	Rezervat Natyror i Menaxhuar Shëngjin - Ishëm (i propozuar)	IV	30.000
AL00000018	Rezervat Natyror i Menaxhuar Kuturman - Qafë Bush	IV	4.210
AL00000019	Peizazh i Mbrojtur Pogradec	V	24.350
AL00000020	Parku Kombëtar Gërmenj - Shelegur - Leskovik - Piskal (i propozuar)	II	30.421
AL00000021	Peizazh i Mbrojtur Lumi Buna	V	22.479
AL00000022	Parku Kombëtar Rajcë – Shebenik	II	33.927
AL00000023	Parku Kombëtar Korab	II	31.360
AL00000024	Rezervat Natyror i Menaxhuar Rrushkull - Ishëm (i propozuar)	IV	2.030
AL00000025	Rezervat Natyror i Menaxhuar Berzanë	IV	1.298

Rrjeti kombëtar i zonave të mbrojtura mjedisore

Në Republikën e Shqipërisë, zonat e mbrojtura mjedisore janë shpallur, me VKM-të e tyre përkatëse, bazuar në aktet ligjore e nënligjore në periudha të ndryshme. Aktualisht për shpalljen e zonave të mbrojtura mjedisore bazohemi në ligjin nr. 81/2017, datë 04.05.2017 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar. Në

vitin 2015 që përkon me krijimin e AKZM dhe AdZM-ve në 12 Qarqet e vendit, sipërfaqja e përgjithshme e zonave të mbrojtura ishte 460060.9 ha ose 16% e territorit të vendit. Në vitin 2022 u bënë ndryshime për kategorinë “Park Kombëtar” duke i shpallur me VKM nr. 59, datë 26.01.2022 “Për Miratimin e Ndryshimit të Statusit dhe Sipërfaqes së Ekosistemeve Natyrore “Park Kombëtar” (Kategoria II) e zonave të mbrojtura mjedisore” dhe për kategorinë “Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror”, duke i shpallur me VKM nr. 60, datë 26.01.2022 “Për shpalljen e Ekosistemeve Natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror (Kategoria IV), si dhe Miratimin e Ndryshimit të Statusit të Sipërfaqeve ekzistuese të Zonave të Mbrojtura Mjedisore”. Në vitin 2023 është shpallur me VKM nr. 155, datë 13.03.2023 Parku Kombëtar “Lumi Vjosa”, me sipërfaqe prej 12727.00 ha, me VKM nr. 154, datë 13.03.2023 është shpallur monumenti natyror (MN) Habitati i Tulipanit Shqiptar me sipërfaqe 35.5 ha. Gjithashtu, me VKM-të përkatëse si më poshtë vijon, janë shpallur edhe zonat e mbrojtura mjedisore “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) dhe konkretisht:

1. VKM nr. 589, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të zonës “Rrushkull”.
2. VKM nr. 590, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) të zonës “Kuturman – Qafë - Bushi”.
3. VKM nr. 591, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) të zonës “Guri i Nikës – Valamarë - Lenie”.
4. VKM nr. 592, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të zonës “Bisht - Kamzë”.
5. VKM nr. 593, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të Lumi Buna, Velipojë”.
6. VKM nr. 594, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) të zonës “Bredhi i Drenovës – Sinicë”.
7. VKM nr. 595, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) të zonës “Kraštë - Verjon”.
8. VKM nr. 596, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të zonës “Pishë Poro - Nartë”.
9. VKM nr. 597, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor” (Kategoria V) të Liqenit të Pogradecit”.
10. VKM nr. 598, datë 25.09.2024, Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur” (Kategoria V) të zonës “Bjeshkët e Oroshit”.

I gjithë sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore, që përfshinë aktualisht rreth 21.76% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kritereve të IUCN –së, dhe konkretisht:

Tabela 76 - Kategoritë e Zonave të Mbrojtura dhe sipërfaqet respektive 2024

Nr.	Emërtimi i kategorisë së zonës së mbrojtur mjedisore	Nr.	Kategoria	Sip. në Ha
1	Park Kombëtar	12	II	313,923.77
2	Monument Natyre	724	III	85.50
3	Rezervat Natyror i Menaxhuar/Park Natyror	27	IV	217,384.68
4	Peizazh i Mbrojtur	10	V	81,916.68
5	Zonë e Mbrojtur e Burimeve të Menaxhuara	2	VI	11,300.00
	Totali	775		624,610.63

Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura rezulton me sipërfaqe gjithsej prej **624610.63 ha**;

- Kategoria Park Kombëtar (PK), janë gjithsej 12 me sipërfaqe prej 313923,77 ha, nga kjo ujore është 37307 ha,
- Kategoria, Zonë e Mbrojtur të Monumenteve Natyror, gjithsej 2 (dy) me sipërfaqe prej 85.5 ha, nga kjo ujore 0 ha,
- Kategoria Rezervat Natyror Menaxhuar/Park Natyror (RNM/PN), janë gjithsej 27 me sipërfaqe prej 217384.68 ha, nga kjo ujore është 23742 ha,
- Kategoria Peizazh i Mbrojtur (PM), gjithsej 10 me sipërfaqe prej 81916,68 ha, nga kjo ujore është 17520 ha,

- Kategoria Zonë e Mbrojtur të Burimeve të Menaxhuara (ZMBM), gjithsej 2 (dy) me sipërfaqe prej 11300.0 ha, nga kjo ujore është 0 ha,

Kemi rritje të numrit të kategorive të zonave të mbrojtura nga 767 në vitin 2023 në 775 në vitin 2024. Nga paraqitja grafike e mëposhtme vërehet tendencë në rritje të sipërfaqes se zonave të mbrojtura referuar viteve të mëparshme.




Figura 202 - Sipërfaqe e zonave të mbrojtura, ha

8.4.2 Monumentet e natyrës

Me VKM-në nr. 187, datë 25.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 303, datë 10.5.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së rishikuar, të përditësuar, të monumenteve të natyrës shqiptare”, janë shpallur gjithsej 721 monumente natyre me koordinata (MN).

Në këtë listë shtohen dhe 3 (tre) monumente natyror (MN), të cilët janë shpallur me VKM-të nr. 102, datë 15.01.1996 me sipërfaqe 2 (dy) MN dhe konkretisht janë:

- 1- Zheji (qarku Gjirokastrë)
 - 2- Vlashaj (qarku Dibër)
- dhe me VKM nr. 154, datë 13.03.2023
- 3- Habitati i Tulipanit Shqiptar 1 (një),

Në total janë gjithsej 724 monumente natyrorë në vendin tonë.

Tabela 77 - Monumentet e natyrës sipas VKM nr. 187, datë 25.03. 2021

Nr.	Qarku	Bashkia	Numri i MN
I	Berat	Berat	8
		Skrapar	27
		Poliçan	2
	Totali		37
II	Dibër	Dibër	42
		Bulqizë	18
		Mat	23
	Totali		83
III	Durrës	Durrës	5
		Krujë	11
		Shijak	2
	Totali		18
IV	Elbasan	Elbasan	15
		Librazhd	22
		Gramsh	19
		Prenjas	11
		Belsh	4
		Peqin	5
	Totali		76
V	Fier	Fier	4
		Lushnjë	5
		Divjakë	9
		Patos	3
		Mallakastër	13
	Totali		34

VI	Gjirokaštër	Gjirokaštër	12
		Përmet	21
		Libohovë	17
		Dropull	13
		Tepelenë	14
		Memaliaj	4
		Këlcyrë	4
	Totali		85
VII	Korçë	Korçë	11
		Pogradec	17
		Devoll	9
		Maliq	10
		Pustec	7
		Kolonjë	23
	Totali		77
VIII	Kukës	Kukës	15
		Has	7
		Tropojë	25
	Totali		47
IX	Lezhë	Lezhë	10
		Mirditë	18
		Kurbin	12
	Totali		40
X	Shkodër	Shkodër	57
		Vau Dejës	3
		Fushë Arrëz	9
		Pukë	12
		Malësi e Madhe	34
	Totali		115
XI	Tiranë	Tiranë	14

		Rrogozhinë	2
		Kavajë	7
	Totali		23
XII	Vlorë	Vlorë	20
		Sarandë	3
		Selenicë	10
		Himarë	28
		Delvinë	12
		Finiq	8
		Konispol	5
	Totali		86
	Shuma Total (MN)		721

8.4.3 Biodiversiteti në zonat e mbrojtura

- *Fauna e egër në zonat e mbrojtura mjedisore*

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), që nga 6-mujori i dytë i vitit 2017 e në vazhdim është përfshirë në kryerjen e punës, për ndjekjen permanente, të Vëzhgim-Monitorimit të Faunës së Egër, në territoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, sipas specieve të përcaktuara për këtë qëllim. Në Vëzhgim - Monitorim, janë gjithsej 40 specie, si më poshtë vijon

1. Ariu i Murmë (*Ursus arctos*),
2. Mace e Egër (*Felis silvestris*),
3. Rrëqebulli (*Lynx lynx balcanicus*),
4. Lundërza (*Lutra lutra*),
5. Dhia e Egër (*Rupicarpa rupicarpa*),
6. Kaprolli (*Capreolus capreolus*),
7. Baldosa (*Meles meles*),
8. Ujku (*Canis lupus*),

9. Çakalli (*Canis aureus*),
10. Derri i Egër (*Sus scrofa*),
11. Lepuri i Egër (*Lepus europaeus*),
12. Dhelpra (*Vulpes vulpes*),
13. Zardafi/Kunadhja Gushëverdhë (*Martes martes*),
14. Shqarthei/Kunadhja Gushëbardhë (*Martes foina*),
15. Kryekuqe e Madhe (*Anas penelope*),
16. Kryekuqe Qafëgjelbër (*Anas platyrhynchos*),
17. Grilla (*Anas crecca*),
18. Rosa Bishtëgjelë (*Anas acuta*),
19. Rosa e Përhime (*Anas strepera*),
20. Sqepluga (*Anas clypeata*),
21. Marsatorja (*Anas querquedula*),
22. Shapka e Ujit (*Gallinago gallinago*),
23. Bajza (*Fulica atra*),
24. Thëllënxa e Malit (*Alectoris graeca*),
25. Pëllumb i Egër (*Columba livia*),
26. Shapka (*Scolopax rusticola*),
27. Turtulli (*Streptopelia turtur*),
28. Shkurta (*Coturnix coturnix*),
29. Lauresha (*Alauda arvensis*),
30. Pelikani Kaçurrel (*Pelecanus creopus*),
31. Kryekuqja e Mjeme (*Aythya ferina*),
32. Kryekuqja e Vogël (*Aythya nyroca*),
33. Zhytraku i Madh (*Mergus merganser*),
34. Karabullaku Madh (*Phalacrocorax corba*),
35. Karabullaku me Çafkë (*Phalacrocorax aristotelis*),
36. Pelikani Rozë (*Pelecanus onocrotalus*),
37. Çafka e Përhime (*Ardea cinerea*),
38. Karabullaku i Vogël (*Phalacrocorax pygmeus*),
39. Murrçaku (*Netta rufina*),
40. Dallandyshja Faqebardhë e Detit (*Chlidonias hybrida*).

Nga këto specie, 13 janë gjitarë dhe 27 prej tyre janë shpendë. Speciet e gjitarëve grupohen në gjitarë të mëdhenj, të mesëm dhe gjitarë të vegjël, sikundër shpendët grupohen në ujorë e jo ujorë.

Nga këto 40 specie, 17 prej tyre janë shpallur objekt gjuetie, kurse 23 të tjerat, konsiderohen specie kryesore të faunës së egër, ndaj janë përcaktuar për vëzhgim dhe monitorim.

Procesi, realizohet nëpërmjet punës së përditëshme të Rangers-ave (Rojëve Mjedisore), sipas AdZM-ve në të 12-të qarqet e vendit.

Bazuar në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 92/43/EEC e dates 21 maj 1992, mbi ruajtjen e habitateve natyrore dhe të faunës e florës së egër (Direktiva e Habitave), dhe gjithashtu në Direktivën e Këshillit të Europës nr. 79/409/EEC e datës 2 prill 1979 mbi ruajtjen e shpendëve të egër (Direktiva e Shpendëve), AKZM ka krijuar një Sistem të Monitorimit të Faunës së Egër “AKZM-SiMF”, si sistem kombëtar i monitorimit, i njehsuar me sistemin e BIONNA-s, si sistem ndërkombëtar i monitorimit. Vazhdon të praktikohet hedhja online e të dhënave nëpërmjet aplikimit të këtij sistemi të ri, në mënyrë të përditësuar.

Evidentimi i specieve dhe identifikimi i tyre realizohet sipas këtyre mënyrave: Kamera Kurth, Vrojtim direkt, Jashtëqitje, Gjurmë, Tjetër (Pupla, Qime etj). Përveç këtyre, në tërësinë e të dhënave të Rangers-ave, në bashkëpunim me specialistët e AdZM-së përkatëse, janë plotësuar edhe informacioni për datën, orën, koordinatat në gradë Decimal, pra jo në UTM dhe vendin e identifikimit (zonë e mbrojtur apo jo dhe emri popullor), konfliktet e ndodhura, lloji i dëmit të shkaktuar dhe koha e kryerjes së tij, ngordhjet e konstatuara në F. Egër (koha, shkaku, mënyra e ngordhjes dhe gjinia e moshës për specien e ngordhur), pa përfshirur këtu shënime apo sqarime të tjera specifike për çdo rast, sipas zonave të mbrojtura ku është kryer Vëzhgim-Monitorimi.

Censusi ndërkombëtar i shpendëve ujorë dimërues ndër vite 2021-2024

Numërimi Ndërkombëtar i Shpendëve Dimërues në Shqipëri nga AKZM prej vitit 2016 e në vazhdim organizohet në muajn janar, me përfshirjen e Administratave të Zonave të Mbrojtura në të 12 qarqet me mbështetjen e ekspertëve ornitolog dhe specialistëve e vullnetarëve. Ky Censusi mbulon mbi 30 vendnumërime (ligatina, lumenj, liqene, rezervuare, ekosisteme bregdetare etj), në të gjithë vendin tonë.

Për vitin 2024 në total u regjistruan 60 lloje (specie) shpendësh, me një numër total individësh prej 99527. Lloji me numër më të madh të individëve, është bajza (*Fulica atra*). Ndër vite, duke filluar nga viti 2021 – 2024, rezultojnë këto të dhëna:

Vendnumërimet	2021		2022		2023		2024	
	Ind	Sp	Ind	Sp	Ind	Sp	Ind	Sp
Karavasta	34241	53	25670	50	25757	52	24543	47
Kune-Vain	9458	41	14429	36	11534	32	10487	33
Liqeni_Shkodrës	20098	20	29252	24	32089	23	18416	23
Prespa e Madhe	21294	20	11736	26	6884	21	6176	21
Ohër	17900	20	12354	24	7137	22	6878	21
Narta	11291	39	14407	36	14742	42	10724	40
Thana	9850	21	11442	27	1722	22	2414	26
Butrinti	2348	31	4269	29	2430	30	3172	32
Lalzi	7278	26	4103	31	3498	18	2952	20
Orikumi	1006	19	1213	17	969	21	1333	21
Buna-Velipoje	1646	22	1570	20	807	15	511	18
Patok	1981	23	1199	25	1020	19	1781	20
Fierza	624	7	1179	12	1399	10	1626	11
Liqeni i Tiranës	309	7	403	6	600	5	3823	8
Vau i Dejes	1201	10	1044	12	187	11	436	9
Prespa e Vogël	70	6	79	8	307	9	168	10
Shena-Vlash	128	6	219	7	186	15	15	3
Karpen	96	8	138	7	91	9	173	1
Seman	40	8	352	10	94	9	119	12
Banja	83	7	140	9	198	2	463	5
Belshi	207	10	389	11	375	9	540	14

Liqeni i Farkës	48	3	121	4	59	2	15	4
Rezervari i Bulos	157	11	147	11	453	11	559	4
Syri i Kaltër	53	4	53	5	73	4	69	6
Liqeni i Ulzës	14	4	86	4	44	4	76	5
Rezervuari i Kasharit	4	2	28	2	9	2	22	3
Rezervuari i Paskuqanit	62	3	227	4	747	5	407	8
Liqeni i Tapizës	27	4	77	6	146	8	137	8
Liqeni i Bovillës	-	-	-	-	-	-	-	-
Rezervuari i Kujanit	363	8	560	10	207	9	272	10
Këneta e Roskovecit	29	2	1	1	2	2	1	1
Rezervuari i Kusit			3	2	15	1	33	4
Rezervuari i Gjançit			126	6	77	7	92	4
Rezervuari Shtyllë					9	1	0	0
Rezervuari Thumanës					426	6	164	6
Total	142376	64	138494	64	114293	66	99527	60

8.5 Përfundime

Sistemi i zonave të mbrojtura mjedisore, që përfshin rreth 21.76% të territorit të vendit, është përcaktuar sipas kritereve të IUCN –së. Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura rezulton me sipërfaqe gjithsej prej 624610.63 ha. Kemi rritje të numrit të kategorive të zonave të mbrojtura nga 767 në vitin 2023 në 775 në vitin 2024. Në total janë gjithsej 724 monumente natyrorë në vendin tonë. Në Vëzhgim - Monitorim, janë gjithsej 40 lloje nga të cilat, 13 janë gjitarë dhe 27 janë shpendë. Për vitin 2024 në censusin ndërkombëtar të numërimit u regjistruan 60 lloje shpendësh, me një numër total individësh prej 99527. Lloji me numër më të madh të individëve, është bajza (*Fulica atra*).

8.6 Rekomandime

- Të kryhet inventarizimi i florës dhe faunës.
- Të realizohet monitorimi edhe jashtë territorit të Zonave të Mbrojtura.
- Në zbatim të Urdhërit të Ministrit nr 1280, date 20.11.2013 “Për miratimin e Listës së Kuqe të Florës dhe Faunës së Egër”, sugjerojmë që të ketë monitorim të këtyre llojeve nga AKZM për territorin brenda Zonave të Mbrojtura dhe kontrata monitorimi me ekspertë dhe institucione të fushës për llojet e listës së kuqe, për të mundësuar grumbullimin e të dhënave dhe trendin e popullatave të këtyre llojeve ndër vite.

KAPITULLI 9

MJEDISI DHE SEKTORËT EKONOMIK

9.1 Mjedisit dhe Industria

Aktivitetet industriale përveç kontributit të tyre në zhvillimin ekonomik dhe social mund të jene nje burim kryesor i ndotjes së mjedisit nëpërmjet shkarkimeve në ajër, ujë dhe tokë.

Operatorët të cilët jane pajisur me leje mjedisore për zbatimin e kushteve të vendosura në lejen mjedisore dhe të legjislacionit në fuqi, kanë detyrimin për monitorimin e përputhshmërisë si dhe plotësimin e formularit të deklarimit të të dhënave për shkarkimet dhe për transferimin e ndotësve.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit menaxhon sistemin e informacionit mjedisor me të dhënat e grumbulluara nga operatorët ekonomik të pajisur me leje mjedisore të tipit A dhe B.

Regjistri i Shkarkimit dhe Transferimit të Ndotësve është një bazë të dhënash publike që mbledh dhe shpërndan informacion në lidhje me shkarkimet dhe transferimet e kimikateve të dëmshme nga objektet industriale dhe burime të tjera në mjedis. Ai ofron një mënyrë transparente për publikun dhe palët e tjera të interesuara për të hyrë dhe analizuar të dhënat mjedisore. Ky regjistër përmban 9 aktivitete kryesore si dhe 91 ndotës në total në ujë, tokë dhe ajër.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka administruar 313 aktivitete të cilët kanë raportuar shkarkimet totale vjetore për vitin 2024 sipas llojit të aktivitetit dhe sasisë së prodhimit. Gjatë këtij viti nuk ka pasur shkarkime aksidentale si dhe sasia e shkarkuar nuk ka tejkaluar vlerën limite të përcaktuar në legjislacion.

Industritë kryesore që kanë raportuar për vitin 2024 janë prodhimi çimentos, menaxhimi mbetjeve urbane, minierat nentokesore, nxjerrja e mineraleve, rëres dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim me qiell të hapur e nga guroret. Prodhimi i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit. Mbarështimi i pulave për prodhim mishi apo vezëve, përpunimi qumështi. Grumbullim metale me ngjyra ferore& joferore. Grumbullim bateri të

përdorura dhe riciklimi tyre, prodhimi lingotave të aluminit, plumbit, prodhim i ferrokromit, prodhim plastike. Kërkimi dhe nxjerrja e naftës dhe gazit natyror, rritje e derrave dhe gjedhit në një instalim, akuakultura, etj.

Ajo që vlen të theksohet është që numri kaq i lartë i subjekteve që kanë detyrim raportimin e këtij regjistri është rritur për shkak të numrit të lartë të subjekteve të cilat zhvillojnë aktivitetin “minierë nëntokësore” edhe pse sasia e ndotësve nuk e arrin limitin për raportim.

Kontribuesit e ndotjes dhe ndikimi në mjedis

Burimet kryesore të emetimeve vijnë nga proceset industriale që transformojnë materialet fizikisht ose kimikisht (për shembull, furnaltat në industrinë e hekurit dhe çelikut dhe në industrinë e çimentos janë shembuj të mirëfilltë të proceseve industriale që çlirojnë një sasi të konsiderueshme të CO₂). Gjatë këtyre proceseve, mund të prodhohen gaze të ndryshme me efekt serrë, duke përfshirë CO₂, CH₄, N₂O, hidrofluorokarbonet (HFC-të) dhe perfluorokarbonet (PFC-të). Emetimet e gazeve me efekt sërë nga sektori i proceseve industriale shkaktohen kryesisht nga dy nënsektorë kryesorë: Industria minerare dhe industria e metaleve. Gjatë periudhës 2009-2019, emetimet nga sektori i proceseve industriale janë reduktuar me 1,7%, nga 1364,68 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 1341,65 kt CO₂ eq. në vitin 2019.

9.1.1 Vetmonitorimet e aktiviteteve industriale

Gjatë vitit 2024 kemi një rritje të numrit të dorëzimit të raporteve të vetmonitorimit nga Operatorët të cilët janë të pajisur me leje mjedisore. Numri i operatorëve të cilët kanë raportuar për vitin 2024 është rreth 2762 nga të cilat 84 jane operator të pajisur me Leje Mjedisori Tipi A dhe 2678 operatore te pajisur me Leje Mjedisori Tipi B.

Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetmonitorimin për lejet e mjedisit të tipit A dhe B të ndara përkatësisht në secilin qark, për vitin 2024 paraqitet si më poshtë, në formë tabelare dhe grafike:

Tabela 78 - Numri i subjekteve të cilat kanë realizuar vetëmonitorimin për lejet e mjedisit A dhe për vitin 2024

Qarku	Viti 2024		
	Leje Tipi A	Leje Tipi B	Total
Tirane	2	596	598
Durres	7	316	329
Lezhe	1	179	180
Gjirokaster	1	87	88
Vlore	14	246	260
Berat	9	108	117
Fier	9	311	320
Kukes	14	108	122
Shkoder	17	154	171
Diber	5	197	202
Elbasan	1	173	174
Korçe	4	203	207
Totali	84	2678	2762




Figura 203 - Numri i subjekteve që kanë realizuar vetëmonitorimin, 2024

Tabela 79 - Tendenca e numrit të subjekteve të cilat kanë realizuar vetëmonitorimin për lejet e mjedisit A dhe B

Vitet	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Qarku											
Tirane	49	89	188	145	227	162	232	351	496	609	598
Durres	33	80	165	77	160	119	124	180	233	326	329
Lezhe	27	21	53	31	49	35	49	92	112	138	180
Gjirokaster	1	9	14	15	28	13	28	30	53	76	88
Vlore	31	50	68	38	87	63	85	102	146	185	260
Berat	15	35	91	58	82	64	60	78	95	118	117
Fier	29	75	92	67	107	131	97	124	188	236	320
Kukes	3	27	23	23	37	5	19	29	45	74	122
Shkoder	8	21	45	43	67	53	60	72	99	109	171
Diber	49	88	41	23	126	68	59	87	106	140	202
Elbasan	29	35	29	29	62	35	68	86	119	178	174
Korçe	16	36	56	43	68	31	49	83	121	144	207
Totali	290	566	865	549	1100	779	930	1314	1813	2333	2762

Vërehet tendencë në rritje gjatë viteve të fundit e subjekteve që kanë realizuar raportet e vetmonitorimit nga 779 subjekte në vitin 2019 në 2762 subjekte në vitin 2024.

Kjo vjen për disa arsye:

- Rritja e ndërgjegjësimit të subjekteve për vetmonitorimin e burimeve të shkarkimit të veprimtarisë së vet duke u bazuar në kushtet e lejeve dhe në afatet kohore të përcaktuara në to;
- Rritja e numrit të lejeve mjedisore, rishikimit, formatizimit të lejeve të vjetra;
- Njoftimet e bëra nga Drejtoria e Shqyrtimit dhe Monitorimit të LM dhe VNM, drejtuar subjekteve për rikujtesë të detyrimeve.
- Bashkëpunimi Drejtorisë së Shqyrtimit dhe Monitorimit të LM dhe VNM me Drejtorinë e Inspektim-Kontrollit, lidhur me njoftimet sa më sipër.
- Rritja e ndërgjegjësimit të operatorëve mbi detyrimet ligjore, si rezultat i informimit dhe komunikimit të vazhdueshëm nga AKM;
- Zbatimi i masave administrative (gjyba dhe paralajmërime) për mosdorëzimin e raporteve në afat, që ka shërbyer si faktor nxitës për përmbushjen e këtij detyrimi.

Mbetjet e Industrisë Kimike (siç janë mbetjet që përmbajnë substanca të rrezikshme) janë më së shumti të theksuara duke qënë se kjo lloj industrie është më e pranishme në qarkun e Elbasanit. Për këto në Raportet e Vetëmonitorimit janë paraqitur sasitë e shkarkuara; vendgrumbullimi i këtyre mbetjeve; riciklimi; ripërdorimi, trajtimi i mëtejshëm në vendndodhje dhe subjekti i licencuar ku dorëzohen mbetjet.

Përsa i përket shkarkimeve në ajër vihet re se pothuajse në të gjitha subjektet është bërë matja e temperatures, lagështisë, shpejtësia e erës, PM 10 dhe presionit atmosferik për mostrat e ajrit. Në disa subjekte janë matur më shumë parametra (përfshirë CO, CH₄, O₂, SO₂, H₂S, përqëndrimi i nivelit të pluhurit në nivele të ulëta etj). Ndërsa për mostrat ujore pothuajse në të gjitha subjektet kemi matje të vlerave të Nevoja Kimike për Oksigjen, Nevoja Biokimike për Oksigjen, temperature, konduktivitet, pH, dhe lëndët në pezulli. Në disa subjekte kemi më shumë parametra të matura në mostrat ujore si p.sh: Diferenca e temperatures, rrjedhja ditore, P-organik, N-amonikal, produkte nafte, fortësia e përgjithshme, As, Cd, Zn, Cr, Pb, Cianid i lire, Cianid total etj.

Nga raportet e vetëmonitorimit të dërguara nga operatorët pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për vitin 2024 rezulton se parametrat e matur të përcaktuar në lejen mjedisore të tyre janë brenda normave të përcaktuara në legjislacion përkatës.

9.1.2 Aktivitetet që ushtrojnë subjektet sipas qarqeve

Qarku i Tiranës

Në qarkun e Tiranës kanë dorëzuar **598 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku përmendim subjekte që operojnë në fushën e industrisë prodhuese si Industria Minerare, Industria Kimike dhe ajo Hidrokarbure dhe më pak të përmendura janë Industria e Drurit, Industria e Peshkut, Industria e Mishit, Industria Teknologjike, Industria e prodhimit të Birrës etj.

Qarku Elbasan

Për qarkun e Elbasanit kanë dorëzuar **174 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Kimike dhe Industrisë Metalore dhe më pak në Industrinë Minerare, Industrinë e Menaxhimit të Mbetjeve dhe Industrive të tjera.

Qarku Durrës

Për qarkun e Durrësit kanë dorëzuar **329 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Hidrokarbure, Industrisë Minerare, Industrisë Metalore dhe Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore. Në qarkun e Durrësit vihen re se operojnë edhe subjekte të tjera që ushtrojnë aktivitetin e tyre në Industrinë Elektronike, Industrinë e Pijeve dhe ajo e bimëve medicinale, edhe pse të pakta në numër.

Qarku Dibrë

Në qarkun e Dibrës kanë dorëzuar **202 subjekte Raporte Vetëmonitorimi**, ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Metalore dhe asaj Minerare.

Qarku Shkodër

Për qarkun e Shkodrës kanë dorëzuar **171 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Minerare, Industrisë Metalore dhe Industrise së përpunimit të duhanit

Qarku Kukës

Për qarkun e Kukësit kanë dorëzuar **122 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Minerare dhe Industrisë Metalore.

Qarku Korçë

Për qarkun e Korçës kanë dorëzuar **207 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Minerare, Industrisë Hidrokarbure dhe Industrise Kimike.

Qarku Berat

Për qarkun e Beratit kanë dorëzuar **117 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Minerare dhe Industrise Hidrokarbure.

Qarku Gjirokastrë

Për qarkun e Gjirokastrës kanë dorëzuar **88 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Minerare dhe Industria e Përpunimit të drurit.

Qarku Vlorë

Për qarkun e Vlorës kanë dorëzuar **206 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Hidrokarbure, Industrisë Minerare ,Industrisë Metalore dhe Industrisë së përpunimit të Peshkut.

Qarku Fier


Për qarkun e Fierit kanë dorëzuar **320 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Hidrokarbure, Industrisë Minerare, Industrisë Metalore dhe Industrisë së përpunimit të Peshkut.

Qarku Lezhë

Për qarkun e Lezhës kanë dorëzuar **180 subjekte Raporte Vetëmonitorimi** ku më së shumti janë subjekte që operojnë në fushën e Industrisë Metalore, Industrisë Minerare Industria e Menaxhimit të Mbetjeve, Industria Hidrokarbure dhe ajo e përpunimit të peshkut.

9.1.3 Lejet mjedisore dhe VNM

Gjate vitit 2024 janë shqyrtuar në total 729 aplikime nga të cilat kanë qenë aplikime për leje mjedisi tipi A (aplikime te rinj ose per ndryshim) aplikime per leje mjedisi tipi B (aplikime te rinj ose per ndryshim) si dhe aplikime per liçence te nenkategorise III.2.B (aplikime te rinj ose per ndryshim).



Vlerësimi i ndikimit në mjedis

Tabela 80 - Shqyrtime për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, 2024

1	Aplikime gjithsej të shqyrtuara	1154
2	VNM Paraprake	909
3	Vendim për VNM të Thelluar	4
4	Refuzime Vendimi	22
5	Miratime Deklarata Mjedisore	23

Tabela 81 - Dëgjesa me publikun, 2024

Kërkesa për Dëgjesë me Publikun	Nr.
Kërkesë për Dëgjesë me Publikun Total	289
Kërkesë për Dëgjesë me Publikun për Leje Mjedisore	262
Kërkesë për Dëgjesë me Publikun për VNM të Thelluar	27
Tërhequr nga kërkesa	6

9.1.4 Inspektimet

Gjatë vitit 2024 janë kryer **inspektime në fushën e ujërave** për veprimtaritë si mëposhtë vijon:

Për përdorimin e burimeve ujore.

- Inspektim i subjekteve të cilat e kanë të përqëndruar aktivitetin e tyre në përdorimin e burimeve ujore.
- Subjektet të cilat janë të pajisur me leje nga organet përkatëse të AMBU.
- Për përdorimin e ujit për proces teknologjik (veprimari prodhuese).
- Për përdorimin e ujit për aktivitet industrial.
- Imbotilim, konçesione.
- Për përdorimin e ujërave për prodhim hidroenergjie.
- Për qëllime të tjera tregtare dhe fitimi.

- Akuakulturë
- Shfrytëzim i burimeve natyrore të ujërave kurativë, minerale, gjeotermale, etj.

Shfrytëzimi i inerteve lumore

- Subjektet që veprojnë në këtë fushë të jenë pajisur me leje për shfrytëzimin apo e materialeve inerte si rërë, zhavor që nxirren nga shtretërit e lumenjve, përrenjve, liqeneve.
- Inspektim i impjanteve të fraksionimit të inerteve për lejen e përdorimit të ujit për larjen e inerteve dhe prodhimin e betonit.

Shkarkimet dhe monitorimi i cilësisë së ujërave.

- Kontrollin per parandalimin e shkarkimeve të ujërave të ndotura të pa trajtuara në burimet ujore pritëse, sidomos gjatë sezonit turistik.
- Kontrollin në zonat e mbrojtjes higjeno-sanitare.
- Kontrollin e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane e industriale të patrajuara.

Janë kryer në total 361 inspektme nga të cilat janë proceduar me masë administrative **(gjobë) 9 subjekte**. Nga Drejtoria e Inspektim- Kontrollit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit janë kryer 185 inspektme dhe 176 inspektme nga Drejtoritë Rajonale të Mjedisit.

Inspektme të realizuara në fushën e ujërave	Numri i inspektmeve	Masa administrative
AKM	185	3
ARM (Tiranë, Durrës, Dibër)	22	0
ARM (Berat, Elbasan, Korçë)	75	3
ARM (Fier, Vlorë, Gjirokastrë)	26	2
ARM (Lezhë, Shkodër, Kukës)	53	1
Totali	361	9

Gjatë vitit 2024 janë kryer 1269 inspektime për fushën e mjedisit (nga të cilat janë proçeduar me masë administrative (gjobë) 87 subjekte) në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore të subjekteve industriale dhe atyre me veprimtari prodhuese si dhe sigurimin e kontrollit shtetëror të mbrojtjes së mjedisit siç parashikohet në legjislacionin e posaçëm në fuqi.

Janë kryer 247 inspektime nga Drejtoria e Inspektim- Kontrollit pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe 1,022 inspektime nga Drejtoritë Rajonale të Mjedisit.

Inspektime të realizuara për mjedisin	Numri i inspektimeve	Masa administrative
AKM	247	25
ARM (Tiranë, Durrës, Dibër)	307	7
ARM (Berat, Elbasan, Korçë)	243	7
ARM (Fier, Vlorë, Gjirokastrë)	276	17
ARM (Lezhë, Shkodër, Kukës)	196	31
Totali	1269	87

Përgjatë vitit 2024 janë kryer në total 1630 inspektime dhe janë vendosur 96 masa administrative.

Në vitin 2024 kemi rritje të numrit të inspektimeve në fushën e mjedisit dhe të ujërave krahasuar me vitin 2023. Vërehet numër më i madh i masave administrative të vendosura në fushën e mjedisit gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023. Ndërsa për fushën e ujërave janë më pak masa administrative krahasuar me vitet e mëparshme.

	2021	2022	2023	2024
INSPEKTIME TË BURIMEVE NATYRORE (UJËRA)				
<i>Numri i inspektimeve</i>	301	268	329	361
<i>Masa administrative</i>	23	20	36	9
INSPEKTIME MJEDISORE				
<i>Numri i inspektimeve</i>	1021	897	813	1269
<i>Masa Administrative</i>	66	92	48	87

9.1.5 Industria e shfrytëzimit të burimeve natyrore

- *Shfrytëzimi mineralar*

Tabela 82 - Lejet aktive të shfrytëzimit mineralar, 2024

Lloji i mineralit	Numri i lejeve
KROM	226
BAKËR	17
HEKUR NIKEL	31
GËLQEROR	185
TË TJERA	71
TOTAL	530 leje aktive

- Hidrokarburet*

Tabela 83 - Subjektet që kanë nënshkruar Marreveshje Hidrokarbure me Shtetin Shqiptar

Nr.	Emri i Kompanisë	Vendburimi
1	Bankers Petroleum Albania Ltd	Patos-Marinzë
2	Sherwood International Petroleum Ltd	Kuçovë
3	Anio Oil & Gas sha	Ballsh-Hekal
4	United Terra sha	Visokë
5	Delvina Gas Company	Delvinë
6	Fin-Pek Petroleum sha	Finiq-Krane dhe Pekisht-Murriz
7	Edg Natural Gas	Frakull dhe Povelçë
8	Shell Upstream Albania BV	Blloku 2-3
9	Eni Albania	Blloku Dumre

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

- Hidrocentralet*

Tabela 84 - Numri i hidrocentraleve në prodhim, 2024

Qarku	Vendburimi	Numri i HEC-eve në prodhim
Korçë	Devoll, Osum, Vjosa, Lumi i Treskes, Selces Semerices	27
Kukës	Drin, Lumi Luma, Valbonë, perroi i Skatines, Lumi i Shalës	24
Dibër	Mat, Drin, Fan, lumi I Setes	42
Elbasan	Shkumbin, Devoll	33
Shkodër	Lumi Cem, Fan, Drin, Mat, Perroi i Roshit, Arstit	14
Gjirokastër	Vjosë	8
Lezhë	Mat, Fan	13
Berat	Osum	14
Tiranë	Erzen, Ishëm	3
Vlorë	Deti Jon, Vjosa, Perroi i Vrisit	5

Hec-e vendore	Drin, Devoll, Shkumbin, Deti Jon, Vjosa, Osum	22
------------------	--	----

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

- *Impiantet fotovoltaike të certifikuara dhe në shfrytëzim*

Tabela 85 - Numri i impianteve fotovoltaike të certifikuara dhe në shfrytëzim

Qarku	Numri i impianteve
Fier	17
Korçë	14
Elbasan	1
Durrës	2
Total	34

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

9.1.6 Kontrolli dhe inspektimi për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të tyre për vitin 2024

Kontrolli për respektimin e standarteve shtetërore për cilësinë e naftës dhe nënprodukteve të saj realizohet në zbatim të pikës 2 të nenit 23 të ligjit Nr.8450, datë 24.04.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, VKM Nr.147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse,benzinë dhe diesel”, VKM Nr.429, datë 26.06.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil dhe industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar,lumor dhe liqenor), Urdhërit të ministrit nr.6 datë 09.01.2015 “Për kontrollin e standardeve teknike të naftës dhe nënprodukteve të saj, procedurat dhe tarifat përkatëse” dhe Udhëzimit Nr.3492, datë 30.04.2015 “Për koordinimin ndërinstitucional të procedurave standard të kontrollit cilëor dhe fiskal të naftës bruto dhe nënproduktet e saj në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzim I Përbashkët Nr.6529/2 datë 06.10.2020 “Për mbledhjen,ruajtjen marrjen e mostrave dhe raportimin e të dhënave për cilësinë e benzinës,diezelit, gazit të lëngët të naftës

(GLN), lëndëve djegëse të lëngëta të mesme-rënda, lëndëve djegëse të lëngëta të rënda, lëndëve djegëse të lëngëta detare dhe furnizuesit e këtyre të lëndëve djegëse të lëngëta”.

Kontrolli i cilësisë së naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre , përfshin përcaktimin e vetive fizike dhe kimike sipas kërkesave të standardeve shtetërore të miratuara, parandalimin e falsifikimit të cilësisë nga subjektet e tregtimit me shumicë dhe ato me pakicë gjatë transportimit, ruajtjes dhe tregtimit të tyre.

Nga sa më sipër ISHTI kryen marrje të mostrave për kontroll cilësor në gjitha pikat doganore të vendit tonë të produkteve të naftës të klasifikuara për tregtim sipas kategorive përkatëse, në depozitat e subjekteve të tregtimit me shumicë dhe në stacionet e tregtimit me pakicë të tyre.

Testimi dhe Inspektimi për cdo parti nafte dhe nënproduktet e saj, si dhe Raport Testimet nga Laboratori i Naftës dhe Gazit përbëjnë masa shtesë për verifikimin e testimeve të kryera nga rafineritë e naftës dhe importuesit e nënprodukteve të naftës për të dorëzuar raport testime të falsifikuara.

Shtimi i qellimshëm i ndotësve që mund të kryhen gjatë shpërndarjes është i vështirë të identifikohet nëse nuk behen analizat laboratorike dhe monitorohen me kujdes.

Në vendin tonë me përjashtim të rafinerive të naftës që kanë laborator operacional, të gjitha shoqëritë e tregtimit me shumicë që zotërojnë kapacitete depozitimi dhe stacionet e karburantëve nuk kanë laboratorë dhe nuk kontrollojnë cilësinë e nënprodukteve të naftës.

Numri I mostrave dhe testimeve periodike është rregulluar në standartet dhe specifikimet teknike për llojet e produkteve të naftës, si dhe në urdhërin Nr.6/2015 të Ministrit Përgjegjës për Hidrokarburet.

Në zbatim të detyrave të përcaktuara me ligj, janë bërë inspekte për cilësinë e nënprodukteve të naftës për të verifikuar përpuethshmërinë me standardet në të gjithë territorin e vendit. Në ushtrimin e veprimtarisë së tij, ISHTI ka zbatuar një program agresiv për shkelësit e cilësisë, duke përfshirë rafineritë, importuesit dhe shitësit me pakicë të nënprodukteve të naftës.

Gjatë vitit 2024 kanë ushtruar veprimtari rafineritë e përpunimit të naftës bruto “Al Global Oil” sh.a UPN, Fier dhe “RBH Beline” sh.a në Elbasan, ndërsa rafineria e Përpunimit të naftës Ballsh dhe rafineria e naftës “AM-OIL” sh.a me adresë ish-Uzina e Plasmasit, Lushnjë nuk kanë ushtruar aktivitet të përpunimit të naftës bruto.

Gjatë vitit 2024 janë mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimit për sasinë totale 2,347,585 ton naftë bruto dhe nënprodukte naftë, nga të cilat Gazoil 1, 156 ,977 ton, benzinë 137 845 ton. Gaz i lëngëzuar nga nafta (GNL) 327 425 ton, lëndë djegëse (mazut) 9,663 ton, vajra lubrifikante 10, 803 ton, bitium 60551 ton, karburante për avione me turbine JET A-1 83 949 ton, naftë bruto 475, 734 ton, nënprodukte naftë nga rafinerite e vendit tone për eksport 29216 ton, Gazoil+Biodiezel 145, 967 ton.

Janë inspektuar subjektet e tregtimit me shumicë për kontroll cilësor dhe marrje mostra me tarife për cdo 4- mujor, në vitin 2024 dhe janë marrë gjithësej 549 mostra me tarife. Janë marrë gjithashtu 3346 mostra për kontroll cilësor parazhdoganimit. Janë inspektuar subjektet e tregtimit me pakice për kontroll cilësor për vitin 2024 dhe janë marrë gjithësej 2490 mostra me tarife, gjithashtu janë marrë 823 mostra për kontroll cilësor sondazh.

Janë inspektuar subjektet Konsumatorë të Medhenj nga të cilët janë marrë 9 mostra për kontroll cilësor për produktet që përdorin dhe dokumentacioni i furnizimit. Gjithësej janë analizuar 17 mostra për palë të tretë.

Zbatimi i standardeve cilësore të karburanteve, S SH EN 228:2012+A1:2017 për benzinën, S SH EN 590:2022 për gazoilin dhe S SH EN: 558:2018+ A1:2022 për gazin e lëngët është në përputhje me teknologjinë e avancuar të motorëve, por edhe me objektivat e BE-së për emetimin e gazrave nga mjetet lëvizëse.

Metoda e marjes së Mostrave që zbatohen janë në përputhje me standardin S SH EN ISO 3170:2005 dhe S SH EN ISO 3171:2002 ndërsa kryerja e analizave është realizuar në laboratorin e këtij institucioni i cili funksionon sipas S SH ISO/IEC 17025:2017.

Benzina

Sasia e benzinës e cila konsumohet nga mjetet e transportit në vendin tonë furnizohet nga tregu rajonal dhe kryesisht nga rafineritë e naftës në Itali dhe Greqi, të cilat sipas analizave laboratorike rezultojnë në pëpruthje me kërkesat e standardit S SH EN 228:2012 + A1:2017.

Janë importuar 137, 845 ton dhe janë marrë gjithsej 634 mostra.

Gjatë periudhës të mostrimit benzina rezultoi në pëpruthje me standardet shtetërore dhe rregulloret mjedisore. Parametrat që kishin më shumë diapazon ndryshimi ishin hidrokarburet aromatik dhe presioni i avullit.

Olefinat në benzinë të cilat kanë një shkallë të lartë antiknock, vlerat mesatare të tyre u luhatën në vlerën 9-18% duke respektuar kërkesat e standardit.

Monitorimit të këtij parametri i është kushtuar rëndësi sepse oksidimi I tyre, kur benzina nuk përdoret për një kohë të gjatë, krijon depozitime në serbatorët e makinave duke bllokuar sistemin e injektimit të karburantit.

Nga analizimi në laboratorë asnjë mostër nuk rezultoi me numër oktani të ulët dhe përmbajtje oksigjenatesh nën standardet shtetërore. Ndryshimi I vlerës së numrit të oktanit në kufijtë Brenda standardit nuk influencon në ndryshimin e emetimeve.

Përmbajtja e oksigjenateve lidhet drejtëpërdrejtë me numrin e oktanit, sepse këto komponime favorizojnë djegien e plotë të benzinës. Përmbajtja e tyre gjatë kësaj periudhe luhatet në vlerën 1-2.6% në peshë, me një vlerë mesatare 1.7%. Ky parametër është në pëpruthje me rregulloret mjedisore.

Numri i oktanit lidhet me aftësinë e benzinës për tu djegur pa goditje e normalisht në motor dhe gjenerimin e energjisë gjatë djegies së saj.

Vlerësimi i oktanit me metodën S SH EN ISO 5164 rezulton në kufijtë e lejuar. Vlera mesatare e aromatikëve gjatë kësaj periudhe rezultoi 18-33%.

Diferenca maksimale prej 6-8 % e përmbajtjes së olefinave në benzinë nuk paraqet ndonjë ndryshim të rëndësishëm në emisionet e gazrave në atmosferë.

Përmbajtja e benzenit I cili është një product kancerogjen, në benzinë është luhatur në kufijtë 0.4-0.7 % nga 1% që është kufiri I lejuar.

Përmbajtja e squfurit shoqërohet me formimin e oksidit të squfurit dhe formimin e shiut acid. Mesatarja e kësaj periudhe luhetet në kufijtë 5-10 ppm. Ndryshimi i vlerës së përmbajtjes së squfurit influencon në rritjen e saj në atmosferë.

Presioni i avullit karakterizon shkallën e paqëndrueshmërisë të benzinës, për të cilën kërkohet të arrihet një djegie efikase në motor është shumë I rëndësishëm për stinën e verës e nuk ka tejkaluar vlerën 60 kpa.

Gazoili

Sasia e gazoilit që konsumohet nga mjetet e transportit në vendin tonë furnizohet nga tregu I jashtëm dhe kryesisht nga rafineritë e naftës në Itali, Greqi dhe Turqi të cilat sipas analizave laboratorike rezultojnë në përputhje me kërkesat e standardit S SH EN 590:2022.

Janë importuar gjatë këtij viti 1, 156, 977 ton dhe janë marrë gjithësej 1277 mostra.

Vlera mesatare e numrit të cetanit gjatë kësaj periudhe ka rezultuar 52.1 njësi. Pika e flakërimit është një koncept i rëndësishëm për mbrojtjen nga zjarri sepse është temperatura më e ulët në të cilën ekziston rreziku i zjarrit me një lëng të caktuar. Ajo tregon praninë e materialeve të paqëndrueshme në një material të qëndrueshëm. Temperatura e flakërimit është e përcaktuar si temperaturë minimale e nevojshme për karburantin në të cilën formohet një përzierje e ndezshme.

Pika e flakërimit sipas standardit S SH EN 590:2022 duhet të jetë jo më I vogël se 55°C. Gjatë vitit 2024 janë konstatuar 8 raste me shmangie të këtij treguesi, ku kanë rezultuar nga 41°C deri 53.5°C.

Përmbajtja e squfurit për produktin gazoil është tregues i rëndësishëm sipas standardit S SH EN 590:2022. Një rast ka rezultuar me shmangie të standardit, ku përmbajtja e squfurit është 27 mg/kg.

Motorët me naftë injektojnë lëndë djegëse të lëngët në cilindër. Në temperature të ulëta rritet viskoziteti i gazoilit dhe mund të kufizojë rrjedhën e karburantit në cilindër. Nga analizat laboratorike pika e ngrirjes luhetet nga -18 deri në -22°C, për të parandaluar problemet në periudhën e dimrit.

Lëndët djegëse të lëngëta për përdorim termik, civil dhe industrial

Në lëndët djegëse që përdoren për përdorim industrial dhe mjetet e lundrimit detar, inspektimi dhe testimi kanë patur si objektiv, që lëndët djegëse të jenë në përputhje me standartin S SH UNI 6579:2011 dhe Direktivën e Sqfurit të BE 1999/32.

Gjatë vitit 2024 është importuar 9663 ton lëndë djegëse mazut dhe janë marrë gjithësej 27 mostra lëndë djegëse për kontroll cilësor.

Të gjithë përbërësit e naftës kur digjen janë të dëmshëm për mjedisin. Papstërtitë e sqfurit të naftës dhe mbetjeve të rënda do të shkaktojnë formimin e tymrave toksikë me një përmbajtje të lartë të blozës, dhe një përmbajtje e konsiderueshme e përbërjeve që përmbajnë azot con në një përqëndrim relativisht të lartë të oksideve të azotit. Dëmi nga djegia e naftës së papërpunuar është e dukshme dhe jo vetëm për mjedisin, por edhe për pajisjet e përdorura.

Korrozioni i gazit të metaleve, formimi i depozitave të karbonit në furrat dhe depozitat e koksit në sprucatore, çojnë në mbyllje të shpeshta të furrave për pastrim, janë shëmbujt më të zakonshëm të përdorimit destruktiv të naftës. Prandaj, sipas legjislacionit të disa vendeve për mbrojtjen e mjedisit, është e ndaluar përdorimi i naftës së papërpunuar si lëndë djegëse.

Gaz i lëngëzuar nga nafta (GNL)

Gjatë vitit 2024 janë importuar 327, 425 ton GNL, ku janë marrë gjithësej 121 mostra.

Miratimi i standardit të gazit të lëngët si rregull Teknik I detyrueshëm për zbatim, me VKM Nr.429 datë 26.06.2019 “Për cilësinë e disa lëndëve të djegshme, të lëngëta, për përdorim termik, civil dhe industrial, si dhe përdorim në mjetet e transportit ujor (detar, lumor dhe liqenor), disiplinon tregtimin e tij sipas kushteve klimatike të vendit tonë dhe në përputhje me standardin S SH EN 589:2018+A1:2022.

9.1.7 Rekomandime

- Për kompani të mëdha ose të pajisura me Leje Mjedisore të Tipit A, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave të ajrit.
- Të gjithë operatorët që bëjnë trajtimin e peshkut si dhe të prodhimet të pijeve alkoolike apo produkteve ushqimore të instalojnë impiante të trajtimit të ujërave teknologjike.
- Të merren masa për shkarkimet nga mjetet motorrike.

9.2 Mjedisi dhe Turizmi

Gjatë vitit 2024 kanë hyrë 11.292,735 shtetas të huaj që qëndrojnë përkufizimit “turistë”, pra që shpenzojnë më shumë se një natë në vendin tonë.

Udhëtimi me mjete tokësore mbetet udhëtimi më i preferuar për vizitorët e huaj dhe shqiptarë. Gjithsesi udhëtimi me rrugë ajrore ka një rritje prej 65.4% më shumë, krahasuar me vitin 2023.

Në tabelën më poshtë jepet lloji i udhëtimit të shtetasve të huaj dhe shqiptarë, që kanë zgjedhur gjatë gjithë vitit 2024, krahasuar kjo me të njëjtat të dhëna të dy viteve paraardhëse:

Tabela 86 - Numri i vizitorëve sipas llojit të udhëtimit

Mënyra e udhëtimit të vizitorëve të huaj	Janar-Dhjetor 2023	Janar-Dhjetor 2024	Ndryshimi (%)
Gjithsej	10,155,640	11,696,111	15,2%
Me ajër	1,953,042	3,231,105	65,4%
Me det	509,958	514,036	0.8%
Me tokë	7,692,640	7,950,970	3.3%

Burimi: Buletini i Turizmit

Në lidhje me raportin e mënyrës së transportit të zgjedhur nga vizitorët e huaj dhe shqiptarë, për të hyrë në Shqipëri gjatë vitit 2024, me numrin e hyrjeve në total të vizitorëve të huaj, i shprehur në %, është si më poshtë:

- 68 % e të huajve dhe vendasve zgjedhin rrugën tokësore për të hyrë në Shqipëri;
- 27.6% e të huajve dhe vendasve hyjnë në kufirin shqiptar në rrugë ajrore;
- 4,4 % e hyrjeve bëhet nëpërmjet transportit detar.

9.2.1 Turizmi kulturor

Gjatë vitit 2024, vizituan 25 Institucionet tona të Kulturës 1,314,999 vizitorë të huaj dhe vendas. Numri i vizitueshmërisë në 2024 u rrit 31% krahasuar me vitin parardhës.

Tabela 87 - Vizitorët në institucionet e kulturës

	INSTITUCIONI	2023	2024	Ndryshimi në %
1	MUZEU HISTORIK KOMBËTAR TIRANË	99,796	25,212	-75%
2	MUZEU ARKEOLOGJIK Durrës		-	
3	MUZEU I PAVARSISË Vlorë	8,167	12,658	55%
4	MUZEU GJERGJ KASTRIOTI, KRUJË	110,162	174,561	58%
5	MUZEU ETNOGRAFIK, KRUJË		14,061	
6	MUZEU ETNOGRAFIK BERAT	-	-	
7	MUZEU IKONOGRAFIK ONUFRI, BERAT	75,772	106,303	40%
8	MUZEU I ARTIT MESJETAR, KORÇË	14,313	20,991	47%
9	MUZEU ARKEOLOGJIK, KORÇË	1,533	1,425	-7%
10	MUZEU ARSIMIT, KORÇË	13,810	14,068	2%

11	MUZEU K. I FOTOGRAFISË MARUBI	19,220	22,534	17%
12	MUZEU K. I PËRGJIMEVE "SHTËPIA ME GJETHE"	48,835	77,026	58%
TOTALI MUZE		391,608	468,839	20%
1	KALAJA GJIROKASTËR	217,939	263,048	21%
2	KALAJA PORTOPALERMOS	17,691	30,292	71%
3	KALAJA E KANINËS	2,558	4,990	95%
4	KALAJA E HIMARËS	3,166	5,473	73%
5	AMFITEATRI	26,989	23,707	-12%
6	MANASTIRI I 40 SHËNJTORËVE	2,515	2,912	16%
7	TORRE VENECIANE DURRËS	525	14,363	2636%
TOTALI KALA E MONUMENTE TE TJERE		271,383	344,785	27%
1	PARKU KOMBËTAR BUTRINT	119,125	200,570	68%
2	PARKU ARKEOLOGJIK APOLONI	82,265	121,807	48%
3	PARKU ARKEOLOGJIK BYLIS	5,897	7,279	23%
4	PARKU ARKEOLOGJIK SHKODËR	125,735	157,827	26%
5	PARKU ARKEOLOGJIK LEZHË	4,552	7,771	71%
6	PARKU ARKEOLOGJIK AMANTIA	794	654	-18%

7	PARKU ARKEOLOGJIK ORIKUM	1,682	2,081	24%
8	PARKU ARKEOLOGJIK FINIQ	910	666	-27%
9	PARKU ARKEOLOGJIK ANTIGONE	1,864	2,720	46%
TOTALI PARQJE ARKEOLOGJIK		342,824	501,375	46%
TOTALI NUMRI I VIZITOREVE		1,005,815	1,314,999	31%

Burimi: Buletini i Turizmit

Në lidhje me numrin e vizitueshmërisë në 2024 institucioni Kulturor më i vizituar është Kalaja e Gjirokastrës e ndjekur nga Parku Kombëtar I Butrintit. Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët, në institucionet Kulturore për vitin 2024, janë përfituar 466,399,420 Lek, që janë rreth 46,2% më shumë se të ardhurat e përfituara gjatë vitit 2023.

9.2.2 Turizmi natyror

Në lidhje me turizmin natyror, të dhënat nga Agjensia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, tregojnë se viti 2024 ka pasur 5,565,730 vizitorë të huaj dhe vendas, që kanë vizituar zonat tona të mbrojtura me një rritje prej 22% krahasuar me numrin e vizitorëve gjatë vitit paraardhës. Numrin më të madh të vizitorëve e kanë zonat e mbrojtura të qarkut të Shkodrës dhe Korçës, Fierit dhe Durrësit. Kemi një ulje të vizitorëve në zonat e mbrojtura të qarkut të Tiranës dhe Fierit. Në lidhje me të ardhurat nga vizitorët në zonat e mbrojtura të 12 qarqeve janë përfituar 21,283,100 ose 67% më shumë se të ardhurat e mbledhura për viti 2023.

Tabela 88 - Numri i vizitorëve në zonat e mbrojtura sipas qarqeve

QARKU	Vizitorët në Total Janar - Dhjetor		
	2023	2024	Ndryshimi në %
Tirana	206,224	173,326	-16%
Vlora	762,450	805,111	6%

Lezhë	223,393	217,907	-2%
Gjirokastrër	98,116	135,063	38%
Kukës	246,491	220,345	-11%
Korçë	461,298	1,029,048	123%
Berat	187,115	380,598	103%
Elbasan	116,302	191,059	64%
Shkodër	1,093,120	1,331,547	22%
Dibër	56,547	70,228	24%
Fier	844,740	626,748	-26%
Durrës	273,100	384,750	41%
Totali	4,568,896	5,565,730	22%

Burimi: Buletini i Turizmit

Për të pasur më të qartë tërheqjen e vizitorëve në zonat e mbrojtura po japim të dhënat e paraqitura në formë grafike për të gjitha kategoritë e zonave të mbrojtura në dy vitet e fundit. Rreth 2.2 milion vizitorë të huaj dhe vëndas kanë vizituar **Parqet Kombëtare** të vendit tonë gjatë vititi 2024. Ky vit shënon një rritje 4,1% krahasuar dhe me vitin paraardhës. Parku kombëtar më i vizituar është, Alpet e Shqipërisë, Divjakë Karavastaja dhe Mali i Tomorrit:

Janë 591,449 vizitorë që kanë vizituar **Monumentet e Natyrës** gjatë vitit 2024, kjo vlerë shënon një ulje në masën 39.2% krahasuar me vitin 2023. Ujërat Termale të Bënjës, Shpella Shënandoit dhe Sarisalltik janë Monumentet e Natyrës më të vizituara për vitin 2023.

Rreth 1.1 milion vizitorë kanë vizituar **Rezervatet Natyrore** gjatë vitit 2024, nga kjo kategori më të vizituarat kanë qënë Syri i Kaltër, Liqeni i Shkodrës, dhe Lugina e Shalës. Më poshtë po japim paraqitjen grafike të vizitorëve në këto zona të mbrojtura në dy vitet e fundit.

Numrin i vizitorëve në **Peisazhet e Mbrojtura** për vitin 2024 është rreth 1.6 Milion ose 35.1% më shumë se vitin paraardhës. Numrin më të madh të

vizitorëve në këtë kategori e zë Liqeni i Pogradecit i ndjekur nga Lumi i Bunës.

9.3 Mjedisi dhe Bujqësia

Marrëveshja e Gjelbër Evropiane është një grup iniciativash politikash nga Komisioni Evropian që synon të bëjë Klima neutrale e BE-së deri në vitin 2050. Ajo ka pasur një rol të rëndësishëm në politikat e fundit që mbështesin sektori agro-ushqimor. Më e rëndësishmja nga këto nisma për bujqësinë është Strategjia “Farm to Fork” (KE, 2020), e cila ka qenë në vend që nga viti 2020 dhe synon të reduktojë ndikimin në mjedis dhe në klimë i prodhimit primar duke siguruar kthime të drejta ekonomike për fermerët

Bujqësia “natyrale” e cila për të ushqyer bimën përdor produkte gjithmonë po natyrale që nuk prodhohen në fabrika nëpërmjet sintezës kimike, ka lindur me njeriun.

Produktet e prodhuara nga bujqësia organike dhe vetë bujqësia organike na siguron disa përfitime: në radhë të parë përfitime mjedisore që lidhen me rritjen/ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e ajrit, tokës dhe ujit nga ndotja e cila arrin deri tek njeriu nëpërmjet ushqimit.

Bujqësia organike është sistemi bujqësor që përdor kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve dhe plehrat organike që rrjedhin kryesisht nga mbetjet e kafshëve dhe bimëve.

Bujqësia organike është pjesë e Strategjisë së BE-së “Nga ferma në tavolinë” dhe konsiderohet si një sistem i rëndësishëm e i qëndrueshëm bujqësor, me një objektiv që të paktën 25% e tokës bujqësore të BE-së të jetë nën bujqësi organike deri në vitin 2030 dhe Shqipëria ka një mundësi të artë për të zhvilluar bujqësinë organike, në harmoni me kete objektiv.

Shqipëria ka 896.9 ha tokë bujqësi organike, e cila është rreth 1.3% e sipërfaqes bujqësore. Duke qenë se potenciali për eksport është i lartë dhe tregu i BE-së për produkte organike vazhdon të rritet, ndërkohë që edhe preferenca e konsumatorit vendës shfaq, gjithashtu, një tendencë positive. Pritet që sipërfaqja me bujqësi organike në Shqipëri të rritet, kjo edhe si pasojë e vazhdimit të mbështetjes nga skemat kombëtare për fermat organike, por edhe e fillimit të zbatimit të masës agromjedisore-organike të programit IPARD III.

Tabela 89 - Sipërfaqe me prodhime organike në tokë bujqësore, 2023

Emërtimi	Sipërfaqe/ ha			
	Gjithsej	në kalim organik	plotësisht organike	- nga e cila në serra
Tokë e punueshme	610.17	10.67	599.50	1.18
- Drithra	31.88	0.00	31.88	0.00
- Bimë aromatike dhe mjekesore)*	514.60	8.74	505.86	1.18
- Perime	0.89	0.36	0.53	0.00
- Foragjere	2.33	1.07	1.26	0.00
- Të tjera	60.47	0.50	59.97	0.00
Drufrutorët	186.44	104.14	82.30	0.00
- Pemë frutore	28.94	22.33	6.61	0.00
- Agrume	0.00	0.00	0.00	0.00
- Ullinj	140.46	72.90	67.56	0.00
- Vreshta	17.04	8.91	8.13	0.00
Gjithsej	796.61	114.81	681.80	1.18

Burimi: INSTAT

Kemi rritje të sipërfaqes me prodhime organike nga 733.4 ha në vitin 2022 në 796.61 ha në vitin 2023. Kjo ka çuar dhe në rritjen e sipërfaqes plotësisht organike nga 570 ha (2022) në 681.8 ha në 2023.

Tabela 90 - Prodhimet organike në tokat bujqësore 2023

Emërtimi	Prodhim/Ton			
	Gjithsej	në kalim organik	plotësisht organik	nga e cila ne serra/

Tokë e punueshme	1104.60	15.22	1089.38	7.29
- Drithra	45.28	0.00	45.28	0.00
- Bimë aromatike dhe mjekesore)*	1041.38	9.25	1032.13	7.29
- Perime	9.34	1.97	7.37	0.00
- Foragjere	8.60	4.00	4.60	0.00
- Të tjera	0.00	0.00	0.00	0.00
Drufrutorët	494.74	280.30	214.44	0.00
- Pemë frutore	66.63	53.07	13.56	0.00
- Agrume	0.00	0.00	0.00	0.00
- Ullinj	352.91	184.38	168.53	0.00
- Vreshta	75.20	42.85	32.35	0.00
Gjithsej	1599.34	295.52	1303.82	7.29

Burimi: INSTAT

Tabela 91 - Produkte organike të egra, 2019 – 2023

Emërtin	Sipërfaqe/ Ha				Prodhimi /Ton			
	2019	2020	2022	2023	2020	2021	2022	2023
Bimë aromatike dhe mjekesore)*	633,46 5.7	662,78 9.7	446,36 3.0	467,97 3.0	3,78 1.1	10,11 3.0	11,32 6.0	6,29 5.0
Arroret	3,250. 0	2,250. 0	2,220. 0	3,220. 0	873. 0	1,200. 0	452.0	1,00 0.0
Fruta pylli	11,576 .7	12,676 .7	13,000 .0	-	491. 6	420.0	900.0	-
Gjiths ej	648,29 2.4	677,71 6.4	461,58 3.0	471,19 3.0	5,14 5.7	11,73 3.0	12,67 8.0	7,29 5.0

Burimi: INSTAT

9.3.1 Sistemi i ushqimit

Sistemet ushqimore mund të përshkruhen si rrjeta komplekse e aktiviteteve që rrethojnë mënyrat në të cilat ne rritemi, prodhojmë, përpunojmë, tregtojmë, transportojmë, konsumojmë dhe shpërdorojmë ushqimin, ose, thënë thjesht, si e marrim ushqimin tonë nga ferma në tavoline. Sistemet e ushqimit janë thelbësore për shëndetin dhe mirëqenien tonë, jetesën dhe ekonominë tona, si dhe vlerat kulturore dhe sociale. Në nivel global, sistemet ushqimore janë nxitësit kryesorë të ndryshimeve klimatike, ndryshimeve në përdorimin e tokës, varfërimit të ujërave të ëmbla burimet dhe ndotja e ekosistemeve ujore dhe tokësore. Reduktimi i mbetjeve ushqimore është një hallke tjetër e rëndësishme në sistemin e ushqimit që kërkon vëmendje.

Integrimi i Shqipërisë në ekonominë globale, veçanërisht për sektorin agroushqimor është jetik,

por sfidues. Aktualisht, akses i Shqipërisë në tregjet ndërkombëtare të ushqimit është ende i

kufizuar. Është tepër e rëndësishme që produktet shqiptare të kenë akses dhe të bëhen më konkurruese në tregjet e huaja.

Forcimi i sistemit rregullator agroushqimor në Shqipëri është i nevojshëm për të përmirësuar

mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, shëndetit të kafshëve dhe shëndetit të bimëve. Aktualisht,

në sistemin rregullator shqiptar ka disa mangësi specifike, në veçanti baza e kufizuar e provave për fusha kyç, si:

- incidenca në nivel vendi e rreziqeve dhe sëmundjeve të shkaktuara nga ushqimi, duke përfshirë rreziqet dhe sëmundjet për shëndetin e kafshëve;
- kostoja ekonomike e ushqimeve të pasigurta;
- efikasiteti i ndërhyrjeve në sigurinë ushqimore.

Për të forcuar sistemin rregullator duhen adresuar një sërë sfidash specifike, që përfshijnë disponueshmërinë e të dhënave për informim të monitorimit dhe mbikëqyrjes me bazë risku, pikat e dobëta që ekzistojnë në sistemet e sigurisë

ushqimore dhe të shëndetit të kafshëve, lidhur me evidencat shkencore, infrastrukturën e nevojshme, burimet e trajnuara njerëzore, kulturën e sigurisë ushqimore dhe rregulloret e zbatueshme. Strategjia kombetare e sigurisë ushqimore 2023-2027 percakton objektivat për përmirësimin e sistemit të sigurisë ushqimore.

1. Forcimi i Kornizës Legjislative dhe Administrative të perafuar me BE
2. Rritja e Efektivitetit të Sistemit të Kontrollit Agroushqimor
3. Forcimi i pajtueshmërisë në të gjithë sektorin agroushqimor
4. Fuqizimi i konsumatorit për të marrë vendime të informuara

Bujqësia, zhvillimi rural dhe peshkimi që nga viti 2017 janë mbështetur nëpërmjet skemave kombëtare. Këto skema kanë shërbyer, si për rritjen e prodhimit bujqësor e blegtoral, të mjaltit nga bletët, si nëpërmjet pagesave për krerë, gjedh apo të imta apo koshere, ashtu edhe për rritjen e sipërfaqeve të mbjella me kultura, me vlerë të lartë dhe me potencial për eksport, për rritjen e sipërfaqeve të serrave, por edhe për pajisjen më të mirë të flotës së peshkimit për ta bërë atë më eficiente. Që prej vitit 2021 ka filluar implementimi i skemës së mbështetjes të fermerëve me naftë pa akcizë, taksë karboni dhe taksë qarkullimi, për punimet e mekanizuara në bujqësi. Vetëm nëpërmjet kësaj skeme, më 2021-shin kanë përfituar rreth 20 mijë fermerë.

Një mbështetje e rëndësishme për sektorët bujqësor, të zhvillimit rural dhe të peshkimit kanë qenë edhe incentivat fiskale të financuara nga Qeveria Shqiptare, si vijon:

1. Heqja/reduktimi i TVSH-së për inputet bujqësore, që përfshijnë plehrat kimike, pesticidet, farërat dhe fidanët;
2. Heqja e TVSH-së për makinat bujqësore, si në import ashtu dhe brenda vendit;
3. Heqja e pragut të xhiros për efekt rimbursimi të TVSH-së dhe reduktimin e tatim-fitimit në 5% për “Shoqëritë e Bashkëpunimit Bujqësor, që operojnë në fushën e bujqësisë”;
4. Paketa e agroturizmit, për subjektet e certifikuar si agroturizëm:
 - 6% TVSH;
 - 5% Tatim-fitimi;

- 0% Taksë ndikimi në infrastrukturë.

Diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale:

Një dimension tjetër shumë i rëndësishëm i politikave për zhvillimin bujqësor dhe rural është edhe diversifikimi i aktiviteteve ekonomike në zonat rurale, nëpërmjet mbështetjes për investime në agroturizëm, turizmit rural (bujtinat), ngritjen e inkubatorëve të prodhimit dhe produktet tradicionale, si dhe projekte infrastrukturore në zonat rurale.

Në fushën e sigurisë ushqimore ka një përmirësim të ndjeshëm të standardeve të prodhimit dhe të kontrollit, dhe të gjurmueshmërisë përgjatë të gjithë zinxhirit ushqimor. Siguria që i ofrohet konsumatorit shqiptar nëpërmjet ushqimit është rritur ndjeshëm. Në këtë kuadër, rrjeti i laboratorëve të sigurisë ushqimore është përafruar më tepër me standardet e BE-së dhe është rritur numri i analizave dhe i laboratorëve të akredituar.

Garantimi i sigurisë ushqimore është një komponent i rëndësishëm i Strategjisë për Sigurinë Kombëtare, për mbrojtjen e shëndetit të konsumatorëve, që siguron funksionimin efektiv të çdo hallke në zinxhirit ushqimor. Ky princip është i vlefshëm, pavarësisht nga fakti nëse ushqimet prodhohen në Shqipëri apo importohen nga vende të tjera. Politikat efikase të sigurisë ushqimore bazohen në natyrën komplekse të prodhimit të këtyre ushqimeve si dhe në vlerësimin e monitorimit të risqeve mbi shëndetin e njerëzve.

AKU i kryen kontrollet zyrtare sipas "Planit të Kontrolleve Zyrtare me Bazë Risku dhe të Marrjes së Mostrave, për Ushqimin, Ushqimin për Kafshë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Inputeve Bujqësore, si dhe Planin e Marrjes së Mostrave në Pikat e Inspektimit Kufitar".

Ky plan është përgatitur në zbatim të metodologjise për profilizimin e riskut të Operatorëve të Biznesit në varsi të riskut që lidhet me aktivitetet e tyre dhe faktorëve të tjerë ndikues (historiku) duke përdorur sistemin e pikëzimit.

Ne planin e inspektimeve, si ne terren ashtu edhe ne Pikat e Inspektimit Kufitar, janë përfshirë:

- Plani i marrjes së mostrave në kontrollin zyrtar

- Plani i marrjes së mostrave në monitorimin e pesticideve

Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore

Ndërkohë që është bërë progres në këtë drejtim, sipas analizave të bëra dhe sfidave që kanë përpara këta sektorë, duke filluar nga fermerët dhe në nivelin e MBZHR-së, janë të nevojshme përpjekje të shtuara për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës për transferimin e njohurive dhe futjen në shkallë më të gjerë të inovacionit dhe të digjitalizimit. Për të përballuar sfida, si: ekonomia e gjelbër, mirëruajtja e biodiversitetit, efektet e ndryshimit të klimës me pasoja mbi prodhimin bujqësor, të cilat afektojnë fermerët dhe aktorët ekonomikë në zonat rurale, si dhe në sektorin e peshkimit, parashikohet të ndërmerren reforma institucionale dhe strukturore, që tashmë kanë filluar dhe do të fuqizohen më tej, nëpërmjet masave të planifikuara në strategji për rritjen e kapaciteteve, të bashkëpunimit, shpërndarjen efikase të njohurive dhe inovacionit, duke fuqizuar përdorimin e mjeteve dhe të instrumenteve digjitale.

9.3.2 Impakti i bujqësisë në mjedis

Aktivitetet bujqësore kanë ndikim në mjedis dhe në shëndetin e njeriut përmes përdorimit të kimikateve, mbeturinave dhe emetimeve. Një pjesë e mbeturinave nga produktet shtazore dhe joshtazore hidhen në vendepozitime të caktuara. Emetimet e gazrave serrë nga sektori i bujqësisë janë rritur me 4.7% midis viteve 2009 dhe 2019. Emetimet vijnë nga fermentimi enterik, menaxhimi i plehut dhe tokat e administruara, duke përfshirë nga përdorimi i plehëruesve. Objektivi i vendosur në dokumentin e kontributit kombëtar të pikesynuar 2021-2030 për uljen e emetimeve të gazrave serrë nga bujqësia është -3% në vitin 2030.

Metani CH₄ prodhohet si nënprodukt i fermentimit dhe nxirret jashtë. Rreth 83% e CH₄ emetohet gjatë proceseve të fermentimit enterik.

Menaxhimi i plehut organik i referohet kapjes, ruajtjes, trajtimit dhe shfrytëzimit të plehut organik të kafshëve në një mënyrë të qëndrueshme për mjedisin. Plehu i bagëtive lëshon emetime të CH₄ nga fermentimi enterik si dhe se bashku CH₄ ashtu edhe N₂O në kushte anaerobe (pa oksigjen). Emetimet nga menaxhimi i plehut organik përfaqësojnë rreth 17% të totalit të gazeve serrë nga bagëtia.

Aplikimi i uresë ndikon drejtpërdrejt ose tërthorazi në emetimet e N₂O. Ka një trend në rritje në përdorimin e këtij plehu në vend me 32% nga viti 2009 deri në vitin 2019.

Përdorimi i përhapur dhe i tepërt i plehrave plehëruese dhe pesticideve përbën një rrezik të konsiderueshëm për shëndetin e tokës dhe cilësinë e ujit dhe është një kontribues i rëndësishëm në humbjen e biodiversitetit, veçanërisht në zvogëlimin e popullatave të insekteve që luajnë një rol vendimtar në ekosisteme.

Sasitë e Plehrave Plehërues të importuara në vendin tone për përdorim në bujqësi për periudhën janar - dhjetor 2024 rezultojnë se janë:

- 125.974 ton
- 128.869 litra

Sasitë e Produkteve për Mbrotjtjen e Bimëve të importuara për periudhën janar - dhjetor 2024 rezultojnë se janë:

- 913.266 ton
- 442.796 litra

Bujqësia organike dhe roli i saj në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.

Pa dyshim që një nga problemet më të mëdha sot në botë janë ndryshimet klimatike. Ndryshimet klimatike gjithnjë e më shumë po shfaqin ndikimin e tyre në të gjitha sistemet ekologjike me pasoja të mëdha jo vetëm mjedisore, por dhe ekonomike e sociale. Tashmë është e qartë që klima e Tokës po ndryshon si pasojë e lëshimeve të gazeve serrë në atmosferë. Djegia e lëndëve djegëse fosile, industria, transporti, prodhimi i energjisë, shpyllëzimi, bujqësia etj., janë kontribuesit kryesorë të lëshimeve të gazeve serrë.

Bujqësia është një nga kontribuesit kryesorë në ndryshimet klimatike. Kështu që në sektorin e bujqësisë, për të reduktuar lëshimet e gazeve serrë është e nevojshme, në përputhje me drejtimet e strategjive zbutëse, të përshtasim sistemet bujqësore sipas parimeve agroekologjike dhe të modifikojmë praktikatat

bujqësore që zbatojmë në ferma. Praktikrat e reja bujqësore që duhet të ndjekim nga njëra anë reduktojnë gazet serrë që vijnë nga bujqësia si dioksidi i karbonit (CO₂), gazi metan (CH₄) dhe oksidi i azotit (N₂O) dhe, nga ana tjetër, krijojnë mundësinë për një sekuestrim të karbonit në tokë si një nga vend-depozitimet kryesore të tij.

Pjesë e rëndësishme e strategjive zbutëse e përshtatëse në bujqësi është zbatimi i Bujqësisë Organike, praktikrat bujqësore të së cilës krijojnë mundësinë për reduktimin e lëshimeve të gazeve serrë, për sekuestrimin e karbonit në tokë dhe për një përshtatje më të mirë ndaj ndryshimeve klimatike nëpërmjet ruajtjes së tokës, fuqizimit të biodiversitetit dhe duke i bërë feramat organike me një shkallë të lartë elasticiteti dhe mundësi më të mëdha përshtatje.

Përfundime

Vendi ynë ka bërë progres në rritjen e sipërfaqes të bujqësisë organike dhe të prodhimeve organike krahasuar me vitin 2023. Zbatimi i skemës së mbështetjes të fermerëve ka kontribuar në zhvillimin e bujqësisë organike e cila ka ndikim në reduktimin e ndotjes në mjedis dhe sigurinë ushqimore. Emetimet e gazrave serë nga sektori i bujqësisë janë rritur me 4.7% midis viteve 2009 dhe 2019. Duhet zhvilluar praktika të reja bujqësore për reduktimin e gazeve serë dhe sekuestrimin e karbonit në tokë.

9.4 Mjedi dhe Transporti

Rrjetet tona të transportit na lidhin me aktivitete të tilla si punësim, rekreacion, shitje me pakicë dhe arsim. Sistemi i transporti të qëndrueshëm, të aksesueshëm dhe efikas është jo vetëm e rëndësishme për mirëqenien, por ka edhe një funksion kyç në tregti dhe ekonomi.

Sektori i transportit është një konsumator kryesor i energjisë dhe i burimeve materiale. Gjithashtu është dhe një burim i ndotjes mjedisore, veçanërisht nga gazet me efekt serë, ndotësve të tjerë të ajrit dhe zhurmës.

Transporti është një sektor kyç për zhvillimin ekonomik dhe lidhjen e qyteteve e rajoneve në Shqipëri. Megjithatë, rritja e vazhdueshme e numrit të automjeteve, zgjerimi i rrjeteve rrugore dhe ndërtimi i infrastrukturës së transportit kanë sjellë sfida të konsiderueshme për mjedisin.

Ndikimet më të rëndësishme të transportit në mjedis përfshijnë:

- Ndotjen e ajrit nga emetimet e automjeteve.
- Rritjen e emetimeve të gazeve serë dhe ndikimin në ndryshimet klimatike.
- Rritjen e nivelit të zhurmës në qytetet e mëdha.
- Dëmtimin e biodiversitetit për shkak të shtrirjes së infrastrukturës rrugore.

Një rrjet transporti i qëndrueshëm është një atribut jetik i çdo vendi dhe karakterizohet nga presione të ulëta mjedisore dhe nga rezultate të favorshme për shëndetin dhe mirëqenien e njeriut dhe për qytete më të pastra, më të qeta.

Përfitimet mjedisore nga lëvizshmëria e qëndrueshme janë:

- Redukton emetimet e gazeve serrë
- Përmirëson cilësinë e ajrit
- Redukton ndotjen e zhurmës

Taksat mjedisore luajnë një rol të rëndësishëm në rregullimin e ndikimeve negative të transportit në mjedis. Ato synojnë të kufizojnë përdorimin e karburanteve fosile dhe të inkurajojnë alternativa më të pastra.

Sipas INSTAT, në vitin 2022, të ardhurat nga taksat mjedisore ishin:

- 55.5 miliardë lekë, duke pësuar një rënie prej 4.53% krahasuar me vitin 2021.
- Pjesa më e madhe e këtyre taksave vjen nga produktet e energjisë dhe transporti.
- Taksat mbi regjistrimin e automjeteve dhe tarifat për ndotjen e ajrit janë ndër burimet kryesore të të ardhurave.

9.4.1 Ndikimi i transportit në mjedis

Ndikimi i transportit rrugor në cilësinë e ajrit dhe emetimet

Transporti rrugor është një nga burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Shqipëri. Emisionet nga automjetet kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e ndotësve si:

- Dioksidi i azotit (NO₂) dhe grimcat e pezulluara (PM10, PM2.5), të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në shëndetin e njerëzve.
- Dioksidi i karbonit (CO₂), që ndikon në efektin serë dhe ndryshimet klimatike.
- Gazrat e tjerë ndotës si monoksidi i karbonit (CO) dhe hidrokarburet (HC).
- Mosha mesatare e lartë e automjeteve, shumica e të cilave janë të vjetra dhe

joefikase.

- Trafiku i rënduar dhe mungesa e masave për të kufizuar qarkullimin në zonat urbane.
- Mungesa e një sistemi të fuqishëm të transportit publik që të ulë varësinë nga automjetet private.

Masat për Reduktimin e Ndikimit Mjedisor të Transportit

Për të minimizuar ndikimet negative të transportit në mjedis, janë ndërmarrë disa masa të rëndësishme:

- Zhvillimi i transportit publik të pastër: Investime në autobusë elektrikë dhe linja të reja urbane.
- Politikat për ndalimin e makinave të vjetra: Kufizimi i importeve të automjeteve të vjetra me ndotje të lartë.
- Incentiva për automjetet elektrike: Subvencione për blerjen e makinave elektrike dhe zhvillimi i rrjetit të karikimit.
- Kontrolli më i rreptë i emetimeve të automjeteve: Inspektime të rregullta dhe rritja e standardeve të ndotjes.

9.4.2 Sistemi për lëvizshmërinë

Shqipëria ka miratuar Strategjinë Sektoriale të Transportit dhe Planin e Veprimit 2016-2020. Nje nga prioritetet e strategjise eshte promovimi i krijimit të kooperativave dhe sindikatave të transportuesve rrugorë, dhe përveç kësaj, stimuj tatimorë për modernizimin e flotës së automjeteve të mallrave dhe pasagjerëve . Për sa i përket stimujve, ka një zhvillim për automjetet elektrike, për të cilat DPSHTR do të rimbursojë çdo tarifë regjistrimi për herë të parë për automjetet elektrike, pra tarifat do të zerohen. Kjo nismë bazohet në Planin Kombëtar të Menaxhimit të Cilësisë së Ajrit, i cili trajton cilësinë e ajrit si një nga çështjet më kritike mjedisore.

Traktati i Komunitetit të Transportit (TKT), nënshkruar në korrik 2017 midis BE-së dhe gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor (WB6), përfshin dhe Shqipërinë. Traktati mbështet thellimin e Integritimit Evropian të vendeve WB6 në fushën e transportit dhe përfshin angazhime të ndërsjella për veprime specifike që duhen ndërmarrë. Ky traktat përcakton që Shqipëria do të zhvillojë

sisteme efikase të menaxhimit të trafikut, përfshirë sistemet intermodale dhe sisteme inteligjente të transportit rrugor.

Shqipëria ne vitin 2020 ka hartuar strategjine per aplikimin e sistemeve te integjences se transportit rrugor (SIT) . Objektivat kryesorë që duhen arritur përmes SIT-it në Shqipëri, janë:

- a) përmirësimi i sigurisë në komunikacion dhe në zvogëlimin e gjasave për aksidente;
- b) përmirësimi i fluksit të trafikut dhe lëvizshmërinë dhe zvogëlimin e bllokimeve të trafikut
- c) përmirësimi i efikasitetit dhe i parashikueshmërisë së trafikut të mallrave, si brenda Shqipërisë, ashtu edhe ndërkombëtar;
- d) përmirësimi i ligjeve dhe i zbatimit të tyre dhe i rregulloreve ekzistuese, përfshirë zbatimin e përbashkët përtej kufijve;
- e) integrimi gradual i disa prej korridoreve të transportit shqiptar në rrjetin ndërevropian të transportit (TEN-T), përmes pajtueshmërisë me dispozitat e lidhura me SIT-in në direktivat evropiane dhe në Traktatin e Komunitetit të Transportit (TKT) të nënshkruar nga Shqipëria.

Në përputhje me politikat dhe përparësitë e përcaktuara në këtë Strategji të SIT-it, Shqipëria duhet të zbatojë SIT-in në mënyrën e përshkruar më poshtë.

Deri në vitin 2025 vendosja e SIT-it është parashikuar, në sektorin rrugor dhe sektorin e transportit detar/portet. Në periudhën pas vitit 2025, Shqipëria do të vazhdojë me vendosjen e SIT-it ne sektorin rrugor. Vendosja e SIT-it do të zgjerohet, si në fushën e veprimit, po ashtu edhe në shkallë:

Nje nga prioritetet në Shqipëri eshte vendosjs e SIT-it në ato seksione të rrugëve interurbane, të cilat kanë probleme të rënda që lidhen me sigurinë rrugore, bllokimet nga trafiku i rënduar dhe/ose shifra të larta të ndotjes së ajrit.

Që nga viti 2021 (1999 automjete) deri në vitin 2023 (6607 automjete), Shqipëria ka bërë përparim në lidhje me përdorimin e makinave elektrike dhe hibride, si dhe të autobusëve hibridë për transportin publik. Sa i përket efikasitetit të energjisë, në sektorin e transportit, janë marrë masa për rehabilitimin dhe rindërtimin e disa rrugëve që ndihmojnë në uljen e konsumit të karburantit nga automjetet. Rritja e përdorimit të biçikletave dhe transportit publik ka lehtësuar

uljen e përdorimit të automjeteve private. Është vendosur një taksë për të nxitur përdorimin e automjeteve të reja dhe me më pak konsum karburanti, të cilat shkarkojnë më pak emetime.

Tabela 92 - Automjete elektrike dhe hibride

	2021		2022		2023	
	Autoveturë	Autobus	Autoveturë	Autobus	Autoveturë	Autobus
Benzinë + Elektrik/Petrol +	901		1236		1736	
Elektrik	624		1245		2891	
*Të tjera hibride	452	22	993	31	1936	44

** Në kategorinë "Të tjera hibride" sipas lëndës djegëse përfshihen kategoritë "Naftë+Elektrike", "Benzinë+Gaz+Elektrik", "Naftë+Gaz", "Benzinë+Elektrik+Hybrid", "Naftë+Elektrik+Hybrid".*

Burimi: INSTAT

9.4.3 Përfundime

Të dhënat për periudhën 2022-2024 tregojnë se transporti vazhdon të jetë një nga faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në Shqipëri. Megjithatë, masat e marra për promovimin e mjeteve të pastra dhe transportit publik janë hapa pozitivë drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm.

Për të arritur rezultate të qëndrueshme, nevojitet:

- Zhvillimi i një infrastrukture moderne të transportit publik.
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ndikimin e transportit në mjedis.
- Politika më të forta për të reduktuar importin e makinave të vjetra dhe ndotëse.
- Investime në teknologjitë e gjelbra për sektorin e transportit.

9.5 Mjedisi dhe Energjia

Shëndeti, mjedisi dhe klima janë ndikohen në mënyrë të konsiderueshme nga mënyra se si ne e menaxhojmë dhe përdorim energjinë për të përmbushur kërkesat tona në rritje për ngrohje, lëvizshmëri dhe energji elektrike. Qasja në furnizime të besueshme energjetike dhe teknologjive që përdoren me energji elektrike ka përmirësuar cilësinë e jetës sonë dhe ka qenë një mundësi kyçe e zhvillimit ekonomik dhe social.

Tregu i energjisë elektrike në Shqipëri është në tranzicion nga një sistem i planifikuar drejt një sistemi me bazë tregu. Tregu i energjisë me shumicë dominohet nga kompania shtetërore e prodhimit KESH, e cila furnizon OSHEE-në me energjinë elektrike të nevojshme për konsumatorët finalë nën kushte të rregulluara të “furnizimit universal”.

9.5.1 Situata aktuale e energjisë

- *Konsumi i energjisë*

Konsumi final i energjisë sipas sektorëve 2023

Konsumi final i energjisë (Ktoe)	Qymyr	Gaz	Nënprodukte Naftë	Dru zjarri	Energji elektrike	Energji diellore (Uji i ngrohtë)
Industri	127.27	38.79	128.94	6.60	170.00	1.70
Transport	0.00	0.00	705.47	0.00	0.53	0.00
Popullata	0.00	0.00	97.65	111.20	282.45	8.30
Sherbimet	2.80	0.00	62.89	10.70	125.71	4.14
Bujqesia	0.00	0.00	82.27	10.70	10.19	0.00

Burimi: Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

- *Burimet e energjisë së ripërtëritshme*

Pjesa e burimeve të ripërtëritshme të energjisë kundrejt konsumit final 2023: 46.62%.

Burimet e Energjisë së Ripërtëritshme në vendin tonë përfshijnë Hidrocentralet, Parqet Eolike dhe Fotovoltaike.

2023	Hidro	PV	Eolike
Prodhimi Energjisë Elektrike (Gwh)	8708.56	297.46	0

Hidrocentrale në Punë (vetëm Hidrocentrale të reja)	Hidrocentrale në Ndërtim	Hidrocentrale në Proçedurë
266 (1134.20MW)	22 (108 MW)	93 (836 MW)
PV në Punë	PV në Ndërtim	PV në Proçedurë
34 (262 MW)	4 (140 MW)	36 (344.56 MW)
Eolike në Punë	Eolike në Ndërtim	Eolike në Proçedurë
0	0	5 (15 MW)

Burimi: Agjencia Kombetare e Burimeve Natyrore

Impiantet fotovoltaike të çertifikuara dhe në shfrytëzim

Qarku	Numri i impianteve fotovoltaike të çertifikuara dhe në shfrytëzim
Fier	17
Korçë	14
Elbasan	1
Durres	2
Total	34

9.5.2 Ndikimi në mjedis

Në sektorin e energjisë llogariten emetimet (CO2, NH4, N2O) që rezultojnë për shkak të veprimtarive të djegies së lëndëve djegëse, si dhe emetimet aksidentale që rezultojnë nga nxjerrja e lëndëve djegëse të ngurta dhe nga transmetimi dhe shpërndarja e lëndëve djegëse të lëngëta dhe të gazta. Gjatë periudhes 2009-2019

, emetimet janë rritur me 23,8%, nga 4339,02 kt CO₂ eq. në vitin 2009 deri në 5373,00 kt CO₂ eq. në vitin 2019.

9.5.3 Skemë mbështetëse për burimet e rinovueshme të energjisë

Ligji nr 24. date 23.3.2023 'Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burime te rinovueshme përcakton se skema e mbështetjes për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme mund të jetë në një nga format e mëposhtme:

a) marrëveshje për blerje të energjisë; është një lloj marrëveshje për mbështetje, ku një blerës i caktuar garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks.

b) kontratë për diferencën; është një kontratë për mbështetje e rregulluar financiarisht ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar

c) kontratë për prim; është një lloj kontrate për mbështetje ku paguhet një prim fiks (që mund të jetë pozitiv ose negativ në varësi të rezultatit të procesit konkurrues) ose një prim rrëshqitës (si diferencë midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës) nga Operatori i Energjisë së Rinovueshme për prodhuesit me përparësi mbi çmimin e tregut.

Qeveria ka përcaktuar tarifa nxitëse për energjinë diellore, të erës dhe të biomasës në mënyrë që të promovojë zonat më të mira dhe në të njëjtën kohë të ndihmojë në arritjen e objektivave përkatës për përdorimin e burimeve të rinovueshme;

Zhvillimi i një tregu rajonal mund të çojë në një ndryshim më të madh të çmimeve gjatë ditës, sezonit (dimër-verë) dhe duke optimizuar shfrytëzimin e HEC-eve me impiantet e vogla diellore fotovoltaike dhe të erës për të ndihmuar në diversifikimin e burimeve të rinovueshme të energjisë diellore dhe të erës, Shqipëria do të rrisë ndjeshëm përfitimet në nivel vendi.

9.5.4 Sfidat dhe Objektivat

Sfidat në sektorin e energjisë janë:

- Përmbushja e kërkesës për energji sipas zhvillimeve ekonomike në sektorë të ndryshëm dhe kërkesës në rritje të konsumit të energjisë për frymë;
- Përmirësimi i treguesit të intensitetit të energjisë;
- Rritja e sigurisë së furnizimit të energjisë duke përmirësuar eficiencën e energjisë, rritjen e kontributit të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe burimeve të tjera konvencionale të energjisë, si edhe rritjen e bashkëpunimit dhe integritit rajonal.

Strategjia kombëtare e Energjisë 2018-2030 synon që:

Shkalla e hapjes së tregut të energjisë elektrike të arrijë 100% në vitin 2025 duke ndërtuar njëkohësisht një skemë të thjeshtë dhe të zbatueshme në drejtim të mbrojtjes së konsumatorëve familjarë me të ardhura të ulëta.

- Ekonomia dhe shoqëria shqiptare të arrijë një nivel kursimi të energjisë kundrejt konsumit total
- me 15% në vitin 2030;
- Targeti i energjive të rinovueshme kundrejt konsumit total të arrijë në nivelin 42% në vitin 2030;
- Reduktim i emetimeve GHG kundrejt totalit të arrijë 11.5% në vitin 2030;
- Penetrimi i gazit natyror kundrejt furnizimit total me burime primare të energjisë të arrijë në nivelin
- 20% në vitin 2030. Sigurisht që kjo të bëhet e mundur do të duhet të shoqërohet me investime të rëndësishme në ndërtimin dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së gazit në vend.

9.5.5 Përfundime

Vendi ynë ka bërë progres në diversifikimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme duke përdorur jo vetëm hidrocentralet por edhe parqe fotovoltaike dhe eolike. Pjesa e burimeve të ripërtëritshme të energjisë kundrejt konsumit final 2023 është 46.62% duke arritur tashme objektivin prej 42% në vitin 2030.

Qeveria ka zbatuar skeme mbeshetese per nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme te energjisë.

9.6 Mjedi dhe Inovacioni

Zhvillimi i aktiviteteve të inovacionit në ndërmarrje ka ndikim pozitiv në parandalimin dhe reduktimin e ndotësve në mjedis .

INSTAT ka kryer për periudhën referuese 2020-2022 vërtetimin mbi aktivitetet e Inovacionit pranë ndërmarrjeve me 10 ose më shumë të punësuar. Ndërmarrje inovative quhet ajo ndërmarrje që gjatë periudhës referuese prezantoi një inovacion produkti/procesi biznesi, ose kishte aktivitete të braktitura apo të papërfunduara inovacioni gjatë viteve paraardhëse.

Gjatë periudhës 2020-2022, 42,9 % e ndërmarrjeve të vërtetuara kryen një aktivitet Inovacioni. Krahasuar me të dhënat e vërtetimit të mëparshëm të inovacionit me periudhë referuese 2018-2020, aktiviteti i inovacionit u rrit me 6,3 % (nga 36,6 % në 42,9 %).




Figura 204 - Përqindja e ndërmarrjeve aktive në Inovacion sipas aktivitetit ekonomik, 2020-2022 (%)

Aktiviteti i Inovacionit rezulton më i lartë në ndërmarrjet që operojnë në

sektorin e shërbimeve me 46,0 %, ku ndërmarrjet në aktivitetin e Informacionit dhe Komunikacionit kanë rezultuar aktive në Inovacion me 67,3 %, ndërmarrjet në aktivitetet Financiare dhe të Sigurimit me 52,7 %, etj.

Në sektorin e Industrisë aktiviteti i Inovacionit rezultoi me 39,3 % ku ndërmarrjet në aktivitetin e Energjisë elektrike, furnizimi me gaz, avull dhe ajër të kondicionuar kanë rezultuar aktive në Inovacion me 44,4 %, në Industrinë Përpunuese me 42,0 %, etj.

Ndërmarrjet në sektorin e industrisë shënojnë një rritje më të lartë në aktivitetin e inovacionit me 7,2 pikë përqindje ndërsa ndërmarrjet në sektorin e shërbimeve shënojnë një rritje me 5,0 pikë përqindje krahasuar me të dhënat e periudhës së mëparshme.

Aktiviteti i inovacionit rezultoi më i pranishëm në grupin e ndërmarrjeve të mëdha, me mbi 250 të punësuar me 66,5 %. (Tab.1)

Gjithashtu sipas madhësisë së ndërmarrjeve, vihet re se ndërmarrjet e vogla (10-49 të punësuar) kanë pësuar rritje të ndjeshme në aktivitetin e inovacionit me 7,4 pikë përqindje rritje. Gjatë kësaj periudhe bizneset e vogla kanë zhvilluar produkte inovative më shpejt se ndërmarrjet e mesme dhe të mëdha.

Tabela 93 - Ndërmarrjet aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomikë dhemadhe të madhësisë së ndërmarrjes(%)

	Ndërmarrje aktive në Inovacion 2018-2022	Ndërmarrje aktive në Inovacion 2020-2022
Gjithsej	36,6	42,9
Aktiviteti ekonomik		
Industri	32,1	39,3
Shërbime	41,0	46,0
Madhësia e ndërmarrjes		
10-49 të punësuar	32,1	39,5
50-249 të punësuar	49,0	51,4
250+ të punësuar	68,2	66,5

Përqindja më e lartë e ndërmarrjeve që zhvilluan inovacione produktesh, inovacione procesesh dhe inovacione produktesh dhe procesesh së bashku rezultuan në sektorin e Shërbimeve.




Figura 205 - % e ndrmarrjeve që zhvillojnë produkte inovacioni

Gjatë periudhës 2020-2022, 25,6 % e të gjitha ndërmarrjeve zhvilluan inovacione të produkteve (mallra ose shërbime të reja ose të përmirësuara), ndërsa 36,3 % zhvilluan procese biznesi të reja ose të përmirësuara. Ndërmarrjet që zhvilluan së bashku, mallra dhe shërbime të reja ose të përmirësuara rezultuan 42,7 % të ndërmarrjeve që zhvilluan inovacion produkti.

Gjatë kësaj periudhe 44,0 % e ndërmarrjeve me Inovacione produktesh prezantuan mallra ose shërbime që ishin të reja jo vetëm për ndërmarrjen, por edhe për tregun (jo të ofruara më parë nga konkurrentët e tyre) nga 42,0 % që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm. Gjatë periudhës 2020-2022, 13,2 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion zhvilluan aktivitete të kërkim zhvillimit.

Figura 206 - Ndërmarrje aktive në Inovacion sipas sektorëve ekonomikë dhe llojit të Inovacionit, 2020-2022(%)

Për të kryer aktivitetin e tyre të inovacionit, 30,0 % e ndërmarrjeve aktive në Inovacion ishin të përfshirë në bashkëpunim me ndërmarrje të tjera, organizata

shkencore dhe partnerë të tjerë, nga 25,9 % që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm. Për ndërmarrjet me aktivitet ekonomik “Aktivitete profesionale, shkencore teknike” kjo përqindje rezultoi 57,7 %.

Gjatë periudhës 2020-2022, 27,9 % e ndërmarrjeve të vrojtura kanë blerë makineri, pajisje ose mjete programuese të bazuar në teknologji të re që nuk ishte përdorur më parë nga këto ndërmarrje dhe 4,3 % e ndërmarrjeve aktive në inovacion morën mbështetje financiare nga autoritetet publike nga 3,6 %, që rezultoi në vrojtimin e mëparshëm.

9.7 Rekomandime

Mjedisi dhe Industria

- Për kompani të mëdha ose të pajisura me Leje Mjedisore të Tipit A, të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i parametrave të ajrit.
- Të gjithë operatorët që bëjnë trajtimin e peshkut si dhe të prodhimet të pijeve alkoolike apo produkteve ushqimore të instalojnë impiante të trajtimit të ujërave teknologjike.
- Të merren masa për shkarkimet nga mjetet motorike.

Mjedisi dhe Bujqësia

- Duhet zhvilluar praktika të reja bujqësore për reduktimin e gazeve serë dhe sekuestrimin e karbonit në tokë.

Mjedisi dhe Transporti

- Zhvillimi i një infrastrukture moderne të transportit publik.
- Rritja e ndërgjegjësimit të qytetarëve për ndikimin e transportit në mjedis.
- Politika më të forta për të reduktuar importin e makinave të vjetra dhe ndotëse.
- Investime në teknologjitë e gjelbra për sektorin e transportit.

PËRMBLEDHJE

Cilësia e ujërave

Statusi kimik i lumenjve dhe liqeneve

Ujërat e Basenit të Shkumbinit, Vjosës, Matit klasifikohen me gjendje të mirë . Ujërat e Basenit të Drinit klasifikohen në gjendje e moderuar. Ujërat e Basenit të Semanit janë të cilësisë që i përket statusit gjendje e varfër ndërsa të Basenit Ishëm – Erzen klasifikohen në gjendje e keqe.

Lumenjtë më të ndotur në Shqipëri janë Lumi i Tiranës me stacionet e monitorimit më të ndotura Ura – Kthesa e Kamzës, Lanabregas dhe Yrshek – Ish Dogana, Lumi Ishëm me të tre stacionet e monitorimit Ura Rinas, Ura e Gjolës dhe Ura Salmer. Ndërsa në Basenin e Semanit Lumi Gjanica i klasifikuar në Klasën IV – Gjendje e varfër.

Ujërat e liqenit të Shkodrës janë të cilësisë mezotrofike ujërat e Liqenit të Prespës së Madhe janë të cilësisë mezotrofike me tendence eutrofike, ndërsa ujërat e Prespës së Vogël të cilësisë eutrofike. Ujërat e Liqenit të Ohrit janë me cilësi oligotrofike. Vërehet përmirësim i cilësisë të ujërave të liqenit të Ohrit duke kaluar nga status mezotrofik në oligotrofik. Përsa i përket tributarëve te liqenit te Ohrit vlerësohet se Lumi i Pogradecit dhe i Tushemishtit klasifikohen me cilësi të mire ndërsa Lumi i Vërdovës klasifikohet me cilësi të moderuar

Aktiviteti radioaktiv alfa-beta total

Gjatë këtij viti shihet se vlerat e radioktivitetit alfa dhe beta total janë nën vlerat e përcaktuara në standartet kombëtare, në disa raste pranë vlerës kufi. Duke patur parasysh që disa nga burimet e ujit që përdoren për konsum të popullatës dhe sidomos për nevoja të përdorimit të gjerë në bujqësi furnizohen nga lumenjtë është shumë e rëndësishme që treguesit e radioaktivitetit të jenë në monitorim të vazhdueshëm periodik.

Prurjet në lumenj

Lumenjtë e Shqipërisë paraqesin një potencial ujqor të larmishëm i cili mund të kontrollohet, disiplinohet dhe menaxhohet duke u vënë në dispozicion të bujqësisë, industrisë dhe drejtimeve të tjera të ekonomisë në dobi të komunitetit. Rreziku i përmbajtjeve mbetet gjithmonë evident në rrjedhjet e poshtme të lumenjve, por edhe në sektorë të tjerë të cilët kanë filluar të evidentohen në vitet e fundit. Kjo tregon shtrirjen në rritje të këtij fenomeni drejt pjesëve më të sipërme të pellgut. Nga shkaqet kryesore të këtij fenomeni janë ulja e pjerrësisë së shtratit në rrjedhën e poshtme, mbushja e tabanit të kanalit të rrjedhës dhe prurjet e shpejta me intensitet të lartë.

Ujërat nëntokësore

Gjatë viteve 2020-2024, nga monitorimi hidrokimik i ujerave nëntokësore në akuiferet e baseneve Drini, Mat, Erzen-Ishëm, Shkumbin, Seman, Vjosë dhe Zona rezultojnë se ujërat nëntokësorë të këtyre baseneve në përgjithësi kanë veti fiziko - kimike të mira. Vihet re përmbajtje e lartë e fortësisë të përgjithshme si dhe prania e NO_2 dhe e NH_4 në disa shpime monitorimi të baseneve. Ka shfrytëzim të zhavorreve në shtratin e lumit Drin, Mat.

Probleme shqetësuese në shumë basene janë shkaktuar nga hedhja e mbeturinave në shtretërit e lumenjve dhe në terracat aluviale të tyre duke shkaktuar ndotje të ujerave sipërfaqësore dhe atyre nëntokësore.

Ajri urban

Bazuar në të dhënat e monitoruara të cilësisë së ajrit urban, për vitin 2024, vlerësohet se cilësia e ajrit në qytetet e monitoruara nuk është e një niveli shumë të mirë. Ndotësit kryesorë të cilësisë së ajrit urban janë grimcat e pluhurit me diametër 10 mikron (PM_{10}) dhe 2.5 mikron ($\text{PM}_{2.5}$), specifikisht në stacionin Grimm AKM (Tiranë), Korçë dhe Elbasan. Vlerat më të larta të ozonit (O_3) janë monitoruar në qytetin e Korçës.

Ndryshimet klimatike

Tendencat e projektuara tregojnë se temperatura mesatare vjetore në Shqipëri do të rritet me 1,3°C deri në 2,2°C brenda vitit 2050. Emetimet e gazeve me efekt serë janë kontribuesi kryesor që ndikojnë në ndryshimet klimatike. Dokumenti Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar parashikon skenare dhe objektiva për vitin 2030 si dhe masa zbutese sipas sektorëve që ndikojnë në ndryshimet klimatike. Për gazet me efekt serë parashikohet 11 978 kt CO₂e , një rritje prej +18.1% derin në 2030. Diferenca me skenarin BaU në vitin 2030 është -3170 kt CO₂e, çka përbën një zbutje prej -20,9%.

Zhurmat

Kemi tejkalim të normës ditën (që është 55 dB) në të gjitha qytetet, duke përfshirë qytetin e Lushnjes. Niveli më i lartë i zhurmave është vlerësuar në qytetin Tiranë ku kemi tejkalim të normës në masën 15.1 %, Vlorës 14.7%, Sarandës 13.6%, Gjirokastrës 11.1%. Nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit, Permetit dhe Lushnjes.

Për periudhën e natës, niveli më i lartë është monitoruar në qytetin e Vlorës ku kemi tejkalim të normës me 18.75 %, Tiranës me 16.51% dhe Sarandës me 14.6% dhe nivelet më të ulëta janë monitoruar në qytetet e Kukësit, Pogradecit, Permetit dhe Lushnjes.

Mjedisi bregdetar

Referuar rezultateve bakterologjike për vitin 2024, plazhet kategorizohen A (Cilësi e shkëlqyer) 18 pika monitorimi 14.64% e tyre, B (Cilësi e mirë) 57 pika monitorimi 46.35% e tyre, C (Cilësi e mjaftueshme) 15 pika monitorimi 12.19% e tyre dhe D (Cilësi e keqe) 33 pika monitorimi 26.82% e tyre. Përgjatë bregdetit u konstatuan derdhje ujërash sipërfaqësore në det.

Plazhet me cilësi më të mirë janë; Lukova, Palasë, Drimadhe, Dhërmi, Jalë, Livadh dhe Borsh.

Në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 kemi tendencë në rritje të cilësisë së ujrave të kategorisë A-cilësi e shkëlqyer dhe tendencë në ulje të cilësisë së ujrave të kategorisë D-cilësi e keqe.

Nga monitorimi i parametrave fiziko – kimik në zonat bregdetare në Dhërmi, Borsh, Lukovë, Zvernec dhe Ksamil vlerësojmë një cilësi të mirë të ujrave bregdetare . Stacionet e pompimit që kanë më shumë ndikim në cilësinë e ujrave bregdetare janë në Durrës- Porto Romano (Hidrovorit), Kanali i ujrave rurale (Plepa) dhe Vlorë - Në det pas hidrovorit tek Pylli i Sodës.

Ujërat e Lagunave të Karavastasë dhe Nartës vlerësohen me cilësi eutrofike. ndërsa të lagunës së Butrintit vlerësohen me cilësi mezotrofike. Sipërfaqja totale e hapësirave publike është 1 697 131m² ndërsa sipërfaqe totale e hapësirave të menaxhuara është 5,005,689 m2. Bashkia Durrës ka sipërfaqen më të madhe totale me 1,162,404 m2 duke vijuar me Vlorën 716,673m2.

Rajoni i Gjirit të Drinit vijon të jetë rajon problematik me bilanc negativ. Këtu ka segmente ku mbizotërimi i erozionit ndaj akumulimit është i dukshëm. Këto segmente përfshihen në atë pjesë të vijës bregore e cila shtrihet nga gryka e Vilunit deri në grykëderdhjen e Matit.

Tokat

Në të gjitha mostrat e analizuara në stacionet përkatëse (Topojan, Karavasta, Ligenas, Theth, Butrint, Sirian, Karaburun, Kutë, Miras, Dritaj, Klos, Koplik, Ishull Lezhe, Himarë, Lapani, Goricë, Dajti, Rrotull, Gjegjan, Tepelene, Vodicë, Dumre, Lin, Qarisht, Zogaj), treguesit e metaleve të rënda janë nën vlerat limite, gjë që tregon që nuk kemi ndotje, dhe nuk kemi rrezik as për ambientin dhe as për popullatën.

Mbetjet dhe ekonomia qarkulluese

Tirana është bashkia me gjenerimin më të lartë të mbetjeve, duke arritur 257,829 ton . Po ashtu bashkia e Tiranës rezulton me gjenerimin më të lartë për frymë, me 14.52 kg/person/ditë, ndjekur nga Durresi me 5.02 kg/person/ditë

Vërehet tendencë e uljes së sasisë së mbetjeve urbane të menaxhuara nga viti 2020 deri në vitin 2022, me një rritje të lehtë në vitin 2023 që ka vazhduar edhe gjatë vitit 2024.

Përgjatë këtij viti janë krijuar dhe transferuar rreth 6,271,508 ton mbetje në total. Nga keto janë 5,215,491 ton mbetje të rrezikshme dhe 1,056,017 ton mbetje të parrezikshme. Gjatë vitit 2024 nga aktivitetet bujqësore janë gjeneruar rreth 1,993 ton mbetje dhe 635,221 litra mbetje. Nga kjo sasi 15.2 % janë depozituar në landfill. Në vitin 2024, sasia e mbetjeve nga indet e kafshëve është rreth 2,850,359.7 kg/vit. Sasia më e madhe e gjenerimit të mbetjeve nga indet e kafshëve rezulton në qarkun Tiranë me 1,210,904 kg/vit. Në total, 934.765,47 kg mbetje spitalore, të gjeneruara nga spitalet publike dhe private së bashku, janë prodhuar në vitin 2024. Kompanitë private raportuan se nga 79.486,84 kg mbetje spitalore, vetëm 0,9%, e barabartë me 751,1 kg, janë trajtuar sipas standardeve ndërkombëtare

Bazuar në një studim të monitorimit të rrjedhjeve të plastikës në Shqipëri rezulton se për vitin 2011, modeli i ndikimit vlerëson se 24,000 ton plastikë kanë rrjedhur në sistemet e ujit nga Shqipëria. Për vitin 2021, vlerësimi bazë tregon një ulje të konsiderueshme prej 81% krahasuar me vitin 2011, pasi 4,569 ton ose 1.7 kg/banor/vit plastikë kanë arritur në sistemet e ujit. Megjithatë, nevojitet përmirësim i mëtejshëm për t'iu afruar një niveli të dëshiruar nën 0.57 kg/banor/vit, i cili do të ishte i krahasueshëm me nivelet në BE.

AKSHI ka kontraktuar një kompani që po zhvillon Sistemin e Integruar të Informacionit Mjedisor (SIMM), i cili do të jetë funksional në vitin 2025. AKSHI, në bashkëpunim me sektorët përkatës në AKM, ka strukturuar dhe integruar në SIM të gjitha detyrimet ligjore që lidhen me mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave mbi menaxhimin e mbetjeve.

MTM, në bashkëpunim me partnerët e huaj, është në proces hartimi të Ligjit të ri për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve. MTM, në bashkëpunim me partnerët e huaj (OECD), ka prezantuar Udhërrefyesin për Ekonominë Qarkulluese. Ligji për PZP-ne është konsultuar me palët e interesuara dhe është dërguar nga qeveria për miratim në Kuvend.

AKEM, ka krijuar lidhje me bashkitë dhe ka mbledhur të dhëna mbi sasinë e mbetjeve urbane nga të gjitha 61 njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2024, bashkitë raportuan se kanë në funksion qendra kompostimi për mbetjet organike, si në Cërrik, Belsh dhe Roskovec.

Pyjet

Pyjet në Shqipëri shtrihen në një sipërfaqe 1.146.725 ha që përfaqëson 67 % të fondit pyjor dhe kullësor. Kullotat dhe livadhet zenë një sipërfaqe 449.175 ha ose 26 % të fondit pyjor dhe kullësor. Sipërfaqet më bimësi pyjore dhe inproduktive që janë pjesë e fondit pyjor zenë një sipërfaqe 121.351 ha ose 7,0 % të këtij fondi. Sasia e karbonit (C) e stokuar në pyjet në Shqipëri është 100.9 milion ton C dhe 80% e kësaj sasie ekuivalente me 81 milion ton C stokohet në tokat pyjore dhe 20% (19.9 milion ton C) stokohet në biomasën pyjore.

Viti 2024 është karakterizuar nga një situatë me raste të shumta dhe sipërfaqe të konsiderueshme të zjarreve kryesisht gjatë muajve gusht, korrik dhe shtator. Si pasojë e zjarreve në pyje dhe kullota rezulton se; Sipërfaqja totale e përshkruar është 12435 ha; Sipërfaqja totale e djegur është 6127 ha dhe sipërfaqja totale e prekur është 18562 ha. Gjatë 2024, kemi rritje të numrit të zjarreve dhe sipërfaqes të përshkruar dhe të djegur në pyje dhe kullota.

Vëzhgimet e kryera ndaj **fenomenit të rënies së halave për llojet e halorve dhe rënia e gjetheve** për llojet fletorë për klasën e tretë (61-100%) tregojnë se ka rritje gjatë këtij viti krahasuar me 2023. Për llojin pishë e zezë, kemi një rritje të rënies së halave në klasën e tretë me 0.89%. Për llojin e pishave mesdhetare, kemi një rritje 0.10%. Për llojin bredh kemi një rritje 0.65% të rënies së halave. Për llojet halorë e tjerë kemi një rritje 0.40% Për llojin ah dhe mështeknë, kemi një rritje 0.30% .Për llojet e dushqeve dhe gështenjë kemi një rritje 0.45%. Për fletorët e tjerë, kemi një rritje 0.87%,

Për fenomenin e çngjyrosjes së halorëve dhe fletorëve rezulton se kemi rritje në përqindje në klasën e tretë (61-100%) krahasuar me 2023. Për llojin pishë e zezë kemi një rritje 1.80%. Për llojin e pishave mesdhetare kemi një rritje 0.80%. Për llojin bredh kemi një rritje 1.35%. Për llojet halorë e tjerë kemi një rritje 0.89%. Për llojin ah, mështeknë kemi një rritje 0.80%. Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë kemi një rritje 1.00%. Për fletorët e tjerë kemi një rritje 0.80%,

Rezultoni një rritje e shkallës së prekjës nga dëmtuesit dhe sëmundjet në llojet halorë dhe fletorë për klasën e tretë (61-100%) krahasuar me vitin 2023. Për llojin pishë e zezë, kemi një rritje 1.01% të prekjës nga dëmtuesit. Për llojin e pishave mesdhetare kemi një rritje 0.55%. Për llojin bredh kemi një rritje 0.45%.- Për llojet halorë e tjerë kemi një rritje 0.29% . Për llojin ah, mështëknë kemi një rritje me 0.13%. - Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë kemi një rritje 0.18%. Për fletorët e tjerë kemi një rritje 0.74%. Përsa i përket sëmundjeve, për llojin pishë e zezë kemi një rritje 0,69%. Për llojin e pishave mesdhetare kemi një rritje 0.23%. Për llojin bredh kemi një rritje 0.50%. Për llojet halorë e tjerë kemi një rritje 0.25%. Për llojin ah, mështëknë kemi një rritje me 0.68%. Për llojet e dushqeve dhe llojit gështenjë kemi një rritje 0.28%. Për fletorët e tjerë kemi një rritje 1.08%.

Kemi një përkeqësim në llojin bush si pasojë e shkallës së lartë të prekjës nga dëmtuesit dhe sëmundjet duke çuar në tharje masive si lloj në të gjithë arealin e përhapjes së tij. Një fenomen i veçantë këtë vit ishte edhe prekja e llojit gështenjë nga dëmtuesi i grerëzës Aziatike

Llojet drunore më të rrezikuara janë Caraca e Kaukazit, Rrenja Gështenja e kalit, Lajthia e egër. Gjendja vegjetative dhe fitosanitare e bimëve aromatike mjekësore si Çaj mali, Sherebelë, Xhirokull, Boronicë dhe Salep paraqitet e mirë. Problematikë mbetet grumbullimi masiv i këtyre kulturave.

Biodiversiteti

Shqipëria është e njohur për shumëllojshmërinë e saj të lartë të ekosistemeve dhe habitateve.

Në vendin tonë rriten rreth 400 lloje bimore të cilat janë Ballkanike.. Përafërsisht 32 % e florës europiane ndodhet në Shqipëri, kurse pyjet e larta të Shqipërisë janë habitate të rëndësishme për gjitarët si: ariu i murrmë, derri i egër, dhia e egër, etj., si dhe shumë lloje të shpendëve. Flora e pasur detare dhe komunitetet e faunës janë një tregues i nivelit të lartë të ruajtjes dhe cilësisë së këtyre komuniteteve në Shqipëri.

Ekosistemet detare dhe bregdetare të Shqipërisë janë të pasura me tipologjitë e habitateve, komuniteteve bimore dhe llojeve shtazore. Bimësia bregdetare është e përfaqësuar kryesisht nga shkurre me gjelbërim të përhershëm dhe pjesërisht

nga shkurre gjetherënëse. Relievi i Shqipërisë ka krijuar kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të llojeve endemike dhe subendemike. Në Shqipëri rriten rreth 32 lloje bimësh endemike dhe rreth 110 bimë të tjera subendemike.

Vendi ynë ka bërë përparim të rëndësishëm në përafrimin e politikave të saj kombëtare për biodiversitetin me direktivat e Bashkimit Evropian, duke krijuar një themel të fortë për arritjen e objektivave të Kornizës Globale për Biodiversitetin. Duke miratuar Strategjinë dhe Planin e Veprimit për Biodiversitetin dhe duke zbatuar ligje të rëndësishme, Shqipëria ka treguar përkushtimin e saj për mbrojtjen e biodiversitetit. Megjithatë, ende ekzistojnë probleme me zbatimin e plotë të këtyre ligjeve, ndërtimin e kapaciteteve institucionale, menaxhimin e të dhënave dhe përfshirjen e publikut, të cilat duhet të adresohen.

Zonat e mbrojtura

Rrjeti Kombëtar i Zonave të Mbrojtura rezulton me sipërfaqe gjithsej prej **624610 ha** ku;

Park Kombëtar janë gjithsej 12 me sipërfaqe prej 313923,77 ha; Zonë e Mbrojtur të Monumenteve Natyror, gjithsej 2 (dy) me sipërfaqe prej 85.5 ha; Rezervat Natyror Menaxhuar/Park Natyror), janë gjithsej 27 me sipërfaqe prej 217384.68 ha; Peizazh i Mbrojtur gjithsej 10 me sipërfaqe prej 81916,68 ha; Zonë e Mbrojtur të Burimeve të Menaxhuara gjithsej 2 (dy) me sipërfaqe prej 11300.0 ha. Kemi rritje të numrit të kategorive të zonave të mbrojtura nga 767 në vitin 2023 në 775 në vitin 2024 si dhe rritje të sipërfaqes së zonave të mbrojtura nga 613456 ha (2023) në 624610 ha.

Në numërimin e shpendëve dimërues për vitin 2024 në total u regjistruan 60 lloje (specie) shpendësh, me një numër total individësh prej 99527. Lloji me numër më të madh të individëve, është bajza (*Fulica atra*). Vëzhgim-Monitorimi i Faunës së Egër, në territoret e sistemit të Zonave të Mbrojtura Mjedisore, pëfshin gjithsej 40 specie. Nga këto specie, 13 janë gjitarë dhe 27 prej tyre janë shpendë.

• Mjedisi dhe sektorët ekonomik

Mjedisi dhe Industria

Kemi tendencë në rritje të subjekteve që kanë realizuar raportet e vetmonitorimit krahasuar me vitin 2023 ku ishin 2333 subjekte, ndërsa në 2024 janë 2762 subjekte. Në vitin 2024 kemi rritje të numrit të inspektimeve në fushën e mjedisit dhe të ujërave krahasuar me vitin 2023.

Gjate vitit 2024 janë shqyrtuar në total 729 aplikime nga të cilat janë miratuar; 11 leje mjedisi tipi A, 211 leje mjedisi tipi B si dhe 60 aplikime për liçencë të nënkategorisë III.2.B. Janë refuzuar në total 447 aplikime. Janë kryer 361 inspektime në fushën e ujërave dhe 1269 inspektime në fushën e mjedisit. Gjate 2024 janë miratuar 530 leje aktive të shfrytëzimit minerar si dhe operojnë 9 subjekte për shfrytëzim hidrokarbure që kane nenshkruar Marreveshje Hidrokarbure me Shtetin Shqiptar. Janë rreth 205 hidrocentrale në prodhim që shfrytëzojnë vendburime ujore për prodhimin e energjisë elektrike si dhe 34 impiante fotovoltaike të çertifikuara dhe në shfrytëzim. Gjate vitit 2024 kanë ushtruar veprimtari rafineritë e përpunimit të naftës bruto “Al Global Oil” sh.a UPN, Fier dhe “RBH Beline” sh.a në Elbasan, ndërsa rafineria e Përpunimit të naftës Ballsh dhe rafineria e naftës “AM-OIL” sh.a me adresë ish-Uzina e Plasmasit, Lushnjë nuk kanë ushtruar aktivitet të përpunimit të naftës bruto. Gjate këtij viti janë mostruar për kontroll cilësor parazhdoganimi për sasinë totale 2,347,585 ton naftë bruto dhe nënprodukte naftë. Janë inspektuar subjektet e tregtimit me shumicë dhe pakicë për kontroll cilësor si dhe subjektet Konsumatorë të Medhenj.

Janë importuar 9663 ton lëndë djegëse mazut (për përdorimi, termik, civil dhe industrial) dhe janë marrë gjithsej 27 mostra lëndë djegëse për kontroll cilësor.

Mjedisi dhe Turizmi

Gjate vitit 2024 kanë hyrë 11.292,735 turistë në vendin tonë. Udhëtimi me rrugë ajrore ka një rritje prej 65.4% më shumë, krahasuar me vitin 2023. Numri i vizitueshmërisë në institucionet e kulturës gjatë 2024 u rrit 31% krahasuar me vitin parardhës. Kanë vizituar zonat tona të mbrojtura 5,565,730 vizitorë të huaj dhe vendas, që rezulton me një rritje prej 22% krahasuar me vitin 2023.

Mjedisi dhe Bujqësia

Vendi ynë ka bërë progres në rritjen e sipërfaqes të bujqësisë dhe të prodhimeve organike krahasuar me vitin 2023. Zbatimi i skemës së mbështetjes të fermerëve ka kontribuar në zhvillimin e bujqësisë organike e cila ka ndikim në reduktimin e ndotjes në mjedis dhe sigurinë ushqimore. Emetimet e gazrave serë nga sektori i bujqësisë janë rritur me 4.7% midis viteve 2009 dhe 2019. Duhet zhvilluar praktika të reja bujqësore për reduktimin e gazeve serë dhe sekuestrimin e karbonit në tokë.

Mjedisi dhe Transporti

Transporti vazhdon të jetë një nga faktorët kryesorë të ndotjes së ajrit në Shqipëri. Megjithatë, masat e marra për promovimin e mjeteve të pastra dhe transportit publik janë hapa pozitivë drejt një zhvillimi më të qëndrueshëm. Shqipëria ka bërë përpunim në lidhje me përdorimin e makinave elektrike dhe hibride, si dhe të autobusëve hibridë për transportin publik duke rritur numrin nga 1999 automjete përgjatë vitit 2021 në 6607 automjete në vitin 2023.

Mjedisi dhe Energjia

Vendi ynë ka bërë progres në diversifikimin e burimeve të energjisë së ripërtëritshme duke përdorur jo vetëm hidrocentralet por edhe parqe fotovoltaike dhe eolike. Pjesa e burimeve të ripërtëritshme të energjisë kundrejt konsumit final 2023 është 46.62% duke arritur tashmë objektivin prej 42% në vitin 2030. Qeveria ka zbatuar skeme mbështetëse për nxitjen e përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë.

Mjedisi dhe Inovacioni

Aktiviteti i inovacionit u rrit me 6,3 % nga 36,6 % në periudhën 2018-2020 në 42,9 % në periudhën 2020-2022. Ndërmarrjet në sektorin e industrisë shënojnë një rritje më të lartë në aktivitetin e inovacionit me 7,2 pikë përqindje ndërsa ndërmarrjet në sektorin e shërbimeve shënojnë një rritje me 5,0 pikë përqindje krahasuar me të dhënat e periudhës së mëparshme.

ANEKS 1
RRJETI I MONITORIMIT TË PYJEVE
Rrjeti i monitorimit për llojet e dushqeve dhe gështenjës

N r	Bashkia	Lloji drunor	Nr. dru. s.p	Mosh a (vjet)	Sip. (m2)	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Pustec	Bunge	51	mbi 60	400	540642.2	4540655
2	Kolonje	Bun.Shpar	11	mbi 60	400	580387.8	4496494
3	Korçë	Qarr	33	mbi 60	400	502365.7	4539031
4	Tiran	Bun.Shpar	14	mbi 60	400	500046.5	4576451
5	Kukes	Bun.Shpar	35	mbi 60	400	533693.7	4656345
6	Tirane	Geshtenje	10	mbi 60	400	496689.5	4707670
7	Delvine	Geshtenje	15	mbi 60	400	538311.2	4707775
8	Tropoje	Bun.Shpar	16	mbi 60	200	504732.7	4680048
9	Fushë Arrez	Bunge	16	mbi 60	200	505071.8	4677043
10	Puke	Qarr	10	mbi 60	200	487149.7	4661840
11	Mirdite	Bunge	15	mbi 60	200	499494.8	4632488
12	Lezhe	Bunge	11	mbi 60	200	477414	4622229
13	Diber	Qarr	23	mbi 60	200	517553.8	4610490
14	Mat	Bunge	16	mbi 60	200	490774.8	4607871

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

15	Kurbin	Bunge	8	mbi 60	200	481857.7	4609788
16	Mat	Qarr, Shparth	22	mbi 60	200	500148.3	4602684
17	Tirane	Qarr,Bung	14	mbi 60	200	496751.1	4592649
18	Tirane	Qarr	21	mbi 60	200	499507.9	4570685
19	Skrapar	Bulger	19	mbi 60	200	527107.7	4473988
20	Kolonje	Bunge	12	mbi 60	200	543816.3	4456480
21	Vlore	Bung,Bullg r	19	mbi 60	200	462364	4451764
22	Gjiroka ster	Bullgr.Bun g	12	mbi 60	200	500239.8	4445514
23	Dropull	Bulger	14	mbi 60	200	529254.4	4442826
Totali			417		6000		

Rrjeti i monitorimit për gjendjen shëndetësore

Sipërfaqet provë per llojin Pishë Mesdhetare

Për llojet e dushqeve dhe gështenjës

Nr.	Bashkia	Lloji drunor	Nr. dru. s.pr	Mosha (vjet)	Sip. (m2)	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Pustec	Bunge	51	mbi 60	400	540642.2	4540655
2	Kolonje	Bun.Shpar	11	mbi 60	400	580387.8	4496494
3	Korçë	Qarr	33	mbi 60	400	502365.7	4539031
4	Tiranë	Bun.Shpar	14	mbi 60	400	500046.5	4576451
5	Kukës	Bun.Shpar	35	mbi 60	400	533693.7	4656345
6	Tiranë	Geshtenje	10	mbi 60	400	496689.5	4707670
7	Delvinë	Geshtenje	15	mbi 60	400	538311.2	4707775
8	Tropojë	Bun.Shpar	16	mbi 60	200	504732.7	4680048
9	Fushë Arrez	Bunge	16	mbi 60	200	505071.8	4677043
10	Pukë	Qarr	10	mbi 60	200	487149.7	4661840
11	Mirdite	Bunge	15	mbi 60	200	499494.8	4632488
12	Lezhe	Bunge	11	mbi 60	200	477414	4622229
13	Diber	Qarr	23	mbi 60	200	517553.8	4610490
14	Mat	Bunge	16	mbi 60	200	490774.8	4607871
15	Kurbin	Bunge	8	mbi 60	200	481857.7	4609788
16	Mat	Qarr,Shparth	22	mbi 60	200	500148.3	4602684
17	Tirane	Qarr,Bung	14	mbi 60	200	496751.1	4592649
18	Tirane	Qarr	21	mbi 60	200	499507.9	4570685
19	Skrapar	Bulger	19	mbi 60	200	527107.7	4473988
20	Kolonje	Bunge	12	mbi 60	200	543816.3	4456480

RAPORT I GJENDJES NË MJEDIS 2024

21	Vlore	Bung,Bullgr	19	mbi 60	200	462364	4451764
22	Gjirokaster	Bullgr.Bung	12	mbi 60	200	500239.8	4445514
23	Dropull	Bulger	14	mbi 60	200	529254.4	4442826
Totali			417		6000		

Rrjeti i monitorimit të llojeve drunore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukjeje

Nr	Lloji pyjor	Bashkia	Ekonomia Pyjore	(Y) KRGJSH	(X) KRGJSH
1	Rrobull	Bulqizë	Liqeni i Zi	516496.7657	4623080.057
2	Rrobull	Dibër	Lurë	516090.6832	4627912.76
3	Rrobull	Gramsh	Sogor, Mali i Gra bovës, Holtë- Lukovë	535100.6037	4517017.247
4	Arnen	Tropojë	Çerem Dragobi	499611.8609	4707052.441
5	Arnen	Dibër	Lurë	516309.878	4627554.39
6	Ilqe	Vlorë	Llogara	464131.9926	4454103.881
7	Rrenjë	Fier	Kunorë	458557.6222	4519940.772
8	Lajthi e egër	Korçë	Gollumbac	576071.187	4522980.443
9	Lajthi e egër	Has	Tej drini i bardhë	537194.4106	4668550.291
10	Lajthi e egër	Libohovë	Çajup	518520.4124	4451142.054
11	Caraca e Kaukazit	Pustec	Gollomboc	579182.4828	4525635.519
12	Venja	Libohovë	Çajup	516407.8476	4454560.885
13	Venja	Libohovë	Sheper	522844.8332	4452511.038
14	Drunakuqja	Përmet	Petran – Çarshovë, Petran- Zavalan	542988.8305	4445134.282
15	Drunakuqja	Përmet	Pagri	529435.9358	4466414.069

16	Drunakuqja	Përmet	Ali Bostivan	526229.3645	4463099.066
17	Mështekën	Dibër	Kastriot-Sillovë	537167.3949	4634178.103
18	Mështekën	Kukës	Shishtavec-Zapod	551274.1543	4648829.106
19	Gështenjë Kali	Librazhd	Stravaj	532322.5404	4540520.894
20	Gështenjë Kali	Tepelenë	Kurvelesh	496543.5272	4453623.03
21	Hartina	Gramsh	Sogore-Mali I Graboves	536734.6096	4517876.063
22	Valanidhi	Himare	Borsh	489616.5495	4434008.273
23	Valanidhi	Himare	Pilur	480790.6183	4440595.133
24	Tisi	Librazhdi	Shebenik	537652.5763	4571982.432

Rrjeti i monitorimit të bimëve aromatiko-mjeksore të kërcënuara dhe në rrezik zhdukje

Nr	Lloji	Bashkia	Ekonomia Pyjore	Y KRGJSH	X KRGJSH
1	Sherebel	Delvine	Muzine	517084.3761	4420415.059
2	Sherebel	Vlore	Llogara	465232.1555	4451295.415
3	Sherebel	Kolonje	Leskovik	552270.9011	4446946.191
4	Sherebel	Berat	Mali Partizan	495369.3802	4507370.924
5	Sherebel	Permet	Mali Miçanit	534092.6264	4475416.476
6	Sherebel	Poliçan	Terpan	502213.3475	4491420.72
7	Sherebel	Bulqize	Kraste Martanesh	515810.4544	4586628.278
8	Sherebel	Lezhe	Kallmet	473880.7686	4634419.815
9	Sherebel	Vlore	Llogara	464115.1941	4454052.247
10	Sherebel	Fush Arrze	Kryezi	504774.5955	4663318.622
11	Çaj mali	Pustec	Gollomboc	577129.9835	4514446.616
12	Salep	Pustec	Gorice	579289.6444	4525322.483
13	Çaj mali	Dropull	Dropull	515372.0295	4431858.752
14	Çaj mali	Kolonje	Gramoz	562415.317	4469393.462
15	Xhiroku	Kelcyre	Ballaban	518227.2411	4465594.738
16	Salep	Dures	Kepi Rodonit	454692.0787	4605356.962
17	Salep	Libohove	libohove	518193.5809	4447703.098
18	Boronice	Tropoje	Çerem	498701.1439	4708340.666
19	Boronice	Bulqize	Liqeni Zi	524867.9662	4591305.182
20	Boronice	Pogradec	Qaf Panje	544706.3752	4522442.293
21	Salep	Kukes	Novosej	548461.5196	4649297.909

22	Xhirokull	Kukes	Kroi Kuq	539694.9175	4651512.562
23	Boronice	Kukes	Samarthi	540346.7946	4650776.02
24	Boronice	Kukes	Stanet e Bicajve	539461.3752	4647899.264

Institucionet bashkëpunuese

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Agjencia Kombëtare e Ekonomisë të Mbetjeve
Agjencia Kombëtare e Pyjeve
Agjencia Kombëtare e Bregdetit
Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore
Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura
Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizime
Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
Agjencia Kombëtare e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve
Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Instituti i Shëndetit Publik
Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial
Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore
GIZ - Shoqëria Gjermane për Zhvillim